

ENVER HOXHA

VEPRA

63

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

**BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË
SHQIPËRISË**



ENVER HOXHA

**INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANE KQ TE PPSH**

ENVER HOXHA

V E L L I M I

63

DHJETOR 1977 – MARS 1978

**SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1988**

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 63-TË

Vëllimi i 63-të përmban materiale të periudhës dhjetor 1977 — mars 1978, një pjesë e të cilave botohen për herë të parë.

Në këtë periudhë vëmendja e Partisë dhe e masave punonjëse ishte përqendruar te mbyllja me sukses e planit të vitit 1977 dhe te puna që duhej bërë për realizimin ritmik të detyrave që në muajt e parë të vitit 1978. Përveç problemeve të zakonshme që nxirrte ecja jonë përpara, duheshin përballuar edhe vështirësitë e pengesat e krijuara nga imperialistët e revizionistët, të cilave po u shtoheshin edhe ato të revizionistëve kinezë, me mosrespektimin e marrëveshjeve të përfunduara me ta vite më parë.

Një sintezë e qartë e situatave që po kalonte vendi ynë, sidomos në fushën politike dhe ekonomike, jepet në fjalën e mbylljes të Plenumit të 4-t të KQ të PPSH më 31 janar 1978. Në këto kushte, theksonte shoku Enver Hoxha, diktohet nevoja që «zhvillimi ekonomik i vendit tonë të mbështetet tërësisht në forcat e veta».

Autori nuk kufizohet vetëm me dhënien e orientimeve të rëndësishme politike dhe teorike për kuptimin drejt e thellë të këtij parimi të madh, por hap horizonte të gjera, duke treguar konkretisht se ç'duhet bërë

për ta vënë në jetë. Para së gjithash mbështetja në forcat e veta nënkupton realizimin e tejkalimit e planeve dhe shtimit e rezervave të prodhimit. Për këtë, nënvizohet në vëllim, s'duhet të ketë as fjalë, as shfaqësime, por «mëndim të thellë, djersë dhe zbatim në kohë, në cilësi e në sasi, të detyrave dhe të bëjmë kursime kudo». Me argumente bindëse jepen edhe mundësitë reale për të përballuar të gjitha vështirësitë e pengesat, për të zgjidhur me sukses problemet e ndërlikuara që dilnin përpara Partisë. Krahas kësaj shtrohet si domosdoshmëri që, nga njëra anë, të luftohen shfaqjet e euforisë e të vetëkënaqësisë e, nga ana tjetër, të rrënjoset kudo besimi në forcat e veta, pa u tërhequr para vështirësive. Për këtë, — porosit autori, — «kërkohet nga të gjithë entuziazëm revolucionar, besim, studim, organizim, zbatim dhe kontroll i detyrave, kërkohet mobilizim i përgjithshëm i rezervave të brendshme dhe i mundësive tona».

Zhvillimi i pavarur i ekonomisë dhe realizimi me sukses i planit duke u mbështetur tërësisht në forcat e veta bënin shumë të nevojshëm thellimin e mëtejshëm të revolucionit tekniko-shkencor në të gjitha pjesët e tij përbërëse. Në shënimet e datës 20 janar 1978 theksohet: «Revolucioni tekniko-shkencor është zbatimi në mënyrë revolucionare i përvojës së përparuar teknike, në lidhje të ngushtë me diturinë shkencore, për të bërë ndryshime kualitative në procesin e prodhimit, që do të sjellin edhe automatizimin e shumë proceseve të punës». Njëherësh jepet edhe ideja se në kuadrin e revolucionit tekniko-shkencor nuk duhet menduar vetëm për gjëra të mëdha, por edhe për të vogla, të cilat gji-

thashtu kanë rëndësi, se për thellimin e këtij revolucioni kërkohen më pak bujë dhe më shumë punë, më pak teorizime dhe më shumë organizim.

Vend të rëndësishëm në materialet e këtij vëllimi zënë edhe problemet e bujqësisë. Veçoritë e këtij sektori diktojnë nevojën që mbarëvajtja e punëve të ndiqet gjatë gjithë vitit. Për këtë kërkohet të organizohet kontrolli i zbatimit të detyrave nga drejtuesit e ekonomive bujqësore dhe kuadrot, të cilët duhet ta kenë vazhdimisht në dorë situatën. Duke u ndalur konkretisht te disa mosrealizime të vitit 1977, autori shtron detyra për një punë më të kujdesshme lidhur me njohjen dhe përhapjen e përvojës së përparuar, duke e vlerësuar atë si një rezervë të madhe për ngritjen e rendimenteve dhe shtimin e prodhimit. Ai tërheq vëmendjen për të luftuar shfaqjet e njëanshmërisë që viheshin re në rrethet e në ekonomi të veçanta dhe porositi që bujqësia të shihet në një këndvështrim më të gjerë e jo duke neglizhuar këtë apo atë prodhim. Në këtë kuadër ai trajton edhe nevojën e zhvillimit të blegtorisë, kritikon mangësitë që vihen re dhe kërkon të punohet me ngulm për përmirësimin racor, për sigurimin e bazës ushqimore të bagëtive, për shtimin e prodhimeve blegtorale. Parulla «E gjithë toka është e bujqësisë, e gjithë toka është e blegtorisë» duhet të bëhet moto pune për çdo rreth e ekonomi, orienton autori. Gjatë bisedave me kuadro drejtues të Partisë e të pushtetit në rrethet apo me specialistë të bujqësisë shoku Enver Hoxha ndalet edhe në probleme konkrete që lidhen me këtë sektor, duke filluar që nga shfrytëzimi i hartave pedologjike e përmirësimi i sistemit të kullimit të tokave e deri te

kriteret që duhen ndjekur për të pasur sa më shumë tërfil e lakër foragjere.

Në situatat që qenë krijuar rëndësi të veçantë merrnin edhe shtimi i eksportit e pakësimi i importit. Ky problem, siç vihet në dukje në materiale të vëllimit, nuk ka të bëjë vetëm me Ministrinë e Tregtisë së Jashtme apo me ndërmmarrjet që varen prej saj, por edhe me gjithë të tjerët. «Armiqtë tanë imperialistë e revizionistë do të përpiqen që të na pengojnë me një mijë e një mënyra edhe në marrëdhëniet tregtare që kemi me ta, — theksohet në vëllim, — por edhe këto pengesa ne i kemi të gjitha mundësitë t'i kapërcejmë». Për t'ia arritur kësaj, shtrohej detyra që të dimë të bëjmë tregti, të jemi elastikë, të nuhatim e të shfrytëzojmë koniunkturat e tregjeve dhe të çmimeve sa më shumë në favorin tonë.

Ndër problemet e rëndësishme që trajtohen në këtë vëllim janë edhe ato ndërkombëtare, sidomos lufta kundër veprimtarisë hegjemoniste të dy superfuqive, si dhe përpjekjeve të Kinës për t'u bërë superfuqi. Ndonëse autori ka trajtuar edhe më parë aspekte të ndryshme të revolucionit kinez, në shënimet e këtij vëllimi, nëpërmjet argumenteve bindëse, sqarohet më tej se përse ai revolucion nuk mund të quhet socialist. Duke e krahasuar këtë edhe me revolucione të tjera të së kaluarës dhe duke analizuar në dritën e marksizëm-leninizmit forcat e tij lëvizëse, etapat në të cilat kaloi, programin maksimal e minimal, reformat që duhej ta pasonin etj., autori arrin në konkluzionin se kemi të bëjmë me një revolucion thjesht demokratiko-borgjez.

Shoku Enver Hoxha analizon, gjithashtu, situatat

politiko-ekonomike të një sërë vendesh të tjera të botës. Në shënimet «Ç'do të bëhet në Jugosllavi pas vdekjes së Titos» pasqyrohet gjendja e rëndë në këtë vend me një unitet fals, ku sundon një diktaturë shtypëse e reaksionare, një kaos i gjithanshëm. Me largpamësi, shoku Enver Hoxha parashikon se krizat në Jugosllavi do të thellohen edhe më shumë në fushën politike, ekonomike e shoqërore dhe kontradiktat do të acarohen më tepër në udhëheqje të Partisë e të shtetit e ndërmjet kombësive që përbëjnë federatën jugosllave. Në të njëjtën kohë, ai vë në dukje edhe përpjekjet e dy superfuqive për rritjen e influencës në këtë vend, që të mund të veprojnë atje me dorë të lirë dhe, në mos mundshin ta gllabërojnë gjithë Jugosllavinë, të paktën ta kthejnë atë në një satelit të vetin.

Materialet e përfshira në këtë vëllim, të cilat trajtojnë probleme të ndryshme që lidhen me udhëheqjen e Partisë, me gjallërimin e jetës së organizatave-bazë të saj e me shembullin pararojë të komunistëve, si garanci për çdo sukses, janë një pasuri në trashëgiminë e çmuar që na ka lënë udhëheqësi i paharruar i Partisë e i popullit tonë.

Vëllimi është i pajisur me tregues.

UNË RUAJ PËR SHKOLLËN TUAJ DHE TIMEN DASHURI E RESPEKT TË THELLË

*Letër drejtuar kolektivit të shkollës së mesme
të përgjithshme «Raqi Qirinxi» në Korçë*

1 dhjetor 1977

Të dashur pedagogë dhe nxënës,

Këto ditë ju festoni një nga ngjarjet e shënuara në vargun e gjithë ngjarjeve të tilla me karakter të theksuar patriotik e përparimtar që kanë ndodhur në historinë e lavdishme të popullit tonë patriot, të papërkultur, përparimtar, të etur e luftëtar në shekuj për dritë, dituri, arsim e kulturë — 60-vjetorin e themelimit të Liceut të Korçës, sot shkolla e mesme e përgjithshme «Raqi Qirinxi».

Ju falënderoj me gjithë zemër për ftesën që në këtë gëzim të përbashkët të merrja pjesë edhe unë, ish-nxënës dhe ish-mësues në atë lice dhe, së bashku, të vjetër e të rinj, të rikujtonim e të rijetonim ngjarjet e paharruara të atyre viteve, kur, tok me klasën punëto-re korçare dhe të edukuar prej saj, luftonim kundër

shtypjes, shfrytëzimit, obskurantizmit e paditurisë së regjimeve antipopullore, luftonim për liri, përparim shoqëror e dituri.

Të më falni që, me gjithë dëshirën e zjarhtë tuajën dhe timen, punët nuk më lejuan të ndodhem midis jush në këtë ditë të shënuar. Por unë kurdoherë ndjek me interes të veçantë dhe në çdo hap përparimet tuaja, punën e përpjekjet që bëni për të realizuar me ndërgjegje të lartë e me vetëmohim detyrat që ju ka ngarkuar Partia.

Unë ruaj për shkollën tuaj dhe timen, ashtu si për tërë popullin patriot, punëtor e përparimtar të Korçës, dashuri e respekt të thellë. Shpesh kujtoj shokët e shkollës e të luftës, mësuesit e nxënësit e mi, kujtoj gjithmonë ato ditë kur rinia hidhej në demonstrata dhe vër-sulej me trimëri mbi bajonetat e xhandarëve.

Liceu i Korçës është i njohur në gjithë vendin si një vatër e rëndësishme drite e përparimi. Shumë të rinj që ndiqnin atë shkollë, krahas historisë së lavdishme të popullit tonë, krahas asaj pune edukative që është bërë për edukimin e tyre me ndjenja patriotike dhe me urrejtje për shkaktarët e mjerimit e të paditurisë së masave popullore, janë njohur edhe me kulturën përparimtare frënge dhe me historinë e Revolucionit Francez që kanë ndikuar në edukimin revolucionar të të rinjve tanë. Por rrugën e sigurt të revolucionit, të dritës e të përparimit na e treguan vetëm idetë marksiste-leniniste që depërtuan në vendin tonë pas Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit dhe që u përhapën te ne nga komunistët shqiptarë. Veçanërisht Grupi Komunist i

Korçës, duke ushqyer me këto ide punëtorinë korçare, i futi ato edhe në mendjen e zemrat e të rinjve liceistë. Bindjet e mia si revolucionar komunist u formuan dhe u kristalizuan pikërisht në masën e klasës punëtore e të komunistëve korçarë. Në rrugët e Korçës, në ndeshje me forcat e errëta të regjimit zogist, në të rinjtë e liceut, në shembullin e klasës punëtore, vumë për herë të parë në provën e zjarrit aspiratat dhe idetë tona revolucionare, të cilat do të merrnin flakë, që nuk shuhën kurrë, me themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Themelimi i Liceut të Korçës 60 vjet më parë ishte rezultat i drejtpërdrejtë i dëshirës së madhe dhe i përpjekjeve të gjithanshme të popullit tonë për arsim e dije, ishte vazhdim i luftës prej shumë dekadash të popullit patriot e përparimtar të Korçës për gjuhën e shkollën shqipe, që poeti i madh i Rilindjes Kombëtare, Naim Frashëri, e pati përshëndetur në vargje me ndjenjat më të pastra të mirënjohjes:

*Lumja ti, moj Korçë, o lule,
Q'i le pas shoqet e tua,
Si trimi në ballë u sule,
Ta paçim përjetë hua!*

Për të realizuar këto dëshira dhe aspirata në krahi-nën e Korçës punuan e luftuan, me pushkë e me penë, patriotët e shquar të çështjes kombëtare si Naum Veqilharxhi, Petro Nini Luarasi, Papa Kristo Negovani, Thimi Mitko, Pandeli Sotiri, Themistokli Gërmenji, Spiro

Bellkameni, Mihal Grameno, Asdreni dhe shumë të tjerë. Për arsimin e kulturën kombëtare shkrinë forcat e tyre fizike e mendore mësuesit e vjetër të liceut si Sotir Papakristo, Kostaq Cipo, Vangjush Mio e të tjerë, për veprën kulturore e patriotike të të cilëve kam një respekt të thellë.

Më vonë, me formimin e Partisë Komuniste, këto përpjekje do të merrnin një zhvillim të paparë. Veprimtaria revolucionare e Partisë me nxënësit e me mësuesit e liceut e shndërruan këtë shkollë në një vatër të zjarrtë të lëvizjes patriotike, përparimtare, punëtore e komuniste, në një kështjellë të pamposhtur të Partisë, ku iu bë jehonë e fuqishme ideve e thirrjes së saj për luftë të armatosur kundër pushtuesve e tradhtarëve për çlirim e përparim kombëtar e shoqëror.

Në ditët e errëta të agresionit e të pushtimit fashist rinia e Liceut të Korçës, me një frymë të lartë atdhedashurie e guximi revolucionar, mori pjesë aktive në protestat, demonstratat dhe ndeshjet me armikun. Një shumicë ish-nxënësish të kësaj shkolle, bashkë me punëtorë e patriotë të tjerë antifashistë, u përleshën ditën e 8 Nëntorit në rrugët e Korçës, përleshje në të cilën dha jetën komunisti sypatrembur Koci Bako, vepra heroike e të cilit u bë shembull i lartë frymëzimi për rininë e liceut si për gjithë rininë e vendit tonë.

Nga gjiri i të rinjve të liceut dolën shumë komunistë të orëve të para, propagandues të flaktë të ideve komuniste dhe luftëtarë shembullorë. Me qindra nxënës të liceut, duke iu përgjigjur thirrjes së Partisë, i dolën zot atdheut me armë në dorë. Shumë prej tyre

u vunë në krye të reparteve partizane dhe i udhëhoqën ato në luftëra e beteja të lavdishme. Dashuria e lidhjet e çelikta të rinisë së Liceut të Korçës me atdheun, popullin e Partinë u çimentuan me gjak. Me dhjetëra e dhjetëra ish-nxënës e mësues të tij dhanë jetën për lirinë e atdheut, për realizimin e aspiratave të popullit, të klasës punëtore, për idealet e komunizmit, si heronjtë e popullit Musa Fratari, Fuat Babani e Dino Kalenja, komunistët e dëshmorët Raqi Qirinxhi, Vaskë Dushku, Xhafer Cenko Lubonja, Ptoleme Xhuvani, Floresha Myteveli, Sedat Babani e shumë të tjerë. Në Liceun e Korçës mësuan gjatë këtyre dekadave shumë kuadro që sot punojnë në organet e Partisë e të pushtetit popullor, shumë të tjerë të talentuar e të devotshëm në sektorët e shkencës, të ekonomisë, të ushtrisë, të arsimit e të kulturës sonë socialiste, ku punojnë me patriotizëm e partishmëri të lartë për zhvillimin e mbrojtjen e atdheut, për begatinë e lumturinë e popullit.

Korça është bërë sot një qendër e madhe dhe e rëndësishme ekonomike, industriale, bujqësore dhe me një kulturë të zhvilluar e të përparuar, që zë një vend nderi në atdheun tonë socialist. Krahas këtij zhvillimi ka ecur edhe shkolla e mesme «Raqi Qirinxhi», në bazë të orientimeve e të direktivave të Partisë dhe në luftë për vënien e tyre në jetë. Në këtë rrugë të shkëlqyer ajo ka arritur suksese të mëdha në tërë punën që bëjnë edhe tani nxënës e mësues për zbatimin e vendimeve të Kongresit të 7-të të Partisë dhe të Plenumit të 8-të të Komitetit Qendror të saj të vitit 1969.

Por stadi i zhvillimit në të cilin kalojmë dhe ai pers-

pektiv kanë nxjerrë përpara shkollës sonë detyra të reja më të mëdha, për të përgatitur nxënës të zotë e punonjës të nesërm sa më të formuar politikisht e ideologjikisht, të edukuar e të kalitur me mësimet e marksizëm-leninizmit e të Partisë sonë, të pajisur me horizont sa më të gjerë kulturor e me dije të thella shkencore, të edukuar nëpërmjet mësimet, punës e në zjarrin e luftës klasore me frymën, moralin e disiplinën e klasës punëtore, të përgatitur për jetën e të ndërgegjegjshëm për të vënë të gjitha forcat fizike e mendore në shërbim të popullit, të atdheut e të revolucionit, të gatshëm për të punuar atje ku ka nevojë atdheu dhe të aftë për të mbajtur mbi shpatulla e për të realizuar detyra të mëdha në frontet e ndryshme të ndërtimit socialist e të mbrojtjes.

Partia dhe populli kanë besim se, ashtu si deri më sot, edhe në të ardhmen, ju, nxënës e mësues të shkollës së mesme «Raqi Qirinxhi», do t'i shtoni përpjekjet e përbashkëta dhe, duke realizuar si duhet tre komponentët: mësim, punë prodhuese, kalitje fizike e përgatitje ushtarake, do t'u përgjigjeni këtyre kërkesave të kohës. Ata kanë besim se ju, duke zbatuar vijën e orientimet e Partisë, duke jetuar aktivisht me situatat që kalojmë e me problemet që nxjerr jeta, duke punuar, luftuar e jetuar me frymë të lartë revolucionare si në rrethim, duke mësuar kurdoherë nga klasa punëtore e nga populli, duke marrë pjesë gjallërisht në luftën klasore, në luftën kundër imperializmit e socialimperializmit, revizionizmit e oportunitizmit të çdo ngjyre, kundër çdo ndikimi e shfaqjeje të huaj dhe qëndrimi liberal ndaj

tyre, do të realizoni gjithnjë e më mirë detyrat e rëndësishme e me shumë përgjegjësi që keni përpara. .

Përshëndetje të përzemërta

Juaji

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Përpara», nr. 98
(1107), 7 dhjetor 1977*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Letra të zgjedhura», vëll. I, f. 367*

PËR GJENDJEN AKTUALE NË SPANJË

Shënime

2 dhjetor 1977

Dje më raportoi shoku Ramiz për bisedën që pati me sekretarin e KQ të Partisë Komuniste të Spanjës (marksiste-leniniste) dhe me katër shokët e tjerë spanjollë që kanë ardhur me të. Situata në Spanjë është optimiste për sa i përket punës së partisë, por për sa i përket gjendjes, kjo është kaotike, ka papunësi të madhe, ekonomia është në hall të madh.

Në Spanjë ka afro 200 parti të ndryshme. Me fjalë të tjera, borgjezia kapitaliste spanjolle që është në fuqi, kërkon ta hallakatë opinionin publik në Spanjë, të krijojë konfuzion dhe të konsolidojë pozitat e saj.

Në bazë të raportit që më bëri Ramizi, i dhashë disa mendime që mund t'i ketë parasysh kur të bisedojë përsëri me shokët spanjollë. Rëndësi për Partinë Komuniste të Spanjës (marksiste-leniniste) ka konsolidimi i saj nëpërmjet shtimit të radhëve me elementë të klasës punëtore, por edhe me fshatarë. Natyrisht, në radhë të parë me klasën punëtore, por nuk duhet harruar fshatarësinë, sepse gjendja e saj në Spanjë është shumë e mjeruar dhe mundësitë e punës së partisë në radhët

e fshatarësisë janë të mëdha. Prandaj një organizim i fortë dhe një drejtim i mirë i punëve mund ta konsolidojnë aleancën në mes klasës punëtore dhe fshatarësisë, pa harruar inteligjencien, sidomos studentët, të cilët nëpër qytete janë mjaft revolucionarë.

Rëndësi, më duket mua, për Partinë Komuniste të Spanjës (marksiste-leniniste), ka çështja që ajo të kuptojë qartë situatat në vendin e vet. Për këtë është e nevojshme të bëjë një analizë të thellë të gjendjes, të forcave në lëvizje, të korrenteve politike dhe këndej të nxjerrë konkluzione për punën e saj. Ka rëndësi të kuptohet se Spanja aktualisht po kalon një fazë tranzitore, për arsye se del nga një regjim fashist frankist për të kaluar në një regjim demokratiko-borgjez më liberal, sido që në këtë periudhë tranzicioni forcat fashiste në Spanjë janë akoma të pashkallmuara. Megjithatë kalimi nga frankizmi në situatën aktuale ka krijuar disa mundësi të reja, të cilat mendoj se duhen studiuar dhe duhen shfrytëzuar nga Partia Komuniste e Spanjës (marksiste-leniniste).

Vetë fakti që atje u legalizua partia revizioniste e Karriljos dhe e Ibarrurit, fakti që gjithë të emigruarit e Luftës së Spanjës u kthyen, fakti që janë krijuar mundësi për Partinë Komuniste të Spanjës (marksiste-leniniste) që të zhvillojë propagandën e vet nëpërmjet një shtypi legal etj., tregon se atje ka njëfarë liberalizmi demokratik. Ky liberalizëm nga ana e regjimit bëhet që kapitali spanjoll të fitojë kohë për konsolidimin e pozitave të tij, të forcojë pozitën e demokracisë borgjeze kapitaliste spanjolle.

Spanja po bën përpjekje dhe më duket se u fut në

«Evropën e Bashkuar». Po ashtu ajo do të bëjë përpjekje, në qoftë se nuk është futur dot akoma, për të hyrë edhe në Tregun e Përbashkët Evropian, domethënë do të lidhet me vendet e tjera kapitaliste të Evropës Perëndimore. Në Spanjë ekzistojnë baza ushtarake amerikane, natyrisht janë bërë edhe investime kapitaliste amerikane, ekzistojnë, me siguri, edhe investime gjermanoperëndimore, franceze etj.

Sidoqoftë, atje ka papunësi e probleme. Sipas të dhënave vetëm 20 për qind e klasës punëtore spanjolle është e inkuadruar në sindikatat dhe kjo është e kuptueshme, për arsye se nën frankizmin nuk ekzistonte asnjëfarë lirie demokratike, klasa punëtore ishte e shtypur, e paorganizuar dhe ato pak sindikata që mund të ekzistonin, ishin organizata nën drejtimin e fashizmit. Kështu që në këtë *decalage*, në këtë shkarje nga frankizmi në qeverinë aktuale të Spanjës, pjesa më e madhe e punëtorëve ndodhen të paorganizuar.

Kjo është një çështje me shumë rëndësi, më duket mua, për Partinë Komuniste të Spanjës (marksiste-leniniste), pse këtu ka një fushë të gjerë pune dhe organizimi. Objektivi i Partisë Komuniste të Spanjës (marksiste-leniniste), sipas mendimit tim, është që të gjejë format, mënyrat, stilin dhe metodën e punës që ta organizojë këtë 80 për qind të klasës punëtore të paorganizuar, ta ngrejë politikisht dhe ta sqarojë ideologjikisht, që punëtorët të mos inkuadrohen në atë zinxhir të zakonshëm me të cilin borgjezia kapitaliste i ka lidhur punëtorët, si për shembull, në Itali e në Francë, sepse ashtu si në vendet e tjera të «Evropës së Bashkuar», edhe në Spanjë borgjezia do të përpiqet të kri-

jojë ato forma sindikale të lidhura me patronatin, në mënyrë që klasa punëtore të mos lëvizë ose të lëvizë me zor për të drejta politike dhe ekonomike. Kjo është, pra, një çështje themelore, që vetëm shokët spanjollë mund ta sqarojnë si duhet dhe ata vetë mund të gjejnë format dhe mënyrat e bashkimit të punëtorëve në të tillë organizma që të jenë të lirë, të pavarur; por, njëkohësisht, t'i imponojnë kapitalit pikëpamjet e tyre politike, organizative dhe ekonomike dhe të mos e lënë ta tërheqë klasën punëtore nga hunda. Për këtë arsye shokët spanjollë mendoj se do të gjejnë edhe mënyrat e organizimit, ku klasa punëtore të ndiejë forcën e saj, vetë punëtorët ta ndiejnë ndihmën kolegjiale dhe të mos e ndiejnë veten në vetmi.

Natyrisht, shokët tanë në Spanjë do të ndeshin në një forcë kolosale që do ta kundërshtojë këtë veprimtari të tyre politike, ideologjike dhe organizative, por do të përpiqen të çajnë, vetëm se duhen gjetur mënyrat më të përshtatshme që t'i pëlqejë klasa punëtore. Se si e qysh do të veprojnë, është e zorshme të japim një mendim të saktë. Zgjidhja, mendoj unë, duhet të gjenet në vend nga vetë shokët spanjollë.

Çështje tjetër atje është krijimi i frontit kundër borgjezisë kapitaliste, kundër imperializmit amerikan, kundër socialimperializmit sovjetik, kundër partisë revizioniste të Karriljo-Ibarrurit, të ndonjë partie tjetër revizioniste prokineze, kundër partive të kapitalit. Për arritjen e një rezultati të tillë janë të përshtatshme kushtet objektive dhe subjektive. Partia Komuniste e Spanjës (marksiste-leniniste) ka nevojë të studiojë gjendjen në përgjithësi dhe orientimet e ndryshme të të gjitha

këtyre grupimeve që quhen parti dhe që, kush më shumë e kush më pak, kanë influencë në popull. Është mirë që shokët spanjollë të zgjedhin për këtë qëllim ato parti që janë më afër tyre ose që kanë disa pika të përbashkëta politike dhe lufte me partinë e tyre marksiste-leniniste e me to të bashkëpunojnë brenda në një front me një program më të gjerë, ku të grumbullohen masat e popullit, të qytetit dhe të fshatit.

Gjendja në Spanjë nuk mund të zhvillohet siç është zhvilluar te ne. Vetë kushtet nuk e lejojnë atje këtë dhe zhvillimi i këtij vendi tregon se atje do të ekzistojnë shumë parti me programe të ndryshme dhe me qëllime të ndryshme. Çështja qëndron në atë që Partia Komuniste e Spanjës (marksiste-leniniste) të forcohet, të forcojë bazën dhe të rrezatojë politikën e saj të drejtë në masat dhe në partitë e ndryshme. Vetëm autoriteti i saj politik, ideologjik dhe organizativ, fryma e saj revolucionare mund dhe duhet të ngjallin respektin për të dhe të bëjnë që të krijohet ajo situatë që të tjerët ta dëgjojnë, t'i kenë sytë tek ajo e të bashkohen me veprimet e saj.

Për Partinë Komuniste të Spanjës (marksiste-leniniste) kanë rëndësi zbatimi i një vije të drejtë, forcimi i organizimit, i unitetit të mendimit dhe të veprimit, zbatimi i normave leniniste brenda në parti. Me një vijë politike, ideologjike dhe lufte të përcaktuar mirë e drejt, që të përfaqësojë dhe të ndjellë masat e gjera të popullit, punëtorët, fshatarët, intelektualët, në forma të ndryshme dhe në organizime të ndryshme, partia, në qoftë se nuk arrin të udhëheqë vetëm, do të mund të krijojë një bashkëpunim të shëndoshë me forcat e tjera

demokratike dhe revolucionare. Partia lufton për të fituar kohën e humbur dhe për të krijuar atë situatë të shëndoshë që dëshirohet, pse edhe borgjezia kapitaliste punon dhe ka forca të mëdha për të na luftuar ne dhe për të organizuar punën në drejtimet e saj. Prandaj në këtë situatë nga ana e partisë kërkohet një qartësi e madhe politike, një *souplesse*¹ në veprime.

Partia Komuniste e Spanjës (marksiste-leniniste) ka mundësi të përvetësojë traditën e vjetër revolucionare marksiste-leniniste të partisë të kohës së Luftës së Spanjës, larg çdo sektarizmi ose liberalizmi oportunist. Ajo të luftojë pa mëshirë udhëheqjen aktuale të Karriljo-Ibarrurit ose tendencat e njëfarë Listeri ose të ndonjë udhëheqësi tjetër revizionist të Partisë ish-Komuniste të Spanjës, që udhëhoqi luftën spanjolle. Partia Komuniste e Spanjës (marksiste-leniniste) nuk hedh poshtë në bllok gjithë atë traditë të shkëlqyer lufte, sakrifice, heroizmi dhe drejtësie në vijë, po jo vetëm si traditë; ekziston mundësia që ajo të kapet edhe në njerëzit, pse ka shumë nga ata që aktualisht e kanë braktisur partinë e Karriljo-Ibarrurit, e cila kërkon të quhet si vazhduesja e Partisë Komuniste të Spanjës të kohës së luftës. Mund të ketë prej tyre që janë dëshpëruar nga reneгатët spanjollë, por nuk e kanë humbur besimin as te komunizmi, as te revolucioni. Prandaj janë të nevojshme përpjekjet për të vendosur lidhje me elementë të vjetër të luftës, me familjet e tyre, sidomos në ato vende, në ato qytete dhe në ato krahina, ku akoma janë të gjalla Lufta e Spanjës, sakrificat e popullit në këtë

1. Frëngjisht — zhdërvjelltësi.

luftë. Partia Komuniste e Spanjës (marksiste-leniniste), duke punuar me këta njerëz, me familjet e me farefisnin e tyre, tregon se traditat revolucionare marksiste-leniniste të Partisë Komuniste të Spanjës, të Luftës heroike të Spanjës, nuk kanë vdekur, por janë gjallë dhe flamuri i tyre është ngritur nga Partia Komuniste e Spanjës (marksiste-leniniste). Kjo ka rëndësi të madhe, pse në këtë drejtim Karriljo-Ibarruri përpiqen t'i gënjejnë njerëzit dhe t'i grumbullojnë rreth vetes në partinë e tyre të ashtuquajtur komuniste, por që tash Karriljoja ia ndërroi edhe emrin dhe e quan vetëm «marksiste».

Duke gjykuar nga këto drejtime, mund të themi se gjendja e Spanjës ndryshon nga ajo e vendeve të tjera kapitaliste të Evropës Perëndimore. Në këto vende çështja qëndron ndryshe, partitë e borgjezisë janë të koncentruara, janë të vjetra, kanë programet e tyre, kanë baza të forta ekonomike dhe lidhje të ngushta me shtetin kapitalist e me konsorciumet e huaja kapitaliste. Gjithashtu këto parti të kapitalit, si në Francë, në Itali, në Belgjikë, në Holandë, në Angli etj., kanë formuar organizatat e klasës punëtore, sindikatat, dhe i kanë grumbulluar gati të gjithë punëtorët në to, duke i lidhur me një mijë e një fije. Në këto sindikata partitë e kapitalit, pra vetë patronati, bëjnë ligjin dhe pengojnë çdo aktivitet revolucionar politik dhe kërkesat ekonomike të klasës punëtore. Kurse në Spanjë, me daljen nga frankizmi, akoma nuk janë konsoliduar pozitat e borgjezisë si në vendet e Evropës Perëndimore, që përmenda, prandaj ka edhe një fushë të gjerë pune për Partinë Komuniste të Spanjës (marksiste-leniniste), që

me një vijë të menduar mirë dhe me metoda të shkathëta të punës së saj, të përfitojë nga situatat për të hedhur baza të shëndosha veprimi e lufte.

Marrë nga libri:

Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 9, f. 836

EMANCIPIMI I GRUAS DHE SHKRIMTARËT SOCIOLOGË E FILOZOFË TË SHEKUJVE TË KALUAR

Shënime

3 dhjetor 1977

Duke parë ndryshimet kolosale në vendin tonë, midis të cilave përparimin, zhvillimin dhe emancipimin e gruas, nuk mund të mos sjell ndër mend ato mendime e qëndrime të njerëzve të shquar të letërsisë dhe të arteve të shekullit të 17-të e të shekullit të 18-të për gruan, sidomos në Francë.

Është e çuditshme, por Molieri¹, Bualoi², Fenëloni³, Rasini⁴ dhe La Bryjeri⁵ flasin, në veprat e tyre, me ironi të egër, kundër lirisë së grave, kundër kulturës për to. Është e çuditshme që këta njerëz të shquar gruan e shtynin të rrinte brenda katër mureve të shtëpisë.

1. Zhan-Baptist Pokëlen, i quajtur Molier (1622-1673), dramaturg francez.

2. Nikola Bualo (1636-1711), shkrimtar francez.

3. Fransua de Salinjak de la Mot (1651-1715), shkrimtar francez

4. Zhan Rasin (1639-1699), dramaturg francez.

5. Zhan de la Bryjer (1645-1696), shkrimtar francez.

Molieri vetë kishte urrejtje dhe i kritikonte gratë. Ai thoshte se nuk u duhet dhënë shkencë grave. Fenëloni ka bërë një libër, të cilin e kam lexuar dhe më kujtohet edhe titulli i tij «Traktat për edukimin e vajzave». Këtë e ka botuar në vitin 1688. Në këtë libër ai shpreh pikëpamjen se nuk duhen lejuar gratë të shkollohen, se bëhen qesharake, mbasi nga natyra e tyre ato kanë mendje të dobët, shumë më të dobët se burrat, dhe vetëm kurioziteti ekziston në to. Gratë, sipas Fenëlonit, nuk duhet të qeverisin në shtet, nuk duhet të marrin pjesë në luftë etj., etj.

Pra, në shekullin e 17-të, sidomos gjatë regjimit të Luigjit të 14-të, shkopi u ngrit i fortë kundër grave, u ekzaltuan kulti i familjes dhe kulti i burrit mbi gruan. Kurse në «L'esprit des lois» të Monteskjës¹ më kujtohet se denoncohet shtypja që u bëhet grave. Ky, Monteskjëja, ishte për edukimin e grave. «Autoriteti që ushtrojmë ne mbi gratë është një tirani e vërtetë», thoshte ai, prandaj duhet ta zhdukim këtë tirani nga gjysma e popullsisë së Francës. Ky mendimtar i shquar arsyeton drejt se mendimi i grave, po të zhvillohet, është po aq i lartë sa edhe mendimi i burrave. Edhe forca e tyre mund të jetë e barabartë me atë të burrave, në qoftë se ne u japim atyre edukatën e duhur.

Kurse d'Alamberit², që ishte një matematikan i famshëm në të gjithë Evropën, i vinte shumë keq që gratë trajtoheshin në një mënyrë kaq përbuzëse në shekullin

1. Charl Monteskjë (1689-1755), historian dhe shkrimtar francez, ideolog i monarkisë konstitucionale.

2. Zhan lë Rond d'Alamber (1717-1783), shkrimtar, filozof dhe matematikan francez.

e tij dhe ai shkruante një letër, ku kritikon qëndrimin jo të drejtë që mbahet ndaj tyre. Në këtë letër d'Alambëri shprehet në mbrojtje të grave dhe kërkon të bëhet çdo përpjekje që të mos përfitohet nga ato në mënyrë të padrejtë.

Çuditësh kur shikon në enciklopedinë e madhe, që publikohej nga Didëroi¹, se ndaj gruas ndiqet rruga tradicionale, mbrohen burrat dhe ushtrohet diskriminim ndaj grave. Në enciklopedinë e madhe ka fraza të tilla, si «natyra u ka dhënë burrave të drejtën të qeverisin», përmendet Sofokliu², i cili ka thënë se «heshtja është stolia më e madhe e grave» etj.

Këto janë afirmacione arbitrare. Në shekullin që e kanë quajtur «shekulli i arsyes së njerëzve» siç ishte shekulli i enciklopedistëve³, vetëm këta njerëz të shquar nuk marrin të paktën mundimin të diskutojnë si duhet për këtë problem kaq të madh, siç është problemi i gruas.

Kam përpara një libër që citon një letër të shkruar nga Didëroi, në të cilën bëhet fjalë për kushtet e gruas. Në të thuhet: «Kur shkruan për gratë, duhet ta ngjyesh penën në ylber dhe të hedhësh në letër pudrën me krahë prej fluturë». Kurse Volteri⁴ në librin e tij «L'essai sur les mœurs» ka disa qëndrime më të mira për gratë. Por për çudi Rusoi ka qenë lideri më i shquar në

1. Deni Didëro (1713-1784), shkrimtar dhe filozof francez.

2. Poet grek (495-406 para erës së re).

3. Kështu quheshin dijetarët, filozofët dhe specialistët e të gjitha disiplinave, që bashkëpunuan për redaktimin e Enciklopedisë së madhe Franceze në shekullin e 18-të.

4. Fransua Marl Aruë, i quajtur Volter (1694-1778), filozof, shkrimtar, historian dhe iluminist francez.

luftën kundër grave në shekullin e 18-të dhe pikëpamjet e tij kundër grave deri në njëfarë shkalle, kanë influencuar edhe te Robespieri¹, për të mos folur për Napoleonin.

Rusoi qëndroi kristian në kundërshtim me Volterin, me Didëronë, me Kondorsenë². Ky i fundit ishte një djallë me baba të panjohur, por një mbrojtës i zjarrtë i çështjes së gruas. Kurse Rusoi me pikëpamjet e tij u ngjiste priftërinjve të kishës, skolastikës dhe i quante gratë shkaktare të degjenerimit të racës njerëzore. Ai për Sofinë, të shoqen e Emilit, në librin e tij të famshëm «Kontrata shoqërore», përjashtonte çdo edukatë që duhej të merrte ajo. As gjuhët, as teologjia, as historia nuk mund të jenë të nevojshme, përkundrazi, ato mund t'i bëjnë dëm gruas, thoshte ai. Gruaja, domethënë Sofia, për Rusonë nuk duhet të njohë veçse kuzhinën, të dijë të qepë dhe të mësojë të flasë me njerëzit që takon. Dinjiteti i saj, thotë Rusoi, është të jetojë e harruar, të mos e shohë njeri dhe ajo të rrojë vetëm për çmimin që mund t'i japë burri, Emilit. Burrat, thotë Rusoi, janë për jashtë, gratë janë për brenda. Ky është ligji i natyrës, sipas tij. Gjatë ditës të dy sekset s'kanë asgjë të përbashkët, përveç ushqimit.

Siç e shohim, idetë e Rusoit u përngjasin shumë ideve të myslimanizmit, që gruan e konsideron vetëm si një shërbëtoreshë në shtëpi, si një mjet për të lindur dhe për të rritur fëmijë, kurse të gjitha punët jashtë, gjithë

1. Maksimilian dë Robespier (1758-1794), politikan francez, një nga udhëheqësit e jakobinëve.

2. Marl Zhan Antuan dë Karita Kondorse (1743-1794), matematikan, filozof, ekonomist dhe politikan francez.

autoritetin, mendimet duhet t'i ketë burri në duart e tij.

Duhen lexuar me kujdes këta shkrimtarë, sociologë dhe filozofë të shëkujve të kaluar, për të parë se ç'pikëpamje retrograde, obskurantiste kanë pasur ata në dësa çështje të rëndësishme ose kyç për shoqërinë, pavarësisht se në shumë probleme të tjera ishin në pararojë. Kur flasim për enciklopedistët, natyrisht, kemi parasysh që ata janë në pararojë të shekullit të iluminizmit, por, kur i studiojmë veprat e tyre mirë e me kujdes, ne gjejmë në to mendime jo të përshtatshme për gruan dhe jorevolucionare në atë shkallë siç i kishin ata mendimet për çështjen e lirisë, për luftën kundër monarkisë etj. Kur lexon veprat e tyre, shikon se flitet për lirinë, por për lirinë e burrave dhe jo për lirinë e grave, flitet për barazinë, por për barazinë në mes burrave, jo edhe për barazinë në mes burrit dhe gruas. Ata flitnin për të drejtat e njeriut, por me këtë kuptonin të drejtat e burrave në shoqërinë me klasa e jo edhe të drejtat e grave. Këtë e them në përgjithësi, sepse në mes tyre kishte edhe burra, edhe gra, edhe shkrimtarë, edhe filozofë që shquheshin në mbrojtjen e të drejtave, të lirisë dhe të edukimit të grave.

Pikëpamje të tilla të prapambetura të shëkujve të 17-të, të 18-të e të 19-të ekzistojnë në vendet kapitaliste edhe aktualisht, në shekullin e 20-të, në shekullin e atomit. Deri dje në Zvicër, që hiqet si një vend nga më të përparuarit dhe nga më demokratët në botë, gratë nuk kishin të drejtën e votës. Në Angli gratë nuk kishin, gjithashtu, të drejtën e votës dhe kanë luftuar shumë për ta fituar këtë të drejtë. Të mos flasim pastaj në përgjithësi për të drejtat e tjera të grave në shoqërinë

borgjeze kapitaliste, ku ato janë të shtypura e të shfrytëzuara. Gruaja edhe sot konsiderohet nga borgjezia kapitaliste si një krijesë më e ulët nga burri, pikërisht ashtu siç e konsideronte kisha, siç e konsideronte borgjezia e shekullit të 18-të e të 19-të, për të mos folur për shekujt e tjerë të mëparshëm.

Emancipimi i gruas në vendet kapitaliste as që mund të krahasohet me emancipimin e vërtetë të gruas në vendin tonë socialist. Në këtë drejtim nuk mund të bëhet asnjë barazim.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Për shkencën» (Përmbledhje
veprash), vëll. II, f. 93*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Për shkencën»
(Përmbledhje veprash), vëll. II,
f. 93*

Ç'DO TË BËHET NË JUGOSLLAVI PAS VDEKJES SË TITOS

Shënime

3 dhjetor 1977

Ky është një problem me shumë pikëpyetje, por në përgjithësi mendojmë se, pas vdekjes së Titos, gjendja nuk do të jetë e qetë në Jugosllavi, do të ketë turbullira dhe do të duhet një kohë mjaft e gjatë për stabilizimin e situatës. Ujku plak jugosllav, renegati e tradhtari i marksizëm-leninizmit dhe i popujve të Jugosllavisë, e hëngri çairin, por Jugosllavinë e ka varur plotësisht në qafën e ujkut, ose më mirë të themi në qafë të ujqve dhe do ta lërë në kaos, pse në këtë vend kanë futur thonjtë imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe të gjitha shtetet kapitaliste të botës.

Titoja mund të vihet në një pedestal të historisë për të përfaqësuar udhëheqësin e një shteti, i cili me vetëdije dhe në mënyrë sistematike shiti lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e popujve të Jugosllavisë tek të huajt. Atij mund t'i ngrihet një monument për të karakterizuar aventurierin e të gjitha intrigave, kallëpve, mashtrimeve, tradhtive, fjalëve boshe, teorive reaksio-

nare dhe nënshtrimit ndaj të huajve në formën gjoja të një politikani parimor.

Ky renegat i marksizëm-leninizmit asnjëherë nuk ka qenë parimor, asnjëherë nuk ka pasur një pikëpamje të qëndrueshme politike. Pikëpamjet e tij politike kanë qenë kaotike, por ai ka një zotësi dhe është mjeshtër për t'iu adaptuar shumë bukur rrethanave, koniunktura-ve, ka ditur të diktojë prirjet dhe qëllimet e imperializmit amerikan, të socialimperializmit sovjetik e të fuqive të tjera të kapitalit ndërkombëtar dhe të manovrojë. Kjo nuk do të thotë se përkrahësit ose skllavëruesit e tij dhe të popullit të tij nuk e kanë kuptuar personalitetin e këtij njeriu të çuditshëm. Por ky personalitet u ka hyrë atyre në punë, u është dashur për ta përdorur si domos kundër Bashkimit Sovjetik të Leninit e të Stalinit, kundër komunizmit, kundër socializmit, kundër shteteve që u çliruan, duke luftuar në këtë drejtim që gjatë Luftës së Dytë Botërore, me qëllim që këto shtete, me intrigat e tij, të mund t'i shkëpuste nga Bashkimi Sovjetik dhe t'i hidhte, siç e hodhi Jugosllavinë, në kthe-trat e imperializmit amerikan e të borgjezisë reaksionare evropiane. Pra, ky njeri vepronte me ndërgjegje të plotë, dhe ata që e drejtonin, e udhëzonin, e ndihmonin dhe e nxitnin me ndërgjegje të plotë në veprimet e tij.

Është e qartë se, sado që përpiqeshin imperializmi amerikan dhe borgjezia reaksionare botërore të fshihnin gishtin e tyre kur lëviznin këtë marionetë, ishte e pamundur që ky gisht të mos dukej sa një krah, për arsye se Jugosllavia u katandis në një vend me një unitet fals. Po pikërisht borgjezisë reaksionare, kapitalit ndërkombëtar dhe imperializmit amerikan u interesonte që Ju-

gosllavia, nën Titon dhe nën titizmin, të ekzistonte si republikë federative, pavarësisht se ky regjim krijonte dhe thellonte kontradiktat në mes republikave të ndryshme që e përbënin, me një fjalë, midis popullsive të ndryshme të këtij vendi. Zaten një politikë e tillë e hallakatjes, e shpërndarjes së kontradiktave u intereson imperia-lizmit amerikan dhe borgjezisë kapitaliste ndërkombëtare, pse parulla e tyre ka qenë dhe është kurdoherë «përçaj e sundo», mjafton që pushteti federal, pushteti kryesor të ishte në shërbim të plotë të tyre. Ky pushtet duhej të përfaqësonte atë diktaturë fashiste, shtypëse, reaksionare që, duke i mbajtur nën thundër e nën terror popujt e Jugosllavisë, të krijonte bindjen tek imperia-lizmi amerikan dhe te borgjezia ndërkombëtare se regjimi titist ishte një regjim që e shndërronte Jugosllavinë në një vend kapitalist, sepse zhvillonte pronën private, tregtinë private, mbronte interesin privat në kurriz të interesit të përgjithshëm e të socializmit.

Me fjalë të tjera, imperializmi amerikan dhe të gjithë ata që financuan regjimin e Titos u përpoqën dhe ia arritën qëllimit që të krijohëj në Jugosllavi një shtresë e borgjezisë së re kapitaliste, e cila të merrte e të konsolidonte frenat në duart e veta dhe të administronte fondet e mëdha që kishin investuar shoqëritë e huaja kapitaliste në interesin e tyre e jo në interesin e popujve të Jugosllavisë. Dhe kur themi në interesin e tyre, kuptojmë në interesin e kësaj klase kapitaliste që është krijuar në Jugosllavi dhe të atyre jashtë që bëjnë investime në këtë vend.

Megjithatë imperializmi amerikan dhe vetë Titoja arritën të krijonin në këtë kaos politik, ideologjik, orga-

nizativ dhe ekonomik një armë të diktaturës fashiste në ushtrinë jugosllave dhe ta stabilizonin gjendjen me kamxhik, të krijonin po ashtu një numër shumë të madh kuadrosh, më tepër politikanë dhe intrigantë, financierë borgjezë kapitalistë, me fjalë të tjera, njerëz të hurit, të litarit e të intrigave dhe kësaj çështjeje t'i vinin një rëndësi të jashtëzakonshme.

Udhëheqësit jugosllavë më në dukje shquhen për djallëzi të mëdha, por këto nuk janë djallëzi prej budallenjsh, por prej njerëzish finokë, të cilët imperializmi amerikan, nëpërmjet regjimit titist, ka ditur t'i përpunojë e t'i përdorë si ndihmës në të gjitha sferat: politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake, në të gjitha tratativat e mundshme në të cilat amerikanët përpiqeshin të fshihnin dorën e tyre dhe të vinin përpara një shtet si Jugosllavia për të realizuar disa qëllime të veçanta. Këto qëllime të veçanta të imperialistëve kishin për synim ta nxirrnin titizmin si një marksizëm të kohës dhe Titon si një marksist-leninist, si një komunist, po komunist të një natyre të veçantë, i cili ndërton socializmin në Jugosllavi në forma e në përmbajtje krejtësisht të ndryshme nga socializmi i parashikuar prej Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Pra, imperializmi amerikan ka synuar që gjithë zhvillimi i Jugosllavisë të bëhej në atë mënyrë që ta përdorte si një shembull për të treguar se në ç'rrugë duhej të futeshin një sërë vendesh të shtypura nga kapitali amerikan e nga ai botëror dhe cilat forma shtetërore, administrative, ekonomike, e sidomos politike dhe ideologjike, duhej të adoptonin. Ato duhej, pra, të adoptonin rrugën titiste. Në këtë drejtim Titoja krijoi

një personalitet, i cili u demaskua krejtësisht, por duhet thënë se ai, gjatë gjithë jetës së tij, ka ditur të manovrojë dhe të mos lëvizë nga kjo vijë, bile ta perfeksionojë këtë vijë intrigash dhe të mund të bëhet, ndër qarqet sunduese të shumë vendeve të botës, një personalitet i dorës së parë. Një nga titujt e kësaj politike është ajo që Titoja gjoja përfaqëson lëvizjen e shteteve «të paangazhuara», të cilën e kemi shpjeguar se është një rrenë e madhe e që synon të inkudrojë në kosheren e imperializmit vendet e tjera, të bëjë mjaltë për imperializmin nën parullën e «vendeve të paangazhuara», disa nga të cilat, në fakt, janë plotësisht të angazhuara tek imperializmi amerikan dhe te borgjezia kapitaliste reaksionare botërore, disa të tjera janë të lidhura me rubla e armë nga socialimperializmi sovjetik, nën skllavërinë e të cilëve punojnë e derdhin djersën dhe gjakun e popujve të tyre.

Titoja, ky renegat i marksizëm-leninizmit, u ka shërbyer shumë armiqve të popujve dhe të socializmit, prandaj ata e kanë ndihmuar, por ndihma e imperialistëve dhe e socialimperialistëve konsiston më parë në ndihmën për vetveten. Me këtë dua të them që këta armiq kanë pasur fitime kolosale për veten e tyre, pastaj i kanë dhënë një krodhë edhe Jugosllavisë. Është e vërtetë se ata kanë investuar me miliarda në Jugosllavi, por duhet thënë që këta miliarda kanë hipotekuar pasuritë jugosllave dhe sidomos lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e këtij vendi.

Ne mendojmë se imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror kanë investuar në Jugosllavi më shumë se ç'ka investuar socialimperializmi sovjetik, prandaj në

regjimin e Titos influencë më të madhe politike dhe ekonomike kanë imperializmi amerikan dhe kapitali perëndimor, në radhë të dytë vjen influenca e socialimperializmit sovjetik dhe kjo ka arsyet e veta të mëdha, pavarësisht se shumica e popujve të Jugosllavisë është sllave. Edhe çështja e kombësisë, e pansllavizmit luan rol në këtë influencë, por Titoja i ka përpunuar me kohë popujt e Jugosllavisë që të mos e donin, ta urrenin dhe ta luftonin Bashkimin Sovjetik socialist të ndërtuar e të drejtuar nga Lenini e nga Stalini. Lufta që Titoja u shpalli Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit të madh, arriti ta armiqësonte shumicën e popujve të Jugosllavisë me Bashkimin Sovjetik.

Me ardhjen në fuqi të hrushovianëve, natyrisht, me peripeci të vazhdueshme, me nënshtrimin e Hrushovit tezave të Titos, me hedhjen poshtë nga Hrushovi dhe hrushovianët të figurës së Josif Visarionoviç Stalinit dhe me kthimin e Bashkimit Sovjetik në një vend kapitalist, u trash miqësia e Bashkimit Sovjetik me Jugosllavinë titiste, por jo në atë shkallë siç ishte konsoliduar kjo miqësi me imperializmin amerikan dhe me kapitalizmin botëror. Hrushovianët, natyrisht, kishin qëllimet e veta, që ta kthenin Jugosllavinë në rrugën e tyre, t'i jepnin formën e vendeve të tjera «socialiste», satelite të Bashkimit Sovjetik, po kësaj nuk ia arritën dot, pse Titoja ishte proamerikan, ishte pro Perëndimit dhe kundër Bashkimit Sovjetik.

Gjatë gjithë jetës së tij Titoja nuk i ka dashur Bashkimin Sovjetik, as komunizmin, as leninizmin, përkundrazi, ka luftuar kundër tyre në të gjitha format, të cilat kanë shkuar kreshendo deri në prerjen e lidh-

jeve dhe në armiqësimin e plotë me ta. Miqësia me Bashkimin Sovjetik hrushovian, natyrisht, u rilidh, por ishte e dobët dhe vazhdon të jetë e tillë. Megjithëkëtë Bashkimi Sovjetik nuk i ka humbur shpresat, ai edhe tash, nëpërmjet ndihmave, nëpërmjet pansllavizmit, nëpërmjet kundërshtarëve të regjimit titist, mendon, punon dhe lufton të hedhë bazat e influencës së tij të qëndrueshme në Jugosllavi dhe, pas vdekjes së Titos, duke u mbështetur në këto baza, të mund të influencojë më shumë në këtë vend, domethënë të ketë atje dorë më të lirë që të veprojë brenda vendit, në mos mundtë dot ta gllabërojë tërë Jugosllavinë dhe ta kthejë në një satelit të vetin.

Kthimi i Jugosllavisë në një satelit sovjetik është një nga synimet kryesore të Bashkimit Sovjetik revizionist, i cili, po të ketë në dorë Jugosllavinë, i ka dalë NATO-s përballë, jo kryesisht nga ana ekonomike ose nga pikëpamja e interesit të kapitaleve që kanë investuar vendet perëndimore atje, sepse për këto çështje, në situatat aktuale, ashtu si zhvillohen marrëdhëniet ekonomike në mes kapitalistëve, fare lehtë mund të gjendet një rrugëdalje dhe bashkëpunim. Bashkimit Sovjetik i intereson Jugosllavia sidomos nga ana strategjike, nga ana ushtarake. Kush prej dy grupeve të mëdha ushtarake në Evropë ka Jugosllavinë, ai ka një pozitë të fortë strategjike kundër grupit tjetër. Në rast se NATO-ja e humbet influencën në Jugosllavi dhe këtë influencë e fiton Bashkimi Sovjetik, atëherë Bashkimi Sovjetik veçon Greqinë, vë në rrezik Austrinë, i afrohet Italisë dhe dominon në Adriatik e në Mesdhe. Kështu që NATO-ja pëson një humbje të madhe strategjike.

Mirëpo do ta lejojë imperializmi amerikan këtë gjë? Unë mendoj se është zor ta lejojë. Po do të shkojë në luftë imperializmi amerikan në rast se Bashkimi Sovjetik ia hedh kthetrat thellë Jugosllavisë ose e pushton këtë ushtarakisht? Mendoj se NATO-ja nuk do të rrijë me duar lidhur, por, pa arritur akoma në një konflagracion të përgjithshëm, do të bëhet më parë një luftë e ashpër ekonomiko-politike për ta pasur Jugosllavinë gjithsecili në krahët e tij. Prandaj vdekja e Titos edhe për ne do të krijojë kokëçarje.

Në radhë të parë, ne duhet të jemi të përgatitur për çdo eventualitet, pse kontradiktat që do të zhvillohen brenda në Jugosllavi dhe ndërmjet dy superfuqive, do të kenë reperkusione për vendin tonë, prandaj kufijtë tanë duhet të jenë të mbrojtur mirë në këto situata.

Edhe Greqia, nga ana e saj, e sheh me shqetësim të madh çështjen e Jugosllavisë pas vdekjes së Titos. Aktualisht Greqia e dëshiron një situatë të tillë statukuoje, e cila është në favorin e imperializmit amerikan dhe të NATO-s. Greqia e di se Jugosllavia ka pretendime tokësore mbi Maqedoninë e Egjeut dhe në rast se ajo hyn në kthetrat e sovjetikëve e të bullgarëve, atëherë rrezikohet në përgjithësi edhe NATO-ja, por veçanërisht rrezikohen pavarësia, liria dhe sovraniteti i Greqisë, pse synimet sovjeto-bullgare do të jenë ta zgjerojnë Maqedoninë, që këtë herë do të jetë një Maqedoni bullgare, me përjashtim të tokave shqiptare e të shqiptarëve, të cilët janë një problem tjetër që nuk po e trajtoj këtu. Por ata do të synojnë të dalin të Selanik dhe, po të kenë Selanikun, atëherë e kanë cunuar

Greqinë. Për këtë arsye Greqia qëndron kurdoherë vigjilente në drejtim të Jugosllavisë dhe të Bullgarisë. Për këtë arsye politika aktuale greke është miqësore me ne.

Pra, duke e gjykuar Jugosllavinë në situatat aktuale dhe në ato që do të krijohen pas vdekjes së Titos, ne shqiptarëve na bie detyrë e rëndësishme të forcojmë vendin, të forcojmë mbrojtjen e kufijve, të jemi vigjilentë, të fuqizojmë ekonominë. Ne duhet të përpiqemi të qëndrojmë në një politikë miqësore, brenda parimeve, me Greqinë, të vazhdojmë të kemi marrëdhënie tregtare me Italinë dhe të jemi vigjilentë për ngjarjet që do të zhvillohen në Jugosllavi, bile të përpiqemi çdo ditë të azhurnohemi me gjendjen atje dhe të parashikojmë ç'mund të ngjasë në këtë vend fqinj.

Marrë nga libri:

Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 9, f. 849

PANORAMË E ZYMTË KINEZE

Shënime

8 dhjetor 1977

Panorama kineze është e zymtë si brenda, ashtu edhe jashtë Kinës.

Ka kaluar më tepër se një vit që klika e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit ka ardhur në fuqi dhe po tregon shumë zell për të konsoliduar pushtetin borgjez kapitalist dhe ideologjinë revizioniste në të gjithë Kinën. Faktet e shumta që japin shtypi dhe agjencitë e lajmeve, njoftimet që na vijnë nga ambasada jonë në Pekin, në bazë të kontakteve të shumta që ka kjo me diplomatët e vendeve të ndryshme të botës të akredituar në Pekin, tregojnë se situata atje është kaotike, aspak e stabilizuar.

Që prej ardhjes së Hua Kuo Fenit në fuqi, përveç peripecisë së lëkundjes së grupit të tij për rehabilitimin e Ten Hsiao Pinit, që nga koha e goditjes së të ashtuquajturit grup të të katërve konstatohet se vazhdojnë turbullirat, bile thonë edhe goditjet me armë.

Në fakt, në shtypin zyrtar kinez shkruhet se po pushkatohen njerëz të shumtë nga 10, nga 17, nga 20

apo nga 25 veta në të gjitha provincat. Kjo shkon në ngjitje. Ne shohim se në shtypin kinez jo një herë po bëhet thirrje për «disiplinën shtetërore» jo vetëm në punë, por edhe për disiplinën e brendshme. Kjo theksohet në shumë artikuj kryesorë, sidomos të «Zhenmin-zhibaos». Një gjë e tillë tregon se punët në Kinë nuk ecin si në gjalpë e në qetësi, siç mendonin njerëzit e grupit puçist të Hua Kuo Fenit. Siç duket, lëvizja kundër Hua Kuo Fenit atje është mjaft e theksuar. Përveç arrestimeve, burgimeve dhe pushkatimeve, puçistët kanë ndërmarrë gjatë kësaj kohe edhe fushata për likuidimin e Revolucionit Kulturor. Kjo do të thotë diskreditim i Mao Ce Dunit, natyrisht në mënyrë të tërthortë, por kurdoherë diskreditim, kur dihet se është propaganduar shumë se ka qenë Mao Ce Duni ai që e ka frymëzuar dhe e ka udhëhequr personalisht atë (dhe kjo ka qenë e vërtetë). Tash klika e Hua Kuo Fenit thotë se Revolucioni Kulturor mbaroi, kurse, në realitet, sipas Maos, ai do të vazhdonte për «likuidimin e borgjezisë» në Kinë. Por, sipas grupit të Hua Kuo Fenit, kjo «borgjezi në parti» është rritur prapë dhe, për fat të keq të tij, ajo përbëhet nga 12 ose 16 milionë njerëz (nuk e di saktë sa elementë të rinj kanë pasë hyrë në parti gjatë Revolucionit Kulturor) dhe këta, siç është thënë prej vetë atyre, ishin elementë të shëndoshë të ardhur nga klasa punëtore dhe nga rinia revolucionare!

Pra, ky Revolucioni Kulturor duhej të vazhdonte, kurse puçistët e ndalën. Pse e ndalën? Se nuk ishin dakord me të, se Revolucioni Kulturor, të cilin e ngriti Maoja, ashtu si e ngriti dhe me ato qëllime që e ngriti, në fakt ishte në luftë kundër grupit të Liu Shao Çisë,

të Ten Hsiao Pinit, të Pen Çenit e të gjithë të tjerëve, të cilët kanë pohuar në autokritikat e tyre se kanë qenë monarkistë, kanë qenë konfucianë, kanë qenë kundër-revolucionarë. Me deklaratën publike që bëri Hua Kuo Feni në Komitetin Qendror, donte të thoshte se Revolucioni Kulturor ka qenë i gabuar dhe tash është i paqenë. Pas Ten Hsiao Pinit janë rehabilituar të gjithë të dënuarit nga Revolucioni Kulturor, që nga Pen Çeni e deri te Pin De Huaja, e sigurisht do të rehabilitohet edhe Liu Shao Çia.

Të gjithë reaksionarët e goditur nga Revolucioni Kulturor janë rikthyer në postet që kanë pasur përpara dhe kanë zënë kyçet e drejtimit. Të gjithë këta jo vetëm janë reaksionarë, revizionistë, trockistë, kapitalistë, por janë edhe të moshuar. Kështu që udhëheqjen e Kinës, qoftë atë të partisë, qoftë atë shtetërore, e hodhi përsëri në dorë reaksioni, reaksioni i vjetër pa dinamizëm, por me zemër të keqe dhe me shpirt hakmarrës, që po godet tash brezin e ri dhe po e hedh në rrugë. Kjo bandë në fuqi spastrimin e filloi me Universitetin e Pekinit, që ka qenë një nga qendrat kryesore të Revolucionit Kulturor. Andej përjashtuan të gjithë elementët e klasës punëtore, që kishin hyrë atje 10-12 vjet më parë dhe ishin bërë kuadro drejtues dhe edukues për brezin e ri. Të tërë këta elementë i përjashtuan nga universiteti, natyrisht, me ceremoni dhe «me lule», kurse poshtë, në provinca, vazhdohet procedura e zëvendësimit të të gjithë atyre njerëzve që nuk janë dakord me udhëheqjen, me elementë besnikë të puçistëve, sidomos me ushtarakë, se udhëheqja aktuale mbështetet tek ushtria. Partia për të është po ajo parti

inekzistuese, një organizatë amorfe, diçka me norma të çoroditura, që duhet të mbështetë e t'i thotë «po» dhe «si urdhëron» kësaj udhëheqjeje që i është imponuar asaj me armë.

Mirëpo e gjithë kjo situatë e ka ligështuar, e ka dobësuar Kinën ekonomikisht, ka dobësuar organizimin shtetëror të saj dhe i ka sjellë një dëm të madh ekonomisë popullore. Kjo shihet kudo në Kinë, ku ka një pakënaqësi të theksuar dhe një furnizim të paktë.

Gjithashtu marrëdhëniet ekonomike të Kinës me vendet e huaja janë dobësuar shumë, jo vetëm me ne që po e po, por edhe me vendet e tjera. Ky është rezultat i kësaj tradhtie të madhe që po zhvillohet në Kinë, që e ka burimin e vet jo vetëm tek ardhja e grupit puçist të Hua Kuo Fenit dhe Ten Hsiao Pinit, por akoma shumë më larg, në vijën revizioniste, antimarksiste, kapitaliste të grupit të Mao Ce Dunit.

Siç po na thonë, në Kinë mbretëron dyshimi te njerëzit; këta nuk guxojnë të flasin bile as me njëri-tjetrin, për arsye se denoncohen në organet e policisë, të ushtrisë dhe përnjëherë merren masa. Vendi është aq i madh, sa nuk dihet se ku çohen këta njerëz. Pushkatohen, varen apo futen në kampe përqendrimi? Të afërmit e tyre nuk dinë asgjë për këtë. Këto janë të dhënat që u thuhën njerëzve tanë nga miq kinezë. Këta njerëz, që mbështetin vijën tonë marksiste-leniniste, flasin me ne, por me njëri-tjetrin këto gjëra nuk i thonë dot. E tillë, pra, është situata, një situatë terrori, një situatë shumë e rëndë për popullin kinez, i cili nuk e meritonte këtë fat të keq që i rezervuan Mao Ce Duni dhe pasardhësit e tij.

Populli kinez luftoi për çlirimin e vendit të tij, për pavarësinë dhe për socializmin, por ai u mashtrua nga udhëheqja, me Mao Ce Dunin në krye, dhe nuk u çua në rrugën e vërtetë të socializmit. Partia nuk u konsolidua me normat dhe me ideologjinë marksiste-leniniste. Shteti i ri kinez nuk u drejtua që të ecte në rrugën e socializmit, por vazhdoi rrugën e zhvillimit kapitalist, të borgjezisë reaksionare dhe të kulakërisë. Të gjithë këta, me Mao Ce Dunin në krye, me Liu Shao Çinë e të tjerë, nuk ishin përveçse nepmanë të tillë, që NEP-in e morën dhe e zbatuan si një periudhë të vazhdueshme dhe për një kohë shumë të gjatë, që gjoja do të çonte në socializëm. Por qëllimi i vërtetë i tyre ishte që socializmin ta inkuadronin në kapitalizëm. Ata nuk ishin tjetër veçse buharinistë.

Edhe në arenën ndërkombëtare konstatojmë se Ki-na e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit është diskredituar me tërë kuptimin e fjalës. Zëri i saj mezi dëgjohet në botë. Ajo nuk e thotë fjalën e saj për asnjë problem kapital që preokupon njerëzimin, që preokupon popujt dhe shtetet. Slogani i saj i vetëm është një: bashkimi i të gjitha shteteve të botës, të «botës së dytë», të «botës së tretë», siç i quan ajo, me imperializmin amerikan kundër socialimperializmit sovjetik. Ky është tërë boshti i politikës së jashtme kineze, rreth këtij boshti kufizohet dhe vërtitet tërë aktiviteti. Në qoftë se mund ta quajmë aktivitet ndonjë lajm të «Zhenminzhibaos» ose të HSINHUA-së, ky «aktivitet» nuk konsiston në tjetër përveçse në ndonjë artikull propagandistik ose në grumbullimin e të gjitha atyre lajmeve të agjencive nga më reaksionaret, të cilat nxitin luftën botërore,

duke u vënë në dukje popujve se socialimperializmi sovjetik është rreziku kryesor i tyre, prandaj kundër tij duhet armatosur dhe duhet luftuar.

Pra, në politikën e jashtme të Kinës mbizotëron ky qëllim: Kina u bën thirrje proletariatit botëror, popujve të shtypur, popujve të vendeve koloniale e gjysmë-koloniale etj. që të bashkohen me imperializmin amerikan, të bashkohen me borgjezinë reaksionare të vendeve të tyre gjoja për të luftuar socialimperializmin sovjetik. Tjetër problem Kina as nuk shtron, as nuk është në gjendje të shtrojë. Po pse nuk është në gjendje? Për arsye se e ka inkuadruar veten në «botën e tretë». Mirëpo vendet e kësaj «bote të tretë», në përgjithësi, janë të lidhura qoftë me imperializmin amerikan, qoftë me socialimperializmin sovjetik. Vetë Kina, pjesëtare e së ashtuquajturës bote të tretë, është e lidhur me imperializmin amerikan dhe me satelitët e tij, pra me klikat e vendeve të «botës së tretë».

Në këto kushte Kina nuk mund të ketë një mendim, nuk mund të ngrejë ose të mbrojë një çështje në interes të një shteti të «botës së tretë», ose të grupeve të disa shteteve të «botës së tretë», që mund të jenë të revoltuara kundër imperializmit amerikan, por mbështet ato udhëheqje kapitaliste që paraqiten në mënyrë koniunkturale kundër imperializmit sovjetik. Kësisoj le që të gjitha qëndrimet e Kinës në arenën ndërkombëtare janë të shpëllara, pa konsistencë, pa zjarr, për arsye se nuk janë revolucionare, por duket qartë që Kina mbështet skllavërimin imperialist amerikan mbi popujt. Kështu, popujt që ajo i quan të «botës së tretë» dhe për të cilët mendon të bëhet çoban,

nuk e dëgjojnë këtë çoban hileqar, që mban ison e atij imperializmi që i shtyp. Popujt e së ashtuquajturës botë e tretë nxjerrin përfundimin se politika kincze është e keqe, një politikë antipopullore, një politikë false, siç është fals edhe qëndrimi i saj kundër imperializmit sovjetik.

Edhe popujt, edhe udhëheqësit reaksionarë, që i mbajnë këta nën robërinë e tyre, e kuptojnë qëllimin që ka Kina kur sulmon Bashkimin Sovjetik, e kuptojnë që Kina bën një politikë të tillë dhe ka një dada antisovjetike, se kërkon të krijojë pozita strategjike dhe tregje në të ashtuquajturën botë të tretë.

Kur mblidhet Organizata e Kombeve të Bashkuara, ose kur ndodhin ngjarje të rëndësishme në botë, siç ishin, për shembull, veprimet e Sadatit, veprimet e amerikanëve në Lindjen e Mesme, kur janë bërë mbledhje si ajo e Tripolit etj., zëri i Kinës jo vetëm është futur dhjetë pashë nën dhe, por ajo edhe mbështet, me gjysmë buze natyrisht, ata që bëjnë lojën e amerikanëve. Mendimin e saj për lëshimet e kompromiset që bëhen ndaj Izraelit në kurriz të popujve arabë, Kina nuk guxon ta thotë hapur, se ia vënë këmbët në një këpucë ambasadorët e vendeve arabe në Kinë e gjetkë, të cilëve ajo nuk di ç't'u thotë. Është fakt se Kina punon për përçarjen e këtyre popujve. Ajo nuk e shikon dhe s'ka si ta shikojë objektivisht këtë problem, për arsye se popujve arabë nga njëra anë u qëndron imperializmi amerikan, nga ana tjetër u qëndron imperializmi sovjetik. Të ndjekë një rrugë të drejtë siç bëjmë ne, Kina këtë nuk mund ta bëjë, sepse ka mbajtur pozita antisovjetike jo në baza parimore si bëjmë ne, dhe kjo e detyron atë që të mos e thotë dot mendimin e saj.

për këtë çështje. Pavarësisht se ç'thonë sovjetikët, Kina duhet të ketë mendimin e saj për ngjarjet në Lindjen e Mesme, siç e kemi edhe ne. Këtë ajo nuk e bën dot, por i qëndron besnike asaj politike tradhtare sipas së cilës duhet me doemos të mbrojë politikën e imperializmit amerikan.

Pra, në politikën e përgjithshme të Kinës në botë shohim një fiasko të madhe, sepse kjo politikë konsiston në qëndrime të padrejta ose të shumtat e herës në heshtje.

Marrëdhëniet tregtare dhe ekonomike të Kinës me vendet kapitaliste zhvillohen në një fshehtësi të madhe. Fakt është se në Kinë venë me qindra delegacione të imperializmit amerikan dhe të kapitalizmit botëror. Po ashtu, me dhjetëra e me qindra delegacione kineze, të përbëra prej ekonomistësh, inxhinierësh, teknikësh, ushtarakësh, shkojnë në të gjitha vendet kapitaliste të botës, dhe të tëra këto, natyrisht, lidhin kontrata për pajisje makinerish, për teknologji, për ndërtime fabrikash e uzinash të mëdha dhe për armatime. Të tëra këto marrëveshje bëhen nën rrogë, në errësirë; pagesat bëhen me kliring ose i jepen Kinës në formë kredish të mëdha. Kina është futur në ingranazhin e marrjes kredi prej shoqërive shumëkombëshe, prej shteteve të ndryshme kapitaliste dhe prej imperializmit amerikan. Kjo është gjithë politika e Kinës. Eksportet e saj janë ulur, për arsye se ekonomia kineze nuk punon me rendimentin e duhur.

Për sa i përket miqësisë së Kinës me një varg vendesh, me të cilat gjoja ka pasur marrëdhënie të mira, situatat tregojnë se këto janë përtokë.

Kina nuk është dakord me Korenë, se Koreja kërkon të luajë në të dyja tablotë, edhe me Bashkimin Sovjetik, edhe me Kinën. Ajo dëshiron të marrë kredi të mëdha nga Bashkimi Sovjetik, por edhe nga Kina, e cila nuk është në gjendje t'i japë. Republika Popullore Demokratike e Koresë kërkon që Kina ta mbrojë pranë Shteteve të Bashkuara të Amerikës për bashkimin e vendit, por këtë Kina nuk e bën, se nuk mund të futet në kundërshtim me mikun e saj të madh, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ja përse Koreja nuk e ka mirë me Kinën.

Vietnami po ashtu. Tash së fundi në Kinë vajti Le Zuani dhe, sipas lajmeve, të dyja palët nuk arritën të forconin miqësinë në mes tyre, sepse Kina ka pretendime mbi territoret vietnameze. Ajo nuk do dhe nuk është në gjendje t'i japë kredi Vietnamit të djegur e të shkatërruar, përveç kësaj nuk dëshiron që Vietnami të marrë kredi nga socialimperializmi sovjetik. Kina dëshiron dhe do të jetë e kënaqur që Vietnami të bëhet vasali i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Me Kamboxhian Kina paraqitet sikur ka marrëdhënie të mira. Natyrisht, Kamboxhia është një shtet shumë i varfër, sapo doli nga lufta, nuk ka akoma një politikë të kristalizuar. Në këto kushte, për arsye edhe të situatës shumë të vështirë që ekziston në mes Kamboxhias dhe Tajlandës, si dhe në mes Kamboxhias e Vietnamit për konflikte territoriale, ajo duket sikur e ka mirë me Kinën.

Të marrim marrëdhëniet e Kinës me Pakistanin. Aktualisht me Kinën Pakistani është i ftohtë, por Kina ka filluar të ndezë urat e miqësisë me shahinshahun

dhe me princeshat e Iranit. Kështu Kina «socialiste» po bën aleatë të rinj me njerëz dhe me dinasti nga më të ndyrat, nga më të poshtrat, nga më intrigantët. Kina mendon të marrë kredi nga shahu i Iranit, i cili është nën ndikimin e madh të imperializmit amerikan dhe të shoqërive të naftës. Ai ka investuar shumë kapitale jashtë, por sidomos ka investuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Gjermaninë Perëndimore, domethënë te miqtë aktualë të Kinës. Përveç kësaj, Shtetet e Bashkuara të Amerikës i shesin shahut të Iranit armatime nga më modernet dhe e kanë atë një vegël, njëloj si dhe Izraelin, përballë rrezikut sovjetik. Shahinshahu armatohet se ka plane të mëdha, të pushtojë Irakun, Gjirin Persik dhe të presë hovin e një invadimi nga ana e Kaukazit ose nga ana e Kaspikut. Apo nuk është pasardhësi i perandorëve të shquar të Perandorisë Persiane dymijepesëqindvjetorin e së cilës e festoi me shpenzime kolosale! Shahu i Iranit bën një jetë përrallore si në kohën e Harun El Rashidit, kurse populli iranian vuan si në kohën e skllavërisë. Ja, me këtë shtet borgjez kapitalist e me klikën e tij reaksionare Kina mban marrëdhënie shumë miqësore.

Me vendet arabe, siç e kam thënë, politika e Kinës është inekzistuese. Në marrëdhëniet me këto vende ajo shquhet për qëndrimin e saj proamerikan dhe antisovjetik. Ky orientim dikton politikën e Kinës në gjithë pellgun e Mesdheut. Kështu me ato vende arabe që Bashkimi Sovjetik ka marrëdhënie dhe përpigjet të vendosë influencën e vet, Kina është në kundërshtim, ndërsa me vendet e tjera arabe, ku Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë hedhur kthetrat dhe vendosin ligjin

e tyre, Kina është pro. Pra, nga një anë, disa nga shtetet e këtij pellgu janë në kundërshtim me politikën e Kinës, por edhe shtetet e anës tjetër nuk janë pro Kinës, për arsye se e shohin që ajo nuk bën asgjë. Çfarë bën Kina në fakt? Ajo duartroket Somalinë, presidentin Mohamed Siad Bare, se ky i qëroi sovjetikët nga Somalia, dhe për këtë bëri mirë, por Kina e duartroket pikërisht pse ky shkoi në Uashington dhe e futi vendin e tij nën zgjedhën e imperializmit amerikan. Ja, kjo është politika e Kinës.

Kina gjithashtu duartroket Mobutun, që është një tradhtar, një renegat, një agjent, një kapitalist nga më të mëdhenjtë e Afrikës. Nga ana tjetër, ajo është kundër Angolës, sepse atje ka influencë Bashkimi Sovjetik. Një politikë e tillë, pra, është reaksionare, jorealiste. Janë edhe shtetet e tjera kapitaliste të zhvilluara, të cilat mbrojnë interesat e tyre të përgjithshëm, por ato mbrojnë edhe interesat e tyre të veçantë, në kundërshtim me imperializmin sovjetik, por, kur u është e nevojshme, edhe në kundërshtim me imperializmin amerikan. Kina përpiqet të zërë vend në shtetet e së ashtuquajturës botë e tretë, por këtë vend ajo kërkon ta zërë me asgjë në kokë dhe me asgjë në xhep, vetëm se duartroket një imperializëm dhe me fjalë sulmon një imperializëm tjetër. Pra, vetëm këtë bën ajo, se nga ana ekonomike s'ka mundësi të ndihmojë, bile ajo tani nuk mban dot as detyrimet zyrtare dhe morale që ka ndaj shteteve të tjera, se kontratat janë nënshkruar në kohën kur Kina hiqej si një vend socialist. Aktualisht udhëheqësit kinezë e çorën maskën, prandaj mund t'i prishin edhe këto marrëveshje që kanë nënshkruar.

Ndaj nesh Kina ka marrë pozita armiqësore, të cilat po i shtrin gradualisht edhe në fushën e marrëdhënieve shtetërore dhe ekonomike. Siç dihet, Kina na ka akorduar neve disa kredi për të ndërtuar një numër fabrikash, si edhe një hidrocentral. Aktualisht ajo na nxjerr pengesa në dërgimin e makinerive dhe të pajisjeve përkatëse në afatet e caktuara. Përveç kësaj, edhe specialistët kinezë kanë filluar të kenë pretendime të mëdha. Ata marrin sa dy herë rroga ime në muaj dhe akoma kanë pretendime. Të tërë njerëz të ligj ata nuk janë, por ambasada e tyre i nxit që shumë herë të lidhin duart, të mos interesohen për punën dhe, kur del në gazetën tonë ndonjë artikull ideologjik, ata mbajnë qëndrime të ulëta. Kështu ndodhi me një nga specialistët kinezë, i cili mbi gazetën ku ishte botuar fjalimi që u mbajt në Vlorë¹, shkroi gjëra të poshtra dhe e la qëllimisht në dhomë. Kur u pyet, ai u përgjigj: «I kam shkruar vetë, sepse kështu mendoj». Këto janë provokacione.

Për sa i përket tregtisë, edhe në këtë fushë, siç kam shkruar në Ditar, kinezët po na nxjerrin vështirësi të mëdha. Ne luftojmë kundër qëndrimeve haptas të padrejta të tyre, por ata duhet të jenë të sigurt se ne nuk lëvizim nga qëndrimet tona parimore marksiste-leniniste, që përbëjnë forcën e madhe të Partisë dhe të shtetit socialist shqiptar. Qëndrimet tona parimore marksiste-leniniste i vë re gjithë bota, që sheh se ne jemi i vetmi vend i pavarur, që e themi mendimin tonë hapur

1. Me rastin e 65-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë dhe 33-vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

dhe kritikojmë e demaskojmë gjithë armiqtë e popujve, imperialistë, socialimperialistë, revizionistë të çdo kallëpi, të gjithë ata që i shtypin, që i skllavërojnë dhe që i kolonizojnë popujt, që luftojnë kundër revolucionit dhe përpjekjeve të popujve për çlirim.

Habiten njerëzit në botë, habiten kancelaritë e ndryshme se ku e gjejmë ne këtë forcë. Natyrisht, ata nuk mund ta kuptojnë, por këtë forcë ne e gjejmë te vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë, tek uniteti i çeliktë brenda radhëve të saj dhe tek uniteti i Partisë me popullin, e gjejmë te klasa jonë punçtore, e gjejmë te zbatimi me vendosmëri i parimit të mbështetjes në forcat e veta. Më në fund e gjejmë edhe te mbështetja internacionaliste e gjithë marksistë-leninistëve dhe e njerëzve përparimtarë të botës, të cilët e duan Republikën tonë Popullore Socialiste dhe kanë respekt për politikën e guximshme e të drejtë të Partisë së Punës të Shqipërisë. Kjo është një mbështetje tjetër për vendin tonë.

Në botë ka njerëz që marrëdhëniet ekonomike të vendit tonë me botën që na rrethon, nuk mund t'i kuptojnë dot ashtu si ne, sepse është krijuar një pikëpamje e tillë që asnjë shtet, i vogël ose i madh goftë, nuk mund të rrojë pa kreditë e dikujt. Domethënë ka njerëz që nuk e kuptojnë dot pavarësinë tonë ekonomike, që do të thotë edhe pavarësi politike, që ne mund të rrojmë dhe do të rrojmë shumë mirë, dhe në fakt rrojmë shumë mirë, pa i hedhur aspak vetes zinxhirët e robërisë ekonomike dhe politike.

Çështjet tregtare janë tjetër punë. Ne duhet të bëjmë përpjekje, bile përpjekje shumë të mëdha, që

për mallrat tona të gjejmë tregje dhe të sigurojmë devizë të fortë ose kliring për të sjellë ato mallra të cilat nuk mund t'i prodhojmë dot akoma vetë, me qëllim që të plotësojmë nevojat e vendit për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë popullore. Këtë gjë ne absolutisht do ta bëjmë vetë, me forcat tona. Por këtë nuk e kuptojnë as vendet kapitaliste, as vendet revizioniste.

Udhëheqësit revizionistë kinezë menduan se ne do t'u përulëshim atyre, se nuk do t'i qëndronim besnikë marksizëm-leninizmit, për hir të disa kredive që na jepnin. Si duket ata e harruan shpejt eksperiencën e madhe të luftës së Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të shtetit shqiptar kundër revizionistëve titistë e hrushovianë dhe morën pikërisht rrugën e tyre. Shihet qartë se revizionistët kinezë nuk kanë asnjë ndryshim nga ata sovjetikë në qëndrimet e veprimet ndaj nesh dhe ndaj botës, ata janë po ashtu revizionistë, janë po ashtu socialimperialistë, vetëm me ndryshimin se janë socialimperialistë të rinj, të cilëve u duhet ta krijojnë atë forcë koloniale që synojnë. Por, kur do ta krijojnë dhe si do ta krijojnë, ky është një problem tjetër. Në marrëdhëniet me botën e jashtme kinezët përpiqen ta shesin ideologjinë e tyre të qelbur antimarksiste, revizioniste, për ideologji marksiste-leniniste. Por nuk ka të atillë të marrë në botë që ta hanë sapunin për djathë. Të tërë, qofshin marksistë-leninistë të vërtetë, qofshin elementë demokratë, qofshin reaksionarë, e kuptojnë fare mirë që ideologjia kineze nuk është aspak marksiste-leniniste.

Revizionistët kinezë e kanë hedhur tej marksizëm-leninizmin dhe kanë adaptuar një formë të re revizio-

nizmi të mbështjellë me një ideologji të theksuar social-demokrate kapitaliste dhe të përzier me filozofitë e vjetra reaksionare, etatiste, feudale kineze. Dhe këtë politikë, këtë ideologji ata përpiqen ta përhapin, por nuk u zë vend kurrkund. Ajo zë vend vetëm në disa «marksistë-leninistë» të rinj të çoroditur, që krijuan grupe të ashtuquajtura marksiste-leniniste nën saçin e Revolucionit Kulturor kinez dhe nën hijen e «autoritetit të madh» të Mao Ce Dunit. Këta elementë, që kanë krijuar disa parti false të vogla, nuk mund të dalin nga kjo guaskë dhe s'mund të shkëputen nga kjo ngjitje shpirtërore që kanë bërë me kinezët, prandaj mbajnë anën e tyre, shkruajnë në ato gazeta ose revista që financohen nga kinezët për të përhapur teori false gjoja marksiste-leniniste, gjëra pa kripë, pa vend dhe në thelb revizioniste.

Ata që bëjnë pjesë në këto grupime janë të përçarë, për arsye se pikëpamjet revizioniste kineze, si të çdo revizionizmi tjetër, nuk mund të sjellin kurrsesi unitetin dhe kohezionin e mendimit e të veprimit, përkundrazi, ato përçajnë. Kështu bënte Maoja, i cili predikonte që në Kinë dhe në Partinë Komuniste të Kinës të kishte «dy vija ose pesë vija», «të lulëzonin njëqind lule dhe të konkurronin njëqind shkolla», sepse, sipas tij, sa më shumë rryma të kishte, aq më mirë do të ishte. Dhe në vendet kapitaliste, ku ekzistojnë të ashtuquajturat parti marksiste, prokineze, lulëzojnë jo njëqind, po nga një mijë «lule».

Çdo njeri, çdo anëtar i këtyre partive-bisht të revizionistëve kinezë ka një mendim të vetin të cilin ai e shpreh. Këtë mendim ai nuk e shpreh për të vepruar,

por edhe kur vepron, vepron jo i vendosur. Prandaj propaganda e kinezëve, e cila përhapet jo vetëm tek ata që quhen marksistë, por edhe tek ata që nuk quhen marksistë, bën të krijohen me qëllim grupe fashistësh me damkë, të cilët marrin emrin «proletarë», «revolucionarë», «Gardë e kuqe» etj., etj., por që në realitet nuk janë tjetër veçse agjentë të borgjezisë dhe fashistë, të cilët bëjnë propagandën e Kinës. Çfarë influence është kjo për Kinën? Asgjë, vetëm sa për të thënë që Kina mban lidhje me partitë komuniste marksiste-leniniste, kurse në fakt këto nuk janë të tilla parti. Partia Komuniste e Kinës ka vendosur marrëdhënie në rrugë partie me Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, është puqur me të ideologjikisht dhe politikisht; ajo gjithashtu mban lidhje të forta me Partinë Komuniste të Rumanisë, e cila është njëkohësisht agjunkturë e imperializmit amerikan, si edhe e revizionizmit sovjetik dhe e rrymave të ndryshme të revizionizmit modern.

Partia Komuniste e Kinës dhe shteti kinez u buzëqeshin vendeve revizioniste dhe pseudodemokratike popullore, siç është për shembull, Polonia. Mësojmë se ambasadori kinez në Varshavë ka kërkuar të lidhet me kryeministrin polak për t'i propozuar këtij që të kontraktojnë për shitblerjen e mallrave ushqimore, por ai as nuk denjoi ta priste kinezin dhe iu përgjigj të parazitet e të bisedojë me ministrin e Tregtisë për këto gjëra. Çdo veprim, qoftë edhe të vogël, bile edhe një nuancë kundërshtimi që këto vende shfaqin kundër zgjedhës sovjetike, Kina përnjëherë e vë në dukje dhe kërkon të japë përshtypjen sikur është ajo që ndikon në këto rezistenca të ndryshme. Por të tilla kundërshti-

me të këtyre vendeve janë të natyrshme. Ato as e kanë dëgjuar, as e dëgjojnë dhe as do ta dëgjojnë Kinën, sepse e njohin ç'është dhe nuk kanë asnjë interes të lidhen me të. Kinës këto s'ia varin fare, por ajo kërkon të hiqet sikur e ka një gisht brenda në to, domethënë të japë përshtypjen që është një shtet i madh, pa të cilin bota nuk mund të ecë. Klikat revizioniste në vendet e ish-demokracisë popullore kanë më shumë interes të kenë të bëjnë me Bashkimin Sovjetik. Për të qenë më të saktë, duhet të theksojmë se ato, në fakt, në radhë të parë, do të donin të lidheshin me vendet kapitaliste perëndimore dhe me imperializmin amerikan.

Në përgjithësi, e tillë është panorama kineze: e zymtë, plot me kontradikta, plot rreziqe, plot të papritura, plot aleanca dhe marrëveshje, të hapëta e të fshehta, me imperializmin amerikan dhe me imperialistët e tjerë të botës. Kina ka hyrë në një numër tratativash të rrezikshme për njerëzimin edhe për vetveten, ajo lufton për hegjemoni dhe, për këtë qëllim, sakrifikon interesat e popullit të vet dhe të popujve të tjerë. Çdo gjë që ajo thotë gjoja për interesat e popujve, është demagogji, një bluf pa kripë dhe i maskuar keq.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 700

Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 700

MBËSHTETJA NË FORCAT TONA NUK ËSHTË AUTARKI

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

9 dhjetor 1977

Kemi thënë vazhdimisht që zhvillimit të ekonomisë dhe realizimit të planeve paskëtaj t'u kushtojmë një vëmendje edhe më të madhe. Këtë, aktualisht, duhet ta theksojmë me një forcë të posaçme, sepse i tërë zhvillimi ekonomik e kulturor te ne realizohet me forcat tona. Por ka rëndësi që kjo të kuptohet mirë nga të gjithë, sepse mbështetja tërësisht në forcat tona nuk do të thotë aspak autarki. Duke ndjekur kursin e mbështetjes në forcat tona në zhvillimin e ekonomisë, ne kemi arritur në atë gjendje që na krijon mundësi të rritim prodhimin dhe të eksportojmë në vendet e tjera mallra dhe produkte në sasi të atilla që të sigurojmë gjithnjë e më shumë të ardhura në valutë dhe me to të blejmë mallra, makineri e pajisje që na nevojiten dhe që nuk i prodhojmë dot akoma vetë.

Krejt ndryshe është zhvillimi autarkik i ekonomisë. Autarki do të thotë as të mos shesësh, as të mos

blesh nga vendet e tjera. Por kjo gjë nuk mund të ndodhë. Çdo vend ka nevojë të blejë dhe të shesë jashtë. Mirëpo duhet të prodhosh që, më parë, të shesësh jashtë, pastaj të blesh. Kjo të kuptohet drejt nga të gjithë.

Për të zhvilluar më tej forcat tona prodhuese, neve na duhet të importojmë shumë gjëra. Kështu, që të zhvillohet edhe më shumë, ta zëmë, nxjerrja e naftës sonë, nevojitet të importojmë sonda e gjithfarë pajisjesh të tjera; që të shfrytëzojmë mineralet e tjera duhet të sjellim gjithashtu makineritë përkatëse. Këta mekanizma, që do të na shërbejnë për nxjerrjen e naftës dhe të mineraleve, si dhe ekskavatorë, traktorë e pajisje të tjera për bujqësinë, për ndërtimin etj., aktualisht nuk mund t'i prodhojmë të gjithë në vend. Prandaj, kur themi të mbështetemi në forcat tona, jo vetëm që nuk duhet të na shkojë mendja për t'u kufizuar në një zhvillim autarkik, por na vihet detyrë që, me forcat që kemi, të realizojmë, bile të përpiqemi t'i tejkalojmë planet që aprovojmë, të krijojmë suficite prodhimesh për të shtuar eksportin, me qëllim që të sjellim nga jashtë të gjitha ato mjete që janë të domosdoshme për zhvillimin e mëtejshëm e të pandërprerë të ekonomisë sonë. Tash, me gjithë këtë industri mekanike që kemi, me këto qindra, në mos me mijëra, torno e makina metalprerëse, mund të bëjmë mjaft gjëra që nuk mundëm t'i bënim deri tani.

Në goftë se dikush mendon se mund të bënim vetë mjaft gjëra të tjera pa këtë bazë materialo-teknike që kemi krijuar sot, një mendim i tillë nuk do të ishte real. Edhe sikur të sforcoheshim më shumë për të rea-

lizuar një prodhim intensiv, ky zhvillim, natyrisht, do të kërkonte përsëri investime të mëdha nga ne. Por situata jonë ekonomike tash nuk është si në pesëvjeçarët e kaluar, ajo është përmirësuar mjaft, pasi kemi krijuar mundësi të reja më të mëdha për të ndërtuar me forcat tona objekte, që do të na shërbejnë për zhvillimin e mëtejshëm të forcave prodhuese. Megjithatë duhet thënë se që të ndërtojmë vetë kombinatet hidrocentrale të mëdha ne do të marrim nga jashtë pajisjet e nevojshme, ekskavatorë dhe makineri të tjera të komplikuar që vetë nuk i prodhojmë dot akoma. Prandaj të inkurajojmë e të planifikojmë prodhimin dhe ndërtimin me forcat tona të atyre fabrikave e uzinave dhe makinerive për të cilat disponojmë bazën materiale dhe shkencore, si dhe njerëzit me eksperiencën e tyre. Pra, në ngjitjen tonë drejt objektivave më të mëdhenj është e domosdoshme të ecim hap pas hapi. Realizimi në jetë i këtyre objektivave kërkon të plotësojmë deri në një planet në të gjitha hallkat e në të gjithë treguesit.

Gjithashtu është e nevojshme të kontrollojmë me rreptësi importin e mallrave, të bëhemi gardh i pakapërcyeshëm për sjelljen e gjërave të panvojshme dhe të shumëfishojmë përpjekjet për rritjen e eksportit. Eksporti ynë duhet të kompensojë të gjitha ato mungesa që do të hasim gjatë zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë në pesëvjeçarët e ardhshëm.

Këto probleme është e domosdoshme t'i kuptojë mirë, në radhë të parë, Partia, por jo vetëm në mënyrë propagandistike, me eufori dhe pa baza. Ajo duhet të dijë saktë se deri në ç'shikallë ekzistojnë mundësitë to-

na. Në qoftë se Partia i kupton drejt dhe i realizon në praktikë këto mundësi që kemi, do të korrin suksese, ndryshe vetëm me fjalë këto nuk mund të bëhen. Kjo është çështja e parë që duhet mbajtur mirë parasysh nga Partia.

Problemi tjetër që duhet kuptuar realisht është izolimi që përpiqen të na bëjnë imperialisto-revizionistët. Unë mendoj se izolim politik dhe ideologjik armiqtë imperialistë dhe revizionistë nuk janë në gjendje dhe nuk mund të na e bëjnë dot. Izolim, në qoftë se ata do të na bëjnë dhe do të përpiqen të na e bëjnë, prandaj këtë ta kemi mirë parasysh, do të na bëjnë në fushën e ekonomisë, pikërisht në atë që kam thënë edhe më parë, për të na penguar në import-eksportin. Por edhe këtë lloj izolimi sot ne duhet dhe i kemi të gjitha mundësitë ta kapërcejmë:

E para, me realizimin e tejkalimin e planeve dhe me prodhimin e mallrave e të artikujve të tjerë për shkëmbime me jashtë.

E dyta, ashtu siç kemi thënë kurdoherë, të prodhojmë mallra me ato asortimente dhe cilësi që kërkohen në botën e jashtme. Sa më të mira të jenë mallrat tona, aq më tepër do të na rriten mundësitë për shkëmbime tregtare me vendet e tjera dhe do të përhapet emri i mirë i prodhimeve tona.

E treta, duke e konsideruar real presionin e vendeve kapitalisto-revizioniste, të mbahet kurdoherë parasysh edhe fakti se në mes këtyre vendeve ekzistojnë kontradiktat që dimë. Por ndërmjet tyre ka edhe kontradikta për çështjen e Shqipërisë dhe kjo është në favorin tonë. Të vijmë konkretisht te fqinjët tanë. Ita-

lia nuk mund të mos ketë kontradikta me Jugosllavinë lidhur me Shqipërinë. Jugosllavia ka gjithashtu kontradikta po për vendin tonë si me Italinë, edhe me Greqinë. Edhe kjo ka kontradikta me dy vendet afër nesh. Armiqtë synojnë që pushteti socialist në Shqipëri të përmbysset, që Shqipëria të lidhet me ta sipas dëshirave të tyre. Në fushën politiko-ideologjike me ta ne kemi e do të kemi qëndrim të prerë. Por tregti do të bëjmë si dhe me vende të tjera.

Kontradiktat që ekzistojnë midis armiqve në drejtim të Shqipërisë ne duhet t'i shfrytëzojmë edhe në fushën e tregtisë. Për ne edhe kjo fushë ka karakter politik, por ka edhe rëndësi ekonomike. Ne kemi mbajtur kurdoherë qëndrim konsekuent në fushën politike dhe ideologjike me Jugosllavinë, kësaj vazhdimisht ia kemi thënë dhe ia themi troç pikëpamjet tona, kurse në fushën ekonomike kemi pasur dhe duhet të zhvillojmë me të marrëdhënie ekonomike me leverdi reciproke. Kështu veprojmë edhe me të tjerët. Pra, të mos lejojmë që shkëmbimet ekonomike me vendet e tjera të influencojnë negativisht mbi ne në drejtimin politik dhe ideologjik. Këtu duhet të ruhem i dhe të bëjmë shumë kujdes. Tendencat e tyre, si, fjala vjen, prirjen që ka Greqia për ta pasur mirë me vendin tonë, ne t'i shfrytëzojmë, por jo të lejojmë që të gjejnë fushë të lirë synimet e vorioepirotëve dhe rivendikimet e shovinistëve e të reaksionit grek në drejtim të Shqipërisë së Jugut. Kjo nuk duhet të ndodhë në asnjë mënyrë, të tilla synimeve ne do t'ua presim thonjtë, sa të tregojnë qoftë edhe majën e tyre.

Me Jugosllavinë ne mbajmë qëndrim të prerë po-

litiko-ideologjik, megjithatë bëjmë tregti dhe përpqimi që nëpërmjet marrëdhënieve që kemi, në rrugë marksiste-leniniste, të forcojmë lidhjet dhe këmbimet e shumanshme me kosovarët. Kjo ka rëndësi. Rivendikime territoriale nuk bëjmë në drejtim të Jugosllavisë, por që kosovarët të ruajnë kombësinë, gjuhën, zakonet, që ata ta shtojnë vazhdimisht dashurinë për Shqipërinë, në këtë drejtim ne kemi luftuar dhe do të luftojmë. Qëndrimet tona politike dhe ideologjike kundër titizmit, kundër serbomëdhenjve dhe gjithë shovinistëve të tjerë janë me rëndësi të madhe politike dhe ideologjike. Por në marrëdhëniet tona me Jugosllavinë, natyrisht, rëndësi kanë edhe këmbimet tregtare, goftë edhe për faktin se kosovari sheh dhe mund të përdorë mallra të prodhuara në atdheun e tij të lirë e të pavarur. Kjo besoj se është një gjë e mirë, e mban atë të lidhur me atdheun e lirë e të pavarur.

Situatat politike t'i ndjekim me kujdes që t'i njohim mirë. Kjo do të na ndihmojë për të çarë përpara dhe për të rritur këmbimet tregtare me vendet e tjera. Për këtë qëllim në sektorin e tregtisë së jashtme të sjellim e të përgatitim njerëz të zotë, në radhë të parë të ngritur e të fortë politikisht dhe ideologjikisht, por të jenë njëkohësisht edhe tregtarë të mirë. Këto ditë mësova për organikën e Ministrisë së Tregtisë së Jashtme dhe them se m'u duk disi e fryrë. Nuk është hera e parë që po bëjmë tregti me jashtë. Unë e kuptoj se tash që Ministria e Tregtisë së Jashtme po krijohet më vete, nevojitet të shtohen edhe 25 apo edhe 30 veta të tjerë, po që të arrijë numri i punonjësve të tregtisë së jashtme aq sa është parashikuar, më duket se mos janë shumë.

Këtu u tha se nga tregtia e jashtme duhen ndjekur çdo ditë bursat, koniunkturat, duhet vajtur jashtë etj. Kjo është e drejtë. Bile kam porositur që këto punë të kryhen mirë e me shkathtësi, megjithatë duhet kujdes dhe, siç kemi thënë kurdoherë, të jemi të shtrënguar në organikat. Pastaj, në qoftë se flasim për të dërguar njerëz jashtë, duhet të mendojmë mirë për devizën, të mos lejojmë të na bredhin vazhdimisht në vende të ndryshme të botës përnjëherë me dhjetëra e dhjetëra punonjës të tregtisë së jashtme, se një praktikë e tillë nuk na leverdis. Pastaj nuk është e domosdoshme të studiohen të gjitha problemet vetëm duke rendur poshtë e lart. Jashtë duhen ndjekur disa çështje, por ka të tjera, siç janë koniunkturat e çmimeve, të tregjeve, të bursave etj., që mund e duhen studiuar më shumë në vend.

Çështja e monedhave, me sa di unë, është mjaft e ndërlikuar. Unë kam studiuar lidhur me këtë problem, sidomos kur filloi të shpërthejë me virulencë kriza monetare që ka përfshirë sot gjithë botën kapitalisto-revizioniste. Dihet se këto vitet e fundit ekzistojnë etaloni flori dhe etaloni devizë. Sipas rregullit, etaloni flori do të thotë të kesh aq kartmonedha sa ke edhe fondin e floririt. Bankat qendrore, që janë banka nacionale dhe që kanë në varësi banka të tjera private, emetojnë etalone në devizë. Ato kanë një kurs të jashtëm dhe të brendshëm. Por Banka e Francës, për shembull, e ka hequr të drejtën e këmbimit të kartëmonedhës me flori. Kështu, në qoftë se, fjala vjen, francezit i hipën në kokë të këmbejë me ar kartëmonedhat që disponon, siç praktikohej në shekullin e 18-të

nga poseduesit e parave, bankat e mëdha sot nuk e lejojnë një veprim të tillë. Kështu veprohet edhe në vende të tjera. Në tregun e jashtëm Banka Qendrore e Francës e ruan paritetin, domethënë ajo duhet të nxjerrë në qarkullim aq franga sa flori disponon. Mirëpo qëllon që kjo bankë qendrore, e detyruar nga kriza, emeton më shumë franga kartëmonedhë nga sasia e arit të depozituar. Atëherë çfarë ngjet në këtë rast? Brenda vendit fillojnë të ngrihen çmimet, fillon, gjithashtu, sulmi edhe nga jashtë, bie kursi i frangut, sepse me kohë është vendosur një paritet në raport me monedhat e tjera.

Tani vendet e Tregut të Përbashkët Evropian po përpiqen të krijojnë një njësi monetare të përbashkët. Këto orvatje janë bërë e po bëhen pas krizës së rëndë që pësoi dollari amerikan. Megjithatë as kjo nuk mund të stabilizojë problemin e monedhës dhe luhatjet e saj të shumta në botën kapitaliste. Në këtë fushë do të ketë prapë sulme dhe kundërsulme. Kështu, për shembull, me zhvleftësimin e frangut, gjermanoperëndimori, në vend që të merrte tre franga nga shitja e një malli në Francë, merr aktualisht shtatë dhe me ta blen atje mallrat që i leverdisin. Francezi, po deshi, le t'i ngrejë çmimet, por në këtë mënyrë vazhdon të prishet më tej balanca e vendosur dhe krijohen perturbacione të pafundme. Prandaj monedha në vendet kapitaliste e revizioniste nuk duhet parë thjesht si një mjet qarkullimi në tregun e brendshëm ose të jashtëm. Ajo ka lidhje me çmimet e vendit që e ka emetuar, por edhe të vendeve të tjera, me të cilat vendi emetues mban lidhje tregtare dhe ekonomike. Në vendet kapitalisto-revizioniste mo-

nedha luan një rol shumë të rëndësishëm për shfrytëzimin dhe për grabitjen e masave të gjera punonjëse nga ana e borgjezisë.

Para Luftës së Dytë Botërore u krijua dhe u imponua një superbankë, sepse banka nacionale e një vendi në asnjë mënyrë nuk mund të dilte mbi bankat nacionale të vendeve të tjera. Kështu, fjala vjen, Banka Kombëtare e Francës nuk mund të dilte mbi atë të Gjermanisë ose mbi Bankën e Anglisë. Këto kishin arritur njëfarë ujdie dhe kartëmonedhat me njëra-tjetrën i shkëmbenin me ar. Gjatë Luftës së Dytë Botërore pjesa më e madhe e arit shkoi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për arsye se vendet ndërluftuese u detyruan t'u paguanin atyre armatimet që kishin marrë. Mirëpo arriti puna që bankat e Evropës dhe të vendeve të tjera kishin aq vështirësi pagesash, saqë, për të dalë nga kjo gjendje, në kohën e Rusveltit, në korrik të vitit 1944 u bë një mbledhje në Bretën Udz të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe u arrit një marrëveshje ndërkombëtare që u quajt «Sistemi monetar ndërkombëtar i Bretën Udzit», në bazë të së cilës etaloni flori u zëvendësua me kartëmonedhën dollar. Në këtë mbledhje u aprovua kursi i këmbimit të një onci¹ ar me 35 dollarë. Si pasojë kartëmonedhat e tjera, si sterlina, frangu, marka, lireta, mbetën nga fundi. Nga ky sistem përfituan Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që jo vetëm grumbulluan nga vendet e tjera akoma më shumë rezerva të konsiderueshme ari, por blenë prej tyre edhe mjaft aksione në monopole industriale, morën gjithfa-

1. 1 onc është baras me 31,103 gramë ar.

rë koncesionesh në Evropë dhe në vende të tjera, në sajë të emetimit në sasi të mëdha kartëmonedhash në dollarë.

Kur vendet e tjera pak nga pak u fuqizuan dhe filluan ta merrnin veten nga pikëpamja ekonomike, nuk mund të pajtoheshin më me këtë gjendje. Dale, thanë ato, ku po shkojmë kështu? Dhe u kërkuan Shteteve të Bashkuara të Amerikës që, në këmbim të kartëmonedhave në dollarë, t'u jepnin arin përkatës që u kishin marrë. Shtetet e Bashkuara refuzuan, duke iu përgjigjur atyre se nuk kanë ar. Ky konflikt shkaktoi rënien e vlerës së dollarit, gjë që bëri që 1 onc ar të këmbehej me 42,2 dollarë, në vend të 35 dollarëve që kushtonte më parë. Por zhvleftësimi i dollarit u thellua me hapa të shpejtë që kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës u çliruan nga detyrimi i konvertimit të dollarit në flori. Sot baza flori e dollarit nuk ka asnjë kuotë fikse të prerë, sepse çmimi i 1 onc ari në tregun e lirë ka arrihur në 100, 120, 150, bile edhe në 170 dollarë. Pra dollari është zhvleftësuar shumë në tregun e lirë të këmbimit të monedhave. Rënie pësuan gjithashtu kartëmonedhat e vendeve të tjera, si frangu, lireta, marka gjermane etj. Në fakt, si pasojë e krizës, sot është përmbytur edhe sistemi i Bretën Udzit, me kursin e tij të dollarit.

Por a mund të thuhet se mbaroi mbretëria e etalonit dollar dhe a do të kalohet në një etalon tjetër monetar? Që të ndodhë kjo, duhet që të gjitha bankat kombëtare qendrore të shteteve të lënë plotësisht të lëvizshëm paritetet e monedhave. Por, në qoftë se dollari vazhdon të bjerë, për të evituar një rivlerësim të

fortë të devizave, do të jetë e domosdoshme të ndërhyhet përsëri për ta mbrojtur devizën amerikane dhe atëherë risku do të jetë më i madh.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk kanë asnjë obligim për sa i përket paritetit të dollarit. Në mars të vitit 1973 «aleatët» u kërkuan Shteteve të Bashkuara të merrnin pjesë në mbrojtjen e dollarit, por këto të fundit pyetën: «Me se?», sepse lidhjet në mes të etalonit dollar dhe etalonit flori ishin këputur qysh më parë. Kështu që «aleatët» në asnjë mënyrë nuk do të pranojnë t'i rilidhin përsëri këta zinxhirë.

Atëherë me devizat e tjera çfarë do të bëhet? Amerikanët do t'u thonë evropianëve ose japonezëve: «Në qoftë se dëshironi që ne (amerikanët) të marrim pjesë në mbrojtjen e dollarit, atëherë ju duhet të na jepni kredi në devizat tuaja». Kjo, natyrisht, është një humbje për evropianët dhe për japonezët, pavarësisht se gazetatat më serioze çirren se evropianët korrën «fitore» mbi amerikanët. Në fund të fundit, dollari është akoma e vetmja monedhë që mund të lejojë manovrime të mëdha në nivelin e tregtisë ndërkombëtare, por mbretëria e tij nuk mund të jetë e përhershme. Përse? Sepse balanca e pagesave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës mund të vazhdojë të keqësohet në mënyrë deficitare. Për arsye të këtij deficiti çmimi i devizës amerikane do të njohë rënie të tjera në tregjet e shkëmbimit dhe kjo do të thotë që devizat e tjera të rivalizojnë më shumë me dollarin.

Duhet ditur, gjithashtu, se lëkundjet e kartëmonedhave të vendeve të ndryshme kapitaliste nuk kanë rë-

ndësi vetëm për *Bourse d'échange*¹, por ato lidhen ngushtë edhe me kreditë, me shitjen e mallrave e me shumë faktorë të tjerë dhe shoqërohen me pasoja të rënda si brenda, ashtu edhe jashtë çdo vendi kapitalist e revizionist. Kështu, aktualisht, vendet «socialiste» njohin në përgjithësi një deficit të madh dhe janë në kushte që thithin një pjesë të madhe të superprodhimit global të vendeve kapitaliste, por vetëm një pjesë. Nga ana tjetër, ajo që quhet ndihmë ndaj «botës së tretë» dhe kreditë që u jepen shteteve revizioniste nga vendet e Perëndimit, kanë pikërisht këtë qëllim, të financojnë në këtë thithje të superprodhimit kapitalist. Por kjo thithje është e pjesshme. Pjesa tjetër e këtij superprodhimi kapitalist është e tillë sa të shkaktojë një mospërputhje dhe çorganizim në projektet dhe në perspektivat që kërkon të arrijë çdo shtet kapitalist. Për këtë arsye, megjithëse kompromiset janë shumë të mundshme, kur Evropa gjoja e bashkuar dhe «perandoria aziatike» e dominuar nga Japonia ose nga Kina të përbëjnë entitete të fuqishme për të ekuilibruar Amerikën e Veriut, këto kompromise nuk mund të jenë më të mundshme dhe fraktura e botës kapitaliste do të shkaktohet në mënyrë definitive.

Natyrisht këto janë disa nocione të thjeshta, të përgjithshme, jokomplete, që kam unë në lidhje me çështjen e monedhës, të rolit të saj, të fluktuacionit në tregjet kombëtare e ndërkombëtare dhe të manovrave bankare të shteteve kapitaliste. Por shokët e bankës

1. Frëngjisht — Bursa e shkëmbimeve. Këtu në kuptimin e shitblerjes e të këmbimit të kartëmonedhave në bursë.

sonë që merren me anën financiare, me çështjet e bursës, shokët e Tregtisë së Jashtme, që merren e duhet të merren më mirë e më në thellësi me problemet e çmimeve ndërkombëtare të mallrave të ndryshme, duhet t'i thellojnë këto probleme, të kuptojnë mirë koniunkturat e tyre dhe qëllimet që kanë në këto koniunktura shtetet e ndryshme kapitaliste e revizioniste, me të cilat ne kemi marrëdhënie tregtare.

Njerëzit tanë duhet të ngulin këmbë që çmimet e shitblerjes të caktohen bashkërisht dhe në lidhje me koniunkturat ndërkombëtare. Këto çmime punonjësit tanë të tregtisë t'i njohin mirë, si të mallrave që duam të blejmë, ashtu edhe të atyre që duam të shesim. Pas kësaj, para se të lidhen kontratat, ata të bëjnë llogaritë mirë sa kushton ky ose ai mall që do të blejmë e do të shesim. Vështirësi kemi, sepse revizionistët përpiqen të fitojnë në kurrizin tonë ose në çmime, ose në cilësinë e mallrave, «të na e japin sapunin për djathë», si thotë populli. Po fundi i fundit me ta nuk kishim ç'bënim. Ata mund edhe të na thoshin: «Shkoni merrini gjatë, po të doni, tregti është kjo».

Prandaj çështja është, së pari, të dimë të bëjmë tregti, të jemi elastikë, të nuhatim pse e thotë ose pse e bën ky ose ai këtë apo atë propozim dhe ne ç'duhet të bëjmë.

Në përgjithësi e kam çështjen tek ajo që thashë në fillim, që izolimin e vendit tonë nga pikëpamja ideologjike dhe politike imperialistët dhe revizionistët nuk e bëjnë dot, kurse nga ana ekonomike kanë mundësi të na dëmtojnë e të na pengojnë. Prandaj ne të përpiqemi të përballojmë çdo vështirësi që do të na nxje-

rrin. Ta kuptojmë mirë rëndësinë që ka, veçanërisht në kushtet aktuale, realizimi i planeve. Këtu s'ka receta, s'ka llafe, po duhen punë, mendim i thellë, djersë e zbatim në kohë, në cilësi dhe në sasi të detyrave dhe të bëjmë kursim kudo. Ne kurrsesi nuk shkojmë në autarki, kjo do të ishte marrëzi, po ta mendonte kush. Ne duhet të punojmë që të shesim, që të na krijohen mundësi edhe të blejmë. Të tjerët i shohim që marrin të gjithë kredi dhe janë futur deri në grykë në borxhe, duke e lidhur vendin kokë e këmbë te kreditorët. Gurët s't'i blen njeri, se kanë të gjithë, por kromin, bakrin e përpunuar etj. t'i blejnë që ç'ke me të, se të tërë kanë nevojë. Por në qoftë se do të ketë pakujdesi nga ana jonë, mungesë kujdesi dhe shkathtësie në tregtinë me jashtë, atëherë nuk do t'i shesim me leverdi as kromin, as bakrin, asnjë mall tjetër. Prandaj Partia dhe gjithë kuadrot duhet ta njohin mirë situatën që po kalojmë dhe të nxjerrë secili detyra.

Dotohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP

TRAGJEDIA E POPUJVE ARABË

Shënime

10 dhjetor 1977

Me të vërtetë është një fatkeqësi e madhe për një sërë popujsh arabë të Lindjes së Mesme, të cilët kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë preja e imperializmit amerikan dhe e socialimperializmit sovjetik. Ata kanë qenë dhe janë nën saçin e përhershëm të intrigave si të Traktatit të Varshavës, në personin e Bashkimit Sovjetik, ashtu edhe të NATO-s, në personin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që synojnë të kenë në këto vende zonat e influencës, të kenë tregje dhe baza ushtarake. Qëllimi i të dyja superfuqive është t'i mbajnë këta popuj të përçarë dhe, në fakt, sot për sot ia kanë arritur këtij qëllimi.

Siç e kam thënë edhe herët e tjera, këta popuj nuk janë thjesht arabë, por, pavarësisht nga kjo, ata mund të quhen të tillë. Veç një gjë është e vërtetë, ata i lidh një fe dhe ajo luan rol të madh në këto vende. Popujt arabë, pavarësisht nga emërtimi i shteteve të tyre, në shumicën e rasteve ndodhen akoma nën sundimin e mbretërve, të shahëve, emirëve, që, me përjashtim të veshjeve, në shumë pikëpamje qeverisin me metodat

karakteristike mesjetare të feudalizmit dhe janë të lidhur me fuqitë e mëdha imperialiste. Prandaj nuk mund të thuhet se kanë fituar lirinë e demokracinë e plotë e të vërtetë.

Të gjitha këto shtete dhe popuj, që nga Mauritania, Maroku, Algjeria, Tunizia, Libia, Egjipti e nga Libani, Siria, Iraku, Jordania, Arabia Saudite, Kuvajti, Emiratet e Gjirit Persik, formojnë, siç e quajnë vetë veten e tyre, «familjen e madhe të kombit arab». Por kohët e ngjarjet këtë familje të madhe e kanë shpartalluar, prandaj ky emërtim nuk i shërben shumë. Çdo shtet nga këto mund të jetë dhe mund të quhet anëtar i kombit arab, por të tëra këto nuk mund të formojnë dhe nuk e formojnë të njëjtin komb arab. Afërsi me njëri-tjetrin kanë, secili vend ka shtet më vete, të pavarur dhe sovran, kanë interesa të përbashkët, por këta interesa të përbashkët nuk janë dhe nuk mund të jenë kurrë në akord me interesat e çdo shteti të marrë në veçanti. Përse? Sepse ekonomia, pasuritë e tyre janë të pabarabarta. Jo vetëm për këtë arsye, por disa nga këto shtete udhëhiqen nga individë ose nga grupe njerëzish ose partish që s'kanë asgjë demokratike. Pasuritë kryesore, diku të mëdha, diku mesatare, sidomos nafta, janë vënë në ankand dhe, në grabitjen e shfrytëzimin e saj, epërsi të madhe kanë fituar monopolet amerikane, pra, imperialistët amerikanë. Për sa u përket sovjetikëve, sot për sot ata po përpiqen të mbajnë në këtë zonë një gjendje të turbullt, përpiqen të influencojnë politikisht dhe ideologjikisht mbi qeveritë dhe partitë e vendeve arabe, të kenë në këtë pëllg baza ushtarake dhe strategjike. Rivaliteti midis këtyre dy

superfuqive për epërsi politike, ekonomike e ushtarake në këtë rajon, shkakton e thëllon edhe përçarjen aktuale në mes popujve arabë, midis shteteve arabe.

Në këtë rajon, përveç këtyre popujve, ekzistojnë edhe populli arab palestinez si dhe ai izraelit. Këtu popullsia izraelite nuk ka qenë në numër të konsiderueshëm, por me kohë, sidomos pas krijimit të shtetit të Izraelit, numri i saj u rrit relativisht shumë. Në qoftë se nuk gabohem, Izraeli sot ka mbi 3 milionë e gjysmë banorë, por psikologjia dhe frymëzimi izraelit, sidomos në fushën e organizimit, kanë bërë që ky shtet të forcohej nga të gjitha pikëpamjet, nga pikëpamja ekonomike e financiare po e po, por edhe nga pikëpamja ushtarake. Mbështetja kryesore e tij ka qenë e është imperializmi amerikan, pa lënë mënjanë vendet e tjera imperialiste.

Përveç Izraelit, imperializmi amerikan, nëpërmjet monopoleve të mëdha të naftës, ka nën influencën e vet Arabinë Saudite, vendin më të pasur të kësaj zone në naftë, Emiratet e Gjirit Persik dhe Iranin. Praktikisht ai ka në dorë fushat e naftës në të gjitha këto vende. Për ta ruajtur gjithë këtë pasuri të madhe, imperializmi amerikan është gati të hyjë vetë në luftë, por përpara se të futet vetë, në luftë për interesat e tij fut të tjerët. Kështu, kur pa se mund të rrezikohej zona e tij e influencës në Lindjen e Mesme, ndërseu Izraelin, i cili sulmoi ushtarakisht disa herë me radhë Egjiptin dhe Sirinë. Këta, gjoja për të mposhtur Izraelin, pse kishte pushtuar disa toka të tyre dhe kishte dëbuar nga tokat e veta palestinezët e i kishte detyruar të jetonin, dhe jetojnë, si muhaxhirë në vendet e tjera arabe, u mbë-

shtetën te socialimperializmi sovjetik. Kjo i përgjigjej politikës së socialimperialistëve sovjetikë, sepse qëllimi i vërtetë i tyre ishte që nëpërmjet Egjiptit dhe Sirisë të hidhnin në dorë pasuritë e mëdha të naftës në Lindjen e Mesme.

Naseri ra në kurthin e sovjetikëve, predikoi likuidimin e plotë të Izraelit, bile me një pretekst të paqenë u fut edhe në Jemenin e Veriut. Politika e tij e varësisë nga sovjetikët u solli dëmet që dihen Egjiptit dhe popullit egjiptian.

Anvar el Sadati ndoqi politikën e Naserit, u lidh më ngushtë me Bashkimin Sovjetik dhe vazhdoi me kërcënime kundër Izraelit. Kjo bëri që Bashkimi Sovjetik të ngulte këmbët mirë në Egjipt dhe arrinte deri aty sa të mendonte se s'kishte kush ta shkulte andej. Sadati, duke u bazuar në ato armë që i merrte nga Bashkimi Sovjetik, luajti një manovër politike sidomos për të ardhmen, vlerësoi forcat izraelite në Sinai dhe i sulmoi ato¹, por pa ndonjë sukses të madh. Sidoqoftë ushtritë egjiptiane e kapërcyen bregun lindor të kanalit të Suezit dhe u futën në një pjesë të Sinait që ishte pushtuar nga Izraeli në kohën e Naserit. Në këtë gjendje ndërhyjnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nëpërmjet Këshillit të Sigurimit u vendos armëpushimi. Daljen në bregun lindor të kanalit të Suezit Sadati e quajti një fitore të madhe të luftës së Kipurit, siç u quajt kjo luftë. Por edhe Izraeli luajti pjesën e vet të lojës politike, pasi kaloi bregun perëndimor të kanalit të Suezit, pranoi armëpushimin, bisedimet për të

1. Është fjala për luftën e 6 tetorit 1973, lufta e Kipurit.

cilin u zhvilluan pikërisht në këtë pjesë të tokës egjiptiane të pushtuar gjatë kësaj lufte. Pas armëpushimit Izraeli vazhdon t'i mbajë tokat e pushtuara egjiptiane të Sinaït dhe tokat e tjera arabe, forcat palestineze i ka kurdoherë jashtë territorit të tij dhe bazat e tyre që ndodhen në afërsi të tokave të pushtuara i godet vazhdimisht.

Izraeli mban po ashtu të pushtuar Golanin e Sirisë dhe, në të njëjtën kohë, tok me imperialistët amerikanë, punon që «të ulë gjakrat» në këtë rajon. Kjo taktikë e tij synon të thellojë më tej përçarjen në mes vendeve arabe dhe me më kryesorin prej tyre, Egjiptin, të arrijë një paqe, në mos të përhershme, të përkohshme, në mos të përgjithshme, të paktën të pjesshme. Në këtë drejtim Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë manovruar dhe po manovrojnë me të gjitha mjetet e rrugët në ndihmë të strategjisë izraelite.

Egjipti është vendi më i populluar arab. Në krye të shtetit egjiptian sot ndodhet Anvar el Sadati, një pasanik arab dhe, siç ka shkruar vetë në librin me kujtimet e tij nga koha e Luftës së Dytë Botërore, ka qenë në shërbim të feldmareshalit hitlerian Romel. Kohët e fundit Sadati shkoi në Jerusalem ku bisedoi me Beginin, kryeministrin e Izraelit. Të dy ranë dakord që tash e tutje të jetojnë në «paqe», natyrisht me disa kushte. Këto kushte i leverdisin Izraelit, por edhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat janë prapa kësaj manovre të madhe antiarabe.

Gjesti i Sadatit, vajtja e tij në Jerusalem, bëri që vendet e tjera arabe «të revoltohen», ta quajnë tradhtar të kombit arab dhe të mblidhen në Tripoli të Libisë

për të gjykuar qëndrimin e tij dhe për ta dënuar. Në këtë mbledhje, përveç Kadafit, ishte Bumedieni i Algjerisë, Asadi i Sirisë si dhe një përfaqësues i Libanit. Iraku ishte dakord, por më duket nuk dërgoi njeri. Në mbledhjen e Libisë, pra, ku kërcënuan dhe dënuan Sadatin, nuk vajtën të tëra vendet arabe.

Arabia Saudite, pavarësisht se nuk deklarohet hapur, në të vërtetë qëndron pas Sadatit dhe e mbështet atë. Edhe Emiratet e Gjirit Persik e mbështetin veprimin e Sadatit, i cili hapin që bëri me siguri nuk e ka bërë pa pasur pëlqimin e disa të tjerëve, sidomos të vendeve që përmenda më lart.

Kështu gjendja e marrëdhënieve midis vendeve arabe u ngatërrua akoma më thellë. Aktualisht shohim që nga një anë qëndrojnë Algjeria, Libia, Iraku, Siria dhe Libani, nga ana tjetër Egjipti, prapa të cilit qëndron mbreti hashemit i Jordanisë, Huseini. Qëndrojnë, po ashtu, siç thashë, mbreti i Arabisë Saudite, sheikët e Gjirit Persik, pra, njerëzit më të pasur të botës arabe.

Tunizia qëndron në mes, nuk prononcohet as anej, as këndej, lëshon herë ndonjë fjalë pro, herë ndonjë kundër.

Sadati, për të kundërshtuar mbledhjen e Tripolit, preu përnjëherë marrëdhëniet diplomatike me të gjitha vendet që morën pjesë në këtë mbledhje. Në të njëjtën kohë thirri në Kajro mbledhjen e vendeve të interesuara të kësaj zone, si edhe amerikanët, izraelitët dhe sovjetikët. Këta të fundit, duke u përpjekur të mos dalin fare jashtë fushe, refuzuan të marrin pjesë në këtë mbledhje, kurse amerikanët pranuan, por edhe izrae-

litët janë gati të venë aty. Sadati tregohet i vendosur ta bëjë këtë mbledhje me ose pa vendet e tjera arabe.

Me fjalë të tjera, imperializmi amerikan dëshiron dhe do t'ia arrijë qëllimit që në mes satelitit të tij, Izraelit, dhe Egjiptit të arrihet në një *modus vivendi*, qoftë edhe një «paqe» e përkohshme, e pjesshme. Por Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të dëshironin, dhe për këtë po punojnë, që në këtë marrëveshje për «paqe» midis Izraelit e Egjiptit të marrin pjesë edhe vendet e tjera arabe, sidomos Siria. Kjo atyre u intereson shumë.

Ka gisht Bashkimi Sovjetik në këtë çështje? Unë mendoj se ka. Pavarësisht nga qëndrimi i jashtëm, atij i intereson ta thellojë përçarjen në mes vendeve e popujve arabë që të mund të përfitojë më shumë.

Sadati, i zemëruar nga qëndrimi i përgjithshëm mashtrues i Bashkimit Sovjetik, dëboi nga Egjipti të gjithë këshilltarët e teknikët ushtarakë e civilë sovjetikë e të aleatëve të tij, të vendeve të «demokracisë popullore», dhe uli pothuajse në minimum personelin e përfaqësive të tyre diplomatike. Pas kësaj edhe Bashkimi Sovjetik e ktheu pllakën dhe hapur po mbështet vendet që u mblodhën në Tripoli. Me këtë qëndrim ai mbron politikën e vet në Lindjen e Mesme, sidomos bazat ushtarake që ka në Libi, në Siri etj. Përfitimet që Bashkimi Sovjetik ka në këto vende të brigjeve të Mesdheut kanë karakter ushtarako-strategjik, por me kohë ai mendon t'i zgjerojë ato edhe në fushën ekonomike jo vetëm në vendet buzë Mesdheut, por edhe në brendësinë e Afrikës dhe të Lindjes së Mesme. Prandaj tani ai tregohet gjoja mik i sinqertë dhe i ngushtë i gjithë

popujve arabë, me përjashtim të Sadatit dhe të atyre që e mbështetin atë.

Aktualisht, pra, ne shohim që imperializmi amerikan ka arritur deri diku objektivat e vet, domethënë ka konsoliduar pozitat e tij strategjiko-ekonomike në këtë zonë dhe i ka përçarë popujt arabë. Vendet më të populluara dhe më të fuqishme ekonomikisht dhe ushtarakisht janë në anën e tij, duke pasur, gjithashtu, në të njëjtën kohë, në anën e vet edhe Izraelin, koburen e tij të vërtetë për kohë lufte dhe turbullirash. Kurse Bashkimi Sovjetik përpiqet të ruajë ato pozita që i mbetën, pse Egjiptin e humbi. Megjithatë, sovjetikët nuk i kanë humbur të gjitha shpresat.

Është e drejtë të mendohet dhe të konkludohet se kjo është me të vërtetë një tragjedi për të gjithë popujt arabë, vendet e të cilëve lagen nga Mesdheu, Deti i Kuq dhe Gjiri Persik. Kina mendon se këto vende e këta popuj të «botës së tretë», «forca kryesore lëvizëse që çon botën dhe njerëzimin në revolucionin proletar», do të jenë në anë të saj. Ç'teori skandaloze, kur dihet se në shumicën e këtyre vendeve sundojnë mbretër feudalë dhe borgjezë kapitalistë të mëdhenj që luajnë me fatin e popujve të tyre e që janë të lidhurgushtë me njërën ose me tjetrën fuqi imperialiste!

Politika kineze nuk ka asgjë marksiste-leniniste dhe jeta po tregon se teoria e «tri botëve» s'ka asnjë bazë, asnjë influencë edhe në këto vende, për të mos folur për të gjitha vendet e ashtuquajtura të «botës së tretë». Jo vetëm kaq, por këto situata dhe këto qëndrime e kanë vënë Kinën në një pozitë jashtëzakonisht të dobët dhe qesharake. Ajo nuk mund dhe nuk di ç'që-

ndrim të mbajë, të jetë pro Sadatit apo kundër tij, të jetë kundër Izraelit apo pro, të jetë për paqen apo për vazhdimin e luftës së popujve arabë, dhe në mënyrë të veçantë të popullit arab palestinez, kundër Izraelit që u ka rrëmbyer tokat.

Kina s'mund të prononcohet për këto probleme dhe kjo është e natyrshme, për arsye të politikës së saj inkonsistente, pa baza, reaksionare dhe qesharake. Gjithë popujt arabë e shikojnë që Kina është një fuqi «e madhe», por që s'ka forcë sa të ndërhyjë të paktën me qëndrimet e saj në këto probleme kaq të mëdha që janë lodra e dy superfuqive, por që shqetësojnë botën. Kështu Kina, edhe pse s'e thotë hapur, është pro marrëveshjes së Sadatit me Izraelin, pro sakrificimit të lirisë dhe të pavarësisë së popullit palestinez që kërkon atdheun e tij.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Lindjen e Mesme», f. 160

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Shënime për
Lindjen e Mesme», f. 160*

ÇESHTJA E LINDJES SË MESME NË DRITËN E NGJARJEVE TË FUNDIT

Shënime

17 dhjetor 1977

Siç dihet, imperialistët amerikanë kanë hedhur thonjtë në Lindjen e Mesme dhe kanë ndërmarrë rregullimin e një paqeje ala amerikane në këtë rajon, duke lënë jashtë Bashkimin Sovjetik, konkurrentin e tyre kryesor. Në këtë gjendje ne shohim një ashpërsim të mëtejshëm të kontradiktave në mes imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik. Të dy këta kalendarë përpigën të ndajnë zonat e tyre të influencës në këtë rajon.

Dihet se Lindja e Mesme është një rajon me rëndësi të madhe strategjike si në çështjen e naftës e të pasurive të tjera natyrore, të tregjeve, po kështu edhe nga pikëpamja ushtarake në lidhje me një luftë të madhe eventuale. Flotat detare në Mesdhe, si ajo amerikane, ashtu edhe ajo sovjetike, përpigën të krijojnë baza të përhershme në vendet e këtij rajoni.

Bashkimi Sovjetik, siç e dimë, u përpoq dhe zuri vend për një kohë në Egjipt dhe në Siri, por Shtetet e Bashkuara të Amerikës ia ngritën këmbët nga Egjipti

me anën e Sadatit, i cili bëri si bëri dhe i nxori sovjetikët jashtë nga Egjipti. Veç, siç dihet, ai i nxori jashtë sovjetikët, për të kallur brenda vendit amerikanët. Sovjetikët kanë mbetur tashti në Siri, së cilës vazhdojnë t'i japin ndihma për të pasur aty një bazë detare të fuqishme. Sovjetikët, pas humbjes së Egjiptit, natyrisht, u përpoqën që të kenë baza të tjera në detin Mesdhe dhe ia arritën qëllimit: u lidhën me Kadafin e Libisë, po e armatosin këtë, marrin prej Libisë naftë e dollarë dhe njëkohësisht gjetën mundësinë që të krijojnë në këtë vend baza ushtarake, ajrore dhe detare.

Algjerinë, po ashtu, sovjetikët përpiqen ta bëjnë për vete për të pasur disa fitime, në mos plotësisht strategjike, politike, duan të fitojnë nga konflikti që ky vend ka me Marokun dhe me Mauritaninë për çështjen e Saharës Perëndimore. Algjeria mbështet Frontin POLISARIO, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbështetin mbretin e Marokut dhe Mauritaninë. Nga ana tjetër, siç e dimë, imperializmi amerikan është lidhur fort edhe me Arabinë Saudite, me shahun e Iranit, me Emiratet e Gjirit Persik, me Izraelin e tash edhe me Egjiptin e me mbretin Hysein të Jordanisë.

Shohim, pra, dy blloqe në luftë kundër njëri-tjetrit për të vendosur secili hegjemoninë e vet në këtë rajon në kurriz të popujve arabë. E gjithë politika e superfuqive synon në atë që të përçajë unitetin dhe aleancat e popujve arabë, të pengojë realizimin e aspiratave të tyre dhe secila prej tyre të sundojë sa të jetë e mundur më mirë e më lehtë mbi këta popuj.

Egjipti dhe Izraeli janë dy protagonistët kryesorë në ngjarjet ushtarake që zhvillohen në këtë rajon. Pro-

tagonisti tjetër më pak i rëndësishëm është Siria. Sadati i bëri për vete amerikanët dhe, pa pasur aprovimin e hapur të vendeve të tjera arabe, me të cilat hiqej se ishte i lidhur ngushtë, sikurse kam shkruar edhe më përpara, ndërmori një veprim «të guximshëm», shkoi në Izrael, u takua me kryeministrin Begin e me anëtarët e parlamentit izraelit, knesetit, dhe filloi atje tratativat e «paqes». Sadati u prit shumë mirë nga izraelitët. Bisedimet në fasadë, natyrisht, qenë të përzemërta.

Në vija të përgjithshme, Sadati, Begin dhe Karteri ishin marrë vesh qysh më parë jo për të gjitha problemet, por për ato më kryesoret. Aktualisht këto probleme kryesore po shtjellohen në Kajro, në Uashington dhe gjetkë. Në Kajro tash janë grumbulluar e po bisedojnë ekspertët e të dy vendeve, të Egjiptit dhe të Izraelit. Çfarë bisedojnë, ne nuk dimë akoma shumë gjëra, pse agjencitë e huaja të lajmeve nuk pipëtojnë gjëkafshë të rëndësishme.

Ato gjëra të pakta që thonë lënë të kuptohet se miqësia në mes qeveritarëve egjiptianë dhe izraelitë sa vjen e po trashet. Kjo duket nga fakti se izraelitët flasin me admirim të madh për Egjiptin, për udhëheqjen e tij. Kjo duket, gjithashtu, edhe nga pritja jashtëzakonisht e ngrohtë që po u bëhet të dërguarve izraelitë në Kajro, bile një nga rrugët e këtij qyteti që çon për në piramidat, u quajt «Rruga e paqes».

Gjatë gjithë kësaj kohe Begin silltet rreth e rrotull. Ai shkoi në Francë, ku pati bisedime të përzemërta me Zhiskar d'Estënin, i cili e mbështet këtë «vijë paqësore». Begin shkoi, gjithashtu, në Gjermaninë Perëndimore që, gjithashtu, e mbron këtë «vijë paqësore». Tash

së fundi Beginin ka shkuar në Uashington. Sigurisht, ai është thirrur në kryeqytetin amerikan nga Karteri për t'i precizuar akoma edhe më mirë vullnetin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në këto tratativa. Dhe, siç po duket, Karteri me Beginin kanë rënë në ujdi të mira. Kështu Beginin, siç bëjnë të ditur agjencitë e lajmeve, do të shkojë të takohet me Sadatin në Egjipt dhe do të përfundojë me këtë të fundit një marrëveshje. Çfarë marrëveshje do të jetë kjo në kushtet e sotme? Mund të jetë, dhe ka mundësi të jetë, një paqe dypalëshe, domethënë në mes Egjiptit dhe Izraelit, për të cilën me siguri do të bëhen përpjekje që më vonë të mund të pranohet edhe nga Siria, ndoshta edhe nga vendet e tjera arabe që aktualisht e kanë kundërshtuar. Me këtë rast mund t'i jepet Sadatit shkretëtira e Sinait, natyrisht, duke i akorduar Izraelit shumë të drejta të konfirmuara dhe të siguruara edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si kalimi i lirë e pa pengesa i anijeve të tij nëpërmjet kanalit të Suezit për në Detin e Kuq e nëpërmjet ngushticës së Bab el Mandebit dhe gjirit të Adenit për në Oqeanin Indian, dhe kanali të mbetet krejt i lirë ose nën drejtimin e të dyja palëve.

Nga ana tjetër, kjo marrëveshje dypalëshe për «paqe» mund të çojë po ashtu në zgjidhjen «në parim» të çështjes palestineze. Kjo zgjidhje «në parim» e çështjes palestineze, natyrisht, do të bëhet sipas qejfit të amerikanëve dhe të izraelitëve e do të pranohet edhe nga Sadati. Pra, synimi është të krijohet një «shtet palestinez» ku të përfshihet bregu perëndimor i lumit Jordan, Cisjordania, si dhe Rripi i Gazës në brigjet e Mesdheut, ose, më mirë të themi, jo një shtet i pavarur palestinez,

por një entitet me anë të të cilit vetëm sa të njihet ekzistenca e palestinezëve, të bashkuar me mbretërinë hashemite të Hyseinit.

Ky mund të jetë akordi ose marrëveshja paqësore dypalëshe në mes Egjiptit dhe Izraelit e kurdisur nga imperializmi amerikan. Natyrisht, nga të parët që do ta pranojnë këtë marrëveshje do të jenë Arabia Saudite, Irani, Maroku dhe Emiratet e Gjirit Persik. Vendet e tjera arabe mund ta pranojnë më vonë, pasi çështja e Golanit sirian të gjejë njëfarë zgjidhjeje. Se çfarë zgjidhje do t'i japë ky traktat dypalësh çështjes së Golanit sirian, do të shikohet, por amerikanët kanë tendencë që edhe Sirinë ta bëjnë me vete. Me fjalë të tjera, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përpiqen që Bashkimit Sovjetik t'i ngrihen këmbët edhe nga Siria e, për të arritur këtë objektiv, duhet me detyrë t'i njohin disa të drejta e t'i japin disa privilegje edhe Sirisë. Kjo, mendoj unë, mund të bëhet më vonë, pas shumë tratativave që do të zhvillojnë për këtë problem Karteri, Sadati dhe mbreti Saud i Arabisë Saudite.

Në qoftë se arrihet që edhe Sirinë ta futin në kllapë, atëherë kush mbetet tjetër atje? Mbetet Iraku. Ky, aktualisht, nuk e mbështet Sadatin, por edhe me Sirinë nuk është në marrëdhënie të mira, për arsye të ambicieve territoriale nacionaliste. Të dyja partitë «Baas», që sundojnë në këto vende, janë në kundërshtim e në luftë me njëra-tjetrën. Mirëpo Iraku neutralizohet lehtë nga ana e imperializmit amerikan. Mbeten kështu Algjeria, Libia dhe Libani. Ky i fundit është një shtet kozmopolit. Borgjezia e Libanit është një borgjezi që dëshiron të bëjë tregti, të luajë kumar, të bëjë tratativa

dhe spekulime me të gjithë, prandaj Libani është, si me thënë, nën saçin e imperializmit amerikan dhe të Izraelit. Në këto kushte imperializmi amerikan nuk llogarit shumë as kundërshtimin e Libisë dhe të Algjerisë për të ngatërruar planin e tij në Lindjen e Mesme.

Gurët kryesorë të kësaj loje shahu, Egjiptin, Arabinë Saudite dhe Izraelin, i kanë në dorë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Natyrisht, Shteteve të Bashkuara të Amerikës u intereson shumë që Bashkimit Sovjetik të mos i zënë këmbët dhe as në Libi, as në Algjeri dhe, natyrisht, për këtë ato do të përpiqen.

Karteri kohët e fundit bëri një deklaratë në shtyp dhe tha se do të vijë në Evropë. Ai do të shkojë në Francë, ku do të bisedojë me Zhiskar d'Estënin. «Unë jam shumë i interesuar të bisedoj me Zhiskar d'Estënin, — deklaroi ai, — pse Franca është një vend që, pavarësisht se nuk është në NATO, e mbështet NATO-n, që është një mbrojtje e sigurt, për të cilën të gjithë ne duhet të interesohemi. Por unë, — vazhdoi Karteri, — do të bisedoj me Zhiskar d'Estënin veçanërisht për Afrikën, se Franca ka një njohje të madhe dhe të vjetër për këtë kontinent dhe neve, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, na intereson shumë çështja afrikane». Një deklaratë e tillë nga ana e imperializmit amerikan s'ka si bëhet më qartë. Imperializmi amerikan dëshiron të forcojë pozitën e tij ekonomike, strategjike dhe politike në kontinentin afrikan. Ai do të luftojë që Bashkimi Sovjetik të mos gjejë vend ku të mbështetet atje dhe kudo ku ka mundur të krijojë baza ose zona influence në Afrikë t'i likuidohen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Natyrisht, në këtë veprim imperializmi ame-

rikan do të ruajë interesat e Francës dhe të Anglisë në Afrikë derisa edhe këto t'i mbytë gradualisht nëpërmjet influencës së vet.

Ne shohim që aktualisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës ia ngritën këmbët Bashkimit Sovjetik nga Somalia, presidenti i së cilës, që ishte prosovjetik, është kthyer në proamerikan dhe ka shkuar në Uashington, ku sigurisht i ujdisi letrat me Karterin dhe, në fakt, prej një kohe mjaft të gjatë, në mes Somalisë dhe Etiopisë po zhvillohen luftime. Etiopia, që doli nga gjendja e mjeruar mesjetare e Haile Selasiesë, nuk ka gjetur akoma stabilitet. Pikërisht nga kjo mungesë stabiliteti kanë përfituar sovjetikët, të cilët, ku gjejnë një vrimë miu hapur, futen përnjëherë, japin armatime, në radhë të parë, si dhe ndonjë ndihmë të vogël ekonomike e teknike. Ata kanë zbarkuar në Etiopi ushtri kubane, oficerë e instruktorë sovjetikë dhe kubanë, të cilët organizojnë dhe hedhin në luftë etiopianët kundër somalezëve.

Me gjithë këtë situatë të rëndë e të koklavitur që po zhvillohet në kurrizin e popujve arabë e që përbën një rrezik të madh për paqen botërore, Kina e Hua Kuo Fenit, me tërë kuptimin e fjalës, rri dhe bën sehir. Ajo bën sehir me ankth në zemër, pse nuk di ç'pozita të mbajë, ngaqë është e hutuar dhe e turbulluar nga gjendja e saj e brendshme e rëndë dhe nga teoritë e saj të kalbura.

Në këto tratativa të mëdha që po ndërmerr imperializmi amerikan në Egjipt me Sadatin dhe në Afrikë, s'ka asnjë dyshim se Kina është pro Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe pro paqes bilaterale. Zaten asaj

i pëlqen shumë politika bilaterale, por në këtë mes ajo po demaskohet përpara syve të të gjithë botës, pse nuk thotë haptazi as se është pro këtyre ngjarjeve të drejtuara nga «shkopi i dirigjentit» amerikan, as se është kundër. Ambasadorëve kinezë po u bëhen pyetje kudo për këto çështje dhe ata pa pikë turpi përgjigjen se «ne nuk flasim, nuk marrim pjesë, për arsye se këto probleme janë të koklavitura». Të tjerët, që i dëgjojnë këto përgjigje të tyre, skandalizohen dhe thonë: «Si është e mundur të mbahet ky qëndrim? Si është katandisur një shtet i tillë i madh që quhet socialist, sa të mbyllë gojën dhe të thotë se nuk përzihem në këto çështje kaq të mëdha, për arsye se janë të koklavitura?». Me fjalë të tjera, të gjithë e kuptojnë se Kina është futur në llumin e një rendi e të një shteti kapitalist, por të një shteti kapitalist kaotik dhe të çorganizuar, që gjendja nuk e lejon të mbajë një qëndrim, të ketë një pikëpamje të saj dhe ta thotë këtë pikëpamje siç bën çdo vend kapitalist, qoftë edhe i vogël.

Ja, deri këtu e ka çuar vija antimarksiste revizioniste e Mao Ce Dunit Kinën e madhe, tek e cila ne kemi pasur besim se do të luftonte me konsekuencë kundër imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Lindjen e Mesme», f. 169

Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Shënime për Lindjen e Mesme», f. 169

INKOHERENCA E POLITIKËS SË JASHTME TË KINËS

Shënime

18 dhjetor 1977

Shumë ambasadorë të vendeve kapitaliste të së ashtuquajturës botë e tretë çuditen për inkoherencën e politikës së jashtme të Kinës lidhur me «tri botët». Ata nuk arrijnë të kuptojnë si është e mundur që një vend i madh, i cili hiqet edhe si socialist, të bëjë një politikë të tillë të çoroditur. Dhe, në fakt, marrëdhëniet që ka Kina me vendet dhe me shtetet e ndryshme, tregojnë se politika e jashtme e saj jo vetëm nuk përbën një objekt studimi serioz, por në këtë drejtim tregohet moskokëçarje e naivitet dhe, mund të themi, një inkoherencë që shkon deri në budallallëk.

Është po ajo Kinë e Mao Ce Dunit dhe e Çu En Lait, e Jeh Çien Jinit dhe e Huan Huasë, ministrit të Jashtëm të sotëm, e Ten Hsiao Pinit dhe e Hua Kuo Fenit, që e ka filluar dhe po e vazhdon një politikë të tillë.

Pozitat e para të Kinës, siç kam shkruar në shënime të mia që kanë lidhje me Kinën, tregojnë se udhëheqësit kinezë qëndronin shumë të izoluar, nuk bënin

përprjekje të kishin lidhje me shtetet e botës. Ky qëndrim i çuditshëm vetizolimi, apolitik si të thuash, u dukej udhëheqësve kinezë si një rrugë nga më të drejtat. Por, në realitet, pse ngjiste kjo, ç'tregonte kjo politikë? Kjo politikë kineze jo e zgjuar, në radhë të parë, vinte nga mungesa e një stabiliteti brenda në Kinë, pavarësisht se lihej të dukej sikur kishte stabilitet; tregonte gjithashtu se në udhëheqjen kineze, në Partinë Komuniste të Kinës, kishte një varg pikëpamjesh të kundërta që lulëzonin, gjë që nuk lejonte të përcaktohej një vijë e drejtë në politikën e jashtme. Korrentet ishin të shumta e të ndryshme dhe njëra i tërhiqte andej, tjetra këtej. Kështu që politika e jashtme e Kinës ishte kurdoherë fluide, hezituese, megjithëse Kina linte përshtypjen e një shteti që i shikon të tjerët nga maja e Olimpikut, ose më mirë të themi, nga maja e Himalajës.

Më vonë kinezët e braktisën guaskën e tyre dhe filluan të hapeshin disi në kontinente të ndryshme, duke lidhur marrëdhënie diplomatike me disa shtete. Por këto marrëdhënie diplomatike të Kinës kishin karakter rajonal, karakter aziatik, kundërevropian, kundër shteteve të Amerikës Latine dhe shteteve të tjera kapitaliste. Po të analizohen qëllimet e politikës së jashtme kineze të kësaj periudhe, do të shikohet se Kina nga faza e izolimit kaloi në një fazë marrëdhëniesh diplomatike me sistem të veçantë për të krijuar një grupim aziatik me shtete borgjeze kapitaliste që mund të pranonin, si të thuash, hegjemoninë e Kinës. Politika kineze synonte në krijimin e kësaj influence (për të mos e quajtur përnjëherë hegjemoni), kurse me të gjitha vendet e tjera të botës Kina nuk bënte përçapje të

lidhte marrëdhënie diplomatike, as marrëdhënie ekonomike, për të mos folur për marrëdhëniet kulturore, të cilat kurdoherë i ka neglizhuar. Edhe aktualisht vazhdon të mos ketë marrëdhënie kulturore.

Për moslidhjen e marrëdhënieve diplomatike me vendet e ndryshme të botës Kina kishte nxjerrë si pengesë çështjen e Tajvanit, duke e vënë këtë përpara si një shkëmb të madh, dhe deklaronte se, po të dëshirojë ndonjë shtet të ketë lidhje me Kinën socialiste, duhet të presë automatikisht marrëdhëniet me Tajvanin. Ky ishte guri i provës, si të thuash, i marrëdhënieve të Kinës me botën e huaj. Mirëpo bota kapitaliste i studionte situatat dhe i kuptonte qëllimet e Kinës. Ajo, nga njëra anë, ishte e interesuar për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Kinën, sepse kjo ishte për të një treg i madh, të cilit ia ndiente nevojën, por, nga ana tjetër, nuk mund ta sakrifikonte Tajvanin.

Kështu që Kina për një kohë shumë të gjatë vazhdoi me politikën e saj të vetizolimit dhe të vendosjes së disa marrëdhënieve me karakter rajonal, aziatik. Pastaj erdhi një moment tjetër i ri, kur udhëheqësit kinezë menduan se nuk mund të ecej më në këtë mënyrë dhe se duhej të gjenin një formulë për ta hequr shkëmbin e Tajvanit nga mesi i rrugës ku e kishin vënë. Këtë formulë e gjetën, e zbatuan dhe filluan të lidhin marrëdhënie diplomatike me shumë shtete. Këto marrëdhënie, natyrisht, nuk sollën akoma futjen e Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, me gjithë përpjekjet dhe luftën që bënë në brenda në këtë organizatë, tok me miqtë e tjerë të Kinës, që ia donin asaj të mirën.

Në votimet për pranimin e Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, çdo vit shikoheshin ndryshime. Votat në anën e Kinës shkonin duke u shtuar, kur ajo bëhej më e arsyeshme në politikën e saj të jashtme, domethënë kur tregohej e dispozuar të lidhte marrëdhënie diplomatike me shtete të rajoneve të ndryshme të botës. Megjithatë, dhe me gjithë përpjekjet tona, pranimi i Kinës në OKB kundërshtohej me «rreptësi» nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga të gjitha ato shtete që kishin interesa të mëdhenj me to e që nuk mund të dilnin kundër tyre. Pra, shumë shtete ishin të lidhura e nën varësinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe nuk pranonin kushtet e kinezëve për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, kështu që Kina mbetej kurdoherë jashtë OKB-së.

Por erdhi edhe momenti tjetër në politikën e jashtme kineze: kinezët ndërruan strategji, nga strategjia e luftës kundër imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik, kaluan në strategjinë e aleancës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kundër Bashkimit Sovjetik. Atëherë filloi të shkrijë akulli edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe, më në fund e më në bisht, Kina u pranua në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Pozitat që mbajti Kina pas futjes së saj në OKB, pozita që ajo i përgatiti për 12 apo 15 vjet me radhë në bisedime të panumërta me ambasadorin amerikan në Varshavë, bënë që strategjia e re e Mao Ce Dunit dhe e Çu En Lait të triumfojë në bisedimet sekrete mes dy ambasadorëve në Varshavë dhe pastaj, më vonë, edhe mes Kisingerit, nga njëra anë, dhe Maos e Çu

En Lait, nga ana tjetër. Kina hyri në një rrugë miqësie me të gjitha vendet kapitaliste të botës dhe zhvilloi luftën kundër socialimperializmit sovjetik. Kina ndërtoi strategjinë e çmendur antimarksiste, reaksionare që të merrej vesh e të puqej me imperializmin amerikan dhe me të gjitha shtetet e tjera borgjeze kapitaliste të botës, për të krijuar kështu një front të përbashkët kundër socialimperializmit sovjetik.

Mao Ce Duni kërkonte që, për t'u bërë Kina aleate me Shtetet e Bashkuara, këto të fundit duhej t'i jepnin kësaj atë ndihmë që nuk ia dha Bashkimi Sovjetik. «Mençuria» e Mao Ce Dunit synonte të gënjente imperializmin amerikan, se Kina do të bëhej një barrikadë e fortë kundër socialimperializmit sovjetik, dhe, pasi të forcohej, do të zaptonte edhe tokat e Siberisë, duke parashtruar se këto i ishin grabitur Kinës nga carët rusë. Këtë ide «gjeniale» Maoja e hodhi duke bërë rivendikime kufitare ndaj Bashkimit Sovjetik. Ky ishte kapari i parë që Kina u jepte Shteteve të Bashkuara të Amerikës për ta dobësuar me luftë e me përpjekje kundërshtarit kryesor të imperialistëve amerikanë në dominimin e botës.

Pra politika e Kinës në marrëdhëniet me vendet e tjera zhvillohej në aksin Kinë-Shtetet e Bashkuara të Amerikës. U harrua Tajvani, u harruan Hong-Kongu dhe Makaoja, u harrua edhe Vietnami që po luftonte. Dhe pikërisht në kohën kur bombardohej egërsisht Vietnami, atëherë u zhvilluan edhe bisedimet përfundimtare në mes Maos e Çu En Lait, nga njëra anë, dhe Kisingerit e Niksonit, nga ana tjetër. Pra Maoja u fut në këtë rrugë antimarksiste, proimperialiste, kur Vietnami

po digjej nga bombat e aeroplanëve B-52 të Niksonit, i cili vajti në Pekin, u përshëndet dhe bisedoi gju më gju me Mao Ce Dunin dhe me Çu En Lain..

Pikërisht në këtë kohë Shtetet e Bashkuara të Amerikës hapën dritën e gjelbër dhe gjithë miqtë e amerikanëve filluan një nga një me radhë të lidhnin marrëdhënie diplomatike me Kinën «socialiste» të Mao Ce Dunit. Megjithëkëtë, duhej të kristalizohej ky orientim, duhej të kristalizohej kjo strategji e Maos që Kina të mund të përcaktonte se në çfarë konsistonin dhe në ç'drejtim duhej të ecnin këto marrëdhënie diplomatike që po vendoseshin.

Me këtë dua të them se në fillim të kësaj periudhe ne përsëri nuk shikojmë një aktivitet të dukshëm dhe të mençur politik nga ana e Kinës. Jo, bile ne, në bisedimet me kinezët, kemi ngulur këmbë shumë herë dhe kemi shfaqur pikëpamjet tona që Kina socialiste të kishte marrëdhënie diplomatike me vendet e tjera të botës, se ishte e domosdoshme që ndikimi i Kinës socialiste të ndihej në të gjitha kontinentet dhe kjo të shkonte në favorin e luftërave nacionalçlirimtare të popujve, në favorin e revolucionit proletar. Mirëpo Kina dhe Partia Komuniste e Kinës as ua vinin veshin fare sugjerimeve dhe pikëpamjeve tona lidhur edhe me këtë problem të rëndësishëm. Ato i gzykonin këto nga lart.

Konkretisht Kina u fut në brazdën antisocialiste dhe kjo përcaktoi akoma më qartë ideologjinë, strategjinë dhe taktikat e saj: miqësi dhe aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga e cila Kina do të përfitojë në teknologji, në ekonomi dhe në armatime;

Kina është, gjithashtu, për miqësi dhe aleancë edhe me të gjitha vendet e tjera kapitaliste të zhvilluara, nga të cilat do të marrë kredi për teknologji të re dhe për armatime. Për sa u përket vendeve të tjera, nga të cilat nuk do të nxirrte dot as kredi, as teknologji, ndaj tyre Kinës i duhej të ndikonte me politikën e saj gjoja socialiste, dashamirëse, mbrojtëse dhe kështu javash-javash, në këtë bosht miqësie Kinë-Amerikë, të krijonte terren të favorshëm për një rritje të hegjemonisë së vet të ardhshme. Nga kjo strategji Mao Ce Duni doli me një «analizë gjeniale» të ndarjes së botës në «tri botë».

Gjatë kësaj kohe, si rezultat i strategjisë së Maos, në Kinë u bënë ndryshime të mëdha. Atje erdhën në fuqi elementë si «Hrushovi numër dy» i Kinës, Ten Hsiao Pini, element kryesor i grupit reaksionar të Liu Shao Çisë. Çu En Lai mori krahë për ta zhvilluar si duhej këtë strategji në drejtim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të kapitalit botëror, dhe, tok me Maon, likuiduan Revolucionin Kulturor. Ky revolucion, në fakt, nuk kishte orientime të qarta, revolucionare, proletare. Ai kishte për qëllim vetëm që Mao Ce Duni t'i merrte fuqinë nga duart Liu Shao Çisë, ta likuidonte fuqinë e këtij të fundit dhe të arrinte në ato përfundime që arriti.

Kam mendimin se Liu Shao Çia ka qenë më i djathtë nga Mao Ce Duni dhe ishte ai mbështetësi i borgjezisë kompradore, kurse Maoja ishte mbështetës i borgjezisë nacionale. Maoja nuk e luftoi borgjezinë nacionale, përkundrazi, e ruajti. Elementët e kësaj bor-

gjezie merrnin fitime si në fabrika, ashtu edhe në komuna. Këta do të ishin, dhe në fakt janë, ndihmësit kryesorë të politikës aktuale që ndjekin Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini, e cila është rrjedhim i boshtit të politikës proamerikane të Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait.

Vdiq Çuja, vdiq dhe Maoja pas tij, dhe që të dy lanë si trashëgim një turbullirë të madhe në Kinë. Kush do ta merrte fuqinë? «Katërshja»?! Hua Kuo Feni me sigurimin, Ten Hsiao Pini, Jeh Çien Jini e shumë e shumë renegatë të tjerë me përkrahësit e tyre lëvizën dhe u arrit në atë që dimë, në grushtin e shtetit. U bë si kurdoherë puçi ushtarak, por kësaj radhe i kryesuar nga Hua Kuo Feni; u bënë arrestimi dhe likuidimi i «katërshes» dhe sjellja përsëri në fuqi e Ten Hsiao Pinit të rrëzuar dy herë si antimarksist, revizionist dhe kundërrevolucionar. Por Hua Kuo Feni tok me Jeh Çien Jinin dhe me Ten Hsiao Pinin trashëguan një Kinë të çoroditur ideologjiksht, politikisht, por të dëmtuar edhe ekonomikisht. Kjo shkaktoi një konfuzion të madh politik dhe një çorganizim gjithashtu të madh, që dëmtoi prodhimin dhe i krijoi Kinës situata të vështira si brenda vendit, ashtu edhe jashtë. Si pasojë e kësaj, Kinës i duheshin dhe do t'i duhen akoma vite që të marrë veten në rrugën që ajo ka vendosur të ecë, jo në rrugën socialiste, sepse Hua Kuo Feni me Ten Hsiao Pinin i vunë barrikadë edhe asaj rruge «socialiste» që konsiderohej se gjoja ndiqte Kina në kohën e Mao Ce Dunit.

Hua Kuo Feni me Ten Hsiao Pinin kanë deklaruar zyrtarisht se Revolucioni Kulturor mbaroi në Kinë.

Domethënë ata morën fuqinë dhe vendosën që atje nuk do të ketë më as revolucion proletar, as **Revolucion Kulturor Proletar**. Pra në Kinën aktuale, ku vazhdohet me sloganin se do të «lulëzojnë njëqind lulet» dhe do të «konkurrojnë njëqind shkollat», në fakt nuk do të lulëzojë asnjë prej tyre, por do të vendoset diktatura e borgjezisë së egër fashiste. Zaten Hua Kuo Feni me Ten Hsiao Pinin, nëpërmjet të gjitha organeve të shtypit e të propagandës, flasin se «duhet vendosur disiplina kudo». Kjo do të thotë se duhet shuar me gjak çdo rezistencë kundër kësaj diktature fashiste. Pra, klika e ardhur në fuqi në Kinë dëshiron ta vendosë me dhunë «unitetin». Një gjë e tillë është në platformën e brendshme, kurse në platformën ndërkombëtare, domethënë në politikën e jashtme, kjo klikë vazhdon të mbajë në fuqi sloganin e «tri botëve». Mirëpo «tri botët» nuk kanë unitet as brendapërbrenda secilit vend, as me njëra-tjetrën. Këtu qëndron aberracioni i kësaj teorie absurde, nëpërmjet së cilës Kina kërkon të vendosë hegjemoninë dhe të bëhet një superfuqi botërore. Derisa nuk ekziston uniteti në mes shteteve që formojnë këto «tri botë» të ndryshme, do të thotë se në to ekzistojnë diversiteti dhe dualiteti i përhershëm, për arsye të kontradiktave të mëdha që ekzistojnë në mes tyre. Në këto shtete mbretëron ligji i xhunglës. Pikërisht në këto të ashtuquajtura tri botë «lulëzojnë njëqind lule dhe konkurrojnë njëqind shkolla», prandaj nuk është aq e lehtë për Kinën e Hua Kuo Fenit që të vendosë pushtetin e saj në unifikim të këtyre «tri botëve», siç bën me diktaturën borgjeze që po vendos brenda në vend.

Këtë situatë nuk e kishin parashikuar as Maoja, as Hua Kuo Feni, as Ten Hsiao Pini. Ata kishin menduar se do t'u imponoheshin popujve, shteteve dhe botës me një teori të tillë ideologjike dhe politike. Por, për fat të keq të tyre, kjo teori nuk mundi të ketë sukses.

Të predikosh unitet me gjysmën e «botës së parë», ose unitet në «botën e dytë», ose në «botën e tretë», nën drejtimin dhe parullën e kinezëve, se gjoja tërë këto «botë» rrezikohen nga socialimperializmi sovjetik, do të thotë të kesh një pikëpamje dritëshkurtër dhe të mos marrësh parasysh as situatat ndërkombëtare, as kontradiktat që brejnë kapitalizmin, as fazën e kalbëzimit të imperializmit dhe të revolucioneve proletare.

Kjo politikë dritëshkurtër reaksionare e Kinës e ka futur këtë në një rrugë pa krye. Prandaj politika kineze gjendet dhe do të gjendet në një balotazh¹ të përhershëm dhe, ca më keq akoma, ky balotazh do të karakterizohet vazhdimisht nga disfata të rënda, për arsye se politika e secilës prej këtyre «tri botëve», që Kina do të përpiqet t'i manovrojë sipas pikëpamjes së saj «shumë të zgjuar», do të ketë prirje jo për unifikim, po për dominim dhe për përçarje. Kjo gjë bie në kundërshtim me qëllimet e Kinës, e cila do të përpiqet t'i bashkojë «dhentë» në shkopin e vet, por ja që «dhentë» s'janë dhen, por janë ujë dhe ujku ujku e njeh. Bisha rron në pyll, dhe pylli është xhungël.

Me këtë politikë që ndjek Kina në arenën ndër-

1. Nga frëngjishtja — këtu me kuptimin e luhatjes, lëkundjes, paqëndrueshmërisë.

kombëtare, ç'qëndrim duhet të mbajë ndaj manovrës amerikane në Lindjen e Mesme? Kina ka për qëllim të ruajë statukuonë në këtë zonë të botës, Egjiptin ta kthejë në një partner të bindur të saj; ajo kërkon që edhe vendet e tjera arabe ta njohin e ta respektojnë. Njëkohësisht kjo manovër synon të mbajë të përçarë popujt arabë. Natyrisht, në këtë rrugë që ka zënë, Kina duhet të mbajë dhe mban në fakt anën e amerikanëve, domethënë mbështet krerët arabë proamerikanë, mbështet dhe Izraelin, është pra për një paqe ala amerikane, ku të mos fitojnë liria dhe pavarësia e popujve arabë, por lakmitë e fashistëve izraelitë dhe të pasanikëve egjiptianë, arabosauditë etj.

Del qartë që kjo pozitë e kinezëve është antimarksisiste. Kina është e detyruar ta mbajë këtë pozitë dhe në sy të të gjithë popujve arabë të hiqet se gjoja i ka mbrojtur dhe i mbron, por në fakt ajo nuk mbron asnjë nga këta popuj, nuk mbron aspiratat e tyre të çlirimit nacional, por mbështet kapitalizmin dhe imperializmin.

Një qëndrim të tillë të Kinës e kanë vënë re edhe më parë të gjitha vendet e së ashtuquajturës botë e tretë, por sidomos tashti ato kanë dyshime të mëdha te Kina, prandaj nuk e pëlqejnë politikën kineze dhe po luftojnë kundër saj. Bile nuk kanë besim te Kina as ato shtete të kësaj «bote të tretë» që hiqen gjoja prokineze, pavarësisht se krerët e tyre kanë vajtur një herë në Kinë si, për shembull, Mobutu i Zaires etj. Kjo ndodh sepse ata e dinë që Kina nuk ka asnjë influencë dhe nuk luan asnjë rol për fatet e tyre, prandaj kjo le t'i bjerë sa të dojë trumbulekut për ta. Fatet e këtyre klikave kapitaliste që sundojnë në këto vende,

janë në duart e imperializmit amerikan, siç është aktualisht në duart e socialimperializmit sovjetik fati, për shembull, i Etiopisë, i Angolës ose i ndonjë vendi tjetër.

Prandaj politika e jashtme kineze e «tri botëve», e bashkimit në një bllok të vetëm të të gjitha vendeve kundër socialimperializmit sovjetik, jo vetëm ka hasur në pengesa, por ka pësuar edhe dështime. Këto dështime do të jenë të njëpasnjëshme, ashtu sikundër janë situatat koniunkturale që krijohen në mes shteteve të «botëve» të ndryshme siç i quajnë kinezët, për arsye të kontradiktave të mëdha që ekzistojnë në mes tyre, dhe në këto situata Kina nuk di nga t'ia mbajë. Atë që thotë sot, nuk ia vërteton koha nesër dhe kthehet në të kundërtën e asaj që ka menduar e ka shprehur më parë. Në këto situata Kina nuk do të mund të mbajë njëfarë ekuilibri në politikën e saj të jashtme. Jo vetëm që nuk do të mund ta mbajë ekuilibrin siç bëjnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, me të cilët Kina, në heshtje, kërkon të hyjë në konkurrencë për të vendosur edhe ajo dominimin e vet në botë, por as edhe si vendet e tjera kapitaliste, të cilat kanë një përvojë të madhe në politikën e jashtme dhe dinë të manovrojnë, dinë të lidhin dhe të zgjidhin aleanca, dinë të ndërhyjnë me armë, me subversion e një mijë mënyra të tjera.

Kështu, në fund të fundit, Kina do të thotë: «Le të bëhet ç'të bëhet, unë kam vendosur të jem me Shtetet e Bashkuara të Amerikës hëpërhë dhe të marr nga ato dhe nga vendet e tjera të zhvilluara kapitaliste teknologji industriale, bujqësore dhe ushtarake, pra të rregulloj ekonominë dhe gjendjen time dhe të qëndroj

kurdoherë në kundërshtim me atë superfuqi që kundërshton politikën time dhe politikën e mikut tim të madh, Shteteve të Bashkuara të Amerikës». Ky është kursi antimarksist që do të ndjekë Kina në politikën e jashtme të saj.

Aktualisht, përpara këtyre disfatave të politikës së Kinës në arenën ndërkombëtare, shohim se udhëheqja revizioniste kineze e kryesuar nga Hua Kuo Feni nuk po ndihet, nuk po flet, nuk mban qëndrime për ngjarjet e rëndësishme që ndodhin në botë. Po përse nuk mban qëndrime? Sepse e sheh që çdo hap që hedh është një disfatë për të. Prandaj ajo qëndron në heshtje, ose shpreh nën buzë ndonjë mendim çapraz që s'gënjen dot kurrkënd, vetëm shquhet, si të thuash, për anti-sovjetizmin e saj dhe kaq. Por edhe antisovjetizmin ajo e ka ulur disi, për arsye se, duke pasur një politikë shumë të lëkundshme, nuk do t'i shkojë deri në fund luftës kundër socialimperializmit sovjetik, do t'i lërë dyert të hapura që ta ketë më të lehtë për të manovruar në rast se dështon në aleancën që ka me imperializmin amerikan. Kjo është e natyrshme. Në rast se Kina do të vazhdojë të bëjë një politikë të tillë koniunkturale, antimarksiste, kapitaliste, duhet edhe ajo të bëhet një politikane akrobate, ndryshe nuk ka si të qëndrojë në këtë rrugë, se nuk e lënë të tjerët të jetojë. Ajo mund të jetonte, mund të triumfonte, mund të qëndronte kryelartë vetëm në rast se do të mbronte socializmin, në rast se do të udhëhiqej nga teoria marksiste-leniniste; por kjo gjë ka vdekur për të. Kina ka mbaruar në batak dhe politika e saj antimarksiste do

ta fundosë atë akoma më shumë. Vetëm një revolucion i vërtetë proletar mund ta shpëtojë Kinën nga kjo humnerë, nga kjo tragjedi.

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha, «Shënime
për Kinën», vëll. II,
f. 720*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Shënime për
Kinën», vëll. II, f. 720*

ÇDO GJË DUHET BËRË SA MË E STUDIUAR, ME PËRGJEGJËSI E NË BAZË TË DIREKTIVAVE TË PARTISË

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

24 dhjetor 1977

Në këtë takim shoku Hekuran Isai informoi për disa probleme të punës së Partisë në rrethin e Durrësit.

Unë mendoj se të gjitha këto që na u thanë janë shumë interesante, por nuk duhet të mbetemi vetëm në konstatime. Me këtë nuk dua të them se nuk po punohet në këtë drejtim, sepse përpjekje bëhen dhe mjaft gjëra janë realizuar. Por ka edhe shumë detyra të tjera që nuk po realizohen e po zvarriten. Jo vetëm kaq, por për disa prej tyre as që vihet fare uji në zjarr: është mjaftuar duke shtruar parimet, duke dhënë disa direktiva dhe vetëm kaq. Mirëpo kjo është krejt e pamjaftueshme.

Prandaj mendoj që për të gjitha çështjet që u prekën sot këtu, të organizojmë një mbledhje me kua-drot kryesorë të të gjithë atyre sektorëve që u takon

të merren me këto probleme. Konkretisht, me këto që u thanë, kanë të bëjnë më shumë dy ministri, ajo e Industrisë dhe e Minerave dhe ajo e Tregtisë. Pra, në këtë rast të mos bëhet mbledhje e gjerë, me qindra vota. Nga çdo dikaster apo institucion që ka të bëjë me këto probleme, për shembull, mund të thirren ministri, zëvendësministrat dhe ata kuadro kryesorë, si drejtorë e kryetarë degësh, që kanë përgjegjësi dhe që merren me këto punë. Mendoj, gjithashtu, të mos thirren as drejtorët e ndërmarrjeve vartëse, cilatdo qofshin këto, me qëllim që të vëmë përpara përgjegjësisë kuadrot kryesorë.

Nuk është hera e parë që Partia e ngre në një shkallë të gjerë çështjen e kooperimit e të revolucionit tekniko-shkencor. Në këtë fushë, krahas realizimeve mjaft të mira, siç thashë, ka akoma shumë gjëra për të cilat nuk është treguar vëmendja e duhur. Po ku hasen vështirësitë në këto mosrealizime dhe cilët janë faktorët që pengojnë? Mos pengon vallë ministria? Ka pengesa në planifikim, apo pengon çështja e njëfarë kompetence në kuptimin e ngushtë të fjalës? Më së fundi, mos pengon gjë mosakordimi i sasisë së nevojshme të valutës për porositjen e këtij apo të atij materiali etj.? Pastaj, këto kërkesa mos kanë të bëjnë edhe me materiale që disponohen nga rezervat e shtetit apo të ministrive etj.? Mendoj se këto çështje duhen sqaruar. Prandaj thashë që të thirren në një mbledhje drejtuesit e ministrive e t'u thuhet atyre disa gjëra konkrete, duke u dhënë, së pari, eksperiencën pozitive të rrethit të Durrësit. Pastaj t'u tërhiqet vëmendja se kjo është eksperiencia e një rrethi, por ashtu si në Durrës mund

e duhet të punohet kudo në vendin tonë. Kështu, në një mbledhje tjetër, në shkallë më të gjerë, mund t'u vihet në dukje pjesëmarrësve se edhe në mjaft rrethe të tjera, sidomos në ato më kryesoret, si në Korçë, në Tiranë, në Shkodër etj., ka mundësi të krijohen kushte dhe të zgjidhen në këtë rrugë mjaft probleme të mëdha. Kam mendimin se një gjë e tillë duhet të bëhet.

Por lidhur me këtë çështje të bëjmë shumë kujdes që të ruhem nga rutina. Problemi nuk duhet shtruar, siç ndodh në ndonjë rast, sa për të shkuar radhën. Po të veprohet kështu, ata që do të marrin pjesë në mbledhje të tilla, do të krijojnë mendimin se këto që po u thuhën i dinë të gjitha. Çështja është që të gjejmë mënyrat dhe format që këto që po diskutojmë, së pari, të detajohen nga ana e tyre. Pastaj të studiohen me shumë kujdes se cilat ka mundësi të bëhen dhe të marrin masa për të kontrolluar zbatimin e tyre. Për të gjitha këto probleme ata të vijnë edhe këtu e të njoftojnë se kjo do të bëhet e kjo tjetra nuk mund të bëhet për arsye se nuk kemi lëndë të parë, ose nuk disponojmë devizë etj., prandaj, në rast se është e domosdoshme, duhet të ndërhyri në Qeveri. Për ato gjëra që gjykohet se janë të nevojshme të bëhen, pse japin rezultate të mira dhe kanë mundësi t'i prodhojnë, të mos pyesin njeri, por të marrin masa e t'i bëjnë. Por, vetëm kujdes! Asgjë të mos prodhohet kot! Kështu, më duket mua, duhet ta bëjmë këtë mbledhje.

Njerëzit tanë kurdoherë kanë menduar dhe mendojnë për ta çuar prodhimin përpara, por tani e tutje ata duhet ta vrasin mendjen më shumë. Le të marrim, për shembull, problemin e farës që u zu në gojë këtu.

Të gjithë kemi folur për këtë çështje. Dihet se toka është mëma dhe fara që hidhet në gjirin e saj është embrioni, është celula e parë e prodhimit bujqësor. Shaqir Koni¹ që foli në Durrës për këtë problem, ka qenë kryetar kooperative dhe ka përvojë, është nga njerëzit tanë më kompetentë për llojet e farërave të pambukut, për trajtimin e tyre dhe për plot çështje të tjera që lidhen me to. Ne këtu kemi folur dhe flasim në parim për këto çështje dhe, natyrisht, për detyrën që kemi, nuk mund të bëjmë më tepër. Por agronomi që është ngarkuar të merret me pambukun në një ndërmarrje apo kooperativë bujqësore, e ka për detyrë t'i dijë këto probleme më mirë nga Shaqir Koni. Mirëpo, në realitet është ky që i di këto çështje më mirë nga një agronom. Ai me të drejtë flet me njëfarë revoltimi se po abuzohet me farën, duke vënë në dukje dëmet e mëdha që kemi nga trajtimi i saj në mënyrë joshkencore. Prandaj, kur të bisedohet me ata që do të thirren në mbledhje, mund t'u thuhet përse nuk marrin masa që të vihen në jetë këto detyra, përderisa i dinë. Në qoftë se nuk bën Fabrika e Zhveshjes së Pambukut, atëherë shtrohet problemi: me ato fabrika që kemi ndërtuar këtu e afro 30 vjet përpara do të rrimë? A nuk mund t'i bëjmë sot disa modifikime kësaj fabrike për të zgjidhur dhe problemin e farës?

Një punë e tillë, mendoj unë, mund dhe duhet të bëhet, por, siç thashë, nuk mendohet thellë për këtë problem, nuk vihet sa duhet uji në zjarr. Bile as ata

1. Hero i Punës Socialiste, në atë kohë kryetar i këshillit popullor të fshatit të bashkuar Maminas.

që janë përgjegjës e kompetentë nuk marrin mundimin për zgjidhjen e problemeve të tilla kaq të rëndësishme, siç është ai i rritjes së prodhimit dhe i përmirësimit të cilësisë së pambukut, dhe nuk insistojnë që këto të rregullohen. Prandaj Ministria e Bujqësisë ta marrë më mirë në dorë situatën për problemin e farërave të pambukut dhe sa më parë të interesohet që të gjitha proceset e punës që kanë të bëjnë me nxjerrjen dhe me trajtimin e këtyre farërave, të ndiqen nga ana e saj. Me këtë rast, pra, duhen rishikuar edhe këto gjëra.

Ne, gjithashtu, kemi diskutuar dhe kemi vendosur që pambukut t'i jepen tokat më të përshtatshme. Dërisa është kështu, në qoftë se nga lart dërgohen urdhra të tjerë që shkaktojnë spostimin e pambukut nga toka të tilla, do të thotë që këta urdhra të rinj bien në kundërshtim me vendimin që është marrë. Atëherë, atyre që veprojnë kështu, u duhet tërhequr vëmendja. Mundet që një urdhër i tillë nuk jepet fare hapur në kundërshtim me vendimin, por u bëhet presion rretheve që të mbjellin sa më shumë misër në toka nën ujë etj. Drejtuesit e rretheve në këtë rast nuk duhet të veprojnë në tym; ata kanë të drejtë të përgjigjen se misër në toka nën ujë mund të mbjellim vetëm deri në njëfarë mase dhe jo më tej, për arsye se nuk mund të spostojnë pambukun nga tokat nën ujë për hir të misrit, dhe t'u kujtojnë këtyre lart, që japin të tillë urdhra, se ka dhe një direktivë nga Komiteti Qendror që pambukut duhet t'i caktohen tokat më të mira dhe të mos lëvizin nga kjo direktivë! Në qoftë se ndodh që dikush në një kooperativë vepron ndryshe, sepse shikon interesin e ngushtë të ekonomisë së vet ose të rrethit, në këtë rast me

domosdo duhet të ndërhyjë Ministria e Bujqësisë dhe ta ndreqë gabimin. Çështja është që çdo gjë duhet bërë sa më e studiuar, me përgjegjësi dhe në bazë të direktivave të Partisë.

Në qoftë se pambukut do t'i jepen tokat më të mira, siç kemi vendosur, leverdia e tij ekonomike, natyrisht, do të jetë e madhe. Por, për të pasur rezultatet e dëshiruara, kërkohet që kësaj bime t'i bëhen të gjitha shërbimet që parashikohen në kodin agroteknik, duke filluar që nga zgjedhja e trajtimi i farës, ndryshe, vërtet mund të okupohen tokat më të mira dhe nën ujë, po rendimentet në prodhim do të jenë të ulëta. Është e natyrshme që në këto rrethana kjo bimë nuk mund të dalë me leverdi. Ndërsa mbi ujë, po, ndryshon puna, po të merren 13 kuintalë e më shumë për hektar, duke i bërë bimës një shërbim sa më të kualifikuar, atëherë rritja e pambukut mund të jetë e leverdishme.

Çështjen e shtroj në përgjithësi, që me këtë rast t'i jepet një shtytje përpara thellimit të revolucionit tekniko-shkencor, për arsye se ka akoma mundësi shumë të mëdha të pashfrytëzuara për sa u takon mjeteve mekanike dhe njerëzore. Ne sot kemi shumë më tepër mundësi për t'ia arritur këtij qëllimi. Ne kemi, gjithashtu, njerëz të mësuar, të zotë, me iniciativë dhe me prirje për t'iu futur këtyre punëve. Është e vërtetë që nevojat e vendit tonë sot në këtë drejtim janë më të mëdha, por edhe mundësitë për t'i plotësuar ato me forcat tona të brendshme janë shtuar shumë.

Të tërë kemi thënë dhe vazhdojmë të theksojmë që importimet nga jashtë të shkurtohen. Po ja që në praktikë këtë direktivë të dhënë këtu e shumë vjet më

parë, nuk e kemi realizuar si duhet. Po çfarë kemi thënë ne? Konkretisht, kemi thënë që të gjitha ato makineri e pajisje që kemi mundësi t'i bëjmë vetë brenda vendit, duke sjellë nga jashtë vetëm disa pajisje plotësuese, t'i prodhojmë sa të jetë e mundur më shpejt. Por kjo detyrë duhet të realizohet hap pas hapi dhe në bazë të një grafiku. Këtë vit, për shembull, do të bëjmë këtë pjesë të një impianti industrial; vitin tjetër të bëjmë përpjekje që të prodhojmë pjesën tjetër dhe kështu, si të kalojnë jo më shumë se dy vjet, ky impiant të ngrihet i tëri në këmbë dhe të japë prodhim. Prandaj në këtë drejtim, pasi të vendoset për një gjë, duhet ndjekur e kontrolluar me kujdes se çfarë është bërë dhe çfarë nuk është bërë, me qëllim që objekti të realizohet në kohën e parashikuar. Po të bëhet bilanci i këtyre çështjeve, do të na dalë se shumë gjëra të rëndësishme e interesante, që mund të prodhoheshin në vend, akoma nuk janë bërë.

Problem i madh dhe i rëndësishëm për ne në fazën e tanishme është edhe transporti. Duke e njohur rëndësinë e këtij problemi dhe duke ditur edhe mundësinë që kemi për të ndërtuar vetë anije me kapacitet transportimi 3-5 mijë tonë, përse të mos i hyjmë kësaj pune e t'i bëjmë vetë me forcat tona, në vend që t'i blejmë jashtë? Kjo është me leverdi të madhe ekonomike, mendoj unë, prandaj t'i prodhojmë e t'i përdorim dhe jo t'i lëmë pa i ngarkuar këto mjete me vlerë.

Meqenëse e kemi fjalën për transportin, të kujdesemi, gjithashtu, që edhe t'i kombinojmë mirë punët në këtë sektor. Për shembull, për të lehtësuar ca çështjen e devizës, mund të merremi vesh me ndonjë nga

shtetet që bëjmë tregti që mallrat tona t'i çojmë deri në një nga portet e tyre me mjetet që kemi vetë, në vend që të vijmë vaporët e huaj deri në Durrës dhe të ngarkohen me mallrat që eksportojmë. Me këtë mënyrë mund të ekonomizojmë ca devizë. Çështjen e kam këtu, që shumë gjëra ka mundësi të bëhen dhe të kemi përfitime në vlera monetare dhe në kohë.

Pra, aktualisht kërkohet që t'i japim një shtytje të mëtejshme kooperimit dhe revolucionit tekniko-shkencor në të gjitha pjesët përbërëse të tij. Për këtë qëllim u përmend këtu edhe Akademia e Shkencave.

Konstatojmë se nuk po na ecën si duhet shfrytëzimi i projekteve, i teknologjisë e i gjithçkaje tjetër që është sjellë nga vendet e tjera në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit tekniko-shkencor që kemi. Gjithë këto materiale janë me vlerë të madhe për ne, por ato, ndonjëherë, nuk dihet se ku ndodhen, mbasi janë të shpërndara andej-këtej e nuk ka evidenca të plota, nuk ka informacion e komunikim shkencor. Dhe informacioni e komunikimi shkencor mendoj se duhet të bëhet nga një qendër: ose nga Akademia e Shkencave, ose nga institucionet përkatëse që i disponojnë këto të dhëna. Qoftë në Akademinë e Shkencave, ashtu edhe në çdo institucion tjetër, duhet të ketë njerëz që t'u punojë koka, të dinë me saktësi se çfarë librash e literature tjetër shkencore ka për teknologjinë, për shembull, në bibliotekat e tyre. Veç kësaj, të mendojnë se ky ose ai libër i intereson këtij apo atij institucioni apo sektori, ky tjetri një institucioni apo sektori tjetër e kështu me radhë. Atëherë për këta libra e dokumente duhet të hartohet një buletin periodik ose një-

farë informacioni shkencor, i cili të dërgohet kohë pas kohe në adresat përkatëse, ku duhen shfrytëzuar këto materiale. Për këtë qëllim çdo institucion e ndërmarrje duhet të caktojë specialistët e vet që t'i lexojnë dhe t'i studiojnë materialet përkatëse, të nxjerrin detyra dhe t'i zbatojnë ato me këmbëngulje sipas mundësive që kemi. Në qoftë se nuk do të bëhet mirë kjo punë jo vetëm që nuk do të realizohen shumë gjëra, por nuk do të ndihmohet as për zhvillimin e mëtejshëm të intelektualit të inxhinierëve dhe të specialistëve tanë, kusht ky, i domosdoshëm për kualifikimin dhe aftësimin e tyre, pa përmbushjen e të cilit nuk mund të ecet përpara në fushën e kooperimit dhe në revolucionin tekniko-shkencor. Në fakt, këta përpiqen, lexojnë e studiojnë literaturë nga gjejnë e nga nuk gjejnë. Prandaj nuk është aspak e mirë që në këto materiale me vlerë t'i kemi në vendin tonë dhe të mos i vëmë në dispozicion të specialistëve që t'i shfrytëzojnë për të revolucionarizuar prodhimin.

Po si duhet bërë kjo punë? Në një mënyrë ose në një tjetër afërsisht ashtu si po veprohet në disa raste. Për shembull, kam parë që Ilo Kodra, i cili punon këtu në aparat me shokun Ramiz, përgatit vazhdimisht disa skeda lidhur me ato se ç'kanë thënë Marks, Engelsi, Lenini dhe Stalini për këtë apo atë problem, ose çfarë thuhet për këto probleme në materialet e Partisë sonë. Kjo është një punë e mirë, më duket mua. Në këtë mënyrë veprojnë edhe disa biblioteka. Por tani kjo punë duhet riorganizuar mbi baza shkencore dhe të bëhet kudo, që të shërbejë në mënyrë sa më efektive, e në një shkallë sa më të gjerë.

Nuk mund të lejohet që Akademia e Shkencave të mbajë tërë ata njerëz në aparatit e saj dhe të mos bëjë një punë të tillë për t'u ardhur në ndihmë ndërmarrjeve dhe institucioneve të ndryshme të vendit tonë. Kështu duhet të veprojnë universiteti e të gjitha shkollat e tjera të larta, Biblioteka Kombëtare, Komisioni i Planit të Shtetit, Presidiumi i Kuvendit Popullor etj. për çështjet që mbulon secili dikaster apo institucion. Përse mbahen njerëz të veçantë, apostafat për këtë qëllim, në disa degë të caktuara të tyre? Vallë vetëm sa për t'i dërguar nga 15 ditë në rrethe? Atyre u duhet kërkuar hesap, dhe shumë bile, edhe në këtë drejtim, duke u thënë: «Keni ju dokumentacione për këtë ose për atë punë që ka të bëjë me sektorin që merreni, mbasi ato na duhen?». Në Presidiumin e Kuvendit Popullor, për shembull, duhet t'u kërkohej punonjësve të Drejtorisë së Ligjshmërisë nëse i kanë të skeduar kushtetutat e vendeve të ndryshme, si fjala vjen të Bashkimit Sovjetik, të Kinës etj. Në qoftë se nuk i kanë, ata duhen pyetur: «Atëherë ju çfarë bëni këtu? Ku të vemi t'i kërkojmë ne këto gjëra, në Komitetin Qendror? Përse ju kemi vënë këtu? Partia i ka krijuar këto drejtori dhe degë edhe për këto punë, për të cilat ju duhet të përgjigjeni e bile t'i keni sa më mirë të sistemuara!». Kështu duhet kërkuar edhe nga Akademia e Shkencave.

Për probleme që kanë të bëjnë me projekte e me teknologji të ndryshme, edhe dikasteret, si ai i Industrisë, fjala vjen, duhet të punojnë në këtë mënyrë me funksionarët e tyre; atyre t'u caktohen edhe detyra të tilla dhe të vënë mirë në evidencë bibliografinë,

kartotekat, skedarët, studimet e kryera etj. Akademia e Shkencave, si një institucion që koordinon veprimtarinë shkencore të të gjithë republikës, duhet të dijë mirë, në radhë të parë, ç'ka vetë në të gjithë sektorët e aparatit të saj, po nëpërmjet çdo sektori duhet të dijë edhe se ç'kanë të tjerët. Gjithashtu ajo duhet të orientojë e të udhëzojë se si duhet të bëhen këto punë. Akademia, duke ditur mirë çfarë disponojnë entet e ndryshme, duhet të jetë në gjendje që për diçka, brenda pesë ose dhjetë ditëve, për shembull, të të japë në dorë atë që të intereson kur ta kërkojë. Ajo të vihet në lëvizje dhe të drejtojë jo në përgjithësi, por konkretisht. Pra Akademia e Shkencave duhet të përgjigjet edhe për të tilla probleme.

Prandaj, më duket mua, në të gjitha këto drejtime duhet parë se si shkojnë problemet e revolucionit tekniko-shkencor në rrugë shtetërore dhe si po zbatohen orientimet e Komitetit Qendror për këtë çështje. Ne e kemi për detyrë të vëmë në dijeni si Partinë, ashtu edhe shokët që punojnë në organet e ndryshme shtetërore, se si paraqiten problemet e kooperimit dhe të revolucionit tekniko-shkencor në bazë të detyrave që kanë shtruar Kongresi i 7-të i Partisë, Komiteti Qendror e Byroja Politike e nëse ato po ecin me atë ritëm që kërkohet, për arsye se vihet re, siç e vura në dukje edhe më lart, se megjithëse disa detyra janë kryer, prapë ka akoma shumë të tjera që kanë ngecur në mes të rrugës, në një kohë që mundësitë të ne janë sot shumë më të mëdha. Prandaj duhet të organizohet mirë puna, se pikërisht këtu është dhe kyçi i çështjes: tek organizimi i punës.

Problemi i kooperimit te ne ka kohë që ka filluar. Mjaft probleme po zgjidhen nëpërmjet kooperimit të madh, si i thonë. Por duhet të ekzistojë e të fuqizohet më shumë edhe një kooperim tjetër, kooperimi që quhet i vogël, i cili, gjithashtu, krijon mundësi të mëdha prodhimi që nuk arrihen të realizohen dot me kooperimin e madh. Një kooperim i vogël të krijon, fjala vjen, vinçat që zëvendësojnë punën e qindra punëtorëve të ngarkim-shkarkimit dhe ata që iu futën kësaj pune e realizuan këtë. Një uzinë e vogël është ajo në Rrogozhinë, por, siç e dëgjuam të flitet këtu, atje u ngritën gjithë ato linja të reja prodhimi. Ky është një kooperim shumë i vogël, por rezultatet e tij kanë sjellë përfitime të mëdha. Neve na intereson shumë kooperimi i madh për të prodhuar, për shembull, një sondë që të shpojë edhe më thellë se ato të tanishmet, punë kjo me vlerë të madhe. Por, për të arritur që ta prodhojmë vetë, me forcat tona, këtë sondë, duhet t'u krijojmë njerëzve tanë të gjitha kushtet dhe mundësitë. Krahas të tilla ndërmarrjeve, ne nuk duhet dhe nuk mund të neglizhojmë apo të nënvleftësojmë ato mundësi që në pamje të parë mund të duken të vogla, por që në fakt u japin rrugëzgjidhje shumë problemeve konkrete dhe ndihmojnë në zhvillimin e prodhimit. Edhe këto forca ne duhet t'i aktivizojmë sa më shumë.

Kur u fol pas Plenumit të 3-të të Komitetit Qendror¹ për çështjen e revolucionit tekniko-shkencor, çfarë u bë? Abdyl Këllezi mbushi byrotë teknike e teknologjike plot me njerëz dhe u frynë kështu së tepërmi

1. Ky Plenum i zhvilloi punimet më 13-14 tetor 1967.

aparartet e ndërmarrjeve e të institucioneve të ndryshme. Ne e korrigjuam këtë deviacion, por çështja është që byrotë teknike e teknologjike tani duhet të aktivizohen e të veprojnë në mënyrë sa më aktive. Por, që të veprojnë me rendiment, atyre duhet t'u krijohen mundësitë. Në qoftë se për këtë qëllim do të duhen, ta zëmë, edhe dy-tri veta pranë komiteteve ekzekutive të disa rretheve kryesore (dhe natyrisht jo në të tëra, në mënyrë automatike), si, për shembull, në Tiranë, në Shkodër, në Korçë e në Durrës, edhe kjo mund të shikohet, por me kusht që këta njerëz që mund të shtojmë, ta justifikojnë qenien e tyre. Natyrisht, ata të lidhen ngushtë e të kooperojnë mirë edhe me njëri-tjetrin, sepse kështu do të bëhet si duhet kooperimi në shkallë kombëtare.

Prandaj rekomandoj që këto gjëra t'i shtroni në mbledhjen që do të organizoni dhe pastaj të ndiqen nga afër zbatimimi dhe vënia e tyre në jetë sa më shpejt.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga biseda
e incizuar që gjendet në AQP*

A MUND TË QUIHET REVOLUCIONI KINEZ NJË REVOLUCION PROLETAR?

Shënime

26 dhjetor 1977

Natyrisht, për të përcaktuar një problem kaq të rëndësishëm, nga njëra anë duhet të kesh në dispozicion një kohë relativisht të gjatë, të kesh, gjithashtu, dokumente më të gjera e më të sakta për zhvillimin e situatave në Kinë, të cilat janë shumë të komplikuar, të paktën që nga periudha e Sun Jat Senit, e Guomindanit dhe deri në momentet aktuale. Nga ana tjetër, duhet të njohësh zhvillimin e revolucionit në tërësi dhe të Revolucionit klasik Demokratiko-Borgjez Francez, si dhe zhvillimin e revolucioneve demokratiko-borgjeze në vende të tjera.

Revolucionin Demokratiko-Borgjez Francez nuk mund të them se e njoh në gjerësinë dhe në thellësinë e tij, por, sidoqoftë, këtë e njoh më mirë. E kam studiuar jo vetëm në manualët e shkollës, por kam studiuar më pas shumë autorë të rëndësishëm, si Mishëlenç¹,

1. Zhyl Mishële (1798-1874), historian francez.

Matiezin¹, Zhoresin², më vonë Zhorzh Sadulin³ e shumë të tjerë që flasin për këtë revolucion. Për ne janë të njohura, gjithashtu, vlerësimet e klasikëve të marksizëm-leninizmit mbi revolucionin francez.

Marksii në veprën e tij «Tetëmbëdhjetë brymeri i Lui Bonapartit», kur flet për revolucionin francez e cilëson atë si revolucion të viteve 1789-1814. Por në të njëjtën kohë ai thekson se ngjitja e këtij revolucioni vazhdon deri në vitin 1794. Ai shkruan:

«Në revolucionin e parë francez, pas sundimit të konstitucionalistëve vjen sundimi i zhirondinëve, dhe pas sundimit të zhirondinëve ai i jakobinëve. Secila nga këto parti mbështetet mbi atë që është më e përparuar. Por, porsa njëra nga këto parti e ka shpënë revolucionin aq larg, saqë nuk është më në gjendje ta ndjekë dhe aq më pak ta drejtojë, — kjo parti zhduket dhe dërgohet në gjyotinë nga aleati i saj më i guximshëm. Në këtë mënyrë, revolucionin zhvillohet në vijë të përpjetë»⁴.

Pas përmbysjes së jakobinëve revolucionin «merr të tatëpjetën», fillon periudha e kundërrevolucionit, megjithëse në pushtet mbetet borgjezia. Përveç këtyre, ne njohim mirë procesin e zhvillimit të revolucionit pro-

1. Albert Matiez (1874-1932), historian francez.

2. Zhan Zhores (1859-1914), historian francez.

3. Publicist e shkrimtar francez (1904-1967).

4. K. Marks e F. Engels, «Vepra të zgjedhura», vëll. I, Tiranë, 1975, f. 275.

letar, teorinë dhe praktikën e tij, se e kemi studiuar me hollësi në veprat e klasikëve tanë të mëdhenj, Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Kemi njohur e kemi studiuar zhvillimin dhe fitoren e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit në Bashkimin Sovjetik, të revolucionit proletar të ne dhe në vendet e tjera të ashtuquajtura socialiste, të cilat aktualisht, ashtu si Bashkimi Sovjetik, janë kthyer në vende kapitaliste.

Të gjitha këto i them se, për të bërë një studim të saktë, të drejtë dhe të thellë të këtij problemi që na intereson aktualisht, domethënë për të përcaktuar karakterin e revolucionit kinez dhe etapat e ndryshme nëpër të cilat kaloi ai, duhet të kesh njohuri, të dish sidomos momentet kyç, vendimtare, idetë, luftën e fraksioneve, etapat e ndryshme, forcat lëvizëse, të cilat, të gjitha së bashku, përcaktojnë një revolucion, pastaj të dalësh me një përfundim të drejtë, duke e gjykuar dhe duke e analizuar çështjen në tërësi e në mënyrë shkencore nën prizmin marksist-leninist. Megjithatë, edhe me këto njohuri jo të plota që kemi për Kinën, jo të bashkërenduara e jo të klasifikuara si duhet, nëpërmjet ballafaqimit e paralelizmave, disa herë ndoshta jo aq të përpiktë, mund të japim një mendim për revolucionin atje, që deri tani është quajtur «socialist», «proletar», por që në fakt nuk duket të ketë qenë i tillë.

Në bazë të reflektimeve të mia, sidomos pas gjithë këtyre që kanë ngjarë e po ngjasin në Kinë, natyrisht, pa pretenduar se ato përbëjnë një studim të thellë, kam mendimin se në Kinë nuk është bërë një revolucion proletar, siç quhet dhe siç ishte Revolucioni i Madh Socialist i Tetorit. Këtu nuk e shtroj çështjen se duhe-

shin djegur etapat e revolucionit borgjez dhe të kalohet drejtpërdrejt në revolucionin socialist.

Në Kinë Sun Jat Seni, me luftën e tij, në udhëheqje të Guomindanit, duke kaluar përmes shumë luftërash e përpjekjesh, megjithëse nuk e përfundoi veprën e tij, mundi të rrëzonte monarkinë dhe të vendoste republikën, të formonte qeverinë demokratike të Kantonit, por pa mundur të unifikonte Kinën. Kjo republikë kineze ishte një republikë «demokratiko-borgjeze», e paformuar akoma me të gjitha tiparet e karakteristikat e një demokracie borgjeze të përparuar, ndonëse ecte në atë drejtim. Si çdo revolucion demokratiko-borgjez, edhe ai i kryesuar nga Sun Jat Seni dhe nga Guomindani, sipas mendimit tim, zhvilloi një sërë reformash politiko-ekonomike që patën një rezultat, si të thuash, përmirësues dhe që synonin unifikimin e Kinës. Kjo, në këtë kohë, vuante nën sundimin e dyfishtë të monarkisë absolute, të kaosit në provinca, ku mbretëronin «zotërit e luftës» me administratat autonome e me «ushtritë» e tyre gati private, dhe nën sundimin e një sërë shtetesh imperialiste. Këta kishin zënë vend me koncesionet e tyre, kishin ndarë gati gjithë bregdetin përëndimor të këtij vendi të madh, kishin krijuar kolonitë dhe kontuaret e tyre, nëpërmjet të cilave thithnin djersën dhe gjakun e popullit kinez në fitim të metropoleve angleze, amerikane, franceze, gjermane etj. dhe Intrigonin e ndikonin në përçarje e në kaos.

Shpallja e republikës dhe ardhja në fuqi e Guomindanit nuk do të thoshin se u zhdukën borgjezia e madhe

kineze, borgjezia nacionale dhe borgjezia kompradore. Në asnjë mënyrë jo. Kjo borgjezi qëndroi në fuqi dhe vazhdoi t'i mbante, t'i ruante e t'i zhvillonte lidhjet e saj me shtetet imperialiste, veçanërisht me imperializmin amerikan, dhe të krijonte fërkime e çarje që çuan deri në goditje me armë në mes të Partisë Komuniste të Kinës dhe Guomindanit. Bile vjehri i Sun Jat Senit, që ishte edhe vjehri i Çan Kai Shisë dhe bënte pjesë në komitetin ekzekutiv të Guomindanit, ishte një nga borgjezët më të mëdhenj kompradorë të Kinës. Si ky kishte dhe shumë të tjerë.

Sun Jat Seni dhe Guomindani zgjodhën dhe zhvilluan rrugën e reformave demokratiko-borgjeze dhe, megjithëse kishin marrëdhënie miqësore me Bashkimin Sovjetik leninist, ata ishin larg ndjekjes së rrugës leniniste për transformimin e Kinës. Në raportin që bëri i deleguari i Kominternit, më 26 janar 1923, shkruan se Sun Jat Seni kishte thënë se sistemi i sovjetëve nuk mund të futej në Kinë, pasi në këtë vend nuk ekzistonte asnjë kusht i favorshëm për zbatimin e tij. Sun Jat Seni nuk u tregua plotësisht i aftë të përpunonte një program të qartë e të përpiktë për zhvillimin e Kinës. Pikëpamjet dhe prirjet e tij shoqërore ishin radikale në fjalë, por të zbehta në përmbajtje. Prirjet politiko-ideologjike të Sun Jat Senit, të Çan Kai Shisë dhe të Guomindanit në përgjithësi anonin më tepër dhe kryesisht drejt pikëpamjeve demokratiko-borgjeze evropianoperëndimore, të Amerikës dhe të vendeve të tjera si Japonia. Sun Jat Seni, me sa kam lexuar unë, disa herë ka kërkuar të gjente mbështetje, megjithëse

ishin shumë azarduese¹ dhe të rrezikshme, herë në klanet ushtarake të brendshme, herë në fuqitë e mëdha si Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Japonia. Ai ka marrë ndihma prej tyre për mëkëmbjen e regjimit që po krijohet në Kinë. Kuptohet që kjo ndihmë nuk kishte aspak karakter altruist nga ana e rretheve demokratike amerikane. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si një fuqi imperialiste, kërkonin të hidhnin thonjtë e të ngulnin këmbët e tyre në Lindjen e Largme, veçanërisht në Kinë.

Megjithëse Sun Jat Seni mbeti një demokrat përparimtar me prirje liberale, ai ushqente simpati për Revolucionin e Tetorit dhe për Bashkimin Sovjetik. Republika demokratiko-borgjeze e krijuar prej tij lidhi marrëdhënie me Bashkimin Sovjetik dhe pati te Bashkimi Sovjetik dhe te Lenini një ndihmës të fuqishëm për çuarjen më tej të transformimit shoqëror, politik dhe ushtarak që po fillonte në Kinë. Testamenti që la Sun Jat Seni zbulon më së miri dëshirën e tij të zjarrtë për ta çuar gjer në fund revolucionin demokratiko-borgjez dhe besimin e simpatinë që ushqente ai për Bashkimin Sovjetik. Ai e mbyll testamentin e tij me këto fjalë:

«Të dashur shokë, në kohën që unë po ju lë, dëshiroj të shpreh një shpresë të madhe, shpresën që së shpejti do të ndritë agimi, atëherë Bashkimi Sovjetik, miqtë dhe aleatët e tij do ta pranojnë një Kinë të fortë, të zhvilluar dhe të pavarur në luftën e madhe për emancipimin e popujve të botës. Dy vendet tona do të ecin

1. Nga frëngjishtja — të pasigurta.

dora-dorës drejt fitores. Ju drejtoj përshëndetjet vëllazërore».

Në këtë periudhë, kur Guomindani ishte i plotfuqishëm, kur në krye të tij ndodhej Sun Jat Seni, kur republika kineze ishte në zhvillim e në miqësi me Bashkimin Sovjetik të Leninit, më 1921 u themelua Partia Komuniste e Kinës.

Partia Komuniste e Kinës lindi dhe u zhvillua në gjirin e shoqërisë dhe të qytetërimit të vjetër kinez dhe anëtarët e saj të asaj kohe kanë qenë produkt i edukimit intelektual dhe moral konfucian, demokratik liberal dhe më në fund marksist-leninist. Por edhe më vonë nuk mund të thuhet se marksistët kinezë u shkëputën krejtësisht nga qytetërimi tradicional, i cili vazhdoi të ndikojë mbi ta me psikologjinë individuale dhe me psikologjinë nacionale.

Para Revolucionit të Tetorit dhe më pas, përhapja e marksizmit në Kinë mori më tepër karakterin e një lëvizjeje për çlirimin kombëtar sesa shoqëror. Grupet e para marksiste karakterizoheshin nga konfuzioni ideologjik dhe nga një lëkundje në vijën politike. Sho Kian, që para vitit 1966 ishte përgjegjës për çështjet kulturore në regjimin maoist, në një artikull të shtatorit të vitit 1957, shkruan: «Le të hedhim një sy pas, ne ishim të pasionuar për të gjitha njohuritë e reja që vinin nga të huajt dhe ishim në pamundësi të vendosnim ndryshimin në mes anarkizmit dhe socializmit, në mes individualizmit dhe kolektivizmit. Niçja, Kropotkini dhe Karl Marksi na tërhiqnin aq shumë, sa njëri dhe tjetri. Më vonë kuptuam se marksizëm-leninizmi ishte e vetmja e vërtetë dhe arma për të çliruar nje-

rëzimin. Ne besonim në komunizmin abstrakt dhe aktet tona ishin kurdoherë të diktuar nga dëshira e heroizmit individual. Ne nuk kishim kontakte të ngushta me punëtorët dhe me fshatarët, ne u afroheshim shumë pak atyre. Revolucioni demokratik ishte qëllimi ynë imediat, kurse revolucioni socialist ishte një ideal i largët. Shumë kohë ne kemi qenë ndikuar nga individualizmi. Ne kishim ëndërrime si të Ibsenit dhe e dashuronim shumë moton e tij: «Njeriu më i fortë në botë është ai që është më i vetmuar».

Të gjitha këtyre pikëpamjeve të ndryshme ideologjike e politike u duhej vënë një fre, në kuptimin që duheshin spastruar radhët dhe duhej zvogëluar ndikimi i elementëve të cilët ishin demokratë, por nuk ishin marksistë, nuk ndiqnin parimet themelore të marksizëm-leninizmit. Me këtë dua të them që duhej spastruar terreni në mënyrë që të formohej një parti me të vërtetë komuniste, e cila të ndiqte dhe të zbatonte në mënyrë krijuese teorinë e marksizëm-leninizmit në kushtet e Kinës, por ta zbatonte me një kuptim më të thellë dhe më të qartë, sipas ideve që udhëhoqën Revolucionin e Madh Socialist të Tetorit, ideve marksiste të Leninit.

Kominterni këtu dha kontributin e tij dhe ishte ai që ndihmoi në formimin e kuadrove të rinj më radikalë, më të qartë, që erdhën njëri pas tjetrit pas Lëvizjes së 4 Majit të vitit 1919, që nga Li Li Sani dhe deri te Mao Ce Duni. Mao Ce Duni ishte shumë më progresist nga paraardhësit e tij, ishte shumë më revolucionar, më konsekuent për rrugën sovjetike nga Sun Jat Seni, por edhe nga shokët e tjerë më të vjetër, Çen

Du Siu, Li Da Çao e të tjerë. Por, megjithatë, në pikëpamjet e kuadrove të rinj mbetën një ndjenjë e theksuar e nacionalizmit kinez, e pavarësisë së këtij «shteti të madh» dhe ndikime të theksuara të ideve filozofike të vjetra të Konfucit, të Mencit etj. Kjo i pengoi shokët kinezë, që po formoheshin gjatë luftës dhe përpjekjeve, ta konsideronin marksizëm-leninizmin si një busull të vërtetë, që t'i udhëhiqte në pyllin shumë të errët të revolucionit demokratiko-borgjez kinez, dhe të përpunonin një vijë politike marksiste-leniniste me objektiva të qartë, që t'i udhëhiqte pa lëkundje në të gjitha etapat e revolucionit kinez. Mirëpo një gjë e tillë, që prej fillimit e deri më sot, jo vetëm nuk u bë si duhet, por u ruajtën vetëm disa formulime dhe slogane marksiste, kurse në brendi Partia Komuniste e Kinës nuk ishte një parti e vërtetë e proletariatit, një parti e revolucionit, që të siguronte udhëheqjen në revolucionin demokratik dhe shndërrimin e tij në revolucion proletar. Në fakt në gjirin e saj u zhvilluan një sërë devijimesh e teorish anarkiste etj. Këtë rrugë kaotike e tregon gjithë zhvillimi i Kinës që nga formimi i partisë, që nga themelimi i republikës demokratike borgjeze të Sun Jat Senit dhe deri tash. Partia Komuniste e Kinës e porsakrijuar duhej të ndiqte rrugën e forcimit organizativ e ideologjik, të punonte për rritjen e personalitetit të saj dhe hap pas hapi të krijonte aleancat me klasat dhe me forcat revolucionare, të luftonte për forcimin e pozitave të demokracisë borgjeze që po ndërtohej në etapën e parë, domethënë të siguronte liritë demokratike të popullit, të rriste influencën popullore dhe, në radhë të parë, proletare në vend, në pushtet, në ushtri e kudo; të zinte

pozita drejtuese në sindikatat që u formuan brenda në Guomindan dhe të zhvillonte propagandën e vet me tendencë, për të konsoliduar pozitat në klasën punëtore, për ta bërë atë klasën hegjemone të revolucionit. Ajo duhej njëkohësisht të zgjeronte influencën e saj në fshatin kinez, sepse këtu jetonte pjesa dërrmuese e popullsisë së këtij kontinenti të tërë, si të thuash, dhe të procedonte më me konsekuencë për zbatimin e reformës agrare dhe për zgjimin politiko-arsimor të fshatit.

Këtë rrugë Partisë Komuniste të Kinës ia kishin hapur Lenini dhe Kominterni, ia kishin hapur Revolucionin i Tetorit dhe përvoja e Bashkimit Sovjetik.

Lenini për Kinën kishte shkruar një sërë artikujsh. Por interesant është artikulli që mban titullin «Demokracia dhe narodnizmi në Kinë», që u botua më 15 korrik 1912. Atje Lenini analizon situatën e këtij vendi, revolucionin e vitit 1911. Ai e njihnte karakterin progresist të ideve të Sun Jat Senit, me gjithë kufizimet e tij doktrinare. Revolucionin demokratiko-borgjez i drejtuar nga Guomindani i dukej Leninit me një interes të veçantë për faktin që ai luftonte kundër shtypjes së shteteve perëndimore dhe ndalonte copëtimin dhe shpërbërjen kombëtare që i kanosej Kinës. Ai njihnte rolin e rëndësishëm që i rezervohej fshatarësisë, duke vënë kurdoherë pyetjen mbi vlerën e saj revolucionare në mungesë të proletarietit në Kinë. Por në «Pravdën» e 8 nëntorit 1912, në mes të tjerave, për fshatarësinë Lenini shkruante:

«A do të dinë fshatarët, pa udhëheqjen e një partie të proletarietit, t'i mbajnë pozitat e veta

demokratike kundër liberalëve, të cilët presin vetëm çastin e përshtatshëm për t'u hedhur në të djathtë, — këtë do ta tregojë e ardhmja e afërt»¹.

Lenini kishte bindjen e plotë se proletariati në Kinë do të krijohej dhe theksonte:

«Më në fund, sa më shumë të rritet në Kinë numri i Shangajeve, aq më shumë do të rritet edhe proletariati kinez. Ai do të formojë, sigurisht, këtë ose atë parti punëtore socialdemokrate kineze, e cila, duke kritikuar utopitë mikroborgjeze dhe pikëpamjet reaksionare të Sun Jat Senit, me siguri, do të krijojë, do të ruajë dhe do të zhvillojë me kujdes bërthamën demokratike-revolucionare të programit të tij politik dhe agrar»².

Mjaftojnë këta dy artikuj për të parë se sa qartë i ka përcaktuar Lenini detyrat që pritej të zgjidheshin nga Partia Komuniste e Kinës.

Në Kongresin e Dytë të Kominternit, që u zhvillua nga 19 korriku e deri më 7 gusht 1920, u pranuan tezat mbi çështjen nacionale dhe koloniale sipas mësimëve të Leninit, një numër mjaft i madh i të cilave i përkitnin edhe Kinës. Kongresi pranoi tezën «se revolucioni në Kinë dhe në vende të tjera koloniale duhet të ketë

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 18, f. 445.

2. Po aty, f. 178.

një program që të lejojë të inkludohen reforma borgjeze dhe sidomos reforma agrare», por theksoi se drejtimi i revolucionit nuk duhet t'i dorëzohet borgjezisë demokratike; përkundrazi, në vendimet e Kongresit thuhej se partia e proletariatit duhej të drejtonte një propagandë të fortë dhe sistematike në favor të sovjetëve dhe të organizonte sa më shpejt sovjetët e punëtorëve dhe të fshatarëve. Kjo ishte vija e përgjithshme e Kominternit që duhej të ndiqej nga partia edhe në Kinë.

Në përgjithësi, mund të themi se Partia Komuniste e Kinës nuk e kreu si duhet, në mënyrë të studiuar dhe sistematike, të shikuar nga prizmi i socializmit shkencor, rolin e saj në këtë situatë që ishte krijuar në Kinë. Për këtë çështje kishte tendenca të ndryshme në atë parti të vogël që quhej Partia Komuniste e Kinës, të cilat në asnjë kohë nuk lejuan të vendosej një vijë e drejtë marksiste-leniniste e të udhëhiqnin mendimi dhe veprimi marksist-leninist. Këto tendenca të fillimit, që shfaqeshin mjaft herë në udhëheqësit kryesorë të partisë, shpesh ishin të majta, disa herë oportuniste të djathta, disa herë centriste, ato shkonin deri në pikëpamje anarkiste, trockiste, borgjeze, shoviniste të theksuara dhe raciste. Edhe më vonë ato mbetën si një nga karakteristikat dalluese të Partisë Komuniste të Kinës, që e udhëhoqi më pas Mao Ce Duni me grupin e tij.

Që kjo parti e re të zhvillonte një luftë sistematike të organizuar, të studiuar, të pjekur në ato situata aq të koklavitura dhe në një kontinent aq të madh, ku idetë e Konfucit dhe rendi feudal kishin lënë mbresa

të thella, për të mos thënë të pashlyeshme, duhej që komunistët kinezë të kishin një besim absolut te marksizmi shkencor, te Lenini dhe te Kominterni, t'u raportonin këtyre realisht për situatat në Kinë, me qëllim që vendimet që merreshin nga Kominterni për Kinën, të ishin të drejta dhe të zbatoheshin drejt nga komunistët kinezë.

Këto, sipas mendimit tim, nga ana e Partisë Komuniste të Kinës, me gjithë vullnetin e mirë të neofitëve, nuk u arritën; prandaj këtu, mendoj unë, e kanë burimin e fillimit gjithë lëkundjet nga e majta dhe nga e djathta që në atë kohë e deri më sot.

Që në formimin e partisë u dukën dy rryma: njëri krahu donte të bënte një punë legale dhe të bashkëpunonte me partitë demokratike borgjeze; krahu tjetër mbronte pikëpamjen që të mos kishin asnjë lidhje me të tjerët. Dhe, në përgjithësi, partia mori vendimin të izolohej, me fjalë të tjera të mbante qëndrim armiqësor ndaj të gjitha partive të tjera, duke përfshirë edhe atë të Sun Jat Senit, e cila akuzohej si përgjegjëse për kaos politik. Në një letër që Çen Du Siu i dërgonte më 6 prill 1922 Vojtinskit, të dërguarit të Kominternit në Kinë, i shkruante se komunistët kinezë ishin kundër bashkimit me Guomindanin, se qëllimet e tyre ishin të ndryshme. Kominterni e kundërshtoi këtë qëndrim dhe e orientoi partinë për bashkëpunim të ngushtë me Guomindanin.

Në Kongresin e popujve të Lindjes së Largme, Kominterni përcaktoi drejt vijën e bashkëpunimit ndërmjet Guomindanit dhe Partisë Komuniste të Kinës, si dhe detyrat e kësaj për periudhën e atëhershme të re-

volucionit kinez. Atje edhe përfaqësuesi sovjetik mbrojt i idenë për të mbështetur Guomindanin, si një alat që lufton për çlirimin nacional dhe demokratik, për emancipimin kombëtar, por njëkohësisht ai theksoi që Partia Komuniste e Kinës nuk duhej të mbështeste organizatat e sindikatat që ishin nën drejtimin e Guomindanit, por ajo, tok me masat proletare, duhej të drejtonte dhe të luftonte për të ndikuar dhe për të krijuar organizatat e saj në masat. «Prandaj në këtë çështje, — thoshte ai, — ne mendojmë që të mos na pengojë në punën tonë Guomindani dhe ne do të bashkëpunojmë sinqerisht me të. Kështu ne flasim haptazi. Tendenca jonë është e tillë dhe për ne duhet të dominojë lëvizja e punëtorëve të Kinës; ajo duhet të zhvillohet lirisht, pavarësisht nga ekzistenca e borgjezisë me tendenca radikale dhe me organizime e parti demokratike».

Kështu kjo parti e vogël komuniste u mbrojt politikisht dhe u ndihmua materialisht nga Kominterni dhe nga Rusia Sovjetike, të cilat ndiqnin me kujdes veprimtarinë e saj në masat, e sidomos në proletariatin e qyteteve. Në këtë drejtim u bënë përparime të shpejta, sidomos në platformën sindikale, ndërsa progreset politike do të ishin më të vonshme, më të ngadalshme dhe fillojnë në vitin 1925 me Lëvizjen e 30 Majit. Lëvizja e 30 Majit bëri që në Kongresin e 4-t të partisë të arrihej një sukses i ri. Bashkëpunimi midis Partisë Komuniste të Kinës dhe Guomindanit u forcua e u bë më i ngushtë, gjë që ndikoi drejtpërdrejt në forcimin, përkohësisht, të unitetit nacional, i cili ishte dobësuar, për të mos thënë ishte zhdukur, pas vitit 1911. Nga ky bashkëpunim Guomindani mori një forcë të re, më të

madhe, por dhe Partia Komuniste e Kinës arriti në Kongresin e 4-t me forca të shumëfishuara. Stalini, në sesionin e shtatë plenar të komisionit kinez të Komitetit Ekzekutiv të Kominternit, më 30 nëntor 1926, midis të tjerash, ka thënë se

«I gjithë zhvillimi i revolucionit kinez, karakteri i tij, perspektivat e tij tregojnë në mënyrë të padyshimtë se komunistët kinezë duhet të mbeuten në Guomindan dhe ta shtojnë aty punën e tyre»¹.

Bashkëpunimi i dy partive u ruajt deri në vitin 1927. Atëherë çështjet u ngatërruan dhe kjo nuk ishte diçka e çuditshme, për arsye se reaksioni borgjez është kurdoherë reaksion. Çan Kai Shia, borgjezia kompradore dhe borgjezia e madhe kineze, që vepronin në kuadrin e kësaj «demokracie» kineze, shikonin një rrezik të Partia Komuniste e Kinës me influencën që kjo fitonte pak nga pak dhe gradualisht mbi klasën punëtore dhe fshatarësinë. Kështu ngjanë prishja, ndarja dhe goditja në Kanton më 1926 e në Shangai më 1927. Gjatë tyre u likuiduan një numër i madh proletarësh e komunistësh. Kjo qe një goditje e rëndë për sindikatat dhe për Partinë Komuniste të Kinës.

Jo vetëm në qëndrimin ndaj Guomindanit, por dhe në qëndrimin ndaj klasës punëtore dhe fshatarësisë, PK e Kinës nuk ka ditur të përcaktojë një vijë të qartë marksiste-leniniste. Në revolucionin demokratiko-borgjez të Kinës fshatarësia luajti një rol vendimtar, por

1. J. V. Stalin, Veprat, vëll. 8, f. 374-375.

kjo nuk do të thotë që Partia Komuniste e Kinës atë duhej ta quante forcën udhëheqëse të revolucionit. Në kushtet e reja ky revolucion do të udhëhiqej nga klasa punëtore.

Njerëzit e Guomindanit nuk ishin elementë të fshatarësisë, por qenë elementë përparimtarë të borgjezisë së qyteteve, në radhë të parë intelektualë, të bashkuar edhe me elementë reaksionarë borgjezë, të cilët do të përpiqeshin që në Kinë të mos rrënjoseshin liritë demokratike. Borgjezia e republikës së re kineze përpiqej që fshatarësinë kineze, fshatarësinë e varfër, fshatarësinë e mesme dhe fshatarësinë e pasur t'i kishte një instrument të saj, t'i kishte një mbështetje. Që fshatarësia kineze ishte një element revolucionar, kjo nuk mund të mohohet. Edhe në Revolucionin Demokratiko-Borgjez Francez të tilla tipare kishte kjo klasë. Megjithëse fshatarësia franceze, në disa momente të revolucionit, ishte më tepër monarkiste, ajo në përgjithësi ishte kundër feudalizmit dhe dëshironte të shpëtonte nga kthetrat e taksave të rënda të feudalëve francezë, taksa jo vetëm në para, por edhe taksa prej skllaví, dhe, sidomos e në radhë të parë, të fitonte tokën.

Në Kinë fshatarësia ishte një element përparimtar revolucionar; ajo ishte kundër monarkisë, ishte kundër shtypjes, kundër «zotërve të luftës» dhe të provincave, por me të duhej punuar. Borgjezia që bëri revolucionin në Kinë, siç thamë, do të përpiqej që këtë fshatarësi ta përdorte për vete. Në këto situata Partisë Komuniste të Kinës i duhej të punonte, por jo duke rënë në pozitat e borgjezisë së Guomindanit, qoftë të asaj «përparimtare», qoftë të asaj reaksionare. PK e Kinës duhej të

kishte vijën e saj politike të pavarur dhe kjo vijë të mbështetej në mësimet e Marksit dhe të Leninit. Në këtë etapë partia komuniste duhej të forconte pozitën e situara mbi monarkinë, mbi feudalizmin, mbi prapambetjen. Duke mbajtur parasysh etapat, ajo nuk duhej të harronte perspektivën e revolucionit, nuk duhej të harronte se ajo ishte një parti marksiste-leniniste e klasës punëtore, ishte maja e shpatës së kësaj klase. Në atë kohë kur u formua PK e Kinës, në Kinë ekzistonte një proletariat relativisht i vogël në krahasim me klasën e fshatarësisë kineze. Megjithatë atje kishte proletariat dhe Partia Komuniste e Kinës e formuar duhej të ishte partia e proletariatit, kurse fshatarësia duhej të konsiderohej nga kjo parti si aleatja kryesore e tij. Prandaj partia duhej të punonte që ta bënte fshatarësinë aleatë të klasës punëtore për forcimin e republikës demokratike borgjeze përparimtare dhe për të kaluar më vonë, pasi të ishin pjekur kushtet, në një etapë më të përparuar, në revolucionin socialist. Kjo ide kryesore, ky parim bazë revolucionar udhërrëfyes nuk ka qenë i qartë as në teori dhe, rrjedhimisht, nuk zbatohej si duhej e me konsekuencë as në praktikë.

Pas prishjes së PK të Kinës me Guomindanin, në vitin 1927, për revolucionin kinez fillon një etapë e re, që njihet me emrin Lufta e Dytë Revolucionare Civile.

Detyrat e partisë për këtë etapë u caktuan në plenumin e jashtëzakonshëm të Komitetit Qendror, që u mbajt më 7 gusht 1927. Plenumi mënjanoi nga udhëheqja e partisë Çen Du Siunë e pasuesit e tij dhe si detyrë kryesore për partinë caktoi revolucionin agrar. Pas plenumit pati një rritje të lëvizjes revolucionare;

partia filloi të krijonte ushtrinë e vet të armatosur. Kurse Kongresi i 6-të i partisë, që u mbajt më 1928, dha orientime për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit dhe caktoi si detyrë kryesore krijimin e bazave revolucionare dhe formimin e Ushtrisë së Kuqe.

Lëvizja revolucionare po fillonte ngjitjen. Komiteti Ekzekutiv i Internacionales Komuniste [KEIK], në dhjetor të vitit 1929, arriti në përfundimin se Kina kishte hyrë në një krizë të thellë nacionale dhe ndodhej në momentin fillestar të ngjitjes revolucionare. Por theksonte se kalimi nga kriza nacionale në situatën e drejtpërdrejtë revolucionare nuk do të bëhej menjëherë. Në të njëjtën kohë Kominterni tërhoqi vëmendjen e KQ të PK të Kinës që «revolucionin në Kinë zhvillohej në mënyrë të pabarabartë». Në këto kushte forcimi i partisë dhe lufta e saj për të bërë të ndërjegjshme dhe për të fituar masat mbeteshin detyrë kryesore.

Konkluzionet e Kominternit, me sa duket, nuk u kuptuan drejt nga udhëheqja kineze e asaj kohe. Në shkurt 1930 KQ i PK të Kinës u dërgoi organizatave të partisë një qarkore në të cilën, në fakt, injorohej teza e Kominternit për zhvillimin e pabarabartë të revolucionit në Kinë dhe thuhej se gjithë Kina është pushtuar nga kriza revolucionare. Kurse më 11 qershor 1930 Byroja Politike, me Li Li Sanin në krye, aprovoi rezolutën «Mbi ngritjen e re revolucionare dhe mbi marrjen e pushtetit në fillim në disa provinca». Udhëheqja kineze kishte mendimin se në kushtet e krizës që kishte kapur botën kapitaliste dhe të krizës që kishte pllakosur vendin, situata revolucionare në Kinë ishte pjekur dhe duhej hedhur menjëherë në kryengritje, në

fillim në një ose në disa provinca, pastaj në gjithë vendin. Ajo theksonte, gjithashtu, se faktori vendimtar i revolucionit ishte lufta e proletariatit; por vetëm me organizimin e një vale grevash nga ana e klasës punëtore në qytete, pa një sulm të ushtrisë mbi qytetet e mëdha, kryengritja nuk mund të kishte sukses. Ndërsa Mao Ce Duni e shikonte kryengritjen si një aksion vetëm ushtarak dhe nuk ishte për një veprim të përbashkët të klasës punëtore në qytete dhe të ushtrisë.

Në qershor filloi kryengritja dhe më 28 qershor Ushtria e Kuqe hyri në Çansha. Qyteti u mbajt për pak ditë dhe përsëri u mor nga forcat e Guomindanit, të cilat shpërthyen terrorin kundër banorëve të qytetit dhe në mënyrë të veçantë kundër klasës punëtore dhe komunistëve.

Nga sa kam lexuar del se e vetmja ushtri që mbështeti kryengritjen dhe rezistoi, ishte grupi i pestë i Armatës së Kuqe. Kurse forcat e zonës së Kensisë, ku drejtonin Çu Deja dhe Mao Ce Duni, në vend që të mbanin dhe të atakonin Çanshanë, u kthyen për t'i shkuar në ndihmë grupit të pestë të armatës. Kështu që ofensiva e madhe në shkallë province dështoi. Por, edhe pas kësaj, Byroja Politike e KQ të PK të Kinës nuk hoqi dorë nga mendimi i saj. Më 18 korrik ajo i dërgoi një letër KEIK-ut që të sanksiononte fillimin e kryengritjes në Uhan, në Çansha dhe në Shangai. Presidiumi i KEIK-ut e refuzoi këtë kërkesë. Më 5 gusht Byroja Politike e PK të Kinës e përsëriti kërkesën. Më 26 gusht 1930 KEIK-u i dërgoi një letër KQ të PK të Kinës ku theksohej domosdoshmëria e anulimit të planit të kryengritjes në disa provinca.

Në shtator 1930, në Lushan u mbajt sesioni i tretë i mbledhjes së gjashtë të Komitetit Qendror. Në këtë mbledhje mori pjesë edhe Pavël Mif si përfaqësues i KEIK-ut. Raporti që mbajti Çu En Lai, i cili porsa ishte kthyer nga Moska me cilësinë e të deleguarit të KQ të PK të Kinës pranë Kominternit, ishte shumë prudent dhe përpigëj të pajtonte pikëpamjen e Kominternit me vijën e Li Li Sanit. Plenumi e konsideroi qëndrimin e udhëheqjes kineze vetëm si një gabim taktik serioz, por jo si një qëndrim që binte në kundërshtim me direktivat e Kominternit. Katër muaj më vonë, në janar 1931, Komiteti Qendror mbajti një sesion të katërt. Në rezolucionin e këtij sesioni theksohej se udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës, e kryesuar nga Li Li Sani, kishte ndjekur një politikë aventureske, puçiste, në kundërshtim me direktivat e Kominternit. Në raport thuhej se vija e Li Li Sanit për marrjen e qyteteve të mëdha në një kohë kur nuk ishin pjekur kushtet, ishte në kontradiktë me tezat e Kominternit për karakterin dhe etapat e revolucionit kinez.

Për disfatat dhe për deviacionet e tyre, për moskuptimin dhe mosnxjerrjen e deduksioneve të drejta nga situatat që zhvilloheshin në Kinë, komunistët kinezë me Mao Ce Dunin ia hedhin fajin Kominternit ose përfaqësuesve të tij në Kinë. Ata e akuzojnë shumë Kominternin se ai i paskësh penguar dhe ngatërruar në zhvillimin e një lufte konsekuente për marrjen e pushtetit dhe ndërtimin e socializmit në Kinë. Natyrisht, periudha e revolucionit kinez është e gjatë dhe e koklavitur, por pikëpamjet e kinezëve mbeten të paargumentuara. E kam thënë shumë herë se doku-

mentet e Kominternit jo vetëm për çështjen kineze, por edhe për shumë probleme të asaj kohe, ndodhen në duart e sovjetikëve, në arkivat e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Shumë prej tyre nuk janë botuar, sepse fraksionet e ndryshme dhe revizionistët aktualë sovjetikë nuk e nxjerrin të vërtetën jashtë arkivave të tyre, kështu që kinezët mund t'i manipulojnë dhe t'i interpretojnë faktet sipas dëshirave të tyre. Nuk mund t'i shfaqësosh krejtësisht përfaqësinë kineze në Komintern dhe përfaqësuesit e Kominternit në Kinë, por nuk mund edhe ta shfaqësosh Partinë Komuniste të Kinës që vepronte në terren, pse veprimet e saj nuk kanë qenë të pjekura, raportet që ajo bënte për gjendjen në vend nuk kanë qenë reale. Në këto kushte ka mundësi që disa vendime të Kominternit të mos kenë qenë të goditura ose të mos jenë transmetuar e zbatuar si duhet nga përfaqësuesit e Kominternit në Kinë, qofshin këta sovjetikë, qofshin kinezë, dhe kjo ka shumë arsye, sepse në ato kohë në Komintern ishin elementë të tillë si Trocki, Buharini, Zinovievi, Kamenievi, të cilët u zbuluan më vonë se ç'ishin. Në fillim të viteve njëzet në Kinë ishte dërguar, si përfaqësues i Kominternit, sovjetiku Adolf Abramoviç Jofe, që ishte një partizan i trockizmit dhe që më vonë vrau veten. Në tetor të vitit 1923 në Kinë shkoi Borodini, edhe ai një element trockist.

Por jam i mendimit se në përgjithësi vendimet e direktivat e Kominternit, të kohës së Leninit në radhë të parë, kanë qenë të drejta, por të tilla kanë qenë edhe në kohën e Stalinit.

Faktet tregojnë se në periudhën e luftës së parë

civile ose në periudhën e parë të bashkëpunimit Guomindan—Parti Komuniste, por edhe në periudhat e tjera, nuk është dukur që të ketë pasur një orientim të gabuar nga ana e Kominternit për zhvillimin e luftës së Partisë Komuniste të Kinës si një parti e pavarur. Stalini në përgjithësi ka kërkuar që Partia Komuniste e Kinës të luftonte në aleancë të ngushtë me Guomindanin, atëherë kur zhvillimi historik i Kinës e shtronte këtë si një nevojë objektive. Kjo, sipas mendimit tim, ishte një direktivë e drejtë. Por që Stalini t'u ketë dhënë direktivën, siç pretendojnë kinezët, që Partia Komuniste e Kinës të likuidohej duke u inkuadruar në Guomindan, pa ruajtur personalitetin e saj, këtë unë nuk mund ta besoj dhe ky nuk mund të ketë qenë kurrë mendimi i Stalinit. Kinezët nuk janë në gjendje të japin asnjë dokument që ta vërtetojë këtë, përkundrazi, ekzistojnë dokumente që vërtetojnë të kundërtën. Këtë e vërtetojnë edhe vetë pohimet e kinezëve, të cilët thonë se Stalini gjoja paska bërë autokritikë kur shkoi Mao Ce Duni në Moskë, por jo për këto çështje, ai paska pranuar se «në një moment të revolucionit kinez ka influencuar disi që Partia Komuniste e Kinës të mbështetej vetëm te proletariati dhe më pak te fshatarësia». «Ky është i vetmi gabim që kam bërë ndaj Kinës dhe asnjë tjetër, dhe për këtë unë bëj autokritikë», paska thënë Stalini, sipas kinezëve. Por edhe në qoftë se kjo do të ishte e vërtetë, është e paprueshme të nxirret konkluzioni, siç bëjnë kinezët, se disfatat e tyre, përpjekjet brenda fraksioneve në PK të Kinës, gjakosja me Guomindanin, qenkan shkaktuar nga politika «e gabuar» e Kominternit dhe e Stalinit!

Këtu duhen gjetur dokumente autentike, se ka më shumë të ngjarë që vetë komunistët kinezë, por edhe disa nga të dërguarit e Moskës, me sa duket, nuk kanë ditur të zhvillojnë një politikë të atillë të drejtë, parimore me Guomindanin dhe me krerët e tij, që të arrinin qëllimet e tyre maksimale.

Ne shohim se fillimi i bashkëpunimit të komunistëve kinezë me Guomindanin ka qenë i arsyeshëm, i ngushtë deri atje, sa të dyja palët së bashku i përgatitnin kuadrot oficerë në akademinë Vampu, ku komandant ishte Çan Kai Shia dhe komisar Çu En Lai. Pra, Çu En Lai me Çan Kai Shinë bisedonin dhe bashkëpunonin fare mirë. Maoja vetë ishte përgjegjës i kuadrove (i edukimit) në Guomindan. Domethënë direktivat e Kominternit nuk kanë qenë të gabuara. Nuk ishte e gabuar po ashtu edhe direktiva e Kominternit për të evituar përçarjen në kohën e agresionit japonez (në qoftë se kjo ishte direktivë e tij), që PK e Kinës me anën e Çu En Lait të ndërhynte për të liruar Çan Kai Shinë, i cili ishte arrestuar më 12 dhjetor 1936 nga komandanti i armatës verilindore të Kinës, arrestim që rrezikonte përçarjen e forcave nacionaliste në luftën kundër Japonisë.

Tani, të gjykosh për vijën dhe për veprimtarinë e Partisë Komuniste të Kinës ndaj Guomindanit, për vendimet që mori KQ i Partisë nën drejtimin e Li Li Sanit më 1930, dhe për vendimet që mori pas dështimit të kryengritjes së vitit 1930, është tepër e vështirë, për arsye se Partia Komuniste e Kinës, në gjirin e së cilës kanë vegjetuar vazhdimisht plot fraksione, nuk i ka shkruar kurrë këto ngjarje të rëndësishme

që kanë ndodhur në vend dhe në gjirin e partisë me objektivitetin e duhur. Përkundrazi, faktet, konkluzionet, mendimet dhe qëllimet janë shtrembëruar dhe janë interpretuar sipas interesave të fraksioneve që sundonin në periudhën e dhënë në Komitetin Qendror.

Kështu që jemi përpara dy vështirësive: e para, të gjykojmë, duke marrë parasysh vetëm ngjarjet dhe duke nxjerrë konkluzione jo të bazuara në dokumente; dhe e dyta, gjendemi edhe përpara asaj inkoherençe ose, si të thuash, përpara atij konfuzioni ideologjik të Partisë Komuniste të Kinës, e cila, e hallakatur në fraksione, në asnjë kohë nuk ka bërë analizën e ngjarjeve dhe nuk ka nxjerrë konkluzione për mësim dhe për edukim. Ne nuk gjejmë të botuara dokumente, të paktën në gjuhë të huaja, gjë që Partia Komuniste e Kinës duhej ta kishte bërë, se i ka pasur dhe i ka mundësitë për këtë.

Pas shtatorit të vitit 1931 filloi lufta nacionalçlirimtare kundër okupatorit japonez. Edhe kjo luftë nacionalçlirimtare u zhvillua me peripecitë e saj jo vetëm ushtarake, por edhe ideologjike e politike. Gjatë kësaj lufte u bënë aleanca në mes borgjezisë përparimtare, borgjezisë nacionale, borgjezisë kompradore, në mes Guomindanit, proletariatit dhe fshatarësisë, midis Partisë Komuniste dhe Guomindanit.

Në gjithë këtë situatë të koklavitur ne përsëri nuk i shohim qartë vijën dhe drejtimin e Partisë Komuniste të Kinës. Materiale, që, si të thuash, janë më tepër artikuj propagandistikë, ne kemi lexuar, por këtu nuk është fjala për propagandë, këtu kemi të bëjmë me çështje aleancash në mes proletariatit dhe fshatarësisë, në

mes Guomindanit dhe Partisë Komuniste të Kinës, në mes ushtrisë së Guomindanit dhe ushtrisë që drejtonte Partia Komuniste e Kinës dhe të gjithë këta së toku, në aleancë ose në disaleancë, kanë qenë në luftë kundër japonezëve dhe kundër njëri-tjetrit. Për të gjetur fillin e gjërave duhet të na shërbejnë dokumentet.

Ne dimë që, në përgjithësi, në fillim është bërë një luftë në aleancë me Guomindanin, pastaj u kalua në luftë me njëri-tjetrin. Çan Kai Shia udhëhiqte Guomindanin, domethënë borgjezinë reaksionare. Është fakt se, duke parë rrezikshmërinë e ngjitjes së Partisë Komuniste të Kinës dhe të luftës së saj kundër okupatorëve japonezë, Guomindani u nda prej saj, kështu lufta kundër japonezëve nga ana e tij u dobësua ose u shua. Guomindani, i udhëhequr nga Çan Kai Shia, u hodh tërësisht në luftë kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe u përpoq si e si të likuidonte repartet luftarake të saj. Me fjalë të tjera, në këtë mënyrë ai i vinte në ndihmë okupatorit japonez. Në të njëjtën kohë lidhjet e tij u shtrënguan, u bënë çdo ditë e më të ngushta me Imperializmin amerikan, në kundërshtim edhe me përfaqësuesin e posaçëm amerikan në Kinë, gjeneralin Marshall, i cili në fillim ishte përkrahës i lobit të Çan Kai Shisë, por më vonë, me sa kemi lexuar, e konsideronte qeverinë e Çan Kai Shisë një «qeveri të korruptuar». Por gjatë dhe pas luftës antijaponeze lidhje me imperializmin amerikan nuk mungoi të ketë as Partia Komuniste e Kinës që udhëhiqte Mao Ce Duni.

Gjatë luftës kundër japonezëve Mao Ce Duni kishte arritur të likuidonte fraksionet e Li Li Sanit, të Van Minit e të shumë të tjerëve dhe kishte vendosur

hegjemoninë. Krahas Maos, në udhëheqje të partisë erdhën Çu Deja, Çu En Lai, Ten Hsiao Pini, Lin Biaoja dhe shumë udhëheqës të tjerë të revolucionit kinez të dalë nga lufta antijaponeze, por edhe këta herë pas here ishin në kundërshtim me Maon dhe me njëri-tjetrin. Pra, lufta e udhëhequr nga Mao Ce Duni në Kinë ishte një luftë nacionalçlirimtare kundër okupatorëve japonezë dhe kundër Guomindanit të udhëhequr nga Çan Kai Shia, i cili *de facto* ishte në aleancë me japonezët dhe *de jure* haptazi me imperializmin amerikan.

Pas Marshimit të Madh historik, të udhëhequr nga Mao Ce Duni dhe nga Çu Deja, që ishte një tërheqje taktike e drejtë për të mos likuiduar forcat e revolucionit, pas grumbullimit në Jenan, riorganizimit të ushtrisë dhe pastaj sulmit, i cili përfundoi me hedhjen në det të Çan Kai Shisë dhe të mbeturinave të ushtrisë së tij, Kina më 1 tetor të vitit 1949 u çlirua dhe u shpall Republikë Popullore.

Siç shihet, kjo është një përmbledhje shumë e përgjithshme e kësaj ngjarjeje të madhe jo vetëm për Kinën, por me rëndësi edhe në shkallë botërore, sepse u krijua Republika Popullore e Kinës, e cila, tok me Dashkimin Sovjetik, në rast se do të ndiqnin një rrugë të vërtetë marksiste-leniniste, do të bëheshin kala të fuqishme të revolucionit të madh botëror proletar.

Për periudhën pas çlirimit të Kinës shtrohet pyetja, dhe kjo është një pyetje e madhe e me rëndësi, e cila nuk mund të analizohet e të zgjidhet me këto fakte e me këto dokumente të pakta, ose edhe të pastuduara në mënyrë të posaçme nga ana jonë: Kina Popullore ndërton socializmin në rrugën marksiste-leniniste apo

është një republikë demokratike borgjeze dhe mbetet si e tillë? Revolucioni që u bë në Kinë ishte dhe mbeti një revolucion demokratiko-borgjez, që shënon etapën e parë të revolucionit, apo munda ta kapërcente këtë etapë dhe të kalonte në etapën e dytë të revolucionit, në socializëm, nën diktaturën e proletariatit? Kjo është një çështje e madhe që duhet sqaruar me fakte.

Periudha e çlirimit u quajt nga Mao Ce Duni «Demokracia e re», së cilës iu përcaktuan dhe orientimet e detyrat. Bazat teorike të kësaj doktrine u hodhën nga Mao Ce Duni qysh në dokumentin «Demokracia e re» që doli më 1940. «Demokracia e re», sipas Mao Ce Dunit, është regjimi që i përshtatet Kinës, ajo nuk u përngjet as republikave perëndimore të kontrolluara nga borgjezia, por as republikave sovjetike proletare.

Republika neodemokratike, sipas Mao Ce Dunit, do të përbëhet nga «katër klasa», (!) antiimperialiste dhe antif feudale, që janë proletariati, fshatarësia, borgjezia e vogël dhe borgjezia nacionale. Në këtë republikë edhe ekonomia duhet të jetë neodemokratike, shteti do të marrë drejtimin, por nuk do të konfiskojë pasuritë e borgjezisë, sepse karakteri i prapambetur i ekonomisë kineze e justifikon ekzistencën e disa formave kapitaliste. Sigurisht do të ndahen toka sipas kësaj ekonomie të re, por ekonomia e fshatarëve të pasur do të ekzistojë, sepse formula e sipërme është, gjithashtu, e aplikueshme edhe për fshatarët e pasur, pasi prodhimi i tyre është shumë i nevojshëm. Kultura e re duhet të jetë, natyrisht, pasqyrim ideologjik i kësaj politike dhe i kësaj ekonomie të re dhe t'u shërbejë kësaj politike dhe kësaj ekonomie.

Kjo politikë tingëllon liberale dhe nacionaliste, sepse Mao Ce Duni, edhe pas krijimit të Republikës Popullore të Kinës, vazhdoi t'i qëndrojë besnik doktrinës së tij.

Me sa gjykoj dhe me sa mendoj unë, Kina bëri një revolucion demokratiko-borgjez të tipit të ri, nëpërmjet luftës së armatosur nacionalçlirimtare. Partia Komuniste e Kinës qëndroi në krye dhe e udhëhoqi këtë luftë në fitore dhe për këtë nuk ka asnjë diskutim. Mao Ce Duni, sekretari i përgjithshëm ose kryetari i Partisë Komuniste të Kinës, në këtë drejtim e në këto realizime ka merita të mëdha gjatë asaj periudhe. Tok me Mao Ce Dunin kanë, natyrisht, meritat e tyre edhe të gjithë ata që, në një mënyrë ose në një mënyrë tjetër, në unitet mendimi ose edhe në diversitet mendimesh me njëri-tjetrin, arritën në këtë qëllim përfundimtar, që ishte çlirimi i Kinës, problem themelor ky, si dhe vendosja atje e një republike demokratike popullore.

A do të ishte ky një regjim demokratik popullor? A do të ndërtohej ky në formën e regjimeve demokratiko-borgjeze perëndimore ose amerikane? Këtë duhet ta këqyrim në zhvillim. Në pamje të jashtme, duke pasur në krye një parti komuniste, duke qenë kjo parti komuniste pjesëmarrëse në Komintern, duke ndjekur në dukje direktivat e Kominternit, si dhe vijën e përgjithshme të tij të luftës kundër fashizmit, të lindnin mendimi dhe shpresa se kjo demokraci borgjeze, kjo etapë e parë nëpër të cilën kalonte revolucionin kinez, do të ishte e ndryshme nga ajo e revolucionit klasik demokratiko-borgjez dhe republika kineze do të ishte ndryshe nga republika demokratike borgjeze amerikane ose perç-

ndimore, do të ecte në rrugën e demokracisë popullore, formë e re e diktaturës së proletariatit.

Pavarësisht se Mao Ce Duni para çlirimit dhe pas çlirimit ka thënë (dhe për këtë ekzistojnë dokumente) se në ndërtimin e Republikës Popullore të Kinës «ne do të frymëzohemi shumë nga demokracia amerikane», në propagandë dhe në shumë nga aktet e fillimit, dhe për arsye se Partia Komuniste e Kinës erdhi në pushtet, u duk sikur Kina ishte një vend që po përgatitej të shkonte në socializëm. Kjo ishte tabloja e përgjithshme.

Pas çlirimit, ndërtimi i vendit, forcimi i pushtetit dhe krijimi i aparatit shtetëror, forcimi dhe modernizimi i ushtrisë nuk do të bëheshin pa luftë dhe pa përpjekje me tendencat e ndryshme të reaksionit kinez që ekzistonte brenda në Kinë dhe që përkrahej jashtëzakonisht shumë edhe nga jashtë dhe nga kuadrot e rinj që futeshin brenda në parti dhe në aparatet shtetërore. Pra, në këtë periudhë të viteve të para ne nuk mund të shquajmë si duhet atë vijë radikale të Partisë Komuniste të Kinës përpara një problemi shumë të madh, atij të konsolidimit të republikës dhe, kur themi të konsolidimit të republikës, me këtë kuptojmë, në radhë të parë, konsolidimin e një politike të drejtë marksiste-leniniste dhe konsekuente për forcimin e pushtetit dhe për përgatitjen e kushteve për të kaluar në periudhën e ndërtimit socialist. Nuk shohim një vijë të drejtë për organizimin sidomos të një partie të tipit Lenin-Stalin, ku të dominonte uniteti i mendimit dhe i veprimit, uniteti i mendimit marksist-leninist dhe i një veprimi të organizuar e shumë të kujdesshëm në një

Kinë të madhe të dalë nga një luftë e ndërlikuar, nga një situatë e koklavitur, ku ishin të gjallë feudalizmi, borgjezia dhe shtresat e ndryshme të fshatarësisë, inteligjencies, konfucianizmi, budizmi etj.

Në periudhën e viteve të para ne nuk pamë një organizim të shëndoshë e me baza të ushtrisë kineze në shembullin e ushtrisë staliniane. Pavarësisht se ajo në luftën nacionalçlirimtare partizane ishte e organizuar në reparte të mëdha, karakteristikat e këtyre reparteve nuk ishin kurdoherë karakteristika partizane, sepse ekzistonin tendencat e një ushtrie borgjeze kapitaliste, për arsye se me ushtrinë e Mao Ce Dunit u bashkuan reparte të tëra të Guomindanit dhe të «zotërve të luftës». Dhe kështu, së bashku me to, në repartet e ushtrisë nacionalçlirimtare kineze u futën edhe pikëpamjet reaksionare, sepse në krye të këtyre reparteve të Guomindanit dhe të «zotërve të luftës» kishte komandantë e oficerë të lartë të Guomindanit, të cilët ishin të stërvitur në luftën kundër popullit dhe kundër komunizmit. Në këtë ushtri, që kishte dalë nga lufta, ekzistonin, gjithashtu, pikëpamjet e vjetra të «zotërve të luftës». Këto pikëpamje imprenjonin, si me thënë, edhe kuadrot e lartë që kishin bërë luftën e madhe të çlirimit, bile që ishin edhe anëtarë të PK të Kinës. Këtë gjë do ta shohim më vonë, kur një numër udhëheqësish kryesorë ushtarakë devijuan dhe u përpoqën të merrnin fuqinë, të rrezonin njërin dhe tjetrin. Kjo do të thoshte se tek ata ekzistonin pikëpamjet e vjetra të «zotërve të luftës», ose pikëpamjet e kuadrove ushtarakë të lartë të një ushtrie borgjeze kapitaliste.

Në këtë drejtim, pra, në ato kohë nuk shohim një

politikë konsekuente, të drejtë, të menduar mirë dhe të formuluar e të zbatuar si duhet nga Partia Komuniste që udhëhiqte Mao Ce Duni. Politika e saj vërtet u quajt marksiste-leniniste, por në brendi nuk ishte një politikë e tillë.

Për sa u përket çështjeve ekonomike, në këtë periudhë mund të themi se u bënë mjaft ndryshime pozitive. Në Kinë u luftuan varfëria dhe papunësia, u luftua deri në njëfarë shkalle edhe prapambetja arsimore e kulturore, ndonëse pikëpamjet borgjeze kapitaliste në masat e intelektualëve nuk u zhdukën. Natyrisht, këto nuk mund të zhdukeshin me një të rënë të shkopit, megjithatë, për sa u përket rindërtimit të vendit të shkatërruar dhe organizimit pak a shumë të gjendjes së ekonomisë në vend, mund të themi që regjimi i demokracisë së re solli në këtë drejtim mjaft ndryshime të pëlqyeshme, të mira. Në Kinë nuk kishte më uri dhe ky ishte një sukses i madh. Këto janë dukuritë e kësaj etape të regjimit të ri demokratik.

Pas fitores së revolucionit demokratiko-borgjez, Partia Komuniste e Kinës duhej të ecte me kujdes të madh, dhe kjo ishte e natyrshme, duhej të mos treguhej majtiste, të mos i digjte etapat, dhe mund të themi se këto nuk i dogji. Ky është fakt që nuk mund të mohohet. Çështja shtrohej, gjithashtu, që Partia Komuniste e Kinës të mos treguhej ashtu sikurse u tregua «demokratike», domethënë liberale, oportuniste ndaj borgjezisë kineze dhe ndaj pronarëve të mëdhenj të tokave. Fakt është se edhe fraksioni i Liu-Tenit, edhe ai i Maos i mbështeti këta duke u bërë lëshime serioze liberale, oportuniste.

Partia Komuniste e Kinës duhej të konsolidonte aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë, në radhë të parë, dhe borgjezia kineze t'u nënshtrohej ligjeve të proletariatit. Kjo ishte absolutisht e domosdoshme. Në këtë rrugë partia mund të përdorte forma të ndryshme për të çarmatosur borgjezinë, për ta larguar këtë nga rruga e subversionit dhe e goditjeve me armë që mund t'i bëhej pushtetit të ri; mund të bënte edhe lëshime të përkohshme me karakter taktik, por pa ndryshuar qëllimet strategjike të revolucionit, pa shkelur parimet. Me fjalë të tjera, borgjezinë ta çarmatoste, por ta çarmatoste politikisht në radhë të parë, ideologjikisht të mos lejonte që të zhvilloheshin pikëpamjet e saj dhe ekonomikisht t'ia hiqte nga duart të gjitha pasuritë që kishte dhe të mos lejonte që ajo të mbante gati po ato pozita që kishte pasur në një kohë kur fshatarësia, në radhë të parë, dhe proletariati ishin në momente të vështira ekonomike, për të mos thënë politike dhe ideologjike.

Në këtë çështje, në këto momente të para të pasçlirimit, për katër-pesë vjet me radhë ne shohim që Kina përpiqet, noton në reforma, të cilat nuk kanë një qëndrueshmëri të përcaktuar. Atje nuk shohim një vijë pak a shumë orientuese, ku duhej të çonin këto masa dhe reforma, nuk shohim një shkallëzim të studiuar objektiv në të gjitha drejtimet e aktivitetit shoqëror, ekonomik, politik, ideologjik dhe ushtarak. Përkundrazi, vëmë re lëkundje të shumta nga të tëra anët, të bie në sy një pleksje e reformave të periudhës demokratike popullore me prirje gjoja socialiste. Gjatë kësaj kohe, u ruajt e gjallë tendenca sipas së cilës etapa e parë e

revolucionit demokratiko-borgjez duhej të vazhdonte gjatë. Në këtë etapë, predikonin udhëheqësit kinezë, krahas zhvillimit të kapitalizmit do të krijoheshin edhe premiset e socializmit. Vetë Mao Ce Duni ka thënë: «Megjithëse një revolucion i tillë demokratik i tipit të ri, nga njëra anë zgjeron rrugën për kapitalizmin, ai, nga ana tjetër, krijon premiset për socializmin». Mbi këtë predikim ata mbështetën edhe tezën e njohur të tyre për bashkekzistencën me borgjezinë dhe me kapitalizmin për një kohë shumë të gjatë, që do të vazhdonte edhe për 30 vjet të tëra pas vitit 1956. Në raportin e Kongresit të 8-të të PK të Kinës thuhet hapur se borgjezia nacionale duhet të ruajë tok me klasën punëtore drejtimin shtetëror të Kinës, të ruajë një pjesë të madhe të pasurisë së saj private. Këto predikime kinezët i kanë paraqitur si zbatim krijues të mësimëve të Leninit për NEP-in. Por midis mësimëve të Leninit dhe teorisë e praktikës kineze ka një ndryshim rrënjësor si në përmbajtje, ashtu edhe në afatet e zbatimit të NEP-it. Lenini e pranon se NEP-i ishte një tërheqje e përkohshme, që lejonte për një kohë zhvillimin e kapitalizmit privat, por, thekson ai,

«Këtu s'ka asgjë të rrezikshme për pushtetin proletar, derisa proletariati e mban mirë pushtetin në duart e tij, derisa ai mban fort në duart e tij transportin dhe industrinë e madhe»¹.

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 32, f. 434.

Kurse në Kinë as më 1949 dhe as më 1956 proletariati nuk mbante plotësisht në duart e tij as pushtetin, as industrinë e madhe.

Një vit pas shpalljes së NEP-it Lenini theksonte se tërheqja kishte marrë fund dhe hodhi parullën për përgatitjen e ofensivës kundër kapitalit privat në ekonomi. Kurse në Kinë periudha e ruajtjes së borgjezisë dhe të kapitalizmit parashikohet të vazhdonte gati tërë jetën.

Me një fjalë, në Partinë Komuniste të Kinës në këtë etapë ekzistonte pikëpamja se rendi i vendosur pas çlirimit duhej të ishte një rend demokratiko-borgjez dhe pushtetin ta kishte edhe borgjezia, kurse në aparencë të ishte në fuqi (dhe ishte në fuqi) Partia Komuniste e Kinës me Mao Ce Dunin si kryetar dhe me Liu Shao Çinë, me Çu En Lain, me Ten Hsiao Pinin e me gjithë të tjerët në udhëheqje. Të tilla ishin pikëpamjet e kësaj partie. Ato nuk ishin pikëpamje të qarta marksiste-leniniste. Derisa pikëpamjet e PK të Kinës nuk ishin plotësisht marksiste-leniniste, revolucioni në Kinë nuk mund të çohet deri në fund, nuk mund të sigurohet shndërrimi i revolucionit demokratiko-borgjez në revolucion socialist. Kalimi nga revolucion demokratiko-borgjez në revolucion socialist mund të realizohet vetëm atëherë kur proletariati e largon në mënyrë të vendosur borgjezinë nga pushteti, bile edhe në ato raste kur ajo për një kohë ka qenë aleate e tij. Përdërisa në Kinë klasa punëtore e ndau pushtetin me borgjezinë, ky pushtet në thelb nuk u shndërrua asnjëherë në diktaturë të proletariatit, si pasojë edhe revolucioni kinez nuk mund të jetë një revolucion socialist.

Edhe problemi i rëndësishëm i kombësive, me gjithë sloganet, nuk ishte zgjidhur në rrugën marksiste-leniniste. Direktivat e Kominternit për problemin e nacionaliteteve, të gjuhëve dhe të shtetit proletar shumëkombësh nuk ishin të qarta për udhëheqësit kinezë jo vetëm në fillim, por edhe pas krijimit të Republikës Popullore të Kinës.

Stalini në intervistën që i ka dhënë Emil Ludvigut, duke folur për detyrat që i dalin partisë marksiste-leniniste në krijimin e shtetit proletar, thotë:

«Kjo detyrë nuk qëndron në forcimin e ndonjë shteti «nacional», por në forcimin e shtetit socialist, pra, — internacionalist...»¹.

Këtë rrugë duhej të ndiqte PK e Kinës. Kurse te Maoja, që flet vazhdimisht për perandorët, për heronjtë e përrallave, që herë i mburr dhe herë i sulmon, nuk gjejmë këto përcaktime të qarta të luftës për një shtet proletar internacional. Këto përcaktime për të ardhmen e Kinës, për çështjen e zgjidhjes së drejtë të këtij grumbullimi të madh kombësh nuk i gjejmë as në kohën e pjekurisë së tij.

Organizimi shtetëror në Kinën e porsaçliruar, të paktën për ne të huajt, nuk u duk aq i qartë, nuk u dukën format dhe lidhjet e bazës me qendrën, nuk u duk në ç'baza bësheshin ndarjet, dhe, përveç rindërtimit në përgjithësi, nuk u dukën mirë orientimet ekonomike se kujt i jepej përparësia: industrisë së rëndë, industrisë

1. J. V. Stalin, Veprat, vëll. 13, f. 101.

së lehtë apo bujqësisë. Flitej shumë, jepeshin direktiva, por konstatojmë se këto direktiva jo vetëm nuk zbatoheshin, por ato ishin edhe konfuze, jo të përcaktuara mirë.

Një fraksion në parti ishte i pikëpamjes se duhej zhvilluar në radhë të parë industria e rëndë, një tjetër ishte kundër; sipas këtij i duhej dhënë prioritet industrisë së lehtë, një fraksion i tretë pretendonte t'i jepej rëndësi e madhe bujqësisë, kishte edhe nga ata që thoshin se duhej ecur me të dyja këmbët. Formula hidheshin plot, sa të duash; megjithatë, jo se nuk bëhej gjë fare, jo se nuk punohej, por, në përgjithësi, orientimet që jepeshin nuk ishin të qarta dhe nuk zbatoheshin si duhej. Kjo mungesë orientimi vinte për arsye se Partia Komuniste e Kinës gjatë gjithë kësaj periudhe, që nga koha e themelimit të saj dhe derisa arriti në çlirimin e vendit dhe më vonë, nuk mundi të konsolidohej ideologjikisht, të fuste thellë në mendjet dhe në zemrat e anëtarëve të saj teorinë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, të adoptonte pikat kyç të kësaj ideologjie të pagabueshme shkencore dhe, duke u bazuar në të, ta zbatonte atë hap pas hapi në kushtet e Kinës, në zhvillimin dialektik të luftës në atë vend. Kjo bëri që Partia Komuniste e Kinës të ishte e ndarë në fraksione të shumta, brendapërbrenda saj; ajo njëkohësisht lejoi jashtë saj ekzistencën e partive të tjera të borgjezisë dhe pjesëmarrjen e tyre në pushtet. Bile Maoja vetë zyrtarisht e ka quajtur të domosdoshme pjesëmarrjen e tyre në pushtet dhe në qeverisjen e vendit me po ato të drejta dhe me po ato prerogativa si edhe Partia Komuniste e Kinës dhe jo vetëm kaq, por, sipas tij, këto

parti të borgjezisë që «ishin historike» nuk mund të shuhen veçse kur të vijë koha që të shuhet edhe Partia Komuniste e Kinës.

Me një fjalë, Mao Ce Duni ka pasur pikëpamjen që të shkohet në socializëm me pluralizëm. Kjo ishte një parullë e djathtë reaksionare. Kjo nuk ishte një parullë marksiste që duhej kuptuar deri diku si një formë aleance e Partisë Komuniste të Kinës me parti të tjera tradicionale që ndodheshin në Front, ku Partia Komuniste e Kinës të ishte hegjemone. Jo.

Në shkrimet e tij teorike Mao Ce Duni thotë se Kina nuk mund të çlirohej pa udhëheqjen e fshatarësisë, se revolucioni në Kinë ishte një revolucion fshatar. Sipas tij fshatarësia ishte klasa më revolucionare, se ajo duhej ta udhëhiqte «dhe e udhëhoqi revolucionin». Ky është një gabim i madh teorik nga ana e Mao Ce Dunit dhe tregon se ai nuk ishte marksist-leninist, por një eklektik dhe borgjez demokrat. Mao Ce Duni, si një demokrat përparimtar, ishte për një revolucion demokratiko-borgjez dhe, kur u çlirua Kina, qëndroi në të njëjtat pikëpamje. Sipas pikëpamjes së tij, fshatarësia ishte hegjemone dhe klasa punëtore duhej të ishte aleatja e saj, se pushteti në Kinë duhej të ishte, në radhë të parë, pushteti i fshatarësisë, se «fshati duhet të rrethojë qytetin», por, kur u zhvillua vija e Li Li Sanit, armata e Maos dhe e Çu Desë nuk e zbatoi direktivën e Komitetit Qendror dhe nuk e rrethoi qytetin e caktuar. Këtë teori borgjeze demokratike të tij Mao Ce Duni kërkonte ta shndërronte në një teori universale dhe në fakt kjo «teori» u quajt maocedunide. Për ta bërë sa më të pranueshme, udhëheqësit kinezë i vinin

maocedunidesë shenjë e barazimit me marksizëm-leninizmin.

Në Kinë monarkia u rrëzua që më 1911, por kinezët, edhe pas krijimit të Republikës Popullore të Kinës, perandorin Pu Ji të Mançurisë, perandorin kukull të pushtesve japonezë, nuk e vranë. Pasi e mbajtën disa vjet në një kamp edukimi, e kthyen në një objekt muzeal, ku vinin delegacione të ndryshme për t'u takuar e për të biseduar me të dhe të krijonin «bindjen» se si riedukohen njerëz të tillë në Kinën «socialiste». Reklama që i bëhej këtij ish-perandori, përveç të tjerash, kishte për qëllim që t'u hiqte frikën mbretërve, krerëve e kukullave të reaksionit të vendeve të tjera me të cilat Kina mban lidhje, dhe, kështu, këta të mendojnë: «Socializmi i Maos është i mirë, pse të kemi frikë prej tij?»! Me fjalë të tjera, me qëndrimin thellësisht oportunist ndaj perandorit Pu Ji, revizionistët kinezë thonë: «Ju, perandorë, mbretër, sulltanë, princër, fashistë, diktatorë të botës së dytë e të botës së tretë, jeni tanët. Ne me ju do të vemi në socializëm!» Ç'socializëm i bukur!

Qëndrime të tilla, që s'bien erë luftë klase, janë mbajtur në Kinë edhe ndaj feudalëve e kapitalistëve, pasuritë e të cilëve nuk u prekën si në revolucionin demokratiko-borgjez të Sun Jat Senit, ashtu edhe pasi Kina u çlirua nga ushtria e Mao Ce Dunit dhe u deklarua një «demokraci e re», ku u ruajtën, si të thuash, treçerek të pasurive të shfrytëzuesve, sepse reformat që u bënë në Kinën «socialiste» nuk ishin të thella.

Në Francë dimë që gjatë revolucionit demokratiko-borgjez u konfiskuan pasuritë e kishës dhe të feudalëve, dhe këto, natyrisht, shkuan në favorin e borgjezisë,

e cila, kur pa se rrezikohej nga trazirat e brendshme dhe nga jashtë nga Brunsviku dhe prej Koblencit e në këto kushte mund të rrezohej pushteti i saj politik dhe ekonomik, i preu kokën mbretit, likuidoi njërin pas tjetrit fraksionet e ndryshme të zhirondinëve, pastaj me radhë edhe të republikanëve më të fortë, ku natyrisht u infiltruan pikëpamjet e elementit konservator borgjez. Kështu dantonistëve¹ e hebertistëve² iu pre koka në gijotinë, siç iu pre më vonë Robespierit e Sen Zhystit nga shokët e tyre të djathtë si Bijo-Varen³ e të tjerë. Borgjezia franceze nuk lejonte t'i prekeshin interesat e saj klasorë dhe as t'i ndaheshin tokat fshatarësisë, siç predikoi Babëfi⁴ dhe Buonaroti⁵.

Në Partinë Komuniste të Kinës gjatë gjithë historisë së saj ka pasur një numër të madh fraksionesh. Në çdo parti marksiste-leniniste ka pasur fraksione, devijime ideologjike, por në Kinë këto devijime kanë pasur një karakter tjetër. Ato mund të barazohen me fraksionet e Revolucionit Demokratiko-Borgjez Francez, me përjashtim të asaj që në Kinë nuk u priteshin kokat kundërshtarëve politikë. Natyrisht këto fraksione në Kinë ruanin karakterin gjoja ideologjik, por, në

1. Sipas emrit të Zhorzh Zhak Dantonit (1759-1794), politikan francez.

2. Sipas emrit të Zhak Rene Hebertit (1757-1794), politikan francez; luftuan kundër zhirondinëve.

3. Zhan Nikolas Bijo-Varen (1756-1819), revolucionar francez, jakobin.

4. Fransua Noel Babëf (1760-1797), revolucionar francez.

5. Filipp Buonaroti (1761-1837), revolucionar francez me origjinë italiane.

fakt, kishin më tepër karakter politik dhe për qëllim vendosjen e pushtetit personal, kishin pikërisht karakterin e veprimeve të «zotërve të luftës», të cilët, natyrisht, donin që republika e porsakrijuar kineze të mos merrte rrugën e socializmit, të një shteti të centralizuar dhe të disiplinuar.

Kinezët i numërojnë këto si «10 luftëra» që ka bërë Mao Ce Duni. Ato luftëra janë, por në Partinë Komuniste të Kinës këto luftëra nuk janë si ato që janë bërë në Partinë Bolshevike ose në Partinë tonë, ku nga njëra anë ishin marksistë-leninistët e vërtetë që luftonin për mbrojtjen e partisë e të vijës së saj marksiste-leniniste dhe nga ana tjetër deviatorët trockistë, anarkistë e çfarë të duash. Jo, këtu, në këto fraksione të Partisë Komuniste të Kinës asnjë krah nuk udhëhiqej nga marksizëm-leninizmi. Kishte fraksione ku të tërë udhëhiqeshin nga pikëpamja konfuze më tepër borgjeze përparimtare sesa marksiste-leniniste; të tjera fraksione ishin më të djathta, ose më të majta, por në udhëheqje të Partisë Komuniste të Kinës kurrë nuk kishte një fraksion marksist-leninist, domethënë një bërthamë të shëndoshë marksiste-leniniste. Pra, Mao Ce Duni dhe shokët rreth e rrotull tij nuk ishin marksistë-leninistë të vërtetë, ata ishin demokratë borgjezë përparimtarë, marksistë në dukje, në frazeologji, por që luftonin e luftuan deri në fund për konsolidimin e një shteti të madh demokratiko-borgjez përparimtar, për një «demokraci të re», siç e quajti Mao Ce Duni.

Liu Shao Çia, Çu En Lai, Ten Hsiao Pini, Pen Çeni dhe elementë të tjerë ishin të djathtë, elementë të borgjezisë që mbronin borgjezinë e madhe nacionale

për të ruajtur prerogativat e saj, natyrisht të maskuara me demagogji majtiste, dhe ky fraksion e bënte këtë nën maskën komuniste. Brenda në PK të Kinës gjatë një periudhe pas çlirimit, ky grup kishte marrë pushtetin dhe vepronte në këtë rrugë për konsolidimin e borgjezisë kapitaliste kineze.

Mao Ce Duni nuk ishte marksist-leninist, por një revolucionar borgjez përparimtar, më përparimtar nga Liu Shao Çia, por përsëri një revolucionar centrist, i cili hiqej si komunist dhe qëndronte në krye të partisë komuniste. Brenda në Kinë, në parti, në popull dhe jashtë vendit atij i doli emri si një marksist-leninist i madh që luftonte për ndërtimin e socializmit. Por pikëpamjet e tij nuk ishin marksiste-leniniste; ai nuk ndiqte teorinë e Marksit e të Leninit, ai ishte ndjekës i veprës së Sun Jat Senit, por në pozita më të avancuara, duke i veshur pikëpamjet e veta, si me thënë, me disa formula revolucionare të majta, me disa teza dhe slogane marksiste-leniniste. Mao Ce Duni hiqej si një dialekticien marksist-leninist, por nuk ishte i tillë. Ai ishte një eklektik, që bashkonte dialektikën marksiste me idealizmin konfucian e filozofinë e vjetër kineze. Fakt është se në drejtimin e partisë dhe të shtetit, të politikës dhe të ideologjisë, në zhvillimin e Kinës dhe të partisë së saj dhe në zhvillimin e koniunkturave ndërkombëtare, ai nuk është mbështetur në dialektikën materialiste marksiste-leniniste, që ta udhëhiqte Kinën në rrugën drejt socializmit.

Nga ana tjetër, shohim se në parti ekzistonte edhe ana majtiste, që maskohej edhe ajo me parulla marksiste-leniniste. Të gjitha këto deviacione nuk çonin ujë

në mullirin e socializmit. Të tëra palët, për të arritur një qëllim, me forma të ndryshme, me metoda të ndryshme, me maska gati të njëllojta, ngrinin flamurin e Mao Ce Dunit, të tërë luftonin nën flamurin e Mao Ce Dunit, flamur që nuk ishte marksist-leninist. Vetëm emri i kishte dalë këtij si i tillë. Ky flamur u duk qartë që nuk ishte marksist-leninist pas vdekjes së Mao Ce Dunit.

Çfarë ngjau? Hua Kuo Feni, «me një të goditur», siç thotë vetë, rrëzoi «katërshen» dhe gjithë teorinë centriste jomarksiste të Mao Ce Dunit, solli në fuqi kra-hun e djathtë, me një fjalë gjithë elementët e dënuar nga revolucioni «i madh kulturor» gjoja proletar dhe bëri grushtin e shtetit, siç bëri Napoleoni i parë, por edhe Napoleoni i tretë më vonë. Edhe Ten Hsiao Pini nuk është veçse një Napoleon i vogël. Ashtu si dhe Napoleoni, që kërkonte të krijonte perandorinë franceze, me qëllim që Franca të dominonte në atë kohë në Evropë dhe t'i priste hovin perandorisë angleze, ta bllokonte Anglinë në ishull dhe ta mundte, edhe Ten Hsiao Pini me shokët e tij luftojnë aktualisht për hegjemoni botërore, me qëllim që Kina të bëhet një superfuqi e atillë që të dominojë në botë, bile të predominojë, po të kishte mundësi, edhe mbi Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pa mbi Bashkimin Sovjetik po se po. Këtë qëllim Kina përpiqet ta arrijë me anë të luftës, duke u armatosur me mjetet më moderne, duke zhvilluar ekonominë, teknologjinë me ndihmën e shteteve kapitaliste dhe duke bërë njëfarë politike, njëfarë ideologjie, që mbështetet në një teori jomarksiste dhe që quhet maocedunide.

Këtë teori revizionistët kinezë do ta përdorin si një

maskë për t'u hequr sikur janë socialistë, por në fakt nuk janë dhe nuk mund të jenë socialistë, nuk mund të jenë marksistë-leninistë. Aq sa mund të ishte Napoleoni një robespierist, një jakobin, aq sa mund të ishte ai një babëfist¹, aq mund të jenë edhe revizionistët kinezë marksistë-leninistë. Revizionistët kinezë janë ashtu siç ishte Napoleoni që kërkonte të vendoste perandorinë e tij. Ai e vendosi dhe e krijoi perandorinë, por kjo shpejt u shkatërrua. Kështu do të vijë dita që edhe revizionistët kinezë të shkatërrohen.

Marksizëm-leninizmi dhe revolucioni proletar në Kinë do të fitojnë dhe këta renegatë do të humbasin. Natyrisht, një revolucion i tillë nuk do të fitojë pa luftë e pa gjak, për arsye se në Kinë do të duhen shumë përpjekje për të krijuar faktorin kryesor subjektiv, partinë revolucionare marksiste-leniniste, e cila nuk ekzistonte e tillë as më parë e nuk ekziston as tash.

Duhet përgatitur po ashtu masat që të kuptojnë se nuk mund të rrohet me iluzione. Masat duhet ta kuptojnë politikisht se në krye të tyre nuk qëndrojnë revolucionarë marksistë-leninistë, por elementë të borgjezisë, të kapitalizmit, që kanë hyrë në një rrugë që s'ka asgjë të përbashkët me socializmin dhe me komunizmin. Por që ta kuptojnë këtë, masat duhet të realizojnë çështjen bazë që maocedunideja nuk është marksizëm-leninizmi dhe se Mao Ce Duni nuk ishte një marksist-leninist. Ai, si me thënë, nuk e tradhtoi vetveten. Ne themi se Maoja është një renegat, është një antimarksist dhe ky është një fakt. Këtë ne e themi

1. Pasues i F. Babëfit.

pse ai u përpoq që të maskohej me marksizëm-leninizmin, por në të vërtetë ai nuk ka qenë kurrë një marksist.

Revolucioni në Kinë, në përgjithësi, mund të themi se në disa drejtime ka pasur disa tipare të atilla që ka qenë i prirë të zhvillohej në rrugën socialiste, por masat e marra mbetën në mes të rrugës, ose u zhdukën, siç po zhduken aktualisht, dhe maskat do të bien njëra pas tjetrës. Të gjitha këto duhet të kuptohen nga populli kinez, por duhet të kuptohen edhe jashtë Kinës, pse për fat të keq gjithë zhvillimi i këtij vendi — lufta nacionalçlirimtare e popullit kinez, vendosja e një pushteti demokratik popullor borgjez përparimtar — ka kaluar në histori si një revolucion proletar, që në fakt nuk ishte i tillë, ka hyrë në histori sikur Kina është një vend që ndërton socializmin, gjë që as kjo nuk është e vërtetë.

Të gjitha çka kemi thënë ne për Kinën në Plenumin e 2-të e të 3-të të KQ të PPSH dhe në këto shënime mendoj se, në përgjithësi, zbulojnë realitetin kinez, por nuk duhet mbetur në këto që kemi thënë. Neve na vihet detyrë që ta studiojmë thellë dhe në çështjet kyç kryesore e vendimtare politikën e veprimtarinë e Partisë Komuniste të Kinës në zhvillimin dialektik të historisë së saj, në mënyrë që me fakte e dokumente t'i vërtetojmë këto ide e përfundime të përgjithshme ku kemi arritur, që mendoj se nuk janë të gabuara. S'ka asnjë dyshim se ka çështje të cilave nuk u kemi dhënë përgjigje të plota, ka mungesa, ka probleme të diskutueshme, që kërkojnë studime më të thella, kjo nuk mund të mohohet, por, në përgjithësi, fak-

tet tregojnë se Kina ka kaluar në një rrugë të tillë kaotike, jomarksiste.

Me këtë që ngjau aktualisht, domethënë pas puçit të Hua Kuo Fenit edhe të Ten Hsiao Pinit, Kina është duke kaluar në një stad akoma edhe më prapa nga ai që kishte arritur me Mao Ce Dunin. Ky ishte më progresist nga Hua Kuo Feni dhe nga Ten Hsiao Pini, pse të dy këta janë ultra të djathtë, ndërsa Mao Ce Duni ishte një centrist.

Në një nga shkrimet e mia¹ kam thënë se duhen rrëzuar mitet dhe pikërisht kam pasur parasysh çështjen që duhej dhe duhet rrëzuar miti i Mao Ce Dunit, ai mit që e ka quajtur atë si marksist-leninist «të madh». Mao Ce Duni nuk është një marksist-leninist, por një demokrat revolucionar përparimtar dhe nën këtë prizëm, mendoj unë, duhet studiuar vepra e tij.

Kam thënë se pikëpamjet e Mao Ce Dunit nuk duhen studiuar vetëm nga frazat e rregulluara në katër vëllimet e tij që janë botuar, por duhen studiuar në zbatimin e tyre në jetë. Dhe ato janë zbatuar në një periudhë jo si ajo e Revolucionit Demokratiko-Borgjez të Francës, kur borgjezia ishte një klasë progresiste në kohën e vet. Aktualisht mendimet e Mao Ce Dunit zhvillohen në kohën e kalbëzimit të imperializmit, të stadi të fundit të kapitalizmit, pra në kohën kur në rendin e ditës janë revolucionet proletare dhe kur shembulli e mësimet e mëdha të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, mësimet e Marksit e të Leninit janë

1. Është fjala për shënimin e datës 31 dhjetor 1976 në Ditarin Politik. (Shih: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 383-384.)

për ne udhërrëfyese të pagabuara. Teoria e Mao Ce Dunit, maocedunideja, që lindi në këto kushte të reja, do të mundohej të vishte petkun e teorisë më revolucionare e më shkencore të kohës, të marksizëm-leninizmit, por në thelb ajo mbeti një teori antimarksiste, për arsye se është në kundërshtim me revolucionet proletare dhe i shkon në ndihmë imperializmit në kalbëzim.

Prandaj, në ideologjinë e Mao Ce Dunit ne do të gjejmë të pasqyruara të gjitha aspektet e ideve që ka shpikur kapitalizmi dhe imperializmi gjatë gjithë kësaj periudhe shumëvjeçare të rënies dhe të kalbëzimit të tij. Maocedunideja është një amalgamë ideologjish, duke filluar që nga anarkizmi, trockizmi, revizionizmi modern ala titist, ala hrushovian, eurokomunizmi ala Mar-she-Berlinguer-Karriljo, më në fund deri dhe te përdorimi i formulave marksiste-leniniste. Në gjithë këtë amalgamë ne duhet të dallojmë edhe idetë e vjetra të Konfucit, të Mencit e të filozofëve të tjerë kinezë, të cilët kanë ndikuar për së tepërmi në formimin e ideve të Mao Ce Dunit, në zhvillimin e tij kulturor dhe teorik. Kështu që është e zorshme të përcaktosh një vijë të vetme ose, si të thuash, një vijë të qartë të ideologjisë kineze. Edhe ato anë të saj, që mund të thuhet se janë njëfarë marksizëm-leninizmi i shtrembëruar, kanë vulën dhe një karakter aziatik, kanë specifikën e një «komunizmi aziatik», janë njëfarë «aziakomunizëm» si edhe eurokomunizmi, ku internacionalizmin proletar të Marksit dhe të Leninit nuk mund ta gjesh në kuptimin e plotë dhe të vërtetë të tij. Në ideologjinë kineze do të gjejmë doza të theksuara nacionaliste, ksenofobe, fetare, budiste, mbeturina të theksuara të ideologjisë feu-

dale, për të mos folur për mbeturina të tjera të shumta që ekzistojnë dhe nuk janë luftuar në mënyrë sistematike jo vetëm gjatë periudhës së luftës nacionalçlirimtare, por sidomos gjatë periudhës së vendosjes së pushtetit të demokracisë popullore.

Duhet pohuar se borgjezia reaksionare botërore e ka pasë ndjekur dhe e ka pasë studiuar më me kujdes zhvillimin e politikës dhe të ideologjisë së Mao Ce Dunit, zhvillimin e luftërave politiko-ideologjike të Kinës, jo vetëm në periudhat e pararevolucionit, por edhe gjatë revolucionit. Pikërisht pse borgjezia reaksionare botërore ka parë që kjo politikë dhe kjo ideologji kishte specifikën e saj kineze aziatike, ishte larg nga marksizëm-leninizmi, prandaj e ka mbrojtur, e ka mbështetur dhe e ka propaganduar, bile edhe si marksiste-leniniste. Borgjezia, në shkrimet e në botimet e veta, e jep qartë orientimin e politikës dhe të ideologjisë së Mao Ce Dunit dhe e cilëson atë jo si marksiste, por si një ideologji borgjeze revolucionare dhe ajo, në fakt, ashtu është. Imperializmit, kapitalizmit botëror i interesonte që Kina, një kontinent i madh si të thuash, të vazhdonte në këtë rrugë, të ndiqte orientimin politik dhe ideologjik të Mao Ce Dunit, i cili një ditë do të binte hapur në kundërshtim me marksizmin shkencor, pse Kina nuk do ta ndiqte rrugën e marksizmit shkencor. Në zhvillimin e Kinës kjo u duk qartë, kundërshtimet ideologjike u bënë të paevitueshme në mes marksizëm-leninizmit dhe maocedunidesë, jo vetëm aktualisht, por edhe më parë.

Të gjitha mosmarrëveshjet dhe keqkuptimet nga ana e kinezëve me Bashkimin Sovjetik, me Kominter-

nin, me Stalinin, ishin kundërshtime për çështje parimore dhe jo për arsye të tjera.

Kur analizojmë maocedunidenë, mendoj se duhet t'i kemi parasysh të gjithë këta faktorë, që kanë luajtur një rol të madh në zhvillimin politik-teorik të udhëheqjes kineze, të Partisë Komuniste të Kinës dhe që janë reflektuar në orientimet e në veprimet e tyre. Këtë rrjedh edhe strategjia aktuale e maoizmit, e cila, siç e dimë, konsiston në aleancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me gjithë kapitalizmin botëror për t'iu kundërvënë Bashkimit Sovjetik revizionist.

Kjo nuk është vetëm një politikë koniunkturale, por një politikë e cila ka një brendi dhe një bindje ideologjike nga ana e maoistëve. Udhëheqësit kinezë mendojnë gati njësoj si imperialistët amerikanë dhe krerët e «demokracive» të tjera kapitaliste të zhvilluara. Ideologjikisht ata puqen, sidomos në qëllimet e dominimit, sepse dhe Kina, si një shtet i madh, nuk dëshiron që të vihet nën drejtimin dhe nën thundrën e cilitdo nga këta imperialistë e kapitalistë, por dëshiron që të dominojë, ose të paktën të ketë edhe ajo fjalën e saj të madhe, e cila të dëgjohet në botë. Është për këtë arsye që, në një mënyrë ose në një tjetër, Kina maoiste predikon aleancën e proletariatit botëror me borgjezinë kapitaliste dhe me imperializmin amerikan. Duke u vënë në këtë rrugë, Kina pengon në fakt revolucionin botëror, e shtrembëron teorinë marksiste-leniniste, siç po e shtrembërojnë edhe revizionistët e tjerë. Politika e veprimtaria e saj u shërbejnë imperializmit e kapitalizmit që po heqin shpirt, si injeksione të reja për t'i ringjallur, për t'ua shtuar jetën.

Çështja e kundërshtimeve që ka me revizionizmin sovjetik, qëndron vetëm në atë që Kina maoiste e konsideron Bashkimin Sovjetik si një fuqi imperialiste më të dobët nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe mendon se në një aleancë me imperializmin amerikan ajo do të realizojë ëndrrat e saj ekspansioniste, zaptimin e Siberisë dhe të rajoneve të tjera lindore të Bashkimit Sovjetik.

Në këtë çështje qëndron kontradikta midis Kinës e Bashkimit Sovjetik dhe kjo kontradiktë nuk ka karakter ideologjik, siç paraqitet, domethënë që Kina gjc-ja është marksiste-leniniste dhe Bashkimi Sovjetik është revizionist. Jo, të dy këto vende janë revizioniste, kanë një ideologji borgjeze nga e cila udhëhiqen dhe luftojnë kundër revolucionit pikërisht në kushtet e kalbëzimit të imperializmit.

Prandaj, më duket mua, të gjitha këto shënime duhen thelluar dhe argumentuar më mirë me një dokumentacion më të pasur, dokumentacion ky që duhet kërkuar, se ekziston në një mënyrë ose në një tjetër, qoftë edhe nëpër gazetatat ose në librat që herë pas here dalin në Kinë ose jashtë saj. Por këto duhen studiuar në mënyrë kritike dhe duhen ballafaquar me realitetin kinez e me parimet e tezave themelore të ideologjisë sonë të madhe revolucionare, marksizëm-leninizmin.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 742

Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 742

NE USHQEJMË NDJENJA TË SINGERTA PËR POPULLIN FRANCEZ

*Nga biseda me kryetarin e Shoqatës së Miqësisë
Francë-Shqipëri, profesor Pol Miliezin*

29 dhjetor 1977

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se na erdhët! Po na gëzoni me ardhjen tuaj. Më kanë thënë se keni qenë i sëmurë. Si jeni tani me shëndet, zoti Miliez?

POL MILIEZI: Faleminderit, mirë jam tani, po kalova një sëmundje të rëndë që më kushtoi shtrenjtë. Nuk e di nëse do të rroj gjatë pas kësaj.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo që po thoni më trishton shumë, por nuk jam dakord me mendimin tuaj. Pavarësisht nga sëmundja që kaluat para pak kohësh, jam i bindur se ju do të rroni shumë.

Unë nuk jam dakord edhe me mendimin tjetër tuajin se është hera e fundit që vini këtu në Shqipëri, dhe nuk jua uroj një gjë të tillë. Gjithçka do të kalojë me sukses, sepse ju jeni njeri me kurajë, bëni ç'është e mundur për t'u kuruar dhe, siç shihet, rezultatet e mjekimeve janë të shkëlqyera. Ju u keni kushtuar tërë vëmendjen tuaj, u keni dhënë kurajë, forcë dhe jetë

gjithë shokëve tanë që kanë ardhur në Francë për vizitë e kurime mjekësore; i keni shëruar në mënyrë që, kur të ktheheshin në atdhe, të vazhdonin punën si dhe më parë, për çka ne ju jemi shumë mirënjohës. Ne jemi plotësisht të bindur se këtë gjendje ju do ta kapërceni, se keni shëndet prej hekuri. Ju, zoti profesor Miliez, duhet të kujdeseni për shëndetin që të rroni shumë, jo vetëm për veten tuaj, por edhe për familjen dhe për të gjithë ne e për shoqatën që drejtoni.

Ne ju nderojmë dhe ju respektojmë, zoti Miliez, si një njeri të shquar në shkencën e mjekësisë, ashtu si dhe shumë shkencëtarë të tjerë. Përveç kësaj, ne vlerësojmë simpatinë e madhe që ju ushqeni për vendin tonë, gjë që na gëzon pa masë. Miqësia juaj për vendin tonë është e çmuar.

Ju jeni një personalitet politik, që i shikoni sipas pikëpamjes suaj drejt problemet dhe e shprehni gjithmonë mendimin tuaj me sinqeritet dhe me kompetencë. Keni një zemër të madhe dhe mishëroni në vetvete karakteristikat aq të mira të popullit francez, që për ne është një popull vëlla shumë i sinqertë, i cili ka luftuar gjithmonë ashtu si dhe populli ynë për lirinë dhe për sovranitetin e vendit të vet. Kurrë populli francez s'ka pranuar t'i nënshtrohet zgjedhës së të tjerëve, sepse ai është karakterizuar gjithmonë nga fryma revolucionare dhe sot lufton për të ruajtur personalitetin e tij të krijuar gjatë shekujve. Të gjitha këto karakteristika ne i kemi parë te mjaft francezë me të cilët kemi pasur rastin të kemi kontakte. Ne i konceptojmë këto pikëpamje për popullin francez me sinqeritet dhe ushqejmë ndjenja të ngrohta për të.

Si janë fëmijët dhe nipërit tuaj? Të rinjtë janë e ardhmja e vendeve tona. Ne punojmë që t'u sigurojmë atyre gjithmonë një të ardhme më të mirë dhe që të gëzojnë një shëndet të plotë. Unë u them fëmijëve të mi, që janë të gjithë të martuar, se kam dëshirë të kenë jo më pak se tre fëmijë, pastaj kush të dëshirojë, le të bëjë edhe më shumë, por tre fëmijë janë të nevojshëm për shtimin e popullsisë.

Shokët e mi dhe unë ju falënderojmë për punën tuaj të madhe e të mirë që bëni në kryesinë e Shoqatës së Miqësisë Francë-Shqipëri.

Siç e dini, ne jemi një popull i vogël, që dëshiron të jetojë në mënyrën e tij, në një jetë të shëndoshë, sipas pikëpamjes sonë. Populli ynë nuk është i prirë të dëmtojë të tjerët, ai kurrë nuk u ka bërë e nuk do t'u bëjë keq të tjerëve. Qëllimi i tij është të përmirësojë çdo ditë e më shumë kushtet e jetesës dhe punon e bën ç'është e mundur që të jetojë i sigurt, i lirë dhe i lumtur në atdheun e vet.

Qeveria jonë ushqen ndjenja të singerta për Francën. Ne duam t'i zgjerojmë kontaktet që janë vendosur prej kohësh mes dy vendeve, Francës dhe vendit tonë të vogël, Shqipërisë. Edhe në të kaluarën kemi folur dhe kemi ushqyer simpati për guximin, kurajën dhe luftën për drejtësi shoqërore që ka bërë plejada e njerëzve të mëdhenj e të guximshëm francezë. Njerëz trima dhe realistë të vendit tuaj kanë mbështetur çështjen e popullit tonë. Ne mund të ngjitemi deri te Montenj, «Esetë» e famshme të të cilit fillojnë me një ide plot elozhe drejtuar Heroit tonë të madh Kombëtar, Skënderbeut. Në këtë fushë ne mund të përmendim,

nder të tjerë, poetin e madh të plejadës, Ronsarin, i cili ka kompozuar një sonet të mrekullueshëm për Skënderbeun dhe për luftërat e tij heroike kundër turqve. Do të desha të përmend, gjithashtu, senatorin D'Esturnel të Konstan, i cili u vu në mbrojtje të tokave kufitare shqiptare që donin të rrëmbenin serbët e malazeztë, si dhe emrin e Zhysten Gojarit, senator dhe ministër i Shëndetësisë, që ka shkruar dy libra për Shqipërinë dhe për jetën e popullit tonë, si dhe shumë të tjerë. Por është një kënaqësi dhe një nder i madh për ne të përmendim midis miqve të mëdhenj të sotëm të Shqipërisë socialiste personin tuaj të shquar, mik besnik dhe i sigurtë i popullit tonë dhe shkencëtar me vlerë dhe famë të madhe botërore. Autoriteti juaj në shkencat mjekësore ndjek famën e shkencëtarëve të mëdhenj që bënë epokë, si Pastëri, Klod Bernari, Rui, Kalmeti dhe shumë të tjerë. Qëllimi ynë është dhe do të jetë që t'i vëmë në dispozicion popullit dhe inteligjencias sonë këtë thesar të madh të shkencës progresiste botërore dhe veçanërisht franceze. Prandaj ne duhet të zgjerojmë marrëdhëniet që janë vendosur midis dy vendeve tona. Populli juaj ka një personalitet të madh dhe një kulturë realiste. Francezët janë njerëz të guximshëm. Në Francë kanë pasur rastin të studiojnë shumë nga njerëzit tanë, të cilët i kanë njohur mirë vetitë e larta të popullit tuaj. Shumë francezë, njëri prej të cilëve keni qenë ju, gjatë kohës së okupacionit gjerman kanë qenë partizanë e kanë luftuar ashtu si edhe partizanët shqiptarë kundër okupatorëve nazifashistë.

POL MILIEZI: Te ne ka pasur partizanë më pak se

në vendin tuaj, ne kemi luftuar më pak se ju, zoti President.

SHOKU ENVER HOXHA: Por të dy popujt tanë gjatë Luftës së Dytë Botërore kanë luftuar për të njëjtin qëllim. Luftën partizane në Francë kam pasur rastin ta njoh nëpërmjet librave që më kanë dërguar vazhdimisht ambasadorët tanë në vendin tuaj. Në bazë të këtyre studimeve për luftën partizane në Francë dalin në pah dy karakteristika të ngjashme me ato të luftës sonë. Në Shqipëri Lufta Nacionalçlirimtare ka qenë e drejtuar nga Partia. Kurse te ju i rëndësishëm ishte fakti që «makitë»¹ përbëheshin nga francezë të guximshëm, të vërtetë, të cilët, pavarësisht nga pikëpamjet e tyre politike e fetare, kanë luftuar në mënyrë të njëjtë për çlirimin e vendit.

Ne, kur filluam luftën kundër okupatorëve, i bëmë thirrje gjithë popullit që të na ndiqte në rrugën tonë. Pa një politikë të tillë për bashkimin e të gjitha forcave të vendit në luftën për çlirim, nuk mund ta realizonim dot fitoren. Natyrisht, kjo thirrje u shoqërua me një punë të madhe nga ana jonë, duke ua bërë të gjithëve të qartë se regjimin politiko-shoqëror do ta vendoste vetë populli sipas dëshirës. Dhe kështu ndodhi. Populli vendosi vetë formën e regjimit dhe arriti një tog suksesesh që mendojmë se janë rezultat i politikës së drejtë që është ndjekur nga Partia jonë. Partia që në fillim, mbi të gjitha, në politikën e saj ka pasur parasysh mbajtjen e lidhjeve shumë të ngushta me popullin.

1. Kështu quheshin partizanët francezë në Luftën e Dytë Botërore.

Kuptohet se kjo rrugë që zgjodhi populli ynë nuk i ka bërë keq Shqipërisë së vogël. Natyrisht, të tjerët kanë pikëpamjet e tyre për rregullimin e jetës në vendet e tyre dhe ne, nga ana jonë, bëjmë ç'është e mundur të mbajmë lidhje me vende të ndryshme të botës, duke bashkëpunuar në çdo drejtim ku kemi përputhje interesash.

Raporti i Kongresit të 7-të të Partisë sonë vë qartë në dukje se me Francën ne kemi lidhje dhe dëshirojmë të vazhdojmë që të rrojmë në miqësi.

Qëllimi i Shoqatës së Miqësisë Francë-Shqipëri është që të zgjerojë sa më shumë radhët e anëtarëve të saj me njerëz me pikëpamje të ndryshme, t'i njohë gjithë këta miq me Shqipërinë dhe me përpjekjet e saj, në mënyrë që, sa të jetë e mundur, gjithmonë e më shumë francezë të simpatizojnë vendin tonë. Prandaj ne u lutemi të gjithë këtyre njerëzve që kjo shoqatë miqësie të ziejë nga puna dhe veprimtaria e vazhdueshme, të ketë në gjirin e saj luftë mendimesh, të bëhen sa më të frytshme debatet demokratike, të cilat paraqitin interes reciprok.

Zoti profesor Milliez, ne jemi të bindur që ju, me shkencën, me diturinë tuaj dhe me personalitetin tuaj, bëni një punë të madhe për zgjerimin e rrethit të miqve të Shqipërisë. Nëpërmjet Shoqatës Francë-Shqipëri ne duam të kontribuojmë për shtimin dhe për forcimin e miqësisë midis dy popujve dhe vendeve tona. Por, natyrisht, kjo veprimtari nuk duhet të jetë e njëanshme. Kjo do të thotë që edhe ne të përiqemi ta njohim popullin tonë me sukseset e popullit francez në fushën ekonomike e shoqërore, në kulturë, në art etj. Ana-

sjelltas, edhe ju e bëni një gjë të tillë për njohjen e popullit tuaj me sukseset e popullit shqiptar në fushat e ndryshme të veprimtarisë politike, ekonomike e shoqërore. Të dyja palët të bëjmë sa më shumë që ta njohim njëri-tjetrin, sepse në këtë mënyrë më tepër dhe më mirë do ta ruajmë pavarësinë, sovranitetin dhe do të thellojmë miqësinë tonë.

Ju, zoti profesor Miliez, jeni një mik i madh i Shqipërisë dhe si i tillë dëshiroj t'ju them se ne jemi kundër diplomacisë së fshehtë, prapa krahëve të popujve. Ne kemi qenë dhe jemi për një politikë të hapur, në dritën e diellit, me të gjithë dhe jemi të bindur se ata që e dallojnë këtë karakteristikë të drejtë të politikës sonë, do të na duan. Por edhe në qoftë se nuk do të na duan, këtë gjë do të na e thonë. Dakord që të tjerët kanë politikën e tyre dhe kanë aspekte që i bëjnë ata të thonë se politika që ndjekim ne shqiptarët është politika e një vendi të vogël. Edhe për këtë ne jemi të ndërgjegjshëm, por kjo politikë sot, kur po flitet për izolim, ne nuk na izolon.

POL MILIEZI: Jam shumë i kënaqur që ju dëgjoj, zoti President!

SHOKU ENVER HOXHA: Në botë ka njerëz dhe politikanë që e kuptojnë se, në këtë përleshje ku jemi futur tash me Kinën, nuk jemi në shërbim të asnjë qeverie. Kjo gjë dihet mirë, si nga shtetet kapitaliste, ashtu edhe nga ato që ne i quajmë revizioniste. Në gazeta të ndryshme të botës dhe të Francës, si për shembull në «Lë Mondë» etj., konstatojmë se disa herë shkruhet me simpati për vendin tonë. Autorët që shkruajnë në këto gazeta nuk na vënë këmbën, nuk thonë

që ne jemi të izoluar, nuk kanë frikë se mos izolohejmë dhe, megjithëse nuk mendojnë politikisht si ne, ndiejmë që ata janë në favor të luftës sonë për të mbrojtur kauzën e drejtë të popujve. Ne i sigurojmë miqtë tanë, që janë të shumtë, se çështja që mbrojmë do të triumfojë.

POL MILIEZI: Miqtë e Shqipërisë janë të sigurt për besën tuaj.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju, zoti profesor Miliez, e keni kuptuar drejt politikën tonë. Mundet që një numër i madh miqsh në botë, të cilët na e duan të mirën, e kuptojnë që pikëpamjet tona s'janë çështje konvencionale. Ato kanë qenë dhe janë bindje për popullin, që nuk mund të realizohen me dekrete ose me masa strikte.

Unë kam qenë kryetar i Këshillit të Ministrave dhe më kujtohet se sa punë e madhe na është dashur në atë kohë për të krijuar bindje të drejta te njerëzit. Ne edhe kryetarëve të komuniteteve fetare u kemi pasë folur atëherë hapur që të mos preknin interesat e popullit, të mos hidheshin kundër tij, por, si priftërinjtë, ashtu edhe hoxhallarët, të kryenin vetëm shërbimet fetare, për të cilat qeveria edhe i financonte, dhe të mos përziheshin me njerëzit e këqij, armiq të Shqipërisë. Ne i paralajmëruam ata se, po të përziheshin në çështje që preknin interesat e lirisë dhe të pavarësisë së vendit, atëherë do të merrnim masa kundër tyre. Megjithatë ka njerëz në botë që vështirë ta kuptojnë se Shqipëria komuniste ka pasë mbajtur një qëndrim të tillë ndaj njerëzve që besonin fenë. Krerët e komuniteteve fetare, në përgjithësi, kanë qenë kuislingë, ata kanë bashkëpunuar me diversantët, kanë bërë punë

armiqësore në altarin e kishës. Prandaj, kur i kemi kapur në flagrancë, i kemi dënuar, sepse i kishim paralajmëruar që të mos merrnin pjesë në komplete të armatosura dhe në veprimtari subversive. Për sa i takon çështjes së besimit ne nuk kemi prekur as popullin, as prelatët e fesë.

Ky ka qenë qëndrimi ynë me popullin për këtë çështje, gjë që bëri të sigurohej uniteti i tij rreth Partisë sonë, si dhe liria dhe sovraniteti i vendit. Ne mendojmë që këto u siguruan, sepse Partia dhe Qeveria kanë punuar dhe punojnë me kujdes e me zemër për të kalitur një unitet të pathyeshëm mendimi në masat e popullit. Por kjo nuk është e mjaftueshme. Ky unitet duhej e duhet të kalitet në një demokraci të gjerë të masave. Ne kemi mendimin se rruga demokratike që ndjekim, është më e mira, por nuk mund të mos njohim faktin se ka edhe njerëz që nuk mendojnë si ne. Këtyre ne u themi: mos bëni veprime kundër politikës së Partisë sonë, por keni të drejtë të kritikoni çdo gjë që mendoni se nuk shkon mirë, dhe këtë ta bëni kudo e kurdoherë që t'ju jepet mundësia dhe jo vetëm në mbledhjet e organizatës së Frontit Demokratik, organizatë në të cilën marrin pjesë masat e gjera të popullit dhe ku shprehen hapur mendimet për probleme të ndryshme.

Na shkruani, u kemi thënë njerëzve të popullit, në qoftë se keni vërejtje për drejtuesit dhe për njerëzit e tjerë. Dhe njerëzit e thjeshtë na shkruajnë, ata kanë besim tek udhëheqja e Partisë dhe e pushtetit. Në Komitetin Qendror të Partisë vijnë çdo ditë me shumicë letra e telegrame, të cilave ne u kushtojmë

një vëmendje të madhe. Në këto letra njerëzit na shkruajnë për probleme nga më të ndryshmet. Ka nga ata që ankohen për persona që nuk e kryejnë si duhet detyrën që u është caktuar dhe ne, pasi e verifikojmë, po të rezultojë e vërtetë çka shkruhet, u heqim vërejtjen funksionarëve, drejtuesve dhe në të njëjtën kohë marrim masa. Njerëz të ndryshëm shkruajnë edhe për ndonjërin që ka qenë në radhët e armikut. Ne u themi këtyre që është e vërtetë se filani ka qenë në radhët e armikut, por të mos harrojmë se ai sot punon mirë dhe fëmijët e tij ne duam t'i kemi në anën tonë dhe jo t'ia japim armikut. Ne nuk lejojmë që këta t'i marrë njeri nëpër këmbë, nuk lejojmë të mbahen qëndrime ekstremiste dhe të dëmshme ndaj tyre. Qëndrime dhe sjellje të tilla i kritikojmë dhe i dënojmë. Mendojmë që format e punës që sugjerojmë për t'u përdorur me këta njerëz, janë të mira dhe rezultati është pozitiv.

Në përgjithësi njerëzit tanë shkruajnë në letrat e tyre hapur, pa frikë për çdo gjë e për cilindo. Për këtë u kemi thënë që, në letrat që na drejtojnë, të vënë edhe emrin e tyre, sepse askush nuk do t'u bëjë keq. Megjithatë ka edhe ndonjë që nuk vë emrin. E tillë është jeta, nuk e kanë të gjithë guximin për të shkruar hapur. Me letrat që marrim, ne procedojmë në mënyrë të tillë: nuk nisemi nga çështja se kush e ka shkruar atë, por nga përmbajtja, domethënë përpiqemi të verifikojmë nëse ato që shkruhen në çdo letër janë të vërteta, apo jo. Dhe unë mund t'ju them se ka shumë letra në të cilat shkruhen ngjarje të vërteta, por ka edhe ndonjë nga ato që nuk pasqyron të vërtetën, ose ka njerëz që shkruajnë thjesht për çështje personale,

për probleme familjare të përditshme, për ndonjë fërkim me njëri-tjetrin etj., dhe i shtrojnë problemet në një frymë të drejtë.

Ne jemi të lumtur që keni pasur një qëndrim të këndshëm në vendin tonë. Natyrisht, kemi dëshirë që të mos mbetet hera e parë e as e fundit, që ju të vini në Shqipëri për të kaluar pushimet. Na vjen shumë keq që këtë herë, ashtu siç na kishit premtuar, nuk erdhën edhe fëmijët tuaj. Megjithatë duhet të gjejnë kohën e përshtatshme që të vijjnë për të kaluar pushimet, sidomos në verë. Është mirë që ata ta vizitojnë dhe ta njohin vendin tonë. Në mënyrë të veçantë vajza juaj, që është edhe arkeologe, do të ketë interes të vijë ta shikojë Shqipërinë. Ne do të jemi shumë të gëzuar që ata të vijjnë përsëri në vendin tonë.

Më lejoni të ngre një dollë, i dashur zoti profesor Milieç! Shokë, ju lutem të pini për zonjën dhe zotin Milieç, miqtë tanë të dashur. Nuk dua të mbaj një fjalim zyrtar, sepse ky është takim intim, midis miqsh e familjeve tona. Shpresojmë të na vini shpesh, shumë shpesh, të dashur miq, sepse ju na sillni pamjen e Francës dhe ne do t'ju komunikojmë juve pamjen e Shqipërisë. Miqësia jonë është një e mirë që së bashku duhet ta kultivojmë e ta zhvillojmë më shumë. Ne kemi gjithashtu te ju, zoti Milieç, njeriun që vlerëson objektivisht realizimet e popullit tonë. Megjithëse jemi akoma larg nga qëllimi që duam të arrijmë, jemi të bindur, dhe këtë gjë edhe ju e vini re, që perspektiva jonë do të jetë gjithmonë e më e mirë.

Ne e dimë që ju jeni bij të popullit të shquar francez, por, siç thashë, keni një kulturë të gjerë, e cila

ju ka hapur horizontin dhe ka rritur e ka zhvilluar te ju ndjenjat e miqësisë për popujt e tjerë, duke përfshirë edhe popullin tonë. Për këtë arsye, të respektojmë zonjë dhe zoti profesor Miliez, ju keni te ne miq që ju duan, që ju respektojnë dhe do t'ju respektojnë gjithmonë, dhe me këtë rast, ashtu si kurdoherë, ne ju urojmë të dyve dhe gjithë familjes suaj shëndet të mirë.

Në emër të të gjithë shokëve e shoqeve, miqve të mi të pranishëm, ju uroj shumë lumturi në jetën tuaj. Ju uroj gjithashtu për Vitin e Ri 1978 lumturi për familjen tuaj, për Francën, për Shqipërinë! Për shëndetin tuaj! Gëzuar!

ZONJA MILIEZ: Ju e flisni frëngjishten shumë mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Bëj përpjekje, përpiqem të evitoj gabimet.

POL MILIEZI: Unë nuk i dalloj dot fare këto «gabime» që thoni ju.

SHOKU ENVER HOXHA: Kam gjysmë shekulli që flas dhe lexoj vazhdimisht frëngjisht. U them shokëve se zotërimi i gjuhës frënge të shërben për të njohur jetën, për të kuptuar klasikët, për të lexuar literaturën e pasur franceze, në radhë të parë, por nëpërmjet frëngjishtes njeriut i krijohet mundësia të njohë edhe studiues e shkrimtarë të tjerë të huaj, si anglezë, gjermanë, rusë e të tjerë. Prandaj për Francën dhe për gjuhën frënge kam një respekt të veçantë.

Ne bëjmë ç'është e mundur për të futur në mendjen e rinisë sonë dhe në mënyrën e të jetuarit të saj e të gjeneratave të ardhshme këto ide të dritës, të miqësisë, të punës, të një demokracie të gjerë të punonjësve, të

miqësisë dhe të internacionalizmit të pastër, jo me dy kuptime.

Ne nuk do të largohemi nga vija jonë. Siç thotë Lenini, njeriu që punon, edhe gabon, por ai që është i ndershëm dhe objektiv bën çdo përpjekje që është e mundur, për t'i korrigjuar gabimet, sepse të mos korrigjosh gabimet, do të thotë të jesh megaloman, si të ashtuqajturit komunistë që, me shpirt dominimi, me shpirt përfitimi në rrugë të dënueshme dhe shfrytëzimi të të tjerëve, përpiqen të mashtrojnë popujt e tjerë. Kështu që, sapo i pamë dhe i kuptuam objektivat dhe qëllimet e të tillë njerëzve, ne i braktisëm.

Ne gjithmonë kemi dashur të rrojmë në miqësi me fqinjët tanë. Me ta, në radhë të parë, duam të bëjmë një politikë miqësore e të kemi marrëdhënie diplomatike. Përveç kësaj, edhe përpara ne kemi luftuar krah për krah me popujt fqinjë, por krerët e këtyre vendeve, me politikën që kanë ndjekur ndaj nesh, kanë pasur për qëllim ta mashtronin vendin tonë, bile kanë dashur të na pushtojnë. Titoja nuk kishte për qëllim vetëm skllavërimin e Shqipërisë, synimet e tij ishin akoma më të mëdha. Ai dhe klika e tij prej kohësh janë vënë në shërbim të imperializmit. Titoja është bërë sot si një monark, si kralët e dikurshëm të Serbisë, me synime për sundimin e popujve të tjerë. Edhe Jugosllavia ku sundon ai është shndërruar në një monarki të re. Me politikën që ndjek, Titoja prej kohësh është vënë në aleancë me të gjitha vendet e Perëndimit në kurriz të popujve të Jugosllavisë. Por një politikë e tillë nuk mund të shkojë gjatë. Çfarë doli, për shembull, nga monarkia austro-hungareze? Asgjë, ajo u shkatërrua.

Po në Jugosllavi çfarë do të bëhet pas vdekjes së Titos?! Të gjithë e bëjnë këtë pyetje. Ne kemi një mendim, që mbase është i gabuar, por politika antipopullore që ka ndjekur Titoja brenda në Jugosllavi ka shkaktuar kontradikta të thella midis kombësive të ndryshme, për shkak të gjendjes së rënduar nga rusët dhe nga amerikanët. Dihet se në Jugosllavi ka shumë kombësi, atje jetojnë serbë, kroatë, malazez, shqiptarë e të tjerë, në këtë vend, pra, ka një përzierje kombesh.

Një gazetar i huaj, që ka shkruar për Jugosllavinë që në kohën e Hitlerit, mes të tjerave thotë se, kur e kishte vizituar këtë vend, në zyrën e një funksionari kroat ai kishte parë një kosh me disa objekte si sy molusqesh dhe kishte pyetur se ç'ishin ato. «Ato janë sy serbësh», lu përgjigjën gazetarit, gjë që tregon për grindjet e mosmarrëveshjet midis kombësive në këtë shtet mozaik. Nuk ka dyshim se edhe pas vdekjes së Titos do të ketë shumë grindje midis kombësive në Jugosllavi, por më shumë midis serbëve dhe kroatëve që janë kombësitë më të mëdha në numër. Secila nga këto dy kombësi dëshiron ta ketë federatën nën drejtimin e vet. Por në Jugosllavi jetojnë gjithashtu më shumë se 1,5 milionë shqiptarë që vuajnë, ata përbëjnë kombësinë më të prapambetur. Krerët e regjimit titist vetëm këto vitet e fundit mezi kanë lejuar më lirisht të hapen shkolla për shqiptarët. Kohë më parë, në vitet fill pas Luftës së Dytë Botërore, rreth 500 000 shqiptarë klika e Titos i ka nxjerrë jashtë Jugosllavisë. Ata nuk i lejuan të vinin në Shqipëri, me qëllim që vendit tonë të mos i shtohet gjithë kjo forcë njerëzore, që të mos bëhet më i fortë.

Kolonizatorët e rinj, titistët, kërkojnë tash një zgjidhje për të përmirësuar gjendjen e federatës dhe propagandojnë se gjoja udhëhiqen nga ideologjia marksiste. Ata kanë organizuar ekonominë e gjithçka në bazë të vetadministrimit që gjoja ka dhënë fryte në Jugosllavi, por, në fakt, nga pjesa më e madhe e ekonomisë jugosllave përfitojnë amerikanët dhe kapitalistët e vendeve të tjera që po e skllavërojnë Jugosllavinë nëpërmjet investimeve dhe kredive të mëdha.

Popujt e Jugosllavisë ne i kemi dashur dhe i duam. Edhe popujt sovjetikë i kemi dashur dhe i duam, pse u lidhëm në miqësi me ta, kur në Bashkimin Sovjetik sundonte ideologjia marksiste-leniniste, që na udhëheq në të gjitha qëndrimet dhe në veprimtarinë tonë. Ne orientohemi dhe zbatojmë ato që na mëson teoria jonë marksiste-leniniste, kurse Bashkimi Sovjetik sot nuk ka asgjë të përbashkët me shtetin socialist. Ai është shndërruar në një shtet socialimperialist, që përpiqet të zgjerojë pozitat e tij sunduese në botë në fushën ekonomike, tregtare etj. Me politikën që ndjek udhëheqja revizioniste sovjetike i nxit popujt e botës të vriten me njëri-tjetrin, ashtu siç bëjnë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pra Bashkimi Sovjetik vazhdon politikën e carëve rusë.

... Ka pasur momente që francezët s'kanë pranuar e s'ua kanë lënë portat hapur amerikanëve dhe e kanë kundërshtuar politikën e tyre. Dë Goli i përzuri NATO-n dhe amerikanët, pastaj edhe Pompiduja nuk i la të bënin si të donin.

Marrëdhëniet tona me Kinën ishin të mira. Ashtu si ne, edhe ajo pati kontradikta me Bashkimin Sovjetik,

me Hrushovin. Revizionistët sovjetikë që në fillim ndër morën shumë veprime të ulëta kundër dy partive tona, por që në vitin 1956 ne vërejtëm te kinezët qëndrime politike dhe ideologjike të dyshimta, që na bënë të mendonim dhe të ndiqnim më me vëmendje kursin e veprimeve të tyre. Por për Partinë Komuniste të Kinës dhe për Kinën ne ruanim një respekt dhe një miqësi të sigurtë. Herë pas here ua vumë në dukje udhëheqësve kinezë vërejtjet që kishim, pikëpamjet dhe kundërshtimet tona, por çdo gjë në lidhje me ta, natyrisht, u bë progresivisht. Pastaj revizionistët sovjetikë filluan të sabotonin hapur ndërtimin e socializmit në Shqipëri dhe në mbledhjen e Bukureshtit, jashtë normave tona, ata sulmuan botërisht Kinën. Duke pasur parasysh se ishte një hap me rëndësi të madhe për lëvizjen komuniste ndërkombëtare e duke pasur kurdoherë si udhërrëfyese mësimet e doktrinës sonë marksiste-leniniste, menduam se ishte koha që duhej të hynim në polemikë të hapur me Hrushovin. Në këto kushte, pra, u forcua miqësia jonë me Kinën dhe ne e mbrojtëm atë. Kinezët në atë kohë hezituan të fillojnë luftën e hapur kundër hrushovianëve, por më pas, përpara tradhtisë evidente për të gjithë botën të hrushovianëve, jo shumë të bindur, kinezët filluan të luftonin.

Kur u rrëzua Hrushovi, qëndrimi i kinezëve ndryshoi menjëherë. Ata jo vetëm që nuk u konsultuan fare me ne për sa i përkonte situatës së krijuar në Bashkimin Sovjetik pas rënies së Hrushovit, por në mënyrë arrogante na thanë: «Çfarë doni ju më, Hrushovi ra, këta që kanë ardhur tani në krye të Bashkimit

Sovjetik janë njerëz të mirë» dhe bile na propozuan që të shkonim edhe ne në Bashkimin Sovjetik. Ne u thamë se «vërtet Hrushovi ra, por të gjithë ata që kanë ardhur pas tij janë po aq revizionistë, bile akoma më të këqij e më dinakë se ai, prandaj ne nuk do të shkojmë në Moskë dhe do të vazhdojmë t'i luftojmë këta renegatë të marksizëm-leninizmit». Dhe Çu En Lai, i cili nuk arriti të na e mbushte dot mendjen dhe të na impononte vullnetin e tij, shkoi vetëm në Moskë duke pasur edhe pëlqimin e Mao Ce Dunit. Por ai u kthye në Kinë si një pulë e lagur, sepse sovjetikët i kishin thënë për Mao Ce Dunin: «Ç'po e mbani akoma atë galloshe të vjetër?». Pas këtij poshtërimi ai qëndroi edhe tri-katër ditë të tjera, në vend që të largohej menjëherë nga Moska. E megjithëkëtë, kur u kthye në Pekin, doli vetë Mao Ce Duni për ta pritur në aeroport si triumfator.

Mbas kthimit të Çu En Lait, ne vumë re një ndryshim në politikën dhe në strategjinë kineze ndaj sovjetikëve. Atëherë kinezët «vlerësuan» qëndrimin tonë të drejtë ndaj sovjetikëve, na dhanë edhe ndihmë ekonomike. Këtë ndihmë ne e konsideronim internacionaliste, ashtu siç duhej të ishte, se ne shqiptarët nuk i shesim lirinë dhe pavarësinë e vendit për hir të disa ndihmave. Mirëpo, siç del, kinezët na ndihmuan jo në frymë internacionaliste, por sepse kërkonin përkrahjen tonë përballë sulmeve të revizionistëve sovjetikë. Nga ana tjetër, brenda në vendin e tyre ishin në kaos. Nga konstatimet tona të vazhdueshme për pozitën e tyre politike dhe ideologjike, për veprimet e tyre inkohente, dilte se Partia Komuniste e Kinës nuk ishte një parti me të

vërtetë komuniste, siç quhej, edhe revolucionit kinez nuk ka qenë një revolucion socialist, por një revolucion demokratiko-borgjez progresist. Mao Ce Duni përhapte teorinë e «lulëzimit të njëqind luleve e të konkurrimit të njëqind shkollave», domethënë të njëqind ideologjive. Ne tash jemi në përfundim të analizës për të parë ndryshimet midis Revolucionit Demokratiko-Borgjez Francez dhe revolucionit kinez dhe na del se aty-aty janë. Por, ashtu siç e dini, revolucionit francez ishte një revolucion tip. Pasi përmbysën monarkinë, grupet e ndryshme që nga fëjantinët deri te robespiëristët ose jakobinët u vranë midis tyre. Ndërsa në Kinë, megjithëse revolucionit filloi nga poshtë, grupet e ndryshme vegjetuan në një bashkekzistencë paqësore, gjë që nuk çoi në reforma të thella politiko-shoqërore si në revolucionin francez. Vërtet në udhëheqje të Partisë në Kinë ishte Mao Ce Duni, por pushtetin s'e kishte kurdoherë ky. Kishte momente kur pushtetin e zotëronte Mao Ce Duni, por në momente të tjera e kanë pasur Liu Shao Çia, Çu En Lai, Ten Hsiao Pini e të tjerë. Ten Hsiao Pinin gjatë Revolucionit Kulturor e kritikuan publikisht dhe e flakën nga udhëheqja. Ishte Mao Ce Duni që e ngriti atë përsëri dhe pastaj prapë e kritikuan, kurse pas vdekjes së Maos e rehabilituan, duke i dhënë të gjitha postet që kishte.

Për shumë probleme me karakter parimor ne me kohë kemi qenë në kundërshtim me udhëheqësit kinezë, sepse e shihnim që ata nuk ecnin në bazë të marksizëm-leninizmit. Për shembull, kinezët shtronin problemin e kufijve me sovjetikët, kërkonin që këta t'u kthenin një pjesë të Siberisë. Gjithashtu thoshin se duhet parë

edhe çështja e kufirit sovjetik me Poloninë, Rumaninë, Hungarinë etj. Duke ngritur problemin e kufijve, kinezët synonin të prishej ekuilibri në marrëdhëniet midis gjithë këtyre vendeve, nga njëra anë, dhe Bashkimit Sovjetik, nga ana tjetër, dhe të krijoheshin kështu probleme serioze midis dy palëve. Mendimin tonë ia shprehëm me një letër Mao Ce Dunit, duke i thënë: Ne nuk jemi dakord me këto pretendime, sepse nuk është e drejtë të merremi me këto gjëra në një kohë kur jemi duke luftuar e duhet të vazhdojmë të luftojmë për çështje kryesore e në plan ideologjik. Ne nuk jemi për prishjen e ekuilibrit në këto zona e për nxitjen e konflikteve kufitare. Mao Ce Duni na u përgjigj se ky është mendimi juaj, kurse ne kemi mendimin tonë, prandaj të mos flasim më për këtë. Në një moment të caktuar kinezët erdhën në pozitat tona në gjykimin dhe në qëndrimin ndaj Bashkimit Sovjetik, por më pas ata u kthyen dhe u afruan me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, morën pozita proamerikane, gjë që u duk qartë kur ftuan për vizitë në Kinë presidentin Nikson. Këtë ne nuk e dinim, nuk dinim që ishin bërë kaq vajtje e ardhje të fshehta të Kisingerit në Pekin, por një ditë të bukur morëm vesh më së fundi që Niksoni do të shkonte për vizitë në Pekin.

Kur Çu En Lai erdhi në vendin tonë, ne biseduam me të dhe nënshkruam një deklaratë të përbashkët për çështjet kryesore të politikës që do të ndiqnin të dy vendet tona. Kinezët donin të na impononin neve vijën e tyre, por ne ngulëm këmbë dhe qëndruam në pozitat tona.

Edhe për vizitën e Niksonit në Kinë, kur e morëm

vesh, kemi dashur të bisedojmë me ta. Pati edhe probleme të tjera për të cilat ne nuk ishim dakord, por nuk mundëm të diskutonim me ta, sepse ata nuk na e kanë dhënë kurrë mundësinë. Megjithatë u shkruam një letër të gjatë, ku shprehnim qartë pikëpamjen tonë kundër afrimit të Kinës me një shtet të madh imperialist si SHBA. Ne u thoshim se nuk ishte momenti i volitshëm të thirrej Niksoni në Kinë, kur amerikanët ndërmerrnin bombardime në Vietnam, duke djegur dhe duke shkatërruar këtë vend, kur Tajvani, tokë kineze, ishte akoma në duart e amerikanëve. U numëruam atyre kështu një varg argumentesh të tjera, po letra jonë mbeti pa përgjigje.

Në kohën e Revolucionit Kulturor një delegacion ynë ndodhej në Kinë, bisedoi atje me Mao Ce Dunin dhe ky i tha se Partia Komuniste e Kinës ishte në rrezik për shkak të punës sabotuese të Liu Shao Çisë, të Ten Hsiao Pinit e të tjerëve. Ne e mbështetëm në bllok Revolucionin Kulturor. Por ky iu besua rinisë, duke errësuar rolin e Partisë. Udhëheqës të rinj u dalluan në këtë revolucion, midis të cilëve edhe Lin Biaoja, që kishte një autoritet të madh në ushtri. Gjithë «historia» që u kurdis kundër tij ishte se gjoja ai kishte qenë një spiun i sovjetikëve. Por Revolucionin Kulturor, që ishte shpallur se do të merrte masa shumë radikale, mbeti në gjysmë të rrugës. Megjithëse ne i mbështetëm Revolucionin Kulturor dhe Mao Ce Dunin, që rrezikohej të mënjanohet nga krahu i djathtë e revizionistët, me Liu Shao Çinë në krye, qysh në atë kohë kemi shprehur pikëpamjet tona lidhur me disa shfaqje e ekstremizma të krahut të majtë, sidomos lidhur me mënja-

nimin e me zëvendësimin e rolit udhëheqës të Partisë, me qëndrimet ndaj kulturës progresive botërore e të tjera, që krijuan shumë konfuzion ideologjik e kaos në Kinë dhe diskredituan shumë nga objektivat e Revolucionit Kulturor, që po ndihen dhe sot e po shfrytëzohen nga e djathta ekstreme.

Çu En Lai, duke parë se humbi shumë nga shokët e tij, ndikoi për rehabilitimin e Ten Hsiao Pinit, përpara se të vdiste Maoja, por ai vdiq para Mao Ce Dunit dhe ndodhi ajo që ndodhi. Maoja, duke pasur frikë nga fraksioni i të rinjve, «e këshilloi» Hua Kuo Fenin të merrte pushtetin. Menjëherë, sa vdiq Maoja, Hua Kuo Feni arrestoi «katërshen» dhe më pas ndodhën gjithë ato që dihen. Kjo ishte shumë e trishtueshme, për arsye se në Kinë ngjarjet u zhvilluan në mënyrë të dëmshme në tri drejtime: për socializmin, për popullin kinez dhe për ne.

Çu En Lai dy herë «na ka këshilluar» me anë të ish-ministrit tonë të Mbrojtjes, Beqir Ballukut, që të lidheshim me Jugosllavinë kundër të ashtuquajturit sulm të rrezikshëm nga Bashkimi Sovjetik. Gjithashtu ai na tha se nuk ishte nevoja që ne të harxhonim forca dhe mjete për fortifikimin e vendit e të kufijve, por në rast agresioni të tërhiqeshim në male, pastaj andej të hidheshim në sulm. Sigurisht, ne e hodhëm poshtë në mënyrë kategorike këtë sugjerim të gabuar të Çu En Lait dhe të paraqitur nga Beqir Balluku, sepse ky është rreziku më i madh për Shqipërinë e pavarur. Kjo strategji e Çu En Lait dhe e tradhtarit Beqir Balluku do të thotë t'i hapësh rrugët pushtimit.

Ato që po vërtetohen tash në Kinë kanë tërhequr

vëmendjen e gjithë opinionit botëror, sepse Kina është, si të thuash, një kontinent i tërë, një fuqi e madhe, numri i popullsisë së saj është më i madhi në të gjithë botën, por ekonomikisht ajo akoma është një shtet i dobët. Edhe nga pikëpamja ushtarake është gjithashtu e dobët. Ne mendojmë se të gjitha veprimet që po ndërmerr Kina tash kanë për qëllim që, me ndihmën e amerikanëve, ta bëjnë atë një superfuqi, në radhë të parë, duke marrë teknologjinë e armatimet amerikane.

Mao Ce Duni dhe dishepujt e tij po flasin shumë për teorinë e «tri botëve», që ne e kritikuam, sepse nuk mund të ndodhë, që botën ta ndash në tri pjesë, domethënë të vësh në një botë imperializmin amerikan dhe socialimperializmin sovjetik, në një botë të dytë shtetet borgjeze të zhvilluara, si Gjermaninë Perëndimore, Anglinë e të tjera dhe, më së fundi, në një botë të tretë gjithë pjesën tjetër të botës, duke futur këtu edhe vetë Kinën, duke e fshirë kështu krejt personalitetin e saj.

Ne nuk ishim dakord me këtë teori, prandaj e dënuam. Këtë teori ne nuk e kemi dënuar vetëm në vitin 1974, kur Mao Ce Duni shpalli botërisht se Kina bën pjesë në «botën e tretë», por që në vitin 1960, bile akoma më përpara, kur flitej pak a shumë në këtë frymë nga Titoja e Hrushovi. Ne e kundërshtuam këtë teori, sepse ajo jo vetëm ishte një teori antimarksiste, por predikonte aleancën me të gjitha shtetet e botës, duke përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kundër socialimperializmit sovjetik. Me një fjalë, ishte një teori jo e drejtë, për arsyet që shpreha më lart dhe e papranueshme për të gjithë popujt e botës dhe njerë-

zit e mençur. Ne nuk i kemi fshehur kurrë pikëpamjet tona dhe Mao Ce Duni e Çu En Lai nuk kanë thënë asgjë kundër nesh. Por pastaj Mao Ce Duni është shprehur se «bota e tretë» është forca lëvizëse, është motori që do ta çojë gjithë botën në socializëm. Një tezë të tillë ne nuk e pranuan dhe s'e pranojmë, sepse nuk është reale. Nuk mund të ngatërrohen drejtuesit e një vendi me aspiratat e popullit mbi të cilin ata sundojnë, nuk mund të ngatërrohen popujt e Arabisë, të Zaires dhe popujt të tjerë që duan lirinë, me qeveritë e tyre që i shtypin e i shfrytëzojnë ata. Çfarë mund të themi ne për mbretin Saud që ka të depozituara me qindra miliardë dollarë në bankat më të mëdha të botës, kurse populli, mbi të cilin ai sundon, jeton në mjerimin më të madh në shkretëtirat e Arabisë? Prandaj themi se ata që drejtojnë në këto vende dhe bëjnë një jetë përrallore, nuk mund t'i vëmë në të njëjtin plan me popujt e tyre të varfër deri në palcë. Po përse Kina pranon të kundërtën? Ajo e bën këtë për t'u treguar Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik se edhe vetë është një forcë botërore, domethënë se është ajo që e drejton këtë «botë të tretë». Por Kina gabohet plotësisht në këtë çështje.

Personalitete të vendeve ku janë të akredituar ambasadorët tanë, u kanë thënë këtyre se nga ana e Kinës kjo është një politikë në erë, një politikë e çmendur, se ata nuk janë dakord me të e se nuk mund të bashkohen me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të luftuar kundër Bashkimit Sovjetik. Asnjë shtet, me sadopak personalitet, nuk mund ta pranojë një gjë të tillë. Në këto momente as mund të na shkojë ndër mend

të parashikojmë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermania, Franca, si dhe të gjitha vendet e «botës së tretë» të bashkohen në luftë kundër rrezikut sovjetik, sepse Bashkimi Sovjetik do të sulmoka!

Ne kemi dashur të shpjegohemi me udhëheqësit kinezë si miq, donim të shkëmbenim pikëpamjet me njëri-tjetrin dhe për këtë kemi pasë rënë dakord, gjë që shprehet edhe në deklaratat e përbashkëta qeveritare të njohura nga publiku brenda dhe jashtë vendit tonë. Ne nga ana jonë për tre-katër vjet me radhë kemi kërkuar vazhdimisht të dërgonim një delegacion tonin atje, ose të vinin ata në Shqipëri, por ata nuk kanë dashur.

POL MILIEZI: Ata kanë frikë të dalin përpara jush.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu është, kanë frikë të ballafaqohen me ne, se nuk i përballojnë dot idetë dhe argumentet tona. Ne shohim e dëgjojmë që ata çdo javë presin gjithfarë njerëzish, deri edhe mbretërit dhe elementët më reaksionarë të botës, kurse ne nuk na presin.

Në Kongresin e 7-të të Partisë sonë ne shprehëm pikëpamjet tona. Derisa udhëheqësit kinezë, me gjithë kërkesat tona të njëpasnjëshme, nuk donin që të shpjegoheshim bashkërisht, atëherë ne bëmë shpjegimin tonë, natyrisht, pa e zënë në gojë Kinën, bile folëm mirë për të, por dënuam teorinë e «tri botëve», dënuam Bashkimin Sovjetik dhe imperializmin amerikan, me të cilin ajo bashkëpunon. Atëherë kinezët filluan të thonë poshtë e lart se i paskësh sulmuar Shqipëria. Ne nuk donim të bënim polemikë me kinezët, mirëpo pas Kongresit të Partisë sonë ata thirrën në Pekin Zhyrkenë

dhe disa udhëheqës të partive të tjera të reja marksiste-leniniste dhe u thanë se shqiptarët janë kokëfortë, nuk e kuptojnë rolin e «botës së tretë», janë kundër kësaj teorie të Mao Ce Dunit dhe i kurdisën kundër Partisë sonë.

Tash kinezët na kanë vënë në shënjestër edhe për çështjet ekonomike. Deri më sot ata na kanë ndihmuar, por akoma janë të detyruar të na ndihmojnë për shkak të kontratave të nënshkruara. Megjithatë, për të na dobësuar ekonomikisht, po bëjnë ç'është e mundur, duke na vonuar furnizimet. Ata po na vonojnë edhe në ndërtimin e Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit, edhe për objektet e tjera të mëdha. Kjo tregon se Kina është duke ndjekur një politikë krejt të gabuar, ajo kërkon të na imponojë politikën e saj. Udhëheqësit kinezë dëshirojnë që ne të afrohemi e të bashkëpunojmë me imperializmin amerikan dhe me satelitët e tij, me Jugosllavinë e Titos etj. Ne ndërtojmë ekonominë tonë, por nuk jemi për atë politikë që ndjekin kinezët, nuk bëjmë aleancë me amerikanët. Kinezët nuk mund të na imponojnë neve një politikë që nuk është në interesin e popullit tonë dhe të të gjithë popujve të tjerë. Ne, nga ana jonë, themi të vërtetën kurdoherë hapur dhe nuk i trembemi askujt, kemi qenë dhe jemi korrektë me kinezët, por duam që edhe ata të jenë korrektë me ne. Ne mbrojmë pikëpamjet tona. Natyrisht, ata le të bëjnë ç'lë duan, por ne do të punojmë, do të ecim përpara pa u ndalur dhe do të forcojmë ekonominë dhe mbrojtjen, që janë dy drejtimet kryesore të politikës së vendit tonë. Me Partinë tonë në krye dhe me heroizmin e popullit tonë po përpiqemi t'i kapërcejmë

vështirësitë që na shkaktojnë veprimet e padrejta të Kinës. Partia jonë është e fortë, prandaj mosmarrëveshjet me Kinën nuk e kanë turbulluar fare. Ajo nuk u turbullua as në kohën e sulmit të revizionistëve sovjetikë kundër marksist-leninistit të madh J. V. Stalinit dhe të sulmit të tyre të tërbuar kundër nesh e jo të turbullohet tani që jemi shumë të fortë. Ne jemi kalitur e jemi forcuar në luftë me armiqtë e shumtë dhe uniteti Parti-popull në vendin tonë është më i fortë se kurrë.

Është e vërtetë se ne nuk kemi shumë mundësi për të pasur më tepër marrëdhënie, për shembull, me Francën, por, me aq sa mundemi me qeverinë franceze mbajmë marrëdhënie normale. Me Italinë ne kemi gjithashtu marrëdhënie, por nga qarqet qeveritare italiane mbahet distancë. Me fqinjët e Veriut dhe të Jugut gjithashtu kemi marrëdhënie. Me Greqinë kemi dashur të jemi gjithmonë miq, por më parë atje kanë qenë vazhdimisht në fuqi qeveri fashiste, kurse qeveria e tanishme greke ka bërë avancime në marrëdhëniet me Shqipërinë. Populli grek është një popull shumë i mirë, i zgjuar dhe me kulturë. Ne kemi pasur marrëdhënie shumë të ngushta dhe e kemi ndihmuar atë gjatë revolucionit që bëri për t'u çliruar nga robëria osmane dhe mendojmë se grekët nuk e harrojnë këtë.

Në vendin tonë kemi një minoritet të vogël grek, banorët e të cilit trajtohen si gjithë popullsia tjetër shqiptare. Atje njerëzit kanë shkollat e tyre, këshillat e pushtetit, zhvillojnë ekonominë e tyre dhe me punë, si të gjithë, ngrenë nivelin e mirëqenies. Ne kemi bërë gjithçka për ta dhe autoritetet greke e kanë parë këtë.

trajtim që i bëhet minoritetit grek në Shqipëri njëlloj me popullsinë shqiptare. Kemi dërguar në Greqi ansamble të këngëve dhe të valleve, të cilat kanë korrur atje sukses të madh. Edhe marrëdhëniet tregtare midis dy vendeve po rregullohen e po zgjerohen.

Me Rumaninë nuk kemi marrëdhënie si duhet, sepse në udhëheqje të këtij vendi është në fuqi një parti revizioniste. Ajo gjoja i reziston Bashkimit Sovjetik, por në fakt kjo nuk është e vërtetë, atje ka një qeveri që mban qëndrime me dy faqe ose, më mirë të themi, me shumë faqe.

Për sa i përket Jugosllavisë, Titoja është një armik për socializmin dhe për ne, ai është shumë dinak. Popujt e Jugosllavisë: serbët, malazeztë e të tjerë janë popuj të fortë, ata kanë luftuar mirë kundër fashistëve italianë e gjermanë. Bashkimi Sovjetik do të bëjë të gjitha përpjekjet për të vënë këmbët në Jugosllavi, por ne kemi besim se popujt e Jugosllavisë do t'u rezistojnë këtyre përpjekjeve.

Ndërsa për popujt arabë mendojmë se kanë një të ardhme shumë të mirë dhe se kjo është e sigurt. Në qoftë se nuk do të ishin intrigat e sovjetikëve dhe të imperialistëve amerikanë, këta popuj do të kuptoheshin e do të merreshin vesh më mirë me njëri-tjetrin dhe do të krijonin një unitet të fortë në mes tyre. Ne mendojmë, sipas atyre që thuhet, se po bëhen përpjekje për një marrëveshje, për krijimin e një shteti palestinez me një autonomi.

Do të më lejoni tani t'ju flas pak për shëndetin tim. Jam shumë mirë me shëndet, zoti profesor Miliez, zbatoj regjimin që më këshillojnë mjekët. Një provë

e mirë për respektimin e këshillave të tyre është fakti se tash katër vjet s'e pi më duhanin.

POL MILIEZI: Kjo është e rëndësishme dhe do t'ju japë kënaqësi gjithë miqve tuaj, sepse është një masë e nevojshme.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju e keni ndihmuar shumë mjekun tonë, profesorin Fejzl Hoxha.

POL MILIEZI: Edhe ai na ka ndihmuar ne shumë për punën tuaj.

SHOKU ENVER HOXHA: Mjekët tanë do të jenë gjithmonë në dispozicionin tuaj. Mëgjithëse unë nuk dorëzohem lehtë te mjekët, por i dëgjoj kur ata më këshillojnë, për shembull, që të mos përdor sheqerin. Më thanë të lë duhanin, e lashë dhe pas kësaj e ndiej veten shumë mirë. Unë kam një konstrukt të fortë.

POL MILIEZI: Kur ndjek këshillat e mjekëve është shumë mirë. Unë e ndiej veten më të fortë nga sa isha para se të sëmuresha. Edhe këtu te ju e kaluam shumë mirë. Ishte një pushim shumë i qetë.

SHOKU ENVER HOXHA: Te ne nuk ka shumë zhurmë, prandaj pushohet qetë. Zoti profesor, unë jam i bindur që rekomandimet e mjekëve duhen ndjekur dhe mendoj se edhe ju duhet t'i ndiqni. Ju, mjekët, me të drejtë thoni që, në qoftë se nuk merresh me ndonjë punë, atëherë ke vdekur. Puna të bën të jetosh gjatë.

POL MILIEZI: Vetëm se në këtë drejtim nuk duhet tepruar. Duhet punuar me orar, çdo gjë duhet bërë me orar. Unë njoh një president në botë që gjen kohë dhe ecën tri orë gjatë ditës¹.

1. Këtu mysafiri bën aluzion për shokun Enver Hoxha.

SHOKU ENVER HOXHA: Më falni, por a mund të na këshilloni në mënyrë shoqërore se çfarë mund të dërgojmë nga ana jonë në Francë për të ngjallur sa më tepër interesim në opinionin e vendit tuaj?

POL MILIEZI: Ministrat francezë thonë se kanë frikë nga ju. «Shqiptarët janë të rrezikshëm», thonë ata. Kur u ktheva nga vizita e fundit në Shqipëri, shkova bisedova me Shumanin për ardhjen e studentëve shqiptarë në Francë. Por kishte ndonjë ministër të asaj kohe që nuk donte asnjë student shqiptar në Francë ngaqë kishte frikë se mos këta u ngjithnin sëmundjen e komunizmit studentëve tanë. Kurse ministri i Jashtëm ishte dakord. Unë, në qoftë se kam një frikë, kjo është se mos korruptohen studentët tuaj nga francezët, nga jeta e atjeshme, nga paratë. Këto po, mund të përbëjnë një rrezik për njerëzit tuaj, prandaj në vendin tonë duhet të dërgohen studentë të zgjedhur e të sigurt.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju mendoni shumë mirë, zoti Milicz, por studentët tanë, nga sa kemi dëgjuar, kanë qenë shumë të sjellshëm dhe shumë korrektë me francezët, me të cilët kishin të bënë. Nuk ka pasur ndonjë gjest negativ për t'u shënuar nga ana e tyre, besoj unë.

POL MILIEZI: Profesorët e institucioneve franceze janë shumë të predispozuar për të punuar me studentët tuaj.

SHOKU ENVER HOXHA: Megjithatë ne do të mundohemi ta organizojmë këtë çështje.

POL MILIEZI: Do të ishte mirë që edhe ne të dërgonim në Shqipëri studentë e specialistë francezë në ato fusha ku mendojmë se ata mund t'u sjellin diçka

të dobishme studentëve tuaj, si për shembull në preventimin e sëmundjeve.

SHOKU ENVER HOXHA: A ka avancime në drejtim të studimit të sëmundjes së kancerit?

POL MILIEZI: Ky është një problem i rëndësishëm për Francën dhe për të gjitha vendet e tjera të botës, më duket mua. Ne nuk dimë se çfarë po bëjnë rusët në këtë drejtim, por nuk dimë që edhe ata të bëjnë shumë gjëra. Kinezët punojnë shumë për zemrën, bile në këtë organ po bëjnë operacione me sukses. Ata vënë në zbatim në shkallë të gjerë mjekësinë popullore për kurimin e sëmundjeve të zemrës, kurse në Evropë nuk dimë shumë nga kjo fushë e mjekësisë. Edhe japonezët janë shumë të shkathët, janë shumë precizë dhe kanë bërë përparime në mjekësi. Natyrisht, kinezët nuk i kanë përfunduar akoma programet e tyre në këtë drejtim, por ata janë të përmbajtur, nuk duan t'i përhapin metodat e tyre të mjekimit në vendet e tjera.

SHOKU ENVER HOXHA: Ata i mbajnë për vete metodat e tyre. Populli kinez është një popull i zgjuar, veçse nuk është shumë i hapur.

POL MILIEZI: Mund të mendohet se kjo karakteristikë vjen ngaqë ata kanë qenë shumë të shtypur, prandaj janë edhe të mbyllur.

SHOKU ENVER HOXHA: Por ama të dënojnë deri Bethovenin, Molierin dhe figura të tjera të shquara me famë botërore në fushën e artit, të letërsisë etj., do të thotë se nuk e kuptojnë që këto figura nuk u përkasin vetëm vendeve të tyre, Gjermanisë, Francës, etj., por gjithë njerëzimit.

POL MILIEZI: Ju shpresoni se një ditë gjendja do të rregullohet?

SHOKU ENVER HIXHA: Ne shpresojmë të paqja, ne shpresojmë që lufta nuk do të ndodhë sot për sot, sepse kontradiktat ndërimperialiste nuk kanë arritur pikën ekstreme të acarimit. Përkohësisht do të ketë rregullime, do të ketë edhe përpjekje. Kapitalizmi është vazhdimisht në rënie, por shohim që ai po përdor një rrugë tjetër për të zgjatur ekzistencën e tij, përpiqet të vendosë sundimin e tij në vende të ndryshme të botës nëpërmjet shoqërive shumëkombëshe. Kapitalistët janë duke bërë në shumë vende një invazion me këto shoqëri të përbashkëta amerikane dhe të Evropës Perëndimore. Natyrisht, këto i ulin përkohësisht kontradiktat, por, nga ana tjetër, dalin në pah tendencat e fuqive të mëdha, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Sovjetik, që aspirojnë për sundim dhe që janë duke vënë gjithnjë e më tepër dorë mbi shumë tregje botërore. Kështu në vendet e mëdha kapitaliste ka fraksione që nuk dëshirojnë të shkohet deri në luftë të përgjithshme botërore, por të kufizohen në luftëra lokale, në luftëra për interesa të pjesshëm. Dhe të tilla luftëra do të ketë, mendojmë ne. Një luftë botërore, tani për tani, mendojmë se nuk do të shpërthejë. Kryesorja është që të luftojmë kundër qëllimeve që çojnë botën drejt luftës.

Ne nuk mund ta mbështetim imperializmin amerikan për të luftuar socialimperializmin sovjetik, ashtu siç bëjnë kinezët, por jemi për atë që t'i luftojmë që të dy, sepse si njëri, edhe tjetri janë të rrezikshëm. Ata po bëjnë përpjekje të ethshme për t'u armatosur. Në

vend që të ndërtojnë aparatūra mjekësorë për të shëruar njerëzit apo për t'u zgjatur këtyre jetën, vrasin mendjen e mobilizojnë forca të shumta për të vrarë njerëzit. Të tilla masa po marrin të gjitha vendet e zhvilluara kapitaliste, si superfuqitë, ashtu edhe vendet e tjera të mëdha.

POL MILIEZI: Ju na bëtë që të kalonim një ditë shumë të bukur.

SHOKU ENVER HOXHA: Ardhjen tuaj këtu ne nuk do ta harrojmë dhe dëshirojmë t'ju presim përsëri.

POL MILIEZI: Do të mundohemi të vijmë prapë. Atje ku jemi, ne do të punojmë dhe do të bëjmë që sa më shumë francezë të jenë me ju, ta njohin sa më shumë e ta duan Shqipërinë dhe të shumë të janë ata që edhe sot e duan vendin tuaj.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju faleminderit! Ju uroj një udhëtim të mbarë dhe të na vini përsëri. Mirupafshim!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

JU JENI E ARDHMJA E LUMTUR E ATDHEUT

*Përshëndetja në mbrëmjen¹ e organizuar me rastin
e Vitit të Ri*

30 dhjetor 1977

Të dashur pionierë dhe pioniere,

Këngët tuaja të bukura na gëzojnë pa masë. Këto i këndojnë atdheut të dashur, Partisë sonë të shtrenjtë, popullit tonë heroik. Partia jonë kur luftoi dhe lufton, ka pasur e ka kurdoherë parasysh mirëqenien dhe lumturinë e popullit dhe, në radhë të parë, lumturinë e kalamanëve dhe të rinisë sonë të mrekullueshme. E ja, edhe sonte në këtë pallat të popullit, që është edhe juaji, jemi mbledhur të festojmë së toku Vitin e Ri. Viti i Ri, siç e dini, festohet nesër, por ne e festojmë që sonte, se pionierët janë në pararojë. Pionierët këtë vit do ta festojnë Vitin e Ri dy herë, një herë këtu, me ne, pastaj me prindërit e tyre të dashur, me gjyshërit e gjyshet, me vëllezërit dhe me motrat e tyre.

1. Në këtë mbrëmje, që u organizua në Pallatin e Erigadave, u mbledhën 500 pionierë të dalluar të ardhur nga gjithë vendi.

Është kënaqësi e madhe që anekënd Shqipërisë një gëzim i madh ka pushtuar gjithë njerëzit tanë. Ky është një gëzim për cilindo, për arsye se sheh atdheun kudo të lulëzuar, sheh popullin të lumtur, sheh rininë të shkollohet. Kështu gjithë populli ynë, me besim të madh te Partia, punon, ndërton e gëzon për të tashmen dhe për të ardhmen edhe më të mirë. Gjithë këto vite që kemi kaluar i kanë sjellë Shqipërisë dhe mbarë popullit shumë të mira, që vetë ju të tërë i keni parë dhe po i gëzoni. Gjithë këto të mira, të dashur pionierë, u arritën në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë heroike. Politika e Partisë është një politikë e drejtë, një politikë marksiste-leniniste, një politikë që ka për qëllim të vetëm mirëqenien e popullit, edukimin e tij me dashuri për njëri-tjetrin, forcimin e atdheut socialist dhe mbrojtjen e tij nga çdo rrezik. Çdo gjë që është ndërtuar në Shqipëri, është arritur nën udhëheqjen e drejtë të Partisë, nga populli, nga gjyshërit, nga baballarët, nga mëmat, motrat dhe vëllezërit tuaj. Po edhe ju, pionierë, që mësoni mirë dhe edukoheni me moralin e shëndoshë të Partisë, keni kontribuar shumë në këtë çështje. Kjo ka rëndësi të jashtëzakonshme për fatet e ardhshme të atdheut, për arsye se sa më të edukuar me një frymë të lartë patriotike të jeni ju, sa më të sjellshëm, sa më të mësuar e të kulturuar të bëheni, aq më i bukur do të jetë atdheu, aq më i lumtur do të jetë populli ynë. Këtë bindje Partia e ka të plotë, sepse ju sheh ju, pionierët, ju të rinjtë e të rejtat, klasën punëtore, fshatarësinë dhe intelektualët tanë popullorë, që nuk kursejnë asgjë, po i janë përveshur punës kudo për të ndërtuar kurdoherë vepra të bukura e të dobish-

me për atdheun, në radhë të parë, për rininë, për ju, pionierë e pioniere.

Prandaj Partia e meriton dashurinë e pafundme që ushqen për atë gjithë populli shqiptar, klasa punëtore, rinia, fshatarësia. Për këtë arsye ju e ngrini zërin në qiell duke kënduar për Partinë. Ta doni Partinë me gjithë shpirt, se ajo është nëna jonë e madhe me zemër të gjerë, me mendje kurdoherë të freskët, me qëllime kurdoherë të larta për popullin tonë dhe jo vetëm për popullin tonë.

Këtu jeni grumbulluar sot të festoni Vitin e Ri nga të katër anët e Shqipërisë dhe kjo është një gjë e bukur. Ashtu siç është gjithë populli ynë i bashkuar si një trup rreth Partisë, edhe ne këtu jemi sonte si një familje e madhe. Ne, përfaqësuesit e Partisë, jemi të lumtur që sot kemi pranë qindra pionierë dhe pioniere. Shokët e mi dhe unë, duke ju përshëndetur ju, përshëndetim gjithë pionierët e Shqipërisë, përshëndetim gjithë rininë dhe popullin shqiptar brenda dhe jashtë atdheut, kudo që rrojnë, dhe të gjithëve u urojmë me këtë rast një vit të gëzuar e të lumtur dhe u shtoftë në zemrat e tyre, në zemrat e çdo shqiptari, dashuria për atdheun tonë të shtrenjtë socialist!

Ne përshëndetim të gjithë pionierët e botës, si dhe gjithë shokët tanë komunistë që luftojnë kudo në botë për një jetë të gëzuar edhe në vendet e tyre, sepse jeta e tyre atje është e mjeruar, nuk ka dhe nuk mund të bëhet asnjë barazim me jetën e lumtur që gëzojnë populli ynë, pionierët tanë. Zemrat tona janë të bashkuara me zemrat e gjithë revolucionarëve e pionierëve të kontinenteve të botës, që shpresojnë e luftojnë të dalin

edhe ata në dritë, siç doli populli ynë, siç dolën rinia dhe pionierët tanë.

Nuk po zgjatem më shumë, se dëshirojmë t'ju dëgjojmë ju të këndonit e të vallëzoni. Prandaj, duke ju uruar të gjithëve një vit të ri të gëzuar e të lumtur, le të fillojmë nga festa me këngë, me gëzim e hare dhe të brohorasim:

Rroftë Partia jonë e lavdishme!

Rroftë populli ynë!

Botuar për herë të parë në gazetën "Zëri i popullit", nr. 314 (9173), 31 dhjetor 1977

Botohet sipas librit: Enver Hoxha, "Për shokët e mi pionierë", f. 361

PRAPA KONFLIKTIT KAMBOXHIA—VIETNAM QËNDRON RIVALITETI I SUPERFUQIVE

Shënime

1 janar 1978

Ka filluar lufta e armatosur midis kamboxhianëve dhe vietnamezëve. Kamboxhia njoftoi se ka prerë marrëdhëniet me Vietnamin, për arsye se ushtria vietnameze ka kapërcyer kufirin duke u futur në territorin kamboxhian. . .

Një gjë është e qartë që tani: prapa konfliktit Kamboxhia-Vietnam, qëndron rivaliteti midis tri superfuqive imperialiste: Bashkimit Sovjetik, Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Aktualisht, drejtpërdrejt të implikuar janë sovjetikët dhe kinezët.

Kinezët kanë intriguar në Vietnam, megjithëse ata e kanë ndihmuar luftën e Vietnamit kundër amerikanëve, por kur Mao Ce Duni dhe Çu En Lai ndryshuan strategjinë e tyre, nga ajo kundër imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik, në atë kundër socialimperializmit sovjetik dhe pro atij amerikan, atëherë qëndrimi i Kinës ndaj Vietnamit u bë shumë ekuivok. Kina, pra, dashur pa dashur, ka predikuar dorëzimin e Vietnamit, gati pa kushte, ndaj imperializmit amerikan,

i cili e dogji dhe e shkatërroi këtë vend për vite me radhë. Me fjalë të tjera, Kina, në kundërshtim me këshillat e mëparshme për luftë deri në fund kundër imperializmit amerikan, u ka sugjeruar vietnamezëve paqen me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Natyrisht, tratativat e paqes me Shtetet e Bashkuara të Amerikës i filluan vietnamezët. Shtetet e Bashkuara të Amerikës u gjendën në kushte jashtëzakonisht të vështira aq sa nuk mund ta vazhdonin dot më tej luftën në Vietnam. Në fakt imperializmi amerikan e pa se nuk kishte më fitim nga vazhdimi i luftës, sepse vërtet Vietnami u dogj, por armët nuk i dorëzonte. Prandaj imperializmi amerikan, në situatat e vështira që u krijuan për të, preferoi më mirë të tërhiqej me «lezet», dhe në këtë tërheqje me «lezet» e ndihmuan jashtëzakonisht shumë Mao Ce Duni e Çu En Lai. Kjo është aq e vërtetë saqë, kur imperialistët amerikanë hidhnin bombat e tyre më të mëdha e më të shumta mbi Hanoin, udhëheqësit kinezë pritnin me nderime në Pekin Niksonin, këtë fashist amerikan. Është e natyrshme që në këto momente, Mao Ce Duni, Çu En Lai e Niksoni kanë diskutuar së toku edhe për luftën në Vietnam.

Në atë kohë ne dëgjuam që vietnamezët deklaruan se nuk lejonin asnjë shtet tjetër që të fliste në emër të Vietnamit për çështjen e tij. Kjo deklaratë e tyre linte të kuptohej qartë se vietnamezët nuk ishin dakord që kinezët, kur imperializmi amerikan ndodhej në momente të vështira e po pësonte disfatë të rëndë, të binin në marrëveshje me të. Rënia në marrëveshje e kinezëve me amerikanët do të thoshte që agresorët janki të mos tërhiqeshin me turp nga Vietnami dhe, pas lufte, këta im-

perialistë barbarë të mos paguanin dëmshpërblimet e luftës, gjë që do të bënte që Vietnami të ndodhej në vështirësi të mëdha e në mëshirën e dy superfuqive për rindërtimin e vendit.

Edhe Bashkimi Sovjetik bënte atëherë një politikë shumë djallëzore. Ai gjoja e ndihmonte Vietnamin, gjoja luftonte kundër imperizmit amerikan, por nga ana tjetër manovronte dhe përpiqej që vietnamezët të bënin paqe me amerikanët, të ndalohej lufta dhe Vietnami të ndodhej nga ana e barrikadës sovjetike. Dhe në realitet kështu ndodhi. Pas disfatës së amerikanëve dhe pas çlirimit të të gjithë Vietnamin, influenca sovjetike në Vietnam u rrit. Se sa e ndihmojnë aktualisht sovjetikët Vietnamin në ndërtimin e tij, këtë ne nuk e dimë, ashtu sikurse nuk e dimë nëse e ndihmon dhe sa e ndihmon edhe Kina. Për ne është e panjohur sa e ndihmojnë edhe vendet e tjera revizioniste... Pra, në këtë konflikt midis vietnamezëve dhe kamboxhianëve, nga ana e Vietnamin qëndrojnë sovjetikët, nga ana e Kamboxhias kinezët.

Kinezët, në shtypin e tyre, flasin se të dy këta popuj duhet «të merren vesh» në mënyrë «paqësore dhe vëllazërore», kurse gazeta «Izvestia» dje kishte një artikull ku sulmonte Kamboxhia dhe ata që qëndrojnë prapa Kamboxhias, domethënë kinezët. Ja se si lufta midis vietnamezëve dhe kamboxhianëve nxitet nga sovjetikët dhe nga kinezët.

Dihet se në muajin e kaluar një zëvendëskryemnistër kinez¹, vajti në Kamboxhia. Atje ai pati kontakte me qeveritarët dhe me njerëzit e partisë dhe vizitoi të

gjitha ato krahina të kontestuara nga vietnamezët, domethënë shkoi pikërisht në ato krahina ku u ndërmor sulmi vietnamez.

Përse vajti ky zëvendëskryeministër kinez në Kamboxhia? Natyrisht jo për të mirë. Kina vetë është në konflikt me Vietnamin për çështjen e disa ishujve, që gjenden në gjirin e Tonkin. Kinezët për këta ishuj thonë se janë të tyre dhe vietnamezët, po ashtu, thonë se janë të tyre dhe kërkojnë që kinezët të largohen nga ishujt që kanë pushtuar. Domethënë Kina me Vietnamin gjenden në konflikt me njëri-tjetrin për çështjet kufitare. Pra Kina ka rivendikime territoriale të deklaruara ndaj Vietnamit.

Politika e Kinës dhe e Bashkimit Sovjetik është antimarksiste, revizioniste, prandaj këta janë ndërlikuar në konfliktin e përgjakshëm midis Kamboxhias dhe Vietnamit. Si do të marrë fund ky konflikt i armatosur në rast se as njëri, as tjetri vend nuk lëshon, sepse Kina dhe Bashkimi Sovjetik nuk lëshojnë? Sigurisht do të zhvillohet një luftë e padrejtë, një luftë e përgjakshme dhe e maskuar, në të cilën do të përdoren të gjitha llojet e mashtrimeve që praktikojnë fuqitë imperialiste, invaduese për të mbuluar agresivitetin e tyre kolonial ose neokolonial.

Është me të vërtetë për të ardhur keq që vende të tilla, siç janë Vietnam, Laosi e Kamboxhia, që luftuan e derdhën gjak për lirinë dhe pavarësinë e vetes tash të zhvillojnë luftime në mes tyre, «të derdhin gjakun për dajko Kalon», siç thotë populli ynë, në vend që të shërojnë plagët e mëdha që u shkaktoi lufta me imperialistët amerikanë. Nga kjo, amerikanët fërkojnë duart dhe

këtë e kemi parashikuar që më përpara. Ne e kemi theksuar se amerikanët dhe sovjetikët do të organizonin një rreth të zjarrtë kundër Kinës. Këtë rreth ata e kanë krijuar e po i fryjnë, kurse Kina nga ana e saj, në pozitë me të cilat ajo ndodhet sot, dhe sikur të mos ndodhë asgjë, po e çon përpara politikën e vet antimarksisiste. Duke u mbështetur tek imperializmi amerikan dhe te borgjezia kapitaliste botërore, ajo synon të bëhet një superfuqi, të armatohet dhe të ndërtojë një ekonomi të fuqishme luftarake. Në të njëjtën kohë Kina me formë neokolonialiste po përpiqet të sundojë mbi vende të tjera të vogla.

Fakt është se, aktualisht, mbizotëron tendenca që superfuqitë të ulin ose të mbytin zörin e fuqive të tjera të vogla. Domethënë fuqitë e mëdha kanë tendenca të theksuara që të mos lejojnë ndërhyrjen e të tjerëve, jo vetëm fizikisht, por as edhe politikisht, në çështjet e ndarjes së botës, të zonave të influencës ose në çështjet për të cilat ka mosmarrëveshje. Prandaj ne shohim që vendet në zhvillim, ose, siç thotë Mao Ce Duni, të «botës së tretë», të japin opinione, të cilat përputhen me politikën e këtyre tri superfuqive që janë: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Sovjetik dhe Kina...

Për të përcaktuar më qartë e më zyrtarisht qëndrimin tonë ndaj konfliktit midis Kamboxhias e Vietnamit, ne, natyrisht, duhet të kemi pak durim dhe të presim, për arsye se na duhet të kemi akoma informata plotësuese për të parë më mirë e më qartë se nga cila anë është e drejta dhe nga cila anë qëndron gabimi tragjik, shkaku i konfliktit, mashtrimi. Kur ne të arrijmë t'i kemi këto informata dhe të kemi formuar bindje rreth

kësaj që thashë pak më lart, atëherë duhet ta themi mendimin tonë. Por, sidoqoftë edhe tash ne duhet të mbajmë qëndrimin tonë, të themi që të pushohen luftimet midis shokëve dhe vëllezërve, të tërhiqen trupat nga territoret e pushtuara, nga njëri ose nga tjetri vend, dhe të fillohen bisedimet shoqërore, miqësore në një frymë marksiste-leniniste, për interesin e të dy popujve dhe të dy vendeve. Nga ana tjetër, ne duhet të atakojmë fort socialimperializmin sovjetik dhe imperia-lizmin amerikan pas të cilit ndodhet dhe Kina që intri-gojnë në këtë gjakderdhje.

Duke goditur këto dy superfuqi, ne, me qitje shumë të largët, të lëmë të kuptohet që superfuqia e tretë, Ki-na, duhet të kontribuojë në rrugë të ndershme që kjo çështje të zgjidhet drejt dhe jo me prapamendime. Ky duhet të jetë qëndrimi ynë tash për tash.

Është me të vërtetë një gjë jashtëzakonisht e hidhur kjo që po ndodh e që na dëshpëron shumë. E gjithë kjo ngjarje është rezultat i pikëpamjeve revizioniste që su-ndojnë në të gjithë pellgun e Lindjes së Largme. . .

Marrë nga libri:

Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 10, f. 3

TË NXITEN E TË INKURAJOHEN MË SHUMË SHPIKJET DHE RACIONALIZIMET

Shënime

13 janar 1978

Shokët më thanë se dhjetëditori i parë i vitit ka qenë periudhë e një mobilizimi të madh të masave punonjëse të vendit tonë, si në industri, në bujqësi, ashtu edhe në sektorin e arsimit e të kulturës. Kjo është një gjë e mirë, një shenjë pozitive, mendoj unë, sepse jo kurdoherë ka ndodhur që qysh në fillim të vitit ose të muajit të vihet re një frymë e lartë mobilizimi në punë. Me këtë s'dua të them se planet nuk realizohen, por ka rëndësi çështja që hovi revolucionar të jetë lartë që në fillim dhe të mos bjerë për asnjë moment, por të qëndrojë gjithmonë i ndezur.

Hekuranin [Isai]¹ e pyeta se kur do ta mbante referatin për revolucionin tekniko-shkencor, për të cilin më kishte folur Nexhmija. Ai më tha se do ta mbante nesër, në datën 14. E përgëzova Hekuranin dhe e dija se ai do ta trajtonte këtë problem të rëndësishëm, pasi disa kohë më parë më kishte raportuar për këtë. Ai e kishte studiuar çështjen e revolucionit tekniko-shken-

1. Në atë kohë sekretar i KQ të PPSH.

cor veçanërisht në rrethet Durrës e Krujë dhe kishte nxjerrë konkluzione shumë interesante.

Në diskutimin që patëm në mbledhjen e Sekretariatit rreth raportit të paraqitur nga shoku Pali [Miska] për vërejtjet dhe sugjerimet që ai na shprehu lidhur me revolucionin tekniko-shkencor, i thashë Hekuranit që ta përpunojë më tej mendimin e tij si dhe të thërriste e t'ua shtronte këtë problem një numri kuadrosh kryesorë të Komitetit Qendror, kuadrove të qendrës, të ministrive, të rretheve, goftë kuadro të Partisë ose edhe të pushtetit. Mendova kështu se ky problem kaq shumë i rëndësishëm, që i jep dhe do t'i japë një hov të madh zhvillimit të ekonomisë sonë, duhet nxitur, duhet ndihmuar dhe kontrolluar. Këtë gjë ua theksova sot shokëve Hekuran dhe Hysni, sepse shohim që njerëzit tanë kanë iniciativa shumë të mira, bëjnë studime, duke u mbështetur në librat, por edhe në eksperiencën e tyre të madhe dhe arrijnë në konkluzione shkencore, që dëshirojnë t'i vënë në praktikë, të zbatohen në jetë e të përgjithësohen në dobi të ecjes përpara të ekonomisë sonë. Mjaft nga këto studime e propozime vihen në jetë, por shumë të tjera lihen pas dorë, qëndrojnë nëpër sirtaret e ministrive e të ndërmarrjeve dhe nuk organizohet puna në mënyrë që t'i jepet rrugëzgjdhje problemit të zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor, për të cilin vendi ka aq shumë nevojë në çdo moment, sidomos në këto momente, por edhe në të ardhmen.

Nxjtja dhe inkurajimi i shpikjeve dhe i racionalizimeve kanë qenë një objektiv i madh i punës së Partisë gjatë gjithë jetës së saj dhe duhet të themi se punonjë-

sit tanë, punëtorët, mjeshtrit dhe specialistët kanë treguar zotësi të rralla dhe i kanë dhënë një hov të madh zhvillimit të prodhimit industrial dhe atij bujqësor. Me kënaqësi vëmë re se një gjë e tillë nga viti në vit po përparon, racionalizimet dhe shpikjet marrin përpjesëtime më të mëdha. Njerëzit tanë të talentuar përpiqen t'u japin zgjidhje jo vetëm problemeve që kanë të bëjnë me realizimin e disa prodhimeve të vogla, ose që lidhen me disa adaptime që japin fryte, dhe që duhen bërë se edhe këto janë të nevojshme, por ata mendojnë më thellë, e vrasin mendjen për më shumë, edhe për zgjidhjen e problemeve të mëdha kapitale.

Dihet se tani për prodhimin e koksit ne përdorim 15-20 për qind të qymyreve tona në përzierje me qymyret e koksifikueshme që importojmë. Është e nevojshme që ky problem të studiohet më thellë e të çohet më përpara. Ne duhet të vazhdojmë të kërkojmë edhe qymyret tona që të kenë veti për koksifikim. Kjo do të ishte një fitore e madhe që do të forconte më tej pavarësinë e industrisë sonë të metalurgjisë së zezë, por do të lehtësonte edhe ekonominë nga importi i qymyreve të koksifikueshme. Prandaj të mos heqim dorë nga studimet e kërkimet.

E theksoj që është e domosdoshme të merret si duhet në dorë kjo çështje dhe probleme të tjera, sepse kam konstatuar se shumë probleme të tilla në fillim janë duartrokitur, por pastaj janë lënë dhe janë zvarritur për shumë kohë, bile kanë zënë pluhur nëpër sirtarët e ministrive e të ndërmarrjeve. Është dashur të ndërhyjë udhëheqja e Partisë që të bëhet diçka, kur dihet që një çështje e tillë është me dobi të madhe për

ekonominë tonë. Në rastin konkret Ministria e Industrisë dhe e Minierave, për shembull, është jashtëzakonisht e interesuar për këtë çështje. Por çfarë ngjet me këto shpikje kaq të rëndësishme? Kur vjen çështja e hartimit të planit, ka raste që një numër artikujsh vihen në listën e materialeve të importit. Në realitet kjo ngjet edhe për shumë shpikje e studime shkencore të rëndësishme, prandaj këtyre problemeve t'u jepet rëndësi e veçantë.

Neve na duhet të ndërtojmë edhe disa fabrika të tjera pasurimi për minerale të ndryshme në rrethe të ndryshme të vendit. Atëherë puna për këto fabrika duhet të fillojë, se tash ne kemi njerëz të aftë, kuadro shkencorë që të studiojnë, të planifikojnë dhe t'u futen vetë ndërtimeve të këtyre fabrikave.

Gjithashtu nevojitet ta rishikojmë organizimin e punës dhe drejtimin për përdorimin sa më efikas të kuadrove specialistë. Këtu, nuk e kam fjalën që të mos grumbullojmë disa kuadro specialistë të nevojshëm për zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Por, nga ana tjetër, të ruhem nga mania për t'i fryrë aparatet me kuadro, sepse fryrja e aparateve është burokratizëm. E theksoj edhe një herë se ka probleme si ai që përmenda pak më lart, po dhe shumë probleme të tjera që kërkojnë një grumbullim kuadrosh, por dhe në këtë rast duhet vepruar me mjaft nikoqirllëk. Kuadrot që nevojiten t'i grumbullojmë dhe në krye të tyre të vihet një drejtues i mirë. Puna të organizohet në mënyrë të atillë që ata të merren seriozisht me problemin që u përket dhe t'ia dalin mbanë punës që u është ngarkuar. Ministrinë përkatëse t'u krijojnë atyre të gjitha kushtet e nevojsh-

me për ta nxjerrë problemin në dritë. Mirëpo këto çështje nuk zgjidhen në këmbë nga një inxhinier, kimist, apo nga një gjeolog që vjen për këtë apo për atë problem sot, nesër, një herë edhe njëqind herë te zëvendësministri ose te drejtori, i cili ka shumë probleme të tjera, sepse merret edhe me gjëra të vogla. Jo, problemet e mëdha e të rëndësishme nuk mund të zgjidhen në këtë mënyrë, ose siç ndodh që edhe kur veprohet, ato zgjidhen me vonesa të dënueshme.

Prandaj, kurdoherë e kam thaksuar dhe përsëri po e theksoj që, kësaj praktike t'i jepet fund. Vetëm kësh-tu shokët e Kryesisë së Këshillit të Ministrave, ministrat dhe drejtorët do të gjejnë një metodë dhe një stil më të mirë pune. Kur ministri apo zëvendësministri do të ketë të bëjë me disa grupe kuadrosh specialistë, të cilët i ka ngarkuar të zgjidhin probleme si ato që thashë, atëherë edhe ministri apo shokët e Kryeministrit nuk do të kenë kohë të merren me cikërrima, ose, më mirë, me çdo lloj pune, në një kohë që ka edhe shumë shokë të tjerë në aparate, dhe këta, po ta kryejnë detyrën ashtu si duhet, kanë me të vërtetë plot punë për të bërë. Pra duhet t'i vihemi seriozisht zgjidhjes së këtyre problemeve.

Unë mendoj se për probleme të rëndësishme, ne mund të kemi edhe një bërthamë shkencore të shëndoshë. Kështu për çështjen e pasurimit të mineraleve të rralla të kemi një grupim inxhinierësh, gjeologësh të tillë që jo vetëm të zbulojnë vendburime, por edhe të interesohen, të studiojnë e të bëjnë planifikime për minierat e fabrikat që nevojiten për larjen, pasurimin e mineraleve etj., etj.

Prandaj, mendoj që këto çështje të mbahen mirë parasysh, të shkunden njerëzit e të ecin përpara, të mos kënaqen e vetëkënaqen me atë që është arritur, por të studiojnë, të thellohen në punën e tyre, të bëjnë luftë dhe kjo luftë të jetë e organizuar, e studiuar, e planifikuar, e kontrolluar e në kohën e caktuar të jepen rezultatet. Fondet për gjëra të tilla jo vetëm që janë caktuar, por edhe në qoftë se nuk janë caktuar, çdo ministri dhe Qeveria ka një fond të saj rezervë, të cilin duhet ta përdorin sidomos për zgjidhjen e problemeve kaq të rëndësishme.

Tash ne do të studiojmë edhe planin e vitit 1978, për këtë na janë paraqitur materialet. Edhe unë jam duke i studiuar ato, dhe sigurisht do të kemi edhe vërejtje, sugjerime dhe mendime që do ta plotësojnë më mirë atë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

REVOLUCIONI TEKNIKO-SHKENCOR TË SHIKOHET NË GJERËSINË DHE NË THELLËSINË E TIJ

Shënime

19 janar 1978

Si çdo ditë, edhe sot bisedova me shokët sekretarë të Komitetit Qendror, mungonte vetëm Prokopi [Murrja]. E përgëzova Hekuranin për referatin që mbajti për revolucionin tekniko-shkencor dhe e pyeta si shkoi. Ai më tha se shkoi mirë dhe ishin bërë diskutime me vlerë. Tashti gjithë çështja është që ato ç'u thanë dhe ç'janë thënë edhe më parë të vihen si duhet në zbatim.

Revolucioni tekniko-shkencor duhet të konsiderohet si një problem i rëndësishëm në gjerësinë dhe në thellësinë e tij, si në tërësi, ashtu edhe për çdo hallkë në veçanti. Nuk është hera e parë që ne e shtrojmë çështjen e thellimit të revolucionit tekniko-shkencor. Këtë problem me rëndësi të madhe për ecjen përpara të ndërtimit të socializmit në vendin tonë ne e kemi shtruar me kohë, kemi marrë masa, kemi ndihmuar dhe kemi pasur realizime. Nuk duhen mohuar realizimet, por nuk duhet harruar se na ngjanë mjaft peripeci dhe mjaft sabotime, lidhur me kuptimin e vërtetë dhe me zhvillimin

e revolucionit tekniko-shkencor, nga ana e sabotatorëve, sidomos nga Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi e të tjerë.

Pra duhet të themi se ky problem i madh është shtruar, punohet, ka rezultate, megjithatë nuk ecet me ritmin e duhur. Prandaj shtruarja edhe një herë e tij nga ana jonë me kuadrot e Partisë e të shtetit duhet të shërbejë për t'i shkundur njerëzit, që këta ta kuptojnë më thellë revolucionin tekniko-shkencor dhe të punojnë me ngulm për shtrirjen e tij në të gjitha degët e sektorët e ekonomisë sonë socialiste.

Të mos mendohet se revolucionin tekniko-shkencor konsiston vetëm në projektimin e disa fabrikave të reja, megjithëse edhe ky është një aspekt me rëndësi. Gjithashtu, duhet bërë e qartë se ky revolucion nuk konsiston vetëm në përmirësimin e teknologjisë në një uzinë ose në hapjen e një linje të re prodhimi. Po të kufizohet këtu, ky do të ishte një shikim i ngushtë i revolucionit tekniko-shkencor. Revolucionin tekniko-shkencor, i parë në gjithë gjerësinë e tij, ka brenda të gjitha problemet kyç të ekonomisë sonë socialiste. Ja, për shembull, të marrim rendimentin. Në qoftë se flasim për rendimentet, që ne luftojmë t'i ngremë se janë akoma të ulëta dhe planet nuk realizohen në të gjithë zërat e degët, këtë do ta lidhim edhe me novacionet, me progresin teknik, me masat organizative, edhe me disiplinën shkencore e proletare në punë. Pra, të gjitha këto çështje janë të lidhura zinxhir, nuk mund të merren të shkëputura nga revolucionin tekniko-shkencor.

- Ose të marrim problemin e madh të normave që e kemi shtruar shumë herë, kemi folur e kemi marrë edhe

masa, kemi përcaktuar edhe afate për vendosjen e normave teknike etj. dhe janë lënë fare pak procese pune të panormuara, të cilat me kohë do të normohen. Por çfarë konstatojmë? Edhe në këtë drejtim ecet, por jo me atë ritëm që kërkohet, sepse nuk ekziston ai kontroll, nuk ekziston ajo ndihmë, nuk janë marrë ato masa që vendimet përkatëse, për sa i përket këtij problemi vital, të japin rezultatin që ne kërkojmë.

Në materialin që na kanë dërguar shokët e Qeverisë për realizimin e planit të vitit 1977 dhe për planin e vitit 1978, unë konstatoj se megjithëse në vendosjen e normave teknike kemi ecur mirë, jemi akoma prapa. Po pse jemi prapa? A nuk ka lidhje ky problem i normave me shpikjet, me racionalizimet, dhe jo vetëm me ndërtimin e fabrikave, por edhe me përsosjen e organizimit të punës, që çon përpara realizimin dhe zhvillimin e prodhimit?

Kur flasim për revolucionin tekniko-shkencor, kemi parasysh një veprimtari të madhe e të shumanshme, një marshim përpara në sasi, por që kthehet edhe në cilësi. Në këtë kuptim, zhvillimi i revolucionit tekniko-shkencor është një çështje e përditshme. Prandaj punëtorët, mjeshtrit, inxhinierët, agronomët duhet të reflektojnë në punën që bëjnë si e si të nxjerrin nga duart e tyre prodhime sa më të përsosura, më me kualitet, me rendiment më të madh e me kosto më të ulët. Për këtë lypsen edukim, organizim i mirë i punës, masa teknike, të cilat të jenë të lidhura me eksperiencën shkencore, prej së cilës duhen nxjerrë kurdoherë konkluzione për të çuar përpara punët dhe rezultatet. Në këtë rrugë të nxitim progresin, duke hedhur tej ose duke skar-

tuar çdo gjë të vjetruar, që dikur mund të ketë qenë progresive dhe e frytshme, por që tash pengon prodhimin. Kjo duhet shoqëruar me marrjen e masave sa më efikase, më të përparuara, me qëllim që prodhimi të ecë përpara.

Në qoftë se e kuptojmë revolucionin tekniko-shkencor në këtë gjerësi, në këtë shtrirje dhe në këtë thellësi, atëherë ky revolucion nuk do të qëndrojë në vend, as nuk do të ecë me ritme të ngadalshme, por me temp revolucionar. Është e vërtetë që Partia duhet të marrë masa që ky problem të kuptohet drejt, por njëkohësisht, krahas këtyre, të merren edhe masa shtetërore, organizative e teknike dhe të mos ndodhë siç ka ndodhur në disa raste që propozimet, shpikjet dhe racionalizimet e njerëzve të përparuar të prodhimit të duartrokiten e pastaj të mbeten sirtarëve, të mos organizohet puna dhe të mos merren masa materiale, teknike për t'i vënë ato në zbatim.

I theksova këto për arsye se vihen re edhe fenomene të tilla në praktikën e përditshme shtetërore. Eliminimi i tyre kërkon që problemet që shtrën udhëheqja të vihen në jetë me frymë më luftarake. Këto probleme në përgjithësi studiohen, njerëzit thellohen në to dhe organizohet puna për zbatimin e tyre, por ka edhe raste të tilla që për disa probleme në fillim bëhet bujë e madhe që i përngjet zjarrit prej kashte. Rezultatet e arritura me këtë hov të fillimit krijojnë te njerëzit tanë një vetëkënaqësi dhe nuk nxitin tek ata atë kurajë, atë organizim që është i domosdoshëm për ta çuar përpara e deri në fund problemin dhe për të kapërcyer vështirësitë që dalin, duke punuar frontalisht, me frymë të

lartë mobilizimi për të realizuar deri në fund vendimet e detyrat dhe që realizimi i tyre të shihet në frytet që japin.

Shtrimi i këtij problemi në Qeveri është i nevojshëm, por ministrat të mos e marrin këtë si një gjë të re, por si një direktivë të rëndësishme që Partia e ka lëshuar më parë dhe që shtrohet përsëri aktualisht për të ecur më mirë dhe më me vrull përpara. Duhet pasur kurdoherë parasysh, siç e thaksoi edhe shoku Ramiz, që organizmat aktualë, që ekzistojnë nëpër ministritë për çështje të ndryshme, të mos humbasin funksionet e tyre duke krijuar andej-këtej komisione inxhinierësh e teknikësh për një varg punësh. Këto komisione për tema të veçanta duhet të krijohen qoftë edhe me dy-tre inxhinierë për t'i studiuar problemet dhe mbasandaj për t'i zbatuar dhe për të kontrolluar zbatimin duhet të udhëhiqen nga organizmat që ekzistojnë.

Këtu del çështja e temave kapitale me të cilat duhet të merret udhëheqja e dikasterit dhe në rast se revolucioni tekniko-shkencor, që ka shumë probleme të rëndësishme e të ndërlikuara për zhvillimin e ekonomisë sonë kuptohet si duhet, atëherë këta organizma në dikastere do të jenë plotësisht të ngarkuar me punë të madhe serioze krijuese. Kështu ata as do të gjejnë kohë të merren me çështje të vogla, siç po merren shumë herë aktualisht, sepse do t'u duhet të drejtojnë, të ndihmojnë dhe të kontrollojnë punën për zgjidhjen e problemeve të mëdha. Edhe këtë duhet ta kemi parasysh.

Mendoj se, duke e shtruar çështjen e revolucionit tekniko-shkencor në këtë kohë dhe në këto përmasa, me këto forma organizimi, drejtimi dhe me këmbëngulje për

studimin e problemeve në zhvillim, ne do ta ngremë atë në një shkallë akoma më të lartë, të nevojshme e të domosdoshme për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë e të ndërtimit të socializmit.

Në materialet që i vijnë udhëheqjes së Partisë për revolucionin tekniko-shkencor, ashtu si edhe për problemet e tjera, nuk duhet folur në përgjithësi, me fraza që mund të thuhen edhe pas 20 vjetësh dhe të mos jenë të gabuara. Në këto materiale e raportime të na bëhet jo një pasqyrë e përgjithshme që komitetet e Partisë punojnë mirë, që aktualisht nuk ka probleme partie, që komiteti i Partisë i rrethit ka ndihmuar më mirë etj., etj. Ato duhet të jenë të studiuara e sa më konkrete dhe të ngrenë probleme, të trajtojnë një ose dy probleme kryesore që me të vërtetë shqetësojnë Partinë dhe të japin një pasqyrë të qartë të gjendjes rreth së cilës mund të diskutojmë këtu e ku mund të shohim dhe anët pozitive, edhe anët negative të problemit, me qëllim që të orientohemi drejt. Mund të dilet te një problem partie që na intereson, për shembull, si janë aktualisht pranimet në Parti nga klasa punëtore, duke folur konkretisht që në këtë uzinë të përparuar, për shembull, kemi kaq pranime, kurse në atë tjetrën, kemi më shumë pranime, ose të kundërtën dhe si kanë ndikuar këto pranime në rezultatet e realizimit të planeve e të thellimit të revolucionit tekniko-shkencor.

Pra, këtej të dilet me konkluzionin që pranimet në Parti, për shembull, ndjekin rrugën e zhvillimit të drejtë dhe të direktivave që ka dhënë Byroja Politike ose përkundrazi, ka boshllëqe. Po të veprohet kështu, me siguri është më mirë sesa të thuhet fraza të përgjithshme në-

për raporte, si, për shembull, që autokritika është e mirë, që ka kritikë etj., etj. Ne e dimë që bëhet autokritikë, ka raste që bëhet e mirë, por ka dhe raste që nuk është e tillë; dimë gjithashtu që ka kritika të mira, por ka edhe jo të mira; ka të bazuara, por ka edhe të pabazuara. Këto gjëra dihen, por është e nevojshme të kapet, si i thonë një fjale, demi nga brirët, pra të merren dy ose tri probleme të veçanta, të studiohen thellë dhe nga këto të nxirren konkluzione që të shërbejnë për mbarëvajtjen gjithmonë e më mirë të punës.

Po kështu mund të veprohet dhe për çështje të tjera. Për shembull, duke marrë shkas nga një problem ekonomik, duhet të dilet me kokluzione politiko-ideologjike, pse për këtë problem ekonomik, në këtë ose në atë rreth, në këto ndërmarrje ose në koordinimin e punës midis tyre nuk ecet me ritmin e duhur dhe sipas direktivave, cilat janë shkaqet e këtyre dobësive etj. Pra të përcaktohet nëse ka shkaqe politike, ideologjike dhe organizative, apo ka çështje të kuptimit jo si duhet të këtyre problemeve nga shokët e pushtetit, që janë njëkohësisht anëtarë partie.

Ja, të tilla probleme duhet të na vijnë këtu në Sekretariat dhe jo të na jepet një pasqyrë e përgjithshme, një grumbullim frazash stereotipe, që nuk kanë vlerë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MË PAK BUJË E TEORIZIME DIJE MË SHUMË PUNË PËR THELLIMIN E REVOLUCIONIT TEKNIKO-SHKENCOR

Shënime

20 janar 1978

Sot, në bisedë me shokët sekretarë të Komitetit Qendror, iu ktheva përsëri problemit të revolucionit tekniko-shkencor, megjithëse dhe një ditë më parë kisha folur për këtë, duke marrë shkas nga referati shumë i mirë që mbajti shoku Hekuran [Isai], në aparatën e Komitetit Qendror, me një numër të konsiderueshëm kuadrosh të Partisë e të pushtetit. Ky referat duhet të zërthehet jo vetëm nga organet e pushtetit, nga Qeveria e nga dikasteret, por edhe nga organizatat e Partisë.

Partia duhet të ketë kurdoherë parasysh që armiku Abdyl Këllezi tentoi ta devijonte, ta fuste në rrugë të shtrembër zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor në vendin tonë. Nuk duhet të harrojmë analizën dhe kritikën që i kemi bërë kësaj veprimtarie armiqësore, e cila shtrembëronte thelbin, kuptimin filozofiko-ideologjik të revolucionit tekniko-shkencor. Mbajtja kurdo-

herë parasysh e kësaj kritike do t'i ndihmojë kuadrot e Partisë dhe të pushtetit të kuptojnë mirë dhe thellë, nën prizmin marksist-leninist, thelbin dhe synimet e revolucionit tekniko-shkencor. Revolucioni tekniko-shkencor është zbatimi në mënyrë revolucionare i përvojës së përparuar teknike, në lidhje të ngushtë me diturinë shkencore, për të bërë ndryshime kualitative në procesin e prodhimit, që do të sjellin edhe automatizimin e shumë proceseve të punës. Si çdo revolucion, edhe revolucioni tekniko-shkencor, si pjesë përbërëse e revolucionit socialist, zhvillohet frontalisht në gjithë aktivitetin e vendit dhe jo vetëm në disa drejtime.

Revolucioni tekniko-shkencor ka për qëllim të perfeksionojë mjetet e prodhimit, të lidhë shkencën me praktikën, të përmirësojë teknologjinë, të rritë rendimentin, të përmirësojë kushtet e punës dhe të prodhimit, të rritë mirëqenien e punonjësve. Këto dy të fundit janë çështje me karakter shoqëror humanitar, që nuk duhet në asnjë mënyrë t'i harrojmë.

Të gjithë, që nga punëtori dhe deri tek inxhinieri më i kualifikuar, duhet të luftojnë, të mendojnë, të racionalizojnë dhe të shpikin mjete më të përparuara nga ato që përdoren sot. Natyrisht, përsosja e mjeteve të prodhimit në vendin tonë do të çojë në ngritjen e rendimentit të punës, në rritjen e prodhimit në sasi e cilësi dhe do të pakësojë lodhjen fizike të punëtorit gjatë kohës së caktuar të punës. Progresi teknik te ne nuk shpie në lindjen e papunësisë dhe as në intensifikimin e prodhimit në kurriz të punëtorëve. Rritja e rendimentit në socializëm, që lidhet me mekanizimin e prodhimit, me

përmirësimin e kushteve dhe të mjeteve të punës, rrit mirëqenien, lehtëson punën e punëtorëve, krijon kushte për zhvillimin e gjithanshëm dhe çlodhjen e kulturuar të tyre. Krejt ndryshe ndodh në kapitalizëm. Kapitalisti e nxit, kur i intereson, progresin teknik për të prodhuar sa më shumë, duke shfrytëzuar në maksimum punëtorin. Kapitalisti, kur mekanizon proceset e punës, s'e ka për gjë që një pjesë të punëtorëve ta hedhë në rrugë dhe pastaj, si «bamirës», t'i japë ndonjë thërrime nga djersa e punëtorëve të tjerë, që i shtrydh deri në palcë, duke i trajtuar si qenie pa shpirt. Pra, kuptimi ideologjik, qëllimet dhe rrugët e realizimit të revolucionit tekniko-shkencor të ne, si shtet socialist, janë krejt të ndryshme nga ato në kapitalizëm.

Revolucioni tekniko-shkencor duhet kuptuar në thelbin e tij ideologjik. Të mos harrojmë, siç e theksova, devijimet që kërkonin të bënin lidhur me këtë revolucion armiq të Partisë e të popullit Abdyl Këllezi e Koço Theodhosi. Këta armiq u përpoqën ta futnin zhvillimin e tij dhe të të gjithë ekonomisë sonë në rrugën revizioniste të vetadministrimit. Ata grumbulluan në Tiranë një numër të madh kadrosh të kualifikuar, gjoja për të bërë studime e racionalizime, por, në fakt, këta kadro hiqeshin nga prodhimi dhe frynin administratën. Kjo do të thoshte që ne të futeshim në rrugën e propaganduar nga teoria pseudomarksiste e revolucionit tekniko-shkencor, sipas së cilës zhvillimi i këtij revolucioni sjell në fuqi teknokracinë, teknikët dhe specialistët e kualifikuar, të cilët drejtojnë jo vetëm në fushën e prodhimit, por edhe në atë të administrimit e të politikës. Me një fjalë, nëpërmjet kësaj teorie, që është teoria e

teknokratizmit, borgjezia kapitaliste përpiqet të krijojë përshtypjen sikur nuk është më ajo që drejton, por drejtojnë teknokratët. Këtëj teoricienët borgjezë nxjerrin konkluzionin se gjoja nuk është më nevoja të bëhet revolucioni proletar dhe të merret fuqia nga proletaria-ti, pse në fakt janë këta inxhinierë dhe specialistë të kualifikuar që e drejtojnë jetën politiko-ekonomike të vendit.

Revolucioni tekniko-shkencor nuk duhet kuptuar në mënyrë të njëanshme, domethënë, nuk duhet kuptuar sikur ai konsiston vetëm në projektimin dhe në ndërtimin e ndërmarrjeve, të uzinave ose të fabrikave të reja me forcat tona dhe të harrohen gjërat e vogla, krijimi i pajisjeve të veçanta dhe përmirësimi i mjeteve aktuale të prodhimit, që do të ndikojnë në rritjen e cilësisë dhe të rendimentit, në uljen e kostos dhe në realizimin e gjithë objektivave që përmenda pak më parë.

Edhe në qoftë se do të na duhet të krijojmë grupe specialistësh të kualifikuar për zgjidhjen e ndonjë problemi të rëndësishëm e të vështirë, fjala vjen, për të projektuar këtë ose atë fabrikë, këto nuk duhet të grumbullohen në Tiranë, siç vepruan Abdyl Këllezi dhe Koço Theodhosi, por atje ku është lënda e parë, ku është vendi i ndërtimit. Grupet e teknikëve dhe të specialistëve të kualifikuar duhet të jetojnë dhe të punojnë atje ku mund të merret më mirë eksperiencia. Ato, natyrisht, të jenë të lidhura me dikasteret ose me drejtoritë përkatëse të dikasterit, por në asnjë mënyrë s'duhet krijuar me to organizma të rinj nëpër dikastere. Këto grupe të mos jenë të shkëputura dhe as të mos sponzojnë organizmat ekzistues shtetërorë, puna e tyre të

jetë e programuar dhe të zhvillohet nën drejtimin dhe kontrollin e organeve përkatëse.

Të kemi kujdes që puna e filluar për nxitjen dhe thellimin e revolucionit tekniko-shkencor të mos jetë si një zjarr kashte. Çështjen e këtij revolucionit, që akoma nuk po ecën me ritmet e duhura, e kemi shtruar me kohë, bile kemi arritur edhe në konkluzione, prandaj kjo që po bëjmë tani të mos duket sikur është diçka e re. Jo, s'ka asgjë të re, por tash çështjen e shtrojmë që të perfeksionojmë punën për realizimin e asaj detyre që Kongresi i 7-të i Partisë dhe Byroja Politike e kanë shtruar si një nga detyrat më të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, për ndërtimin e socializmit. Prandaj më pak bujë dhe më shumë punë në këtë drejtim, më pak teorizime dhe më shumë organizim. Grupeve të punës, të krijuara për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor, t'u vihen detyra dhe të kontrollohet mirë zbatimi i tyre. Një gjë të tillë ta ketë parasysh Partia, por sidomos Qeveria, se kjo do të luajë rolin vendimtar në këtë çështje.

Organizimi i punës për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor nuk duhet të jetë hipotetik, por një organizim i shëndoshë me masa konkrete, se nevojitet një ndihmë reale që ky problem të gjejë zgjidhje. Natyrisht, për këtë çështje do të duhet të forcohet kooperimi midis ndërmarrjeve, të lëvizin, të zëvendësohen ose të merren prej tyre kuadro etj. Kur hiqen specialistë nga prodhimi për në grupe studimi, duhet bërë kujdes. Të marrim nga ndërmarrjet aq kuadro sa na duhen për të bërë projekte të objekteve më të

nevojshme, që na duhet t'i ndërtojmë në një perspektivë të afërme dhe të mos shtrihemi në studimin e detyrave për një periudhë 30-vjeçare, se forcat i kemi të kufizuara. Veç kësaj, duhet pasur parasysh që tërheqja e këtyre specialistëve të mos dobësojë ndërmarrjet, se pikërisht në këto ne do të zhvillojmë revolucionin tekniko-shkencor. Dhe ky revolucion në bazë nuk mund të zhvillohet vetëm me punën e dy-tre kuadrove specialistë të komisioneve tekniko-shkencore që janë krijuar, pa pjesëmarrjen masive të punëtorëve të ndërmarrjeve.

Grupet e krijuara përbëjnë një bërthamë shkencore me disa specialistë që punojnë në prodhim. Këta, me punën e tyre, duhet të ndikojnë në të gjithë ndërmarrjen, që t'u punojë mendja të gjithë punëtorëve, specialistëve e inxhinierëve, që të gjithë të krijojnë, të propozojnë, t'i diskutojnë propozimet e tyre dhe t'i vënë në zbatim me mjetet që kanë ose duke kërkuar ndihmë nga lart, nga komiteti ekzekutiv dhe, kur është e nevojshme, edhe nga ministria përkatëse. Komiteti ekzekutiv me aparatet që ka krijuar posaçërisht për drejtimin e këtyre komisioneve tekniko-shkencore nëpër ndërmarrje, po ashtu dhe ministria duhet t'u përgjigjen në kohë propozimeve të bëra nga baza dhe jo pas disa muajve, ose t'i harrojnë fare kërkesat e propozimet e tyre.

Pra, nga të gjithë duhet të punohet intensivisht në këtë drejtim, se interesat e ekonomisë sonë kërkojnë zhvillimin e një revolucioni të vërtetë, të madh tekniko-shkencor, që është njëkohësisht një revolucion

politik i udhëhequr nga Partia në rrugën e drejtë në bazë të teorisë marksiste-leniniste.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Për shkencën» (Përmbledhje
veprash) vëll. II, f. 136*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Për shkencën»
(Përmbledhje veprash), vëll. II,
f. 136*

ZHVILLIMI I REVOLUCIONIT TEKNIKO-SHKENCOR NDIKON NË REALIZIMIN E PLANEVE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

24 janar 1978

SHOKU ENVER HOXHA: Shoqja Themie² mund të na thuash se cilat janë arsyet që nuk realizohen planet për sigurimin e foragjereve e të ushqimeve të blegtorisë në përgjithësi? Ky nuk është një problem i ri por ka vite e vite që është shtruar e shtrohet nga Partia, sepse vazhdimisht në sektorin e bujqësisë ka pasur mosrealizime. Ku janë arsyet e vërteta të këtyre mosrealizimeve? Mungon toka, mungojnë farërat apo mekanizimi që duhet për punimet etj.? Pra, çfarë mungon objektivisht për këtë problem kaq të rëndësishëm? A mund të na thuash ti se ç'konkluzione keni nxjerrë për këtë

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit që do të mbahej në Plenumin e 4-t të KQ të PPSH, për plotësimin e detyrave të planit të vitit 1977 dhe për detyrat e planit të vitit 1978.

2. Themie Thomai, ministre e Bujqësisë, e pranishme në këtë mbledhje.

çështje? Dhe, në qoftë se deri tani janë bërë disa gjëra, atëherë çfarë masash të tjera mund dhe duhet të merren për ta vënë një herë e mirë në rrugë këtë çështje?

SHOQJA THEMIE THOMAI: Shqetësimi juaj, shoku Enver; është shumë i drejtë. Arsyet që jepen për mosrealizimin e detyrave në blegtori sipas mendimit tonë dhe sipas analizave që i kemi bërë këtij problemi, janë subjektive. Arsyeja e parë është se në këtë sektor punojnë kuadro të paaftë.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk është në karakteristikat e popullit tonë, që ka rrojtur në varfëri, nënvleftësimi i bagëtisë. Bile, më përpara, ka pasur kujdes më tepër për bagëtinë, për lopën dhe për kaun. Atëherë, si qëndron kjo çështje nga ana botëkuptimore, si koncept? Pse, në vend që të ishte i zgjidhur ky problem, të ketë kthim prapa në një kohë që Partia e ka shtruar me forcë këtë çështje dhe i ka ngritur masat politikisht si asnjëherë tjetër?! Mua më duket se këtu nuk duhet të ketë pengesa të pakapërcyeshme. Arsyet janë subjektive dhe organizative; s'ka si të jetë ndryshe, sepse ne i kemi të tëra kushtet dhe mundësitë për zhvillimin e këtij sektori. Ju thoni se disa kapen pas drithërave të bukës dhe nënvleftësojnë blegtorinë. Po a mund të na thuash se çfarë duhet të bëjmë që këta njerëz të kuptojnë se ne nuk kemi nevojë vetëm për drithërat e bukës? Natyrisht, drithërat e bukës janë baza, janë kryesoret, por edhe këto të tjerat janë probleme me rëndësi të madhe. Përse nuk përgjithësohet shembulli i Pogradecit? A nuk ka mundësi të bëhet kjo? Çfarë janë këta njerëz që kanë bërë këtë ndryshim në Pogradec, mos vallë kanë ndonjë gjë të veçantë në krahasim

me ata të Vlorës, të Beratit, të Elbasanit etj.? Sigurisht që nuk kanë ndonjë ndryshim. Atëherë, përse nuk e bëjnë edhe të tjerët këtë? Koha është flori, shoqja Themie, e nuk na pret, prandaj duhet të marrim masa që ta zgjidhim përfundimisht këtë problem. Ne i ndjekim me vëmendje përparimet e arritura në sigurimin e bazës ushqimore, por çështja është që të mos mjaftohemi me to dhe të luftojmë që blegtorinë ta kemi kurdoherë në rritje e në zhvillim.

Këtu u tha që fajin për mosrealizimet në sektorin e blegtorisë e kanë udhëheqjet e kooperativave. Edhe unë kam të njëjtin mendim. Por a ka kontrolluar ministria se si punon shtabi i kooperativës? (Dhe, kur flasim për shtabin e kooperativës kemi parasysh gjithë kuadrot, që nga drejtuesit, agronomët, zooteknikët, veterinerët, planovikët, financierët e të tjerë dhe deri tek tekniku). Fjala vjen, kur vendoset plani, kur ndahen parcelat, kur përcaktohen mbjelljet, kur ndahet sasia e plehut etj., si vepron konkretisht dhe a ka ndryshime në to? A i qëndron specialisti i caktuar (qoftë teknik, qoftë administrator), në kokë kësaj pune deri në fund, me gjithë «ushtrinë» që kanë vetë brigadat? Desha të di nëse bëhet kështu kjo punë apo vepron me hope dhe si të dojë njëri e tjetri?

Të kuptohemi, të tëra këto nuk do t'i bëjë vetëm ministria, pse është e pamundur, por këtë metodë pune, këtë stil pune, duhet ta zbatojmë medoemos, që edhe ministria, por edhe komitetet e Partisë, organet e pushtetit, seksionet e bujqësisë në rrethe ta kenë vazhdimisht në dorë situatën edhe në këtë sektor e ta drejtojnë mirë atë. Në qoftë se Partia nuk vendos një

metodë dhe një stil pune të tillë, politika e saj nuk mund të realizohet si duhet në jetë. Kështu do të bëhet, sepse kështu e do politika e Partisë dhe këtë na e mëson leninizmi. Në qoftë se duam bujqësi e blegtori të përparuar, në qoftë se duam t'ia përmirësojmë jetën popullit, është e domosdoshme të sigurojmë kudo rolin udhëheqës të Partisë. Me këtë duhet kuptuar ajo që edhe kryetari, që në të shumtën e rasteve është anëtar partie, po edhe po të mos jetë ka një detyrë partie me përgjegjësi; po ashtu edhe veterineri, zootekniku, agronomi e të tjerë, të luftojnë që ta zbatojnë sa më mirë këtë parim të madh dhe kjo punë të japë rezultate konkrete. Ministria, natyrisht, duhet të ndihmojë në mënyrë të kualifikuar; të kontrollojë si ecin punët etj. Këtë po, e keni për detyrë ta bëni. Por në bazë, vënien në jetë të këtij parimi, siç thashë, do ta bëjë vetë Partia. Kjo duhet të kuptohet mirë nga komitetet e Partisë të rretheve, nga seksionet e bujqësisë dhe nga të gjithë punonjësit e këtij sektori, kudo. Partia, me punën e saj bindëse, duhet t'ia «ndryshojë» kokën edhe atij kryetari kooperative a specialisti që ngul këmbë në mendimet e tij të padrejta sepse, nuk mund t'i kërkohet zbatimi i detyrës një njeriu, sado i mirë që të jetë ky, kur nuk është i bindur në parimet e Partisë. Një njeri mund të gabojë, por shumë njerëz apo të gjithë përnjëherësh është vështirë të gabojnë. Prandaj këto parime Partia duhet t'ua shpjegojë mirë këtyre njerëzve.

Përveç të tjerave, unë desha të shtoj edhe këtë: kooperativistët, kur është fjala për të përfituar nga përvoja e të tjerëve, mos i dërgoni vetëm në aktive

bujqësore, por në mënyrë kolektive mund t'i çoni edhe në qendra industriale për të mësuar nga organizimi e disiplina proletare në punë dhe nga kontrolli i klasës punëtore. Atje ata do të shohin që në rast se një punëtor i bie gozhdës dhe tjetri potkoit, nuk mund të ecë kurrsesi puna përpara, sepse pengohet zinxhiri i prodhimit. Kështu ne do t'u mësojmë dhe do t'u fusim në shpirt edhe kooperativistëve disiplinën proletare në punë konkretisht dhe jo vetëm me referate. Pra, duke parë në një uzinë se në zinxhirin e punëve njëri ngec, kooperativistët shohin se kështu pengohet tërë procesi i prodhimit dhe plani nuk realizohet. Për analogji, në qoftë se kryetari i kooperativës apo përgjegjësi i sektorit nuk interesohet edhe për punimin e tokës, edhe për bimët foragjere, edhe për farën, edhe për plehërimin e tyre etj., natyrisht nuk mund të ketë as blegtori të përparuar dhe as mish e qumësht. Këtë të vërtetë të thjeshtë duhet ta kuptojnë mirë ata. Prandaj të përdorim disa forma pune të tilla të efektshme, sidomos për ata sektorë ku shohim se ka dobësi.

Atyre që thonë se nuk janë dakord me planet që u keni caktuar, në bazë të direktivave të dhëna, ju të ministrisë mund t'u përgjigjeni se plani i miratuar në kongres është ligj. Atëherë ata me siguri do të mendojnë një çikë më thellë për këtë gjë e mund t'ju pyesin se përse ua keni ngritur planin. Duke e kuptuar këtë, e duke krijuar bindjet e nevojshme ata do të thonë se do t'i përvishen punës si duhet për të realizuar detyrat që vuri kongresi. Por, njëkohësisht mund t'ju paraqitin edhe vështirësitë që mund të kenë. Këto duhen kuptuar e vlerësuar drejt. Se, kur krijohen defi-

cite një çikë të mëdha, për arsye të motit etj., është pak e zorshme të bësh pastaj, si të thuash, një rishpërndarje matematike.

Krahas këtyre mos harroni lulediellin, panxharin dhe pambukun, sepse këto nuk i kemi në sasinë e duhur. Mundësitë janë që planin e këtyre prodhimeve ta realizojmë. Të mos nxirren justifikime të tilla si «realizuar e tejkaluar drithërat e bukës» dhe të harrojmë të tjerat. Sigurisht, çështja e bukës është e para, pse pa bukë nuk rron dot njeriu, por edhe pa bagëti nuk jeton dot. Pra, të gjithë sektorëve duhet t'u vëmë rëndësi të madhe, deri tek ajo që thamë, tek ushqimi i bagëtive.

SHOQJA LENKA ÇUKO¹: Problemet që shtrohen sot këtu kërkojnë thellim të mëtejshëm nga ana jonë, për t'i kuptuar dhe për t'i zbatuar drejt, në kushtet tona konkrete, sidomos çështjet që lidhen me forcimin e disiplinës së planit dhe me thellimin e revolucionit tekniko-shkencor.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë dëshiroja të na sqarosh këtu për një problem. Ju punoni në një rreth të favorizuar, ku ndodhet edhe Instituti i Kërkimeve Bujqësore. Duke qenë kështu, rrethi i Lushnjës duhej të ishte përpara të gjitha rretheve në këta sektorë për të cilët po diskutojmë, por, në fakt, kjo nuk ndodh dhe arsyet ju i thatë këtu pak më parë, kur diskutuat.

1. Në atë kohë kandidate e Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe sekretare e parë e Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës.

Tani, ku konsiston pyetja ime? Ne duam të dimë, së pari, se çfarë ndihme ju jep ky institut kaq i rëndësishëm që i shërben gjithë bujqësisë së vendit, por, në mënyrë të veçantë, bujqësisë së rrethit tuaj se ju e keni, si i thonë fjalës, në shtëpi brenda, ndaj do të ishte me interes sikur të na thoshit edhe se çfarë ndihme kërkonit ju prej tij? Që të të orientoj më mirë në pyetjen që po bëj dhe për të mos u zgjatur, ne duam të dimë, për shembull, se ç'interesim konkret tregon ky institut për pambukun, sidomos në ato kooperativa ku mbillni sipërfaqe të mëdha toke dhe nuk merrni prej tyre rendimentet e parashikuara.

E dyta, kuadrot e këtij instituti bëjnë vazhdimisht studime; gjithashtu organizojnë herë pas here mbledhje. S'ka dyshim që në këto mbledhje rrihen probleme të shkencave bujqësore. Ne duam të dimë nëse kur bëhen studime apo kur organizohen mbledhje nga degët e ndryshme që ka ky institut, a thirren dhe a marrin pjesë edhe agronomë e kultivues kryesorë të bimëve të ndryshme, si: gruri, pambuku etj. Dhe, në rast se marrin pjesë, këta venë atje vetëm si dëgjues? Po vetë këta shkencëtarë a organizojnë pastaj konferenca të veçanta me specialistë të rrethit për probleme që ju preokupojnë sidomos në ato bimë që nuk dalin mirë me rendimentet. Me një fjalë, Partia a i udhëzon këto grupe shkencëtarësh që të japin mendimet e veta dhe të shpërndajnë sa më mirë që të jetë e mundur eksperiencën e përparuar edhe nëpërmjet këtyre konferencave? Këto sqarime duam ne, natyrisht pa u futur në hollësi. Na thuaj shkurtimisht nëse e bëni apo nuk e bëni këtë gjë. Në qoftë se nuk e bëni, mendoj se në të

ardhmen duhet të përpiqeni që jo vetëm ta bëni po edhe ta bëni mirë.

SHOQJA LENKA ÇUKO: Specialistët e Institutit të Kërkimeve Bujqësore na japin një ndihmë konkrete për bimët që kultivojmë në rreth. Ne i kemi aktivizuar ata sidomos për grurin. Ata kanë organizuar konferenca të veçanta, por aty marrin pjesë vetëm bashkëpunëtorët që kanë dhe më pak aktivizojnë agronomët e tjerë të rinj dhe kooperativistët me përvojë për të përfituar edhe këta prej studimeve të tyre.

SHOKU ENVER HOXHA: Kur ndodhi para tre vjetësh fatkeqësia atmosferike e breshërit në rrethin tuaj, që ju dëmtoi grurin, sa mbledhje bënë specialistët e grurit të institutit me kultivuesit e kësaj bime në kooperativa? A u ndoq kjo punë prej tyre dhe a bënë mbledhje për të përcaktuar masat që do të merreshin e për të nxjerrë detyrat se ç'duhej bërë?

Pra, ndodhi një fatkeqësi; u prishën të mbjellat sa u shqetësua tërë populli e udhëheqja. Prandaj edhe instituti duhej të ishte vënë menjëherë në lëvizje e duhej ta kishte kapur në kohë këtë çështje. Siç e shikoni pra, dhe siç e thatë edhe vetë, ju nuk po e përdorni si duhet institutin. Prandaj në të ardhmen duhet ta përdorni më mirë atë në dobi të prodhimit.

Më pas diskutimi u zhvillua për problemet e naftës. Duke bërë fjalë për metodat intensifikuese të nxjerrjes së naftës, shoku Enver Hoxha tha:

Komiteti Qendror dhe Byroja Politike kanë dëgjuar vite me radhë për këtë çështje dhe jo vetëm për këtë, po edhe për të gjitha proceset e tjera që kanë lidhje me naftën, si shpimi, evitimi i avarive e kështu me radhë.

Revolucioni tekniko-shkencor të jep mundësi që t'i perfeksionosh e t'i përsosësh gjithë metodat e punës, të ecësh përpara, pra, me një fjalë, do të thotë të bësh kthesë rrënjësore në tërë hallkat e prodhimit. Kurse neve na ndodh që na vijnë për çdo vit të njëjtat gjëra. Çështja shtrohet që të kuptohet mirë se ç'është revolucioni tekniko-shkencor, teorikisht, politikisht, teknikisht dhe shkencërisht. Nga pikëpamja shkencore duhet që specialistët tanë të naftës të përparojnë në të gjitha drejtimet, të thellohen në studime dhe pastaj t'i kombinojnë e t'i lidhin me teknikën, me praktikën. Kësaj praktike t'i gjejnë edhe mjetet e nevojshme. Këto mjete jo vetëm të funksionojnë si duhet, por të mendohet që edhe të perfeksionohen. Në fund të shihen rezultatet. Ja, ky është revolucioni tekniko-shkencor! Këto ne po i përsëritim vazhdimisht, por jo gjithmonë u shkohet punëve deri në fund nga ana teknike, ndaj këto gjëra t'i shikojmë më seriozisht, ndryshe puna nuk ecën si duhet.

Po sa gjëra të tjera ka që mund të jenë edhe më të rëndësishme se këto që po diskutojmë. Bile, ne duhet t'i mësojmë njerëzit tanë të teknikës dhe të praktikës që edhe kjo që sot quhet moderne, nesër nuk do të jetë më e tillë, sepse do të dalin mjete të tjera shumë më të perfeksionuara. Prandaj të përpiqemi që të bëjmë përmirësime në çdo gjë. Dhe, në fakt, ne kemi sektorë e qendra pune që i kanë përmirësuar makineritë dhe pajisjet. Por prapë na mbetet shumë për të bërë. Fjala vjen, përse të mos e përmirësojmë traktorin që kemi aktualisht në punë, për t'ia përshtatur atë kërkesave

tona? Unë mendoj se mund t'i bëjmë një përmirësim.

*SHOKU PILO PERISTERI*¹: Bëmë bashkimin e motorit të traktorit DT-54 me motorin e traktorit 75 kuaj-fuqi dhe na doli motori i unifikuar 75 kuaj-fuqi.

SHOKU ENVER HOXHA: Pra, edhe ky është një perfeksionim që çon përpara punën. Edhe përmirësimi më i vogël duhet të na tërheqë vëmendjen.

Përveç revolucionit tekniko-shkencor, ne duhet të kemi mirë parasysh edhe kooperimin, se ky është një problem i madh për ekonominë tonë. Ndërmarrjet dhe institucionet kanë në duar shumë mjete, makineri e pajisje. Prandaj në qoftë se nuk i futemi këtij problemi thellë dhe në mënyrë matematike, që të dimë kapacitetet, të dimë aftësinë e kësaj apo të asaj uzine, dhe, në bazë të planit të Qeverisë, të ndajmë punën e të japim urdhra, makineritë e pajisjet që kemi nuk do t'i shfrytëzojmë me kapacitet të plotë. Natyrisht, për këtë duhen bërë konsultime edhe me specialistët më të mirë. Në këto konsultime mund të ketë, sigurisht, edhe njerëz që do të kundërshtojnë, por me logjikë, pikëpamjet e tyre të gabuara duhen rrëzuar derisa ata të binden për domosdoshmërinë e këtij kooperimi. Jo vetëm kaq por atyre u duhen vënë edhe detyra që kjo ose ajo punë të bëhet dhe këto prodhime t'ia japësh ekonomisë në këtë kohë dhe jo më tutje. Kështu duhet të koordinohen punët dhe këtij problemi i duhet vënë rëndësi e madhe. Kjo është absolutisht e domosdoshme të bëhet. Në qoftë

1. Në atë kohë kandidat i Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe drejtor i kombinatit të autotraktorëve «Enver Hoxha».

se nuk bëhet kjo, atëherë është e kotë të presim realizimin e detyrave siç kemi parashikuar dhe ato do të mbeten të shkruara në kartë. Prandaj, kërkohet të bëhet një kooperim serioz, në mënyrë shkencore dhe të organizuar mirë, ndryshe nuk mund të ecet përpara. Këto probleme të naftës dhe të tjera si këto, mendoj se duhet të ishin vënë që më përpara në plan për t'u zgjidhur që të mos na zënë këmbët e të kemi kohë për t'u marrë me punët e tjera që do të na dalin më vonë. Pra, në qoftë se do të na zënë këto çështje, se kemi tridhjetë vjet që po nxjerrim naftë, atëherë nuk do t'i bëjmë dot të tjerat. S'mjafton që të ngarkohen njerëz për të kryer këtë apo atë punë, por ata edhe duhen kontrolluar.

Lidhur me këto që po diskutojmë, desha të shtoja se ka rëndësi të madhe se si e lidh Partia punën e saj politiko-organizativo-ideologjike me problemet shtetërore të planit. Këtu nuk e kam çështjen vetëm për ato që thuhet në mbledhjen e organizatës-bazë, por edhe jashtë saj. Domethënë, kur dilet nga mbledhja e organizatës-bazë duhen ngritur me forcë problemet që u diskutuan, jo vetëm në vija të trasha, por edhe duke i zbërthyer konkretisht.

Këtu u ngrit edhe çështja e fuqisë punëtore dhe e minierave. E kisha fjalën për Minierën e Valiasit. Dihet se atje ne kemi ndeshur në vështirësi, po këto vështirësi duhet të marrin fund dhe të mos na përsëriten më. Flas për vështirësitë teknike, poshtë në minierë. Duhet pasur parasysh se Miniera e Valiasit është një nga minierat më me rëndësi të vendit tonë. Veç

kësaj, e kemi mu te porta e hekurudhës, dhe, si e tillë, është miniera më rentabël dhe më e lirë. Atje tani kanë shqetësim çështjen e punëtorëve, të cilët mendoj se duhet të venë kryesisht nga qyteti i Tiranës dhe jo vetëm nga fshatrat. Për këtë, së pari, qëndron problemi i bindjes politike të njerëzve; së dyti, është puna e banesave. Mendoj se për ata që kanë shtëpi, të qëndrojnë në Tiranë e t'u krijohen mundësi të udhëtojnë me autobusë. Për të tjerët mund të ndërtojmë banesa. Nuk ka pse ta evitojmë ndërtimin e një qyteti të ri atje, por çështja është që të mos na ngjasë si në Memaliaj, ku qyteti është larg minierës.

Pra, në qoftë se e kemi zgjidhur problemin e transportit, për ata që banojnë në qytet, mbetet për t'u bërë me ta puna politike e Partisë, por një punë e shëndoshë, bindëse. Ata që do të venë në Minierën e Valiasit duhet të jenë të rinj, të cilët, në vend që t'i çojmë në fshat, i drejtojmë më mirë në minierë. Duke banuar në Tiranë, në shtëpitë e tyre, vështirësia, në këtë rast, më duket se mund të jetë më e paktë. Sidoqoftë pa punë politike kjo detyrë nuk realizohet.

Këtë çështje e lidh edhe me një studim që ju duhet ta keni parë të gjithë. Në gazetë kam kënduar shkrimin e dy gjeologëve tanë që kanë punuar për koksifikimin e qymyreve¹. Kjo çështje, më duket mua, duhet marrë me një seriozitet të jashtëzakonshëm nga ministria. Të organizohet studimi i këtij problemi nga laboratorit në vend, atje ku është qymyri ose ku mund të bëhet më

1. Shih: «Zëri i popullit», nr. 6 (9179), 7 janar 1978, f. 3.

mirë. Por, kjo kërkon edhe një organizim të shëndoshë që rezultatet t'i arrijmë sa më parë e pastaj t'i vihemi prodhimin gjysmindustrial derisa të realizojmë objektivin që kanë parashikuar ata, që ne të koksifikojmë 70 për qind të qymyreve tona. Në qoftë se do ta arrijmë këtë (dhe unë mendoj se duhet të përpiqemi që ta arrijmë), do të jetë një sukses i madh.

Ky duhet të jetë edhe një nga problemet kryesore të ministrisë. Pse e them këtë? E them sepse bëhen shumë shpikje dhe racionalizime nga njerëzit tanë të talentuar, por disa prej tyre mbeten pa u vënë në jetë e shumë të tjerë shtyhen për më vonë. Kjo shtytje nëpër ministritë ngjet nga burokratizmi, por ngjet edhe nga mungesa e iniciativës për sigurimin e disa fondeve, pse, sigurisht, për këto punë, duhen edhe fonde. Krijohet kështu një frymë justifikimi: «Unë s'kam fonde», mund të thotë ai tjetri. Ndodh që mjaftohet me kaq dhe nuk ia kërkon Qeverisë fondet që i duhen, pavarësisht se ne jemi të bindur që ajo do t'ia jepte menjëherë ato, se për këto punë i ka rezervat, se, siç thashë, është çështje me rëndësi të madhe kjo e koksifikimit të qymyreve tona. Pra, vështirësitë që dalin përpara duhen kapërcyer, qofshin ato të mëdha apo të vogla. Nuk duhet lejuar më që të na digjet qymyri nëpër pjaciale siç edhe ka ndodhur. Për Minierën e Valiasit, që e kemi gati brenda në Tiranë, ka e duhet të ketë kurdoherë fuqi punëtore e të mos na thuhet më se: «Nuk gjejmë dot njerëz që të vënë të punojnë atje».

Mos harroni se në realizimin e planeve ndikon edhe fakti se sa është zhvilluar revolucioni tekniko-

-shkencor, sepse ky vepron çdo ditë dhe çdo orë në mjetet e prodhimit, në perfeksionimin e tyre dhe në ngritjen e rendimentit.

*Botohet për herë të parë, sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TE ARDIURAT E KOOPERATIVISTËVE VAREN NGA VETË PUNA E TYRE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

26 janar 1978

Raportin që ka paraqitur komiteti i Partisë së rrethit e lexuam. Por, do të ishte mirë sikur të na thuhej këtu diçka me gojë, jashtë asaj që është shkruar, për ndonjë problem që ju shqetëson. Për shembull, për tokën desha të di një çikë më konkretisht se ç'po bëni. A ka shokë të tjerë specialistë kuadro të mesëm që të jenë thëlluar në pedologji? Ne kemi thënë që në qendër të çdo kooperative të bashkuar të ketë nga një bërthamë të tillë që të përpunojë të dhënat pedologjike duke përgatitur hartat për tokat e kooperativës e të tjera. Natyrisht, hartat nuk bëhen vit për vit për gjithë tokën, por për një pjesë të mirë të saj duhet të bëhen.

Përdorimi i këtyre hartave është i domosdoshëm, sepse duke u bazuar në to, do të dimë t'i japim tokës

1. Në këtë mbledhje u diskutua për disa probleme të metodës së punës të komiteteve të Partisë të rajoneve të Tiranës, për rritjen e rolit udhëheqës të organizatave-bazë të Partisë.

sasinë e duhur të plehut, do të bëjmë kanalizimet, do të bëjmë qilizmën, do të bëjmë punimin e thellë apo të cekët etj. A bëhen të gjitha këto me hartën në dorë apo jo? Për shembull, në kooperativën e Vaqarit, në qoftë se ju e dini se si është toka, gjendja e kullimit etj. atëherë, duke u bazuar në to, do të përcaktoni, fjala vjen, sa pleh duhet hedhur, se nuk mund të mbillet gruri pa bërë më parë këto apo ato shërbime; se shpenzimet për këto arrijnë kaq, se, mbas kësaj, për këtë tokë na mbetet akoma dhe kaq pleh; se mund t'i japim edhe kësaj tjetrës një sasi plehu për ta rregulluar, por edhe mund të mos i japim, e të tjera çështje të tilla. Pra, a bëhen të gjitha këto, a ndiqet kjo metodë e ky sistem, apo jo?

Këto nuk bëhen, u tha këtu, por të luftojmë që të ecim në këtë rrugë, se vetëm kështu do të kemi rezultate të mira në shfrytëzimin e tokave. Për këtë duhen jo vetëm mjetet, të cilat mund të mos i kemi akoma plotësisht, por edhe njerëzit. Prandaj shtroj pyetjen: A bëni ju herë pas here, në mënyrë të planifikuar dhe sidomos para se të fillojë viti bujqësor, kurse përgatitore me agronomët e me pedologët? Drejtuesit e këtyre kurseve duhet të jenë njerëz me përvojë të madhe, që të dinë të japin instruksione e t'i armatosin pjesëmarrësit e këtyre kurseve me njohuritë e domosdoshme për planifikimin e agroteknikën, pra, të jenë në gjendje të marrin pjesë edhe vetë në diskutime dhe jo vetëm të shkojnë e të dëgjojnë atje se ç'thuhet. Bile, jo vetëm të japin mendime, por të bëjnë edhe debat për çështjet që nuk shkojnë. Të gjitha këto punë duhet të fillojnë në mënyrë sistematike dhe të ecet frontalisht.

Kisha edhe disa probleme për blegtorinë. A u jepen lopë kooperativave dhe, nëse po, këto u jepen me kriter apo si të qëllojë? Mbahen parasysh orientimet që ka dhënë Partia në këtë drejtim? Për shembull, kur i jepet Zall-Herrit një lopë «Laramane» a i thuhet se sa litra qumësht duhet të marrë prej saj? Lopët «Laramane» kanë kapacitet prodhimi të madh, prandaj ato të shpërndahen atje ku mund t'u merret maksimalja e prodhimit dhe jo ku të mundet. Kooperativave që u jepen lopë «Laramane» u duhet thënë që të marrin të paktën tre mijë litra qumësht për krerë se populli do qumësht. Kjo duhet mbajtur kurdoherë parasysh dhe jo të shpërndajmë lopët pa kriter. Të mos harrojmë kurrë se lopa është «fabrikë».

Në zbatimin e orientimeve e të direktivave të Partisë, si në çdo sektor, edhe në blegtori, duhet të jemi kërkues, sepse kjo bëhet për interesin e popullit e jo për qejfin e një kooperative apo të një tjetre, që nuk kujdesen sa duhet për t'i vënë në jetë ato.

Kujdes kërkohet edhe për sigurimin e bazës ushqimore. Pse nuk merret sasia e mundshme e njësisve ushqimore për hektar? A bëhet kujdes në kultivimin e foragjereve dhe të bimëve të tjera që mbillen për ushqimin e bagëtive apo nuk punohet si duhet për rritjen e rendimentit të tyre, sepse ndërgjegjja e komunistëve nuk është akoma në lartësinë e duhur? U tha këtu se në Mëzez merren 80 kuintalë njësi ushqimore për hektar në një kohë që në disa kooperative të tjera mezi marrin 50 kuintalë, megjithëse tokat në to nuk janë më të këqija nga ato të Mëzezit. Atëherë, del pyetja: pse te njëra të merren 50 kuintalë njësi

ushqimore, ndërsa tek tjetra 80 kuintalë? Thuhet se ka konservatorizëm. Po pse nuk punohet për t'i thyer këto koncepte konservatore?! Kur Partia është e sigurt në drejtësinë e direktivës së saj, do të kërkojë me rigo-rozitet që kjo të zbatohet. Në qoftë se dikush nuk e zbaton, atëherë t'ia lërë vendin një tjetri, sepse thamë që Partia është e bindur që kjo masë duhet zbatuar se siguron rendimente të larta. Këtu nuk shtrohet çështja ta lësh në dëshirën e një njeriu këtë punë. Në qoftë se ky njeri është specialist dhe e di rëndësinë e kësaj bime, ai do të bëjë të gjitha përpjekjet dhe do t'i shfry-tëzojë të gjitha mundësitë për t'ia arritur qëllimit, kurse tjetri, edhe në rastet kur nuk bindet, duhet urdhëruar. Pra, duhen përdorur forma të ndryshme, edhe ajo e bindjes apo e edukimit, por kur është nevoja edhe e detyrimit.

U përmend këtu edhe çështja e bilanceve. Mendoj se këto duhet të bëhen që në fillim, qysh kur caktohet plani me hollësi atje në ndërmarrjen bujqësore, në kooperativë apo edhe në çdo sektor. Financieri i ka planet-bilance të vulosura; ai i kontrollon ato që të zbatohen si duhet, dhe, kur ndonjëri kërkon të veprojë në kundërshtim me atë që është vendosur, të ngrejë zërin me aq forcë, sa t'i tunden këmbët atij që sjell pengesa dhe të mos lejojë të veprohet ndryshe.

T'i marrim një çikë konkretisht këto. Kush jep urdhër që të shpërndahet plehu? Si bëhet kjo shpërndarje? Për shembull, dikujt i kanë caktuar këtë sasi plehu, tjetrit atë sasi, në kooperativë apo në fermë qofshin. Kush e bën këtë ndarje? Në qoftë se me këtë punë merren agronomi dhe zootekniku, po financieri, a merr

pjesë apo rri mënjanë? E ka ai këtë bilanc në regjistrat e tij? Duhet ta ketë me docmos, sepse, kur të vijë brigadieri nga kooperativa apo ndërmarrja bujqësore, për të kërkuar pleh, financieri, në qoftë se i ka mbajtur mirë evidencat, do të jetë në gjendje t'i thotë nëse e ka konsumuar apo jo sasinë e plehut që i takon dhe, në bazë të evidencës, do të veprojë. Domethënë, në qoftë se tjetri e ka harxhuar sasinë që i është caktuar në plan, ai nuk duhet të lejojë që t'i jepet tjetër pleh.

SHOKU RAMIZ ALIA: Nganjëherë ndodh që plehu shkon nga azotiku drejt e në arë.

SHOKU ENVER HOXHA: Prandaj duhet të përpiqemi të vendosim rregull në këto gjëra.

SHOKU HYSNI KAPO: Unë isha në kooperativën e Mavrovës¹. Pyeta pikërisht për plehun, se kush i jep urdhrat për shpërndarjen e tij, dhe më thanë se urdhrin e jep agronomi, i cili e shpërndan atë jo sipas planifikimit, por sipas kërkesave që i bëjnë. Nuk dinte gjë as punonjësi i financës, as ai i planit.

SHOKU ENVER HOXHA: Financieri ka përgjegjësi të madhe për prodhimin. Ai duhet të ketë parasysh, për shembull, që në fund të vitit, ky apo ai prodhim, do t'i kushtojë 100 lekë, fjala vjen, por, në qoftë se ka çrregullime, atëherë mund t'i kushtojë edhe 200 lekë. Po të ngjasë kështu, ai duhet të mbajë përgjegjësi për këtë, bile mund të vejë edhe në gjyq. Duke e vënë kështu para përgjegjësisë, financieri do të përpiqet të gjejë mënyrat se si të mos i tejkalojë shpenzimet e parashikuara. Në fillim do të kërkojë shkaqet përse

1. Të rrethit të Vlorës.

po shkelen rregullat, urdhrat etj. Pastaj, nuk do të lejojë të bëhen lëshime për asnjë edhe sikur t'i thotë vetë kryetari se dikujt i duhen akoma, fjala vjen, dhe 50-60 karroca me pleh. Financieri duhet të jetë në gjendje t'i thotë atij se cilat janë mundësitë për blerjen e plehut. Në qoftë se kërkon më shumë, atëherë ai edhe mund t'ia japë, po të ketë, por me kusht që të ngrihet rendimenti i grurit dhe të ardhurat të jenë më të mëdha. Në rast të kundërt, të mos i japë asnjë gram, sepse realizim plani duhet jo vetëm në asortimente e në global, por në të gjithë zërat e treguesit. Natyrisht, këto ne mund t'i themi fare mirë me gojë, por, në jetë, unë e kuptoj se sa vështirësi ka në këtë drejtim.

Për sa i përket çështjes së shkollave të mesme, që u ngrit këtu, dua të sqarohen disa gjëra. Shkollat e mesme me shkëputje dhe pa shkëputje nga puna, kanë programet e tyre, sipas të cilave nxënësi duhet të marrë jo vetëm një kulturë të përgjithshme, por edhe diçka tjetër për bujqësinë e rrethit. E kam fjalën këtu që në këto programe të synojmë për specializime të veçanta në disa bimë të domosdoshme e të nevojshme. Për shembull, Tirana është keq për perime. Në këtë rast a nuk është e nevojshme që në programet e shkollave të këtij rrethi, përveç njohurive të përgjithshme të bujqësisë, të përfshihen tema rreth kultivimit dhe rëndësisë së perimeve, duke parashikuar edhe orët e nevojshme për zbërthimin e këtyre temave? Kam mendimin se kultivimi i perimeve është një problem i rëndësishëm, që duhet trajtuar jo vetëm nga ana agroteknike, se si rriten, kur mbillen, kur nuk mbillen lakra, spinaqi, pazia, preshi, hudhra etj., por edhe nga vlerat

ushqyese e dobinë e madhe që kanë për organizmin e njerëzve dhe për përmirësimin e strukturës së ushqimit etj. Në këtë mënyrë ne nxjerrim nga këto shkolla specialistë të profilizuar sipas nevojave të rrethëve. Kjo mund të bëhet edhe për ullirin, kultivimi, rritja dhe prodhimi i të cilit është një problem shkencor; po kështu për blegtorinë etj. Mendimin e kam këtu: në këto shkolla të mos jepet vetëm një kulturë e përgjithshme, por të zhvillohen edhe mësimet të specializuara, sepse në fshatra duhet të kemi sa më shumë specialistë të mesëm. Pa shikojeni një çikë me kujdes këtë çështje e i kushtoni asaj vëmendjen e duhur, sepse ka rëndësi të madhe.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Unë kam pyetur për këtë dhe shokët e Ministrisë së Arsimit e të Kulturës. Ata thonë se në shkollat bujqësore programi është unik në të gjithë Shqipërinë. Unë mendoj se ka mundësi që brenda programit të gjendet vend për lëndë të profilizuara, po këtë ministria nuk e ka bërë.

SHOKU ENVER HOXHA: A ndihet puna e organizatave të rinisë në fshatra në drejtim të ngritjes së nivelit politik e ideologjik të punonjësve, të shfrytëzimit të kohës së lirë pas pune, të edukimit shkencor, letrar të tyre etj.? Sigurisht, në fshat ka akoma edhe konservatorizëm e qëndrime jo të drejta, sidomos ndaj vajzave. Por, nuk mund të krahasohet kurrë gjendja e tyre tani me atë që ka qenë më parë. Mbase nuk jam shumë i saktë, por nga kronikat që jepen në televizion, nëpër ara shikoj të punojnë më shumë gra. Po burrat ku gjenden? Ku futen ata? Ka prej tyre që janë në blegtori ose në punë të vështira, por ka edhe disa që

zënë qoshe të ngrohta, duke u marrë me ndonjë gjë të lehtë e hiqen sikur gjoja bëjnë punë të rënda. Kur po shikoja matjanet dhe dibranet, më duket se po punonin me bel, u përpoqa të gjeja një burrë midis tyre, por nuk gjeta. Kurse, njëherë kur ndoqa një kronikë nga Gjirokastra, pashë që kishte edhe burra që punonin tok me gratë. Sidoqoftë, në përgjithësi më shumë shikoj gra. Unë nuk them që gratë të mos punojnë, por e kam hallin se mos ka edhe burra që, nën pretekstin e punëve të tjera, u bëjnë bisht punëve në arë. Partia të luftojë në këtë drejtim, por të luftojnë edhe vetë gratë.

Përveç këtyre problemeve, organizata e Partisë në Tiranë ka një fushë të gjerë veprimi edhe për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit tekniko-shkencor e të kooperimit. Nga diskutimet që u bënë këtu, përforcova bindjen që e kam pasë formuar edhe më parë se në këto fronte të rëndësishme disa gjëra nuk bëhen në mënyrë të organizuar. Mirëpo kjo sjell vështirësi në zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor dhe të ekonomisë socialiste në përgjithësi. Në qoftë se vihet rregull, fjala vjen, që tamburet, për të cilat u diskutua sot, i bën më të lira një uzinë këtu, në Tiranë, atëherë përse t'i bëjë Vlora? Kjo ndodh për arsye se këtu askush nuk preokupohet të mendojë se ç'duhet t'i ngarkojmë Vlorës të bëjë. Të mos zgjatëm në këtë, se kurdoherë flasim për stilin e metodën e punës, të drejtimit e të disiplinës, po rëndësi ka që këto t'i vëmë në vend, se konstatoj që njerëzit vërtet punojnë dhe japin mendime të vlefshme për shumë gjëra, por edhe rutina vazhdon të bëjë punën e vet dhe të na frenojë.

Prandaj, mendoj që shokët sekretarë, të organi-

zojnë disa mbledhje tani që po fillon edhe puna për realizimin e planit. Nuk e kam hallin që ta ndryshojmë këtë plan që kemi vendosur, por të bëjmë në të korrigjimet e nevojshme. Unë nuk them të mos i prodhojmë këta apo ata artikuj, por t'i prodhojmë atje ku janë mundësitë për t'i bërë sa më të mirë dhe më të lirë. Kështu duhet kuptuar bashkëpunimi dhe kooperimi që e kemi shtruar vazhdimisht, prandaj ta forcojmë më shumë punën në këtë drejtim. Jo se nuk ekziston fare ky bashkëpunim, por ne synojmë të ecim gjithmonë përpara më mirë dhe më shpejt; të jemi kurdoherë të sigurt jo vetëm në këto situata politike që po kalojmë, por dhe sikur ato të bëhen më të vështira.

*Botohet për herë të parë, sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**PIKËPAMJET TONA JANË PIKËPAMJE
SHKENCORE, TË BAZUARA NË
MARKSIZËM-LENINIZMIN**

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

26 janar 1978

SHOKU ENVER HOXHA: Tani fillojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

Shoku Aleks [Buda], nuk ju pashë kur hytë. Si jeni? Me punët si shkoni? Mos jeni shumë të ngarkuar?

SHOKU ALEKS BUDA: Puna na mban gjithmonë të rinj, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: E them këtë sepse ju tani keni për të përgatitur edhe konferencën për 100-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, për të cilën na keni paraqitur edhe programin.

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe relacioni: «Për përgatitjen e botimit të dytë të tekstit të «Historisë së PPSH» dhe për organizimin e një sesiioni shkencor mbi disa probleme të zhvillimit të sotëm botëror» si dhe platforma ideoshkencore e konferencës kombëtare kushtuar ndërtimit socialist në fushën ekonomiko-shoqërore.

Nuk e di, të kanë ndihmuar shokët për çështjen që të kam thënë?¹

SHOKU ALEKS BUDA: Kam filluar, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: E di që ti je gati të ve-prosh. Unë kam dhënë porosi që shokët të të ndihmojnë, në mënyrë që të lehtësohesh sa më shumë nga punët e tjera. Nuk e di, janë marrë apo s'janë marrë fare me këtë problem ata që duhet të merreshin?

SHOKU RAMIZ ALIA: Janë marrë të gjitha masat për ta lehtësuar, shoku Enver.

SHOKU ALEKS BUDA: Asgjë nuk më shqetëson, shoku Enver, vetëm se duhet të arrij edhe unë që t'i plotësoj ato.

SHOKU ENVER HOXHA: E di unë që ti, Aleks, gjithmonë je i gatshëm, por je dhe modest. Dituria jote i duhet Partisë dhe popullit.

Lidhur me ribotimin e tekstit të «Historisë së Partisë», në përgjithësi, ne jemi dakord, prandaj duhet të fillojë puna për ta realizuar këtë ripunim. Ashtu siç thuhet edhe në relacion, në ribotim duhet të ruhet po ai stil dhe po ajo metodë e botimit të parë. Për ndryshimet që flitet këtu, le të bëhen, por jo një përmbysje e tekstit. Çdo gjë duhet parë me kujdes, sepse mund të ketë vërejtje edhe për gjëra të vogla, pra, të mos mendojmë sikur çdo gjë duhet të shpjegohet një çikë më mirë, sikur kjo të bëhet kështu, kjo tjetra të zgje-

1. Shoku Enver e kishte porositur shokun Aleks Buda që të grumbullojë rreth vetes disa kuadro të rinj dhe t'i aktivizojë ata me qëllim që ta ndihmojnë në punë e të përgatiten edhe vetë, duke përfitur nga përvoja e tij.

rohet ashtu etj. Por, po të fillojmë t'u hyjmë këtyre punëve, pastaj duhet të bëhen vëllime të tëra. Kjo është një vepër shkencore e sintetizuar. Mbi të punohet, bëhen zgjerime, referenca, sepse është jeta e Partisë. Nuk e di në qoftë se shokët kanë ndonjë gjë tjetër? Natyrisht, kjo pasi të jetë ripunuar do të na paraqitet për ta parë.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Pjesa e materialit që do t'i shtohet tekstit të «Historisë së Partisë» do t'i jepet për studim, vërejtje e diskutim një rrethi të gjerë kuadrosh të Partisë, historianësh e specialistësh të tjerë.

Çështja e dytë është sesioni shkencor me temë: «Problemet e zhvillimit të sotëm ndërkombëtar».

SHOKU ENVER HOXHA: Jemi dakord që të bëhet edhe ky sesion. Doja të thosha vetëm që këto sesione shkencore duhet të përgatiten mirë dhe të përcaktohet saktë problematika e tyre në mënyrë të tillë, që të mos ketë përplasje me ato që janë bërë deri më sot. Të bëhen përpjekje që të zërthehen më tej e të argumentohen më gjerë e më thellë tezat bazë të Kongresit të 7-të të Partisë.

Për sa u përket pjesëmarrësve, mendoj se mund të ftojme shokë të partive marksiste-leniniste, siç propozohet. Besoj se edhe shoku Aleks është dakord për këtë gjë, sepse për festimin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit edhe ai na ka propozuar një gjë të tillë. Mendoj se në veprimtari si kjo ne jemi në një mendim me Akademinë e Shkencave, sepse edhe problemet që do të trajtohen nga ana e saj, kanë karakter teorik-shkencor.

Edhe në formën që propozoi Nexhmija mund të veprojmë, domethënë, t'u sugjerojmë atyre që jo vetëm të marrin pjesë, por edhe të referojnë në këtë sesion shkencor. Kjo ka edhe një anë tjetër të mirë, se u japim atyre të kuptojnë që ne dhe ata jemi të barabartë. Ne do të themi me këtë rast mendimet tona dhe ata të tyre. Mund të jenë dakord me pikëpamjet e vlerësimet tona, por mund t'i shtrojnë edhe ndryshe problemet. Edhe sugjerime mund të na bëjnë, në qoftë se do të kenë. Prandaj, them se është më mirë që t'u sugjerojmë atyre të përgatiten për të referuar në sesionin shkencor që do t'i ftojme.

SHOKU RAMIZ ALIA: Ata mund të sjellin kontributin e tyre në këtë sesion shkencor. Për shembull, të marrim çështjen e krizës në vendet kapitaliste. Askush nuk mund të flasë më mirë se ata vetë për vendet e tyre; po kështu edhe për zhvillimin e lëvizjes revolucionare në kohën e sotme, për shembull në Amerikën Latine. Kush mund të flasë më mirë se sa vetë shokët e Partisë Komuniste të Brazilit, apo të ndonjë vendi tjetër?

SHOKU ENVER HOXHA: Ne nuk duhet të nisemi as nga ato se ç'mund të thonë revizionistët, sikur po krijojmë këtu qendrën e Kominternit e të tjera si këto. Në qoftë se Kina nuk do që të bëhen mbledhje të tilla, ku të shkëmbehet eksperiencia, neve aq na bën. Ne do ta bëjmë punën tonë. Ne nuk bëjmë mbledhje organizative për të krijuar qendra, për të dhënë udhëzime e direktiva si në kohën e Kominternit. Jo, në asnjë mënyrë, megjithëse të tjerët mund t'i quajnë të tilla mbledhjet tona.

Gjithashtu edhe për konferencën shkencore që do të bëhet me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit¹, që po përgatitin shokët e Akademisë, me shokun Aleks në krye, ne jemi të mendimit të dërgojmë ftesa, siç propozohet këtu, në mënyrë që pjesëmarrësit nga vendet e tjera të njihen me mendimin shkencor të shqiptarëve për problemet e mëdha ndërkombëtare, evropiane e ballkanike. Le ta dëgjojnë mirë fjalën tonë shkencore, sepse akoma na rrjedh kurrizi gjak. Ka shkencëtarë të huaj, që, megjithëse këto gjëra i dinë mirë, heshtin ose thonë ndonjë fjalë në të kaluar.

Sigurisht, ata që do të vijnë këtu, presupozohet se do të jenë dashamirë ndaj nesh dhe shkencëtarë objektivë që do t'i gjejnë drejt pikëpamjet tona, sepse janë pikëpamje shkencore të bazuara në marksizëm-leninizmin.

Prandaj, është mirë që këto aktivitete shkencore të bëhen në këtë frymë, siç kanë filluar.

Mirë, atëherë, jemi dakord me propozimin që kanë bërë për këtë problem shokët e Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste².

Tani të diskutojmë për platformën ideoshkencore që ka paraqitur Akademia e Shkencave për konferencën kombëtare kushtuar problemeve të ndërtimit socialist të vendit.

Ne, shoku Aleks, kemi nevojë të na sqaroni për këtë

1. Konferenca shkencore me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit i zhvilloi punimet më 12-15 qershor 1978, në Tiranë.

2. Sesioni shkencor, me temën: «Probleme të zhvillimit të sotëm botëror» u mbajt në Tiranë, nga data 2-4 tetor 1978.

konferencë kaq të rëndësishme që po përgatitni, natyrisht jo në detaje, sepse nuk duam të të lodhim. Në përgjithësi ne jemi dakord për këtë, por, duke përfituar nga rasti që ju kemi këtu, dëshirojmë t'ju dëgjojmë.

Pasi shoku Aleks Buda foli për përgatitjet e bëra nga Akademia e Shkencave për këtë konferencë shkencore, për problemet që do të trajtoheshin në të etj., shoku Enver Hoxha tha:

Jam dakord që konferenca kombëtare kushtuar ndërtimit socialist në fushën ekonomiko-shoqërore të bëhet¹. Në përgjithësi jam gjithashtu dakord edhe me platformën ideoshkencore të kësajkonference, por do-ja të shtoja edhe disa gjëra.

Aktualisht, përballë lëvizjes komuniste revolucionare ndërkombëtare janë ngritur rryma revizioniste, antimarksiste, të ndryshme. Tani u shtua edhe revizionizmi kinez. Këto rryma nuk kanë për qëllim të nxitin revolucionin dhe të ndërtojnë socializmin, por përpiqen të mbajnë gjallë frymën e kapitalizmit që është në kalbëzim e sipër, duke kaluar në një proces reformist. Njëkohësisht ata përpiqen të godasin ndërtimin e socializmit, duke luftuar bazat e marksizëm-leninizmit. Me fjalë të tjera, ata synojnë të flakin tej teorinë marksiste-leniniste për shtetin, për revolucionin, për ndërtimin e socializmit e për probleme të tjera, për të cilat do të flitet pikërisht në këtë konferencë e që janë apanazhi, vepra e Partisë dhe e ideologjisë së saj.

Sot, filozofët borgjezë dhe, tok me ta, edhe filozofët.

1. Konferenca kombëtare për problemet e ndërtimit socialist u mbajt në Tiranë nga data 22-23 nëntor 1979.

revizionistë, i janë përveshur punës për shpikjen e shumë teorive antimarksiste, duke maskuar fytyrën e tyre të vërtetë. Për shembull, revizionistët sovjetikë aktualisht janë krejtësisht në rrugën kapitaliste, megjithëse përpiqen të maskohen me frazeologji leniniste. Kinezët gjithashtu janë në rrugën antimarksiste; pretendojnë se ndërtojnë socializmin, por në fakt, nuk e ndërtojnë atë; hiqen se janë marksistë-leninistë, por në të vërtetë nuk janë të tillë. Revizionistët italianë kanë rrugën e tyre kundër marksizëm-leninizmit, francezët dhe spanjollët po ashtu. Do të dalin me siguri edhe variante të tjera të teorive pseudomarksiste-leniniste, të cilat do të kenë për qëllim të mashtrojnë njerëzit, për arsye se sot socializmi dhe revolucioni janë vënë në rendin e ditës.

Me këtë hyrje që bëra, dua të them se midis revolucionit tonë socialist dhe Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, nga i cili ne mësuam dhe mësojmë, ka jo vetëm analogji në vija të përgjithshme, domethënë në parime, por ka analogji edhe në zbatimin në praktikë. Shteti ynë i diktaturës së proletariatit, siç e ka shtruar dhe e ka shpjeguar Partia, ka filluar t'i kryejë funksionet menjëherë pas Çlirimit të vendit. Kjo pasqyrohet edhe në reformat që janë bërë pas Çlirimit dhe që u janë adaptuar kushteve të vendit tonë.

Revolucioni i Madh Socialist i Tetorit, i udhëhequr nga Lenini e Stalini, të mbështetur në teorinë e Marksit, është i njohur në të gjithë botën, edhe për të flasin të tërë. Kurse revolucionin tonë njerëzit jashtë relativisht nuk e njohin sa duhet. Shumica dërrmuese e njerëzve në botë, e dinë që ekziston një Shqipëri socialiste, që

qëndron e patundur dhe që ka një vijë të sajën, të mbështetur në marksizëm-leninizmin. Ka ndër ata që habiten dhe thonë: «Ç'është kështu, pse ngjet kjo, si qëndron kjo Shqipëri?». Ata që mendojnë në këtë mënyrë, natyrisht, gjejnë disa arsye për të shpjeguar qëndrimin tonë, si burrërinë, krenarinë e shqiptarëve etj. Por ata nuk dinë se si kaluam ne në revolucionin proletar, nuk njohin mirë zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe veçanërisht etapat e revolucionit tonë. Me pikëpamjet e tyre, ndodh që ata e lënë në heshtje Shqipërinë, se nuk u del për mbarë krahasimi i revolucionit tonë me revolucionet e tjera. Pra, ka raste që ata nuk flasin për këtë pikë kardinale të historisë sonë.

Historianë, filozofë e dijetarë të fushave të tjera të mendimit, i kanë analizuar, sipas botëkuptimeve që kanë, etapat e kalimit nga feudalizmi në kapitalizëm dhe kanë përcaktuar afërsisht edhe karakterin e këtyre kapërcimeve. Ashtu siç ka kaluar Franca nga feudalizmi përmes revolucionit demokratiko-borgjez, në kapitalizëm, ka kaluar edhe Anglia përmes revolucionit që bëri. Megjithatë, ky kalim nuk qe i njëjlojtë për të dyja, sepse revolucioni francez ishte më radikal. Gjermania, pas shkatërrimit të mbretërive të shumta, në kohën e Bismarkut, që bëri unifikimin nën drejtimin e mbretërisë prusiane, ka kaluar edhe ajo nga feudalizmi në kapitalizëm. Revolucioni francez u zhvillua nga baza lart. Kurse kalimi në kapitalizëm nga këta të tjerët erdhi si rezultat i aleancës së feudalëve junkerë gjermanë apo samurajve japonezë me borgjezinë e madhe të atyre vendeve. Po të marrim risorxhimenton në Itali, kjo nuk kaloi përmes një revolucioni

demokratiko-borgjez siç kaloi Franca, për arsye se, siç e dimë, kyçi i një revolucioni të tillë është çështja agrare. Në Itali, po të lexojmë Antonio Gramshin, do të mësojmë se i gjithë Jugu i këtij vendi mbeti përsëri nën sundimin feudal ose gjysmëfeudal.

Unë mendoj se ne, duke reflektuar për këto gjëra, duhet të bëjmë disa krahasime shkencore e të vëmë në dukje dhe t'i themi botës shkencore, historianëve, sociologëve e filozofëve që të mos ëndërrojnë e të bëjnë pyetje se pse e si u zhvillua e po zhvillohet revolucioni në Shqipëri. Le ta mësojnë të gjithë se tërë kjo ndodhi për arsye se nga Partia u shfrytëzua situata e krijuar te ne, duke ndjekur me besnikëri teorinë e Marksit, u ndoq rruga nëpër të cilën do të kalojnë absolutisht edhe të tjerët, duke shkatërruar imperia-lizmin. Në këtë mënyrë, duke bërë një studim të tillë, ne do të përcaktojmë se revolucion socialist është ai që ndjek shembullin e Revolucionit të Madh të Tetorit, mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Edhe shembulli ynë, pra, këtë tregon. Kështu ne rrëzojmë edhe të gjitha përpjekjet e teoricienëve borgjezë e revizionistë për ndërtimin e një shoqërie gjoja të re «moderne», hibride; vërtetohet ajo që na ka mësuar mark-sizëm-leninizmi, dhe që e ka thënë vazhdimisht Partia jonë, se sistemi shoqëror borgjez ishte më përparimtar e më modern në krahasim me atë feudal, kurse sistemi ynë shoqëror socialist është më përparimtari e më modern nga modernët. Bile, tani, sistemi shoqëror kapitalist është reaksionar dhe këta «miqtë», revizionistët e rinj kinezë, me «socializmin e tyre specifik» qëndrojnë gjithashtu në pozita reaksionare.

Si mendoni ju, shokë, a ka mundësi të bëhet kështu apo jo? Të më kuptoni, këtu nuk e kam fjalën të paraqitet teoria e kalimit nga feudalizmi në kapitalizëm. Çështja është të demaskojmë ata që pretendojnë se nga kapitalizmi mund të kalohet në socializëm me forma dhe metoda të ndryshme, pa revolucion, qoftë edhe nga ato shtete që s'kanë ardhur akoma në stadin kapitalist të demokracisë borgjeze. Ka vende në Afrikë e gjetkë, që kanë bërë luftën nacionalçlirimtare, por reformën agrare, likuidimin e bejlerëve, të agallarëve dhe të feudalëve nuk e kanë kryer ndonëse kjo është gjëja e parë që duhej të bënin. Pra, rrëzimi i feudalizmit në këto vende është bërë, por reforma agrare nuk është zbatuar. Kjo jo vetëm duhej të kryhej por edhe të kalohej sa më shpejt e në forma sa më radikale në rrugën e industrializimit. Këto shtete s'e bënë dot këtë. Përse? Ne e dimë përse, se nuk u udhëhoqën nga ideologjia marksiste-leniniste e nga një parti e proletariaetit. Prej luftës nacionalçlirimtare u arrit çlirimi nga okupatorët e huaj, por atje nuk u vendos diktatura e proletariaetit.

Kurse në vendin tonë, ashtu si edhe në Rusi pas Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, ndodhi ndryshe.

Prandaj çështja është që t'i rrëzojmë të tilla teori dhe të bëjmë të njohur revolucionin tonë, fazat nëpër të cilat kaloi ky revolucion e pushteti që doli prej tij, dhe arsyet pse u bë i tillë dhe pse është i fortë. Të shpjegojmë shkaqet e kalbëzimit të shteteve borgjezo-kapitaliste dhe pamundësinë e kalimit në socializëm me anën e rrugës parlamentare. As vija «speciale»

franceze e Zhorzh Marshesë nuk mund të çojë në socializëm. Po ashtu edhe Anglia nuk mund të shkojë në socializëm me një parti laburiste, ku sundojnë lordët e trusteve, administratorët e lendlordëve të kapitalizmit dhe të imperializmit anglez.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Ne duhet të afirmojmë, në bazë të të gjitha këtyre të dhënave, vërtetësinë e përcaktimit të Leninit mbi epokën tonë si epoka e revolucionit proletar. Prandaj të ngresh në ditët tona çështjen se tani është epoka e revolucioneve demokratiko-borgjeze, siç bëjnë kinezët, kjo është reaksionare. Revolucioni demokratiko-borgjez, në vetvete, nuk është reaksionar, duke e marrë në kohë e në vende të caktuara. Por, ama, duhet luftuar për t'u hapur perspektiva revolucioneve proletare dhe të mos mbelesh brenda kornizave të revolucionit demokratiko-borgjez.

SHOKU ALEKS BUDA: Më duket se përcaktimi që bëtë ju, shoku Enver, është me rëndësi shumë të madhe, sepse kështu konferencës i jepet më qartë edhe ai synim. Në qoftë se ne do t'i mbaheshim programit që kemi hartuar, konferencës do t'i mungonte pikërisht ky drejtim.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju mendojeni vetë mirë këtë çështje dhe reflektoni. Unë jua thashë që ta keni si orientim.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verball i mbledhjes së Sekre-
tarlatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

PARTIA E PUNËS E SHQIPËRISË U FORMUA NË RRETHANA TË NDRYSHME NGA PARTI TË TJERA KOMUNISTE

Shënime

26 janar 1978

Në gjithë punën për brumosjen dhe për revolucionarizimin e pandërprerë të Partisë sonë ne kemi pasur parasysh eksperiencën pozitive e negative të partive të tjera, në mënyrë të veçantë eksperiencën e Partisë Bolshevike të Bashkimit Sovjetik.

Partisë Bolshevike të Leninit, për shembull, i duhej të luftonte kundër rrymave të mëdha të socialdemokracisë, kundër partive të ndryshme të asaj kohe të krijuara brenda dhe jashtë Rusisë. Ne e kemi studiuar dhe e njohim eksperiencën e partisë së Leninit, luftën e tij kundër të gjitha tendencave antirevolucionare, antimarksiste. Ne e kemi studiuar dhe jemi udhëhequr nga ajo luftë që bëri Lenini për formimin dhe për kalitjen e Partisë Bolshevike kundër rrymave dhe fraksioneve të ndryshme brenda në parti dhe jashtë saj. Lufta e Leninit u materializua me fitoren e Partisë Bolshevike kundër perandorisë cariste dhe kundër presionit të jashtëm të imperialistëve që kërkonin ta mbyt-

nin që në vezë bolshevizmin dhe shtetin e parë të proletarëve.

Me vëmendje ne kemi studiuar e po studiojmë, gjithashtu, edhe veprën e madhe të Stalinit, për të ditur se si ai me Partinë Bolshevike luftuan kundër fraksioneve të ndryshme të rrezikshme.

Ne po mësojmë edhe për shkaqet që, për fat të keq, sollën ardhjen në fuqi të revizionizmit në Bashkimin Sovjetik dhe për eksperiencën e hidhur të Partisë Bolshevike për këtë problem.

Në shënime të mëparshme unë kam shkruar edhe për parti të tjera komuniste, duke treguar se si u krijuan ato nga bashkimi i partive komuniste me partitë socialiste, socialdemokrate etj. Kështu kam folur për Partinë e Bashkuar Punëtore të Polonisë, për Partinë Socialiste Punëtore të Hungarisë, për Partinë Komuniste të Çekosllovakisë dhe atë të Rumanisë, ku ka pasë ekzistuar edhe «Garda e hekurt» e Antoneskut.

Jam përpjekur të shpjegoj edhe se si ky fuzion i këtyre partive në këto vende nuk solli atë kalitje të partisë, siç na mësojnë Lenini dhe Stalini. Përkundrazi, këto parti të shartuara, patën një jetë të shkurtër dhe, me ardhjen e revizionistëve sovjetikë në fuqi, morën rrugën e tradhtisë së marksizëm-leninizmit, të devijimit nga kjo teori.

Ndryshe nga të tjerat, Partia jonë Komuniste, që më vonë e quajtëm Partia e Punës, u formua në rrethana të tjera, në rrethanat e Luftës Nacionalçlirimtare. Ajo u formua në një terren të virgjër, ku nuk ekzistonte parti të tjera të borgjezisë ose të fshatarësisë. Partia jonë u formua duke pasur në themel të saj ideologjinë

marksiste-leniniste. Ajo u hodh në luftë si një parti e re, e vogël, por e vendosur për çlirimin e vendit nga pushtuesit fashistë dhe për krijimin e një shteti të demokracisë popullore.

Normat që u vendosën dhe që u zbatuan me rigozitet të madh ishin norma leniniste. Ne ecëm në shembullin e Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit, ndoqëm rrugën e saj, dhe kështu i ngjitëm shkallët e vështira të luftës. Që në fillim iu vumë punës për krijimin e organizatës së Frontit, së cilës nuk i dhamë formën e një partie, por të një organizate të gjerë politike ku të merrnin pjesë të gjithë antifashistët, me të cilët u punua që të brumoseshin me ideologjinë e Partisë sonë, me ideologjinë marksiste-leniniste, me ideologjinë revolucionare çlirimtare.

Cjatë luftës u krijua edhe organizata e Ballit Kombëtar, që përfaqësonte llumin e Shqipërisë, shtresën e bejlerëve, të borgjezisë tregtare, të tradhtarëve dhe të kuislingëve. Në të bënë pjesë ata elementë që edhe mund të kishin formuar ndonjë parti të borgjezisë më përpara, por regjimi i Zogut dhe më vonë pushtimi fashist nuk i lejuan.

Partia jonë e përhapi vijën e saj në masat nëpërmjet organizatës së Frontit Nacionalçlirimtar. Masat luftarake të popullit tonë e ndienin veten në Front, si në organizatën e vërtetë të tyre, ato shikonin të pasqyruara te programi i Partisë dhe te vija e Frontit dëshirat dhe aspiratat e tyre.

Që në fillim, pas Çlirimit, Partisë sonë i doli përpara rreziku i madh i revizionizmit jugosllav, i egër dhe kërcënues, i cili filloi ta sabotonte vijën e drejtë mar-

ksiste-leniniste të Partisë sonë, punonte që, nëpërmjet një agjenture me Koçi Xoxen në krye, ta likuidonte Partinë dhe kështu ta bashkonte Shqipërinë me Jugosllavinë. Ky ishte një rrezik shumë, shumë serioz, por Partia e kapërceu me sukses.

Partia jonë luftoi kundër një numri deviatorësh, që ishin agjentë të revizionistëve jugosllavë, agjentë të kuislingëve dhe, siç doli më vonë, ishin edhe agjentë të revizionistëve sovjetikë. Bazat e tyre në Parti ishin të dobëta, kështu që Partia jonë, e krijuar dhe e kalitur në luftëra, me ideologjinë e saj të qartë marksiste-leniniste, i likuidoi këta elementë ose këto grupe dhe vazhdoi, siç e dimë, punën e saj për ndërtimin e socializmit. Në asnjë moment Partia jonë nuk e dobësoi luftën e klasave. Kjo luftë u zhvillua me një pjekuri të madhe në të gjithë sektorët e veprimtarisë sonë, duke dënuar fajtorët, duke demaskuar armiqtë e fshehtë, duke sqaruar të gabuarit dhe duke kapërcyer pengesat njëra pas tjetrës. Kështu e ndërtuam në bazën ekonomike socialiste, industrinë, bujqësinë dhe kulturën socialiste.

Nga sa thashë del qartë se formimi, zhvillimi, konsolidimi dhe kalitja e Partisë sonë ndryshojnë kryekëput nga procesi i formimit të partive ish-komuniste në Lindje, ose në Perëndim, që tash janë shndërruar në parti revizioniste.

Forca dhe uniteti i Partisë sonë duhet të ruhen dhe të rriten vazhdimisht. Forcimi dhe kalitja e Partisë, e vijës sonë në etapat e zhvillimit të shoqërisë socialiste, duhet të bëhen kurdoherë në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit dhe duke interpretuar drejt këtë shke-

ncë universale të proletariatit. Asnjëherë teoria jonë të mos bjerë në kundërshtim me situatat që mund të krijohen, por të jenë pikërisht kjo teori dhe kjo vijë e Partisë sonë që të parashikojnë e të ndihmojnë për të krijuar situatat progresive në vend. Për këtë arsye duhet që vija e Partisë sonë të qëndrojë absolutisht kurdoherë e pastër, Partia të jetë gjithmonë e vendosur, e zgjuar, vigjilente, e dashur me popullin, t'u prijë masave dhe të japë shembullin në punë e në sakrifica.

Komunistët duhet të jenë në pararojë, të parët në sakrifica e të fundit në pretendime. Një parullë e tillë ka kuptim të madh dhe të thellë. Të gjithë e përmendin këtë parullë, por ka nga ata që nuk e kuptojnë sa duhet dhe si duhet. Të jesh komunist nuk mjafton me pasë tesarën e Partisë në gji; rëndësi ka ta meritosh këtë titull të lartë me një luftë të gjallë revolucionare kudo ku punon dhe jeton. Them kështu sepse kam parasysh që komunisti duhet të mendojë gjatë punës që kryen, por duhet të mendojë edhe jashtë punës. Komunisti ka një mision të madh udhëheqës në shoqëri, mbi supet e tij rëndon një barrë e madhe. Ai kurrë nuk duhet të përkulet nga kjo barrë, por gjithmonë të mendojë thellë për të e t'i përvishet punës me vrull për ta kryer me nder. Komunisti duhet të marrë pjesë aktive në të gjitha punët e shoqërisë sonë socialiste, që udhëheq Partia e tij e Punës.

Duke pasur një Parti të fortë, pavarësisht se vendi ynë është i rrethuar nga një oqean armiqsh kapitalistë dhe revizionistë, prapë ajo është në gjendje t'u rezistojë sulmeve të jashtme, t'i rezistojë presionit të jashtëm, të ruajë kurdoherë brenda një situatë të shëndo-

shë, të krijojë e të kalitë një patriotizëm të madh revolucionar, të krijojë kushte për një jetë të bollshme ekonomike dhe të kulturuar në vendin tonë.

Të gjitha këto do të realizohen sepse të tillë e kemi ne Partinë. Ne kurdoherë i kemi ruajtur e i kemi mbrojtur Partinë dhe marksizëm-leninizmin nga armiqtë. Por megjithëkëtë nuk duhet të harrojmë se armiqtë janë rreth nesh për të na dëmtuar, prandaj kurrë të mos e flemë mendjen, kurrë të mos e nënvleftësojmë armikun, kurrë të mos e shuajmë luftën e klasave dhe të mos vetëkënaqemi, të mos plogështohemi.

Të jemi gjithmonë në sulm. Partia jonë, masat e gjera të popullit duhet të jenë në sulm kurdoherë dhe për çdo gjë.

*Botuar për herë të parë në
revistën «Studime Politiko-
-Shoqërore», nr. 12, 1987,
f. 7*

*Botohet sipas revistës «Studi-
me Politiko-Shoqërore»,
nr. 12, 1987, f. 7.*

TË MBËSHTETEMI TËRËSISHT NË FORCAT TONA

*Fjala e mbylljes në Plenumin e 4-t
të KQ të PPSH¹*

31 janar 1978

Raporti dhe diskutimet në këtë Plenum të Komitetit Qendror na dhanë një tablo të përpjekjeve të mëdha që bëhen për vënien në jetë të vendimeve historike të Kongresit të 7-të të Partisë, për realizimin e detyrave të planit të shtetit, për sukseset, për vështirësitë dhe për të metat që hasen dhe problemet e mëdha që kemi përpara për të zgjidhur. Prandaj do të theksoj vetëm disa momente të planit lidhur me situatat që kalojmë.

1. — Zhvillimit të ekonomisë dhe realizimit të planeve duhet t'u kushtojmë një vëmendje shumë më të madhe. Kjo lidhet edhe me vështirësitë e pengesat që po na krijohen dhe që po na shtohen çdo ditë e më shumë nga imperialistët dhe revizionistët e ndryshëm.

Në këto kushte, zhvillimin tonë ekonomik do ta

1. Ky Plenum, që u mbajt më 30-31 janar 1978, shqyrtoi raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi dhënien llogari për plotësimin e detyrave të planit të vitit 1977 dhe mbi detyrat e planit të vitit 1978».

mbështetim tërësisht në forcat tona. Kjo do të thotë që gjithë fondin e akumulimit ta përballojmë me të ardhurat kombëtare të krijuara në vend, që veprat e reja t'i projektojmë, t'i ndërtojmë dhe t'i vëmë në shfrytëzim vetë, që të zgjerojmë më shumë prodhimin e makinerive e të pajisjeve dhe të rritim bazën e lëndëve të para dhe energjetike brenda vendit, të rritim fuqinë eksportuese dhe, në këmbim të mallrave e me valutën tonë, të sigurojmë nga importi ato makineri, pajisje dhe lëndë të para, të cilat nuk mund t'i sigurojmë vetë brenda vendit.

Pra i tërë zhvillimi ekonomik e kulturor të ne do të realizohet e duhet të realizohet akoma më shumë me forcat tona. Por ka rëndësi që kjo të kuptohet mirë nga të gjithë, pse mbështetja në forcat e veta edhe në kushtet e reja nuk do të thotë aspak autarki. Duke ndjekur kursin e mbështetjes në forcat e veta në zhvillimin e ekonomisë, ne kemi arritur në atë gjendje që na krijon mundësi më të mëdha për të plotësuar në mënyrë të kënaqshme nevojat e popullit, të financojmë ndërtimet, të eksportojmë në vendet e tjera mallra dhe produkte në sasi të atilla që të sigurojmë gjithnjë e më shumë të ardhura në valutë dhe me to të blejmë mallra, makineri e pajisje që na nevojiten për zhvillimin e forcave prodhuese. Kjo detyrë e madhe duhet të kuptohet drejt nga të gjithë dhe të zbatohet.

Na vihet detyrë që me forcat që kemi, të realizojmë, bile të përpiqemi t'i tejkalojmë planet që aprovojmë, të krijojmë rezerva prodhimesh për të përmirësuar jetesën e masave dhe të zhvillojmë forcat prodhuese të planifikuara.

Armiqtë tanë janë përpjekur e do të përpiqen të na izolojnë. Por izolimi është i pamundur për shkak të thellimit të vazhdueshëm të kontradiktave në gjirin e vendeve kapitaliste, revizioniste dhe të koniunkturave të ndryshme që krijohen. Prandaj ne duhet të përpiqemi që nëpër këtë krizë të madhe, e cila ka përfshirë botën kapitalisto-revizioniste, duke qëndruar fort në parimet dhe në politikën tonë marksiste-leniniste, të përballojmë çdo vështirësi që do të na nxjerrin. Ta kuptojmë mirë rëndësinë që ka, veçanërisht në kushtet aktuale, realizimi i planeve. S'duhet të ketë as fjalë, as shfaqësime, por mendim të thellë, djerse dhe zbatim në kohë, në cilësi e në sasi të detyrave dhe të bëjmë kursime kudo e në çdo gjë.

Mundësitë për t'i përballuar vështirësitë e pengesat, për të zgjidhur probleme të ndërlikuara në bazë të planeve tona janë, pse kemi një përvojë të pasur në ndërtimin socialist, kemi një nivel të zhvilluar të forcave prodhuese, kemi një armatë të tërë të klasës punëtore dhe një fshatarësi dhe inteligjencie të brumosur me ideologjinë dhe me vijën e Partisë, të ngritur nga pikëpamja teknike e shkencore. Këto na krijojnë ato mundësi të mëdha që situatat t'i kapërcejmë me sukses dhe të sigurojmë me vazhdimësi ndërtimin dhe mbrojtjen e atdheut tonë socialist.

Duke shtruar këtë problem më me forcë në stadin aktual të zhvillimit, Partia synon të garantojë plotësimin e pesëvjeçarit që kemi dhe të përgatitemi me kohë dhe në tërë gjerësinë e thellësinë e problemit që pesëvjeçarin e ri ta realizojmë pa kredi nga jashtë, me burimet tona të brendshme dhe me ritme

të larta. Ky do të jetë një hap i paparë deri sot në zhvillimin tonë ekonomik. Kur të arrijmë këtë zhvillim, jemi absolutisht të bindur që do të rriten akoma më shumë besimi dhe fuqia e klasës punëtore dhe e masave të gjera punonjëse në forcat e veta. Kjo nuk është një deklaratë fantastike, por një optimizëm revolucionar i bazuar shkencërisht dhe moralisht, që Partia dhe populli ynë e kanë realizuar dhe do ta realizojnë me punë dhe me sakrifica.

Për të luftuar çdo eufori e vetëkënaqësi, për të luftuar mosbesimin në forcat e veta dhe për të mos u tërhequr para vështirësive kërkohet nga të gjithë entuziazëm revolucionar, besim, studim, organizim, zbatim dhe kontroll i detyrave, kërkohet mobilizimi i përgjithshëm i rezervave të brendshme dhe i mundësive tona. Zhvillimi i pavarur ekonomiko-shoqëror socialist, kërkon, gjithashtu, një vlerësim më serioz të gjetjes dhe të përdorimit të burimeve të brendshme për të përballuar nevojat në rritje të ekonomisë dhe për të çarë bllokadën e egër imperialisto-revizioniste. Në rrugën tonë përpara ne do të hasim edhe pengesa, por, në qoftë se do të dimë të drejtojmë e të mobilizojmë si asnjëherë forcat njerëzore, burimet materiale, financiare dhe bazën materialo-teknike të krijuar, shumë nga problemet që na dalin, do t'i zgjidhim më shpejt dhe më mirë.

Situatat dhe kushtet kërkojnë, gjithashtu, që ne të jemi më të shkathët, më të thellë në mendime e në veprime, më praktikë dhe më rezultativë në punët tona. Pa errësuar aspak sukseset e arritura, shohim se akoma disa detyra nuk kryhen në kohë, ngecin në

mes të rrugës, nuk zgjidhen me efektin e duhur. Disa herë na ndodh që gjërat, edhe pse i njohim, i themi e i kritikojmë, prapë gjendja nuk përmirësohet ashtu siç kërkohet. Kur shtrojmë problemin se përse ndodh kështu, shpeshherë ndeshemi me çështjen e organizimit të punës, prandaj duhet kërkuar më shumë për një organizim më të mirë e më shkencor të punëve, i cili tani është një nga kyçet e rëndësishme për zgjidhjen e problemeve që na shtrohen përpara. Kur caktohet detyra, ajo duhet zbërthyer pa humbur kohë, duhet ndjekur e duhet kontrolluar me kujdes çfarë është bërë dhe çfarë nuk është bërë për kryerjen e saj, me qëllim që objekti apo puna të realizohet në kohën e parashikuar.

Duhet të jetojmë me situatat duke luftuar për realizimin e planeve. Njerëzit tanë janë hedhur në punë e në krijimtari shkencore dhe teknike, teorike dhe praktike. Partia, organet shtetërore dhe ekonomike kanë për detyrë që kjo punë të organizohet mirë, këto probleme të programohen sipas radhës e rëndësisë dhe të ndiqet hap pas hapi zbatimi i tyre në jetë, përndryshe do të bëhen propozime boshe, do të ushqehen indiferentizmi dhe shfaqjet e burokratizmit e të liberalizmit. Detyrat që shtrojmë dhe zotimet që marrim nuk janë fakultative.

Lufta për realizimin e detyrave të planit kërkon që t'u kushtojmë një vëmendje më të madhe disa problemeve themelore dhe t'i lidhim ato më mirë me të tërën, me zhvillimin në përgjithësi të ekonomisë sonë socialiste sipas parimit të mbështetjes në forcat e veta.

Çdo mosrealizim plani në një degë apo në një sektor jo vetëm që ndikon negativisht në prishjen e gjithë

zinxhirit të planit unik shtetëror, por ai godet drejtpërdrejt ritmet e zhvillimit e të ecjes sonë përpara, problem ky sa ekonomik, aq edhe politik e shoqëror. Kështu, në qoftë se në bujqësi, veçanërisht vitin e kaluar u krijuan deficite në realizimin e planit, pjesërisht për efekt të thatësisë, ose në qoftë se disa vepra nuk u përfunduan në kohë nga ana e ndërtimit për t'u futur në shfrytëzim etj., të gjitha këto, përveç të tjerash, ndikuan në ritmet e zhvillimit tonë ekonomik. Mirëpo nevojat tona për zhvillimin e riprodhimit të zgjeruar socialist, për mbrojtjen e vendit, për shtimin e rezervave dhe për përmirësimin e kushteve të jetesës së popullit, veçanërisht në kushtet aktuale, janë në rritje. Këtej del edhe një herë domosdoshmëria që problemit të ritmeve të zhvillimit t'i kushtojmë kujdes të posaçëm dhe të mobilizojmë të gjitha forcat dhe energjitë tona për të realizuar e për të tejkaluar me çdo kusht detyrat e planit në kohë dhe për të gjithë treguesit ekonomikë e financiarë të tyre.

Realizimi i ritmeve të zhvillimit të prodhimit shoqëror sipas planit lidhet ngushtë edhe me një problem tjetër të madh, me atë të zënics plotësisht me punë të dobishme shoqërore, me efektivitet e me rendiment të shtesës dinamike të popullsisë sonë aktive. Kjo bëhet më e qartë po të mbahet parasysh se çdo vit në vendin tonë, në fshat e në qytet, shtohen afro 40 mijë forca të reja pune. Për to ne kemi dhe do të kemi nevojë në të gjitha degët e ekonomisë e të kulturës, në bujqësi, në miniera, në ndërtim dhe në fronte të reja pune, prandaj kërkohet një manovrueshmëri më e madhe në lëvizjen me kritere të drejta të forcave të punës

nga qyteti atje ku nevojiten, duke krijuar kushtet e nevojshme, si dhe duke luftuar shfaqjet e huaja për punë të zgjedhura dhe pranë shtëpisë.

2. — Zhvillimi i pavarur i ekonomisë sonë dhe realizimi me sukses i planit, duke u mbështetur fuqimisht në forcat e veta, kërkon që tani, më shumë se kurrë, t'i japim një shtytje të mëtejshme çështjes së revolucionit tekniko-shkencor në të gjitha pjesët përbërëse të tij. Veçanërisht sot as që mund të mendohet ecja jonë përpara pa iu futur me forca të shumëfishuara këtij revolucioni. Njerëzit tanë të mrekullueshëm janë ata që u kanë dhënë dhe duhet t'u japin zgjidhje problemeve të shumta që nxjerr përpara zhvillimi dinamik i ekonomisë dhe i kulturës sonë në rrugën e socializmit.

Revolucioni tekniko-shkencor duhet kuptuar thellë. Ai do të thotë zbatim në mënyrë revolucionare i eksperiencës teknike të ndihmuar nga dituria shkencore, me synim për perfeksionimin e mjeteve të prodhimit, të mekanizmave e të proceseve të ndryshme të punës për përmirësimin e raportit punë—kohë—rendiment. Në qoftë se ky revolucion nuk trajtohet në bazë të kuptimit marksist-leninist, por shihet nga pozitë e filozofisë borgjeze, sjell në fuqi teknokratizmin jo vetëm në ekonomi, por në të gjithë sektorët e jetës, bile dhe në politikë. Synime të tilla armiqësore kishte Abdyl Këllezi me shokë, kur, pas Plenumit të 3-të të Komitetit Qendror për çështjen e revolucionit tekniko-shkencor, fryu së tepërmi byrotë teknike e teknologjike dhe aparatet e ndërmarrjeve e të institucioneve të ndryshme. Ne e korrigjuam këtë deviacion, por çështja

është që byrotë teknike tani të aktivizohen e të veprojnë në mënyrë sa më aktive dhe, që të veprojnë me rendiment, atyre duhet t'u krijohen mundësitë.

Në qoftë se flasim për këshillat tekniko-shkencorë, të krijuar me vendim të Qeverisë, edhe detyra e tyre duhet kuptuar drejt, sepse me të vërtetë burimi i punës së tyre është baza, por ata nuk duhet të rrinë e të presin derisa t'u shtrohet një çështje pastaj ta diskutojnë dhe të krijojnë grupe për projektim e diskutim. Roli i këtyre këshillave tekniko-shkencorë, që drejtohen nga organet e pushtetit apo të ekonomisë, është që ata të jenë aktivë, jo të presin, por të ngacmojnë gjërat, ta nxitin mendimin e masave punonjëse në qytet dhe në fshat.

Për studimin e disa problemeve të rëndësishme në shkallë kombëtare, është menduar mirë që të krijohen grupe pune komplekse me specialistë të qendrës e të bazës, që do të shkëputen për njëfarë kohe. Por këtu duhet pasur kujdes që ato të mos kenë më tepër njerëz nga sa u nevojiten, por dhe as më pak nga sa u duhet për të kryer detyrat e ngarkuara. Në këtë punë do të kemi parasysh, në radhë të parë, që të gjallërohen punët e revolucionit tekniko-shkencor në bazë për të zgjidhur mjaft probleme që dalin përpara dhe për të rritur vazhdimisht rendimentin e punës.

Themelore është që në zhvillimin e këtij revolucion tani të përfshihen masat e gjera të punëtorëve, të kooperativistëve e të specialistëve të ndryshëm. Çdo problem në vetvete është jo pa mbarim, por edhe me një të rënë të lapsit ai nuk zgjidhet. Dialektika na më-

son që përmirësimi nxjerr përmirësimin, nxjerr të re-në, të përparuarën, mënjanon të vjetruarën.

Ky revolucion duhet të bëjë përmirësimë edhe në çështje të tilla, siç janë: normat e punës dhe normativat e materialeve. Mirëpo ne shohim se detyrave të caktuara në këto fusha nuk u shkohet deri në fund. Të mos harrohet se disa nga këto çështje, si normat e normativat, janë kyçe të revolucionit tekniko-shkencor. Këtu ka një kompleks gjërash të ndryshme, të cilave u duhet futur më në thellësi për t'i kapërcyer. Jo se nuk është bërë gjë në këtë drejtim, por kur themi revolucion tekniko-shkencor kemi parasysh: progres, ecje përpara, zbulim, eksperimentim, skartim, realizim, zbatim, adaptim metodash të reja më të avancuara. A nuk i bënë këto punëtorët dhe specialistët e uzinës «Traktori»¹ në Tiranë kur prodhuan motorin e unifikuar DT—75? Sa shembuj të tillë ka në vendin tonë për prodhimin e sondave, të vinçave, të elektrovozave, të pompave të hidrovorëve, të fabrikave e të prodhimeve të reja! Por sa probleme kemi për të zgjidhur në industri, në ndërtim apo në transport, në fushën e zbulimit të vendburimeve të reja të naftës apo të mineraleve, për pasurimin e tyre, për t'u marrë hekur-nikelit, kromit, bakrit dhe mineraleve të tjera të gjithë komponentët!

Kur flasim për rendimentin, që lidhet direkt me revolucionin tekniko-shkencor, duhet të kemi parasysh prodhimin, kohën dhe t'i japim mundësi punëtorit të çlodhet, t'i krijojme kushte të përshtatshme higjien-

1. Sot kombinau i autotraktorëve «Enver Hoxha».

no-sanitare, pra të kemi parasysh edhe anën humane. Të gjitha këto kërkojnë të përmirësohen makinat, të mekanizohen punët, të përmirësohen kushtet e punës, sepse këtej varen rendimenti, mirëqenia, lehtësimi i punës, shëndeti i punonjësve etj.

Mirëpo jo kurdoherë mendohet dhe punohet kështu. Duke mos e kuptuar dhe zhvilluar si duhet revolucionin tekniko-shkencor ndodh si në Ministrinë e Ndërtimit, apo edhe në disa institucione të tjera që kërkojnë fuqi punëtore më shumë nga plani. Kurse jemi të bindur që, duke mekanizuar shumë procese jo vetëm do të lehtësohet puna, por edhe një pjesë e punëtorëve do të lirohen për të punuar në sektorë të tjerë. Po të analizoheshin me këtë sy problemet, nuk do të lireshin pa u shfrytëzuar edhe mjaft mekanizma e mjetet transporti. Në zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor, gjithashtu, nuk duhet të mendojmë vetëm për gjëra të mëdha, por edhe për gjëra të vogla, të cilat kanë rëndësi të madhe.

3. — Problemi i kooperimit në vendin tonë ka kohë që ka filluar dhe mjaft gjëra të mira po bëhen nëpërmjet tij, por duhet të ekzistojë e të fuqizohet më shumë edhe kooperimi i vogël, si i thonë, i cili krijon gjithashtu mundësi prodhimi që me kooperimin e madh nuk arrihen të realizohen dot. Pra duhet t'u vëmë rëndësi gjërave të vogla, krahas të mëdhave, kooperimit të vogël, krahas kooperimit të madh. Një kooperim i vogël të krijon, fjala vjen, vinçat që zëvendësojnë punën e qindra punëtorëve. Një grup të rinjsh ishin ata në Durrës që dhanë idenë e ndërtimit të një batiskafi që, në fakt, duke u vënë në jetë, kri-

joi mundësi të kryhen punë me rëndësi të madhe për të ardhmen. Një uzinë e vogël është ajo në Rrogozhinë, por ka ngritur disa linja të reja prodhimi, të nevojshme dhe me leverdi. Ky është një kooperim shumë i vogël, por rezultatet e tij kanë sjellë shumë përfitime. Neve na intereson shumë kooperimi i madh për të prodhuar, për shembull, një sondë që të shpojë 3-4 edhe 5 mijë metra thellë, punë kjo me shumë leverdi. Por, për të arritur që ta prodhojmë vetë në vend këllë sondë me forcat tona, duhet t'u krijojmë njerëzve tanë të gjitha kushtet dhe mundësitë e kooperimit. Krahas punëve të tilla ne nuk duhet dhe nuk mund të neglizhojmë, apo të nënvleftësojmë ato mundësi që në pamje duken të vogla, por që, në fakt, u japin rrugëzgjidhje shumë problemeve konkrete dhe ndihmojnë në zhvillimin e prodhimit. Edhe këto forca ne duhet t'i aktivizojmë sa më shumë.

Çdo mbyllje në vetvete, çdo nënvleftësim i kooperimit të madh apo të vogël, u vë bërnylin atyre epërsive të mëdha që krijojnë rendi ynë ekonomiko-shoqëror socialist. Një përmirësim rrënjësor kërkojnë gjithashtu komunikimi dhe informacioni tekniko-shkencor për literaturën, projektet teknike e teknologjike, buletinet etj., punë kjo që duhet t'i futen më shumë si vetë ndërmarrjet e kooperativat, ashtu edhe institucionet, dikasteret qendrore dhe Akademia e Shkencave me Universitetin.

4. — Bujqësia ka qenë dhe mbetet dega bazë e ekonomisë sonë, ku lufta për realizimin e planit dhe për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor kërkohet të ngrihet në një shkallë më të lartë. Problemi i

sigurimit në mënyrë të vazhdueshme e të sigurt të bukës në vend mbetet gjithmonë në qendër të vëmendjes. Po kështu ka rëndësi të madhe edhe plotësimi i detyrave për bimët industriale, sepse me to lidhet plotësimi i nevojave të popullit, lidhet puna e dhjetëra mijë punëtorëve të industrisë së lehtë e ushqimore, shtimi i eksportit dhe shkurtimi i importit. Por aktualisht kërkohet të bëjmë më shumë kujdes edhe për blegtorinë, sepse në këtë sektor vërejmë një nënvlef-tësim. Ashtu siç u theksua edhe në analizën që i bëri Këshilli i Ministrave këtij sektori, synimi të jetë që brenda këtij pesëvjeçari të bëjmë medoemos një kthesë në zhvillimin e blegtorisë. Nuk mund të bëhet kjo kthesë pa rritur numrin e krerëve dhe rendimentin e tyre, por këtu çështja themelore mbetet sigurimi i bazës së nevojshme ushqimore. Siç del edhe nga praktika e disa ekonomive bujqësore të përparuara në Po-gradec, në Shkodër, në Berat dhe në ndonjë rreth tjetër, parulla: «E gjithë toka është e bujqësisë dhe e gjithë toka është e blegtorisë» kërkohet të vihet në themel të punës për sigurimin e bazës ushqimore, të përmirësohet struktura e bimëve foragjere dhe të futen më gjerësisht kultura të reja foragjere, që po japin rezultate më të mira, në krahasim me disa prej atyre që mbjellim sot, duke luftuar e duke përmbysur praktikat e prapambetura, konceptet e vjetruara, si dhe duke përsosur më tej organizimin dhe drejtimin shkencor edhe në këtë fushë.

Ky nuk është një problem që shtrohet sot për herë të parë, por ka vite që shtrohet nga Partia. Pakujdesia për bazën ushqimore të bagëtive nuk pajto-

het as me traditën e popullit tonë, i cili është kujdesur për delen dhe për lopën si për fëmijën. Por ky nënvleftësim, më duket mua, shfaqet më tepër te drejtuesit e te disa kuadro të ndërmarrjeve e të kooperativave bujqësore në rrethe e bile edhe në institucione shkencore.

Ditët e fundit, Byroja Politike vendosi disa masa për të përsosur më tej levat ekonomike në marrëdhëniet e shtetit me kooperativat bujqësore. Në këtë kuadër, një shtytje e mëtejshme do t'i jepet shtimit të prodhimit blegtoral nëpërmjet investimeve shtetërore të përqendruara për ngritjen e fermave blegtoriale, për shtimin e prodhimit të mishit, të qumështit e të vezëve, për ndërtimin e serrave për perime për tregun e brendshëm dhe për eksport.

Kur flasim për investimet në bujqësi, duhet të përgatitemi seriozisht për të zgjeruar frontin e tyre nga shteti po dhe nga vetë kooperativat bujqësore. Këto investime sot duhet t'i shohim më gjerë, si një faktor të domosdoshëm për zhvillimin e një bujqësie socialiste të përparuar, për zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor në bujqësi, si mbështetje e fuqishme për të shtuar vazhdimisht prodhimet bujqësore e blegtoriale në të gjitha zonat e vendit, dhe si një front të rëndësishëm për të zgjeruar zënien me punë të forcave të reja aktive nga popullsia e fshatit dhe nga ajo e qytetit.

5. — Problemi i tregtisë së jashtme, i shtimit të ritmit të eksportit dhe i pakësimit të importit në situatat aktuale merr një kuptim e rëndësi të veçantë. Për këtë duhet të mendojnë e të punojnë shumë pu-

nonjësit e sistemit të Ministrisë së Tregtisë së Jashtme, por për këtë duhet të mendojnë e të punojnë edhe të gjithë të tjerët, sepse tregtia shet jashtë atë që prodhohet nga ndërmarrjet industriale, nga bujqësia dhe nga degë e sektorë të tjerë, ashtu sikurse edhe kërkesat për import janë po prej tyre.

Armiqtë tanë imperialistë e revizionistë do të përpiqen të na pengojnë me një mijë e një mënyra edhe në marrëdhëniet tregtare që kemi me ta. Por edhe këto pengesa ne i kemi të gjitha mundësitë t'i kapërcejmë:

E para, me realizimin e me tejkalimin e planeve dhe me shtimin e prodhimit të mallrave e të mjeteve të tjera të shkëmbimit me jashtë.

E dyta, ashtu siç kemi thënë kurdoherë, me prodhimin e mallrave të asortimenteve dhe të cilësisë që kërkohen në botën e jashtme, në mënyrë që të kemi një eksport të garantuar. Sa më të mira të jenë ato, aq më tepër do të rriten mundësitë tona shkëmbyese me vendet e tjera dhe do të përhapet emri i mirë i prodhimeve tona.

E treta, duke e konsideruar real presionin e vendeve kapitalisto-revizioniste dhe duke shfrytëzuar kurdoherë në favorin tonë kontradiktat që ekzistojnë midis këtyre vendeve.

Prandaj çështja është të dimë të bëjmë tregti, të jemi elastikë, të nuhatim dhe të shfrytëzojmë koniunkturaturat e tregjeve dhe të çmimeve sa më shumë në favorin tonë. Shtimi i eksportit duhet të kompensojë të gjitha ato mungesa që do të hasim gjatë zhvilli-

mit të mëtejshëm të ekonomisë në këtë pesëvjeçar dhe në pesëvjeçarët e ardhshëm.

Ne duhet, gjithashtu, të kontrollojmë me rreptësi importin e mallrave, të bëhemi gardh i pakapërcyeshëm në sjelljen e gjërave të panevojshme.

Lufta për realizimin e planit, ashtu siç e ka theksuar kurdoherë Partia, nuk është thjesht një problem ekonomik ose në radhë të parë ekonomik, por është, mbi të gjitha, një problem politik. Është politik sepse nëpërmjet politikës së drejtë marksiste-leniniste arrihen zhvillimi dhe përsosja në rrugë revolucionare e marrëdhënieve socialiste në prodhim, arrihet zhvillimi i forcave prodhuese në atë drejtim e në atë strukturë që duhet për ndërtimin e socializmit, mbështetur fuqimisht në forcat e veta, për forcimin e diktaturës së proletariatit, për rritjen e fuqisë mbrojtëse të atdheut dhe ngritjen e mirëqenies së masave të gjera punonjëse, për të zgjidhur shumë nga problemet e tjera ekonomiko-shoqërore që shtron ecja jonë përpara drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste e komuniste.

Prandaj, ashtu si gjithnjë, Partia të udhëheqë e të përmirësojë pa ndërprerje punën e vet në të gjitha drejtimet për zhvillimin e ekonomisë, të përgatitë popullin për të përballuar situatat që kalojmë, për të ngritur më lart shpirtin e guximit dhe të sakrificës, për një jetë të thjeshtë e pa pretendime. Partia jonë, duke transformuar pa pushim realitetin në rrugën e socializmit të vërtetë, ka parashikuar saktë e qartë të ardhmen e ndritur dhe, me metoda revolucionare marksiste-leniniste, ka pastruar dhe do të

pastrojë nga çdo pengesë rrugën që çon në këtë të ardhme klasën punëtore, fshatarësinë kooperativiste, inteligjencien, gjithë popullin.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime, 1978-1979», f. 7

Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime, 1978-1979», f. 7

REVOLUCIONI NË KINË ESHTË TIJESIIT DEMOKRATIKO-BORGJEZ

Shënime

2 shkurt 1978

Siç e kanë theksuar klasikët tanë, Revolucioni Demokratiko-Borgjez Francez është një revolucion progresiv për kohën e tij, sepse hapi një epokë të re në historinë e njerëzimit. Nga materialet historike del se një karakteristikë e këtij revolucioni është se ai filloi nga poshtë-lart. Revolucioni i madh Borgjez në Francë udhëhiqej nga borgjezia *de robe* dhe mundi të fitonte dhe t'i kryente detyrat vetëm në sajë të rolit vendimtar të fshatarësisë dhe të vegjëlisë së qyteteve. Borgjezia ishte pasuruar mjaft gjatë periudhës së sundimit të feudalizmit e të absolutizmit, por nuk gëzonte ato të drejta politike që kishin pronarët e mëdhenj të tokave, fisnikët dhe kleri. Borgjezia tregtare dhe rentiere u mbështet te fshatarësia, e cila ishte e rënduar jashtëzakonisht shumë nga detyrimet në dobi të klasave të privilegjuara, prandaj ishte kundër taksave e punës angari, me një fjalë, kundër pushtetit mbretëror absolut dhe aristokracisë feudale.

Detyrat themelore të revolucionit demokratiko-bor-

gjez janë rrëzimi i feudalizmit, i pushtetit mbretëror absolut, dhe zgjidhja e problemit fshatar, pra, kryerja e reformës agrare. Revolucioni Demokratiko-Borgjez Francez, ndryshe nga revolucionet e tjera borgjeze, u bë nga masat popullore, nga vegjëlia e qytetit dhe e fshatit, të udhëhequra nga borgjezia, kundër feudalizmit dhe absolutizmit. Pjesëmarrja mjaft e gjerë e masave popullore në këtë revolucion e dallon atë nga revolucionet e tjera borgjeze.

Kur filloi revolucioni, fshatarësia franceze akoma nuk ishte e qartë për nevojën e ndryshimit konstitucional të formës së regjimit. Nevoja e rrëzimit të monarkisë u kuptua më vonë, progresivisht. Nuk po ndalem në peripecitë që kaloi Revolucioni Demokratiko-Borgjez Francez gjatë periudhave të ndryshme të historisë së tij, sepse nuk është ky qëllimi i këtij shkrimi, prandaj pa u zgatur dua të theksoj se, si rrjedhim i gjendjes së krijuar nga lëvizjet popullore, u ndie nevoja e thirrjes së *les états généraux*¹. Pas shumë mbledhjesh *le Tiers Etat*², i nxitur nga entuziazmi i masave të revoltuara, që kërkonin luftë të vendosur kundër pushtetit në fuqi, më 17 qershor e shpalli veten Asamble Kombëtare. Më 9 korrik mbledhja në sallën «Jeu de Paume» e shpalli veten Asamble Kushtetuese, që duhej të përpunonte kushtetutën e re.

Oborri mbretëror dhe përkrahësit e tij, feudalë e klerikë, por edhe elementë të borgjezisë, filluan të kundërveprojnë ndaj Asamblesë. Për shpërndarjen e saj u

1. Kuvend i përgjithshëm.

2. Shtresa e tretë.

sollën forca ushtarake në Paris dhe në Versajë. Zemërimi i thellë i masave popullore, kur morën vesh orvatjet e reaksionit, bëri që pjesëmarrja në kryengritje të zgjerohet dhe të thellohet shumë dhe më 14 korrik 1789 u dogj kështjella-burg e Bastijës, simboli i tiranisë.

Më në fund populli kryengritës përmbysi monarkinë absolute. Të gjitha prerogativat e feudalizmit u likuiduan. Pushteti ra në duart e borgjezisë së madhe bankare-tregtare dhe të disa fisnikëve që e mbështetën atë. Kjo borgjezi, që u bë pronare e madhe, e përdori fitoren për interesat e saj, ajo ruajti tokat e veta dhe të mirat komunale i ndau disi me fshatarësinë.

Pavarësisht se krahu i djathtë i revolucionit francez, i përbërë nga fejtantët, më vonë nga zhirondinët, të pasuar nga dantonistët dhe hebertistët, u përpoq jo vetëm të ruante mbretërinë, por edhe ta ndalonte në mes të rrugës revolucionin, ky krahu u dërrmua nga diktatura demokratike revolucionare e borgjezisë së qytetit, e artizanëve, e robespieristëve që përkraheshin nga masat popullore. Periudha e Robespierit ishte kulmi i Revolucionit Demokratiko-Borgjez Francez.

Më pas borgjezia kundërrevolucionare sulmoi jakobinët, shfrytëzoi grindjet e brendshme në radhët e këtyre të fundit, rigrupoi forcat dhe e likuidoi diktaturën robespieriane. Më vonë Babëfi shkroi dhe predikoi reformën e plotë agrare. Ai ishte kundërshtar i vendosur i pronës private mbi tokën dhe mbrojtës i flaktë i barazisë. Babëfi dhe përkrahësit e tij luftuan kundër pushtetit borgjez, por atë e arrestuan dhe e ekzekutuan. Meqenëse Babëfi ishte komunist utopist dhe organizator i «komplotit të të barabartëve», babëfizmi u quajt

ekstremi i majtë, «komunizmi», në Revolucionin Demokratiko-Borgjez Francez.

Pra, Revolucioni Francez i vitit 1789 pati peripecitë e veta dhe me diktaturën e jakobinëve shënoi periudhën më të ndritur të tij. Pas diktaturës jakobine, më 1794, ky revolucion filloi rënien, erdhi reaksioni termidorian, që vulosi mbarimin e Revolucionit Demokratiko-Borgjez të shekullit të 18-të.

Borgjezia kundërrevolucionare ushtroi sundimin e saj të pakufizuar nën pushtetin e Direktoratit. Mirëpo edhe Direktorati, gjatë 5 vjetëve të qeverisjes, e humbi autoritetin në sytë e borgjezisë, sepse u bënë spekulime dhe shpërdorime të shfrenuara në arkën e shtetit. Shpërthimet e lëvizjeve popullore kundër Direktoratit e trembën borgjezinë, prandaj ajo kërkoi një pushtet më të fortë. Në këto rrethana, më 9 shtator 1799 (18 brymer), u krye një grusht ushtarak shteti nën drejtimin e Napoleon Bonapartit, i cili kishte përkrahjen e gjithanshme të borgjezisë së madhe. Direktorati u përmbys dhe vendin e tij e zuri diktatura ushtarake e Bonapartit. Pushteti i tij, — siç thotë Engelsi, — i hoqi popullit francez të gjitha liritë politike të fituara gjatë revolucionit.

Revolucioni Demokratiko-Borgjez, që shembi feudalizmin dhe regjimin që e mbronte, nuk arriti ta realizonte plotësisht reformën agrare. Me gjithë karakterin përparimtar të diktaturës jakobine, kufijtë e një pushteti borgjez nuk u kapërcyen. Më pas revolucioni ra për shkak të aspiratave hegjemoniste të borgjezisë së madhe që u përpoq të konsolidonte pozitën sunduese me synime imperialiste. Borgjezia nuk mund t'i mbante dot

rreth vetes për një kohë të gjatë masat popullore që shfrytëzonte.

Duke u angazhuar në luftë kundër Ruisë, Pruisë dhe Austrisë, ushtria franceze pësoi disfatë. Në mars të vitit 1814, pas kapitullimit të Parisit, Napoleoni u detyrua të abdikonte dhe u dërgua në ishullin e Elbës. Këtë situatë e shfrytëzoi dinastia e Burbonëve, e cila rimëkëmbi pushtetin e saj dhe shpërtheu terrorin kundër-revolucionar. I ndihmuar nga pakënaqësia e borgjezisë ndaj qëndrimit të Burbonëve, Napoleoni erdhi përsëri në fuqi, por kësaj radhe nuk mundi ta mbajë pushtetin veçse 100 ditë. Më 18 qershor 1815 ushtria e tij u mund përfundimisht në betejën e Vaterlosë dhe vetë Napoleoni u internua në Shën Elenë, ku vdiq më 1821.

Edhe dinastia e Burbonëve pati peripecitë e veta. Në Francë erdhën në fuqi mbretër «republikanë» që sunduan «me anë të shpatës dhe të kryqit», gjersa më 1852 Napoleoni III u bë president për një kohë të shkurtër dhe rikrijoi perandorinë franceze. Gjatë kësaj periudhe, pas gjithë këtyre luftërave, borgjezia franceze u mëkëmb, u fuqizua ekonomikisht dhe kështu filloi industrializimi i Francës.

Disa historianë thonë se mund të merret si një revolucion demokratiko-borgjez model edhe ai i Kromuellit, që u krye në Angli. Mua më duket se ky vlerësim nuk është i drejtë, për arsye se, ndryshe nga Revolucioni Demokratiko-Borgjez Francez, revolucioni në Angli u bë kryesisht nga lart, në kompromis midis përkrahësve të pushtetit mbretëror: feudalëve, kishës anglezë, nga njëra anë, dhe përkrahësve të parlamentit: borgjezisë së madhe dhe fisnikëve të rinj, nga ana tje-

tër. Vërtet që edhe në Angli u prokoka e mbretit, por revolucionit atje e la fshatarësinë pa tokë. Kjo vazhdoi të paguante detyrimet e mëparshme ndaj feudalëve dhe kishës. Të gjitha vështirësitë e luftës civile parlamenti anglez ia ngarkoi popullit, duke i shtuar taksat. Gjendja ekonomike e masave u keqësua më tej. Ky revolucion konsolidoi pozitën e borgjezisë pronare të tokave, si dhe pozitën e feudalëve. Borgjezia ndërmoi zhvillimin industrial më përparase të bëhej revolucionit; ajo u fut në rrugën e zhvillimit kapitalist dhe, nga synimet për ekspansion në kolonitë, hyri në konflikt me perandorinë e Bonapartit, që, për të kënaqur ambiciet e veta, kërkonte t'u vinte fre lakmive të borgjezisë angleze.

Revolucioni francez u quajt revolucion i madh pikërisht sepse, siç na mëson Lenini,

«... tipari i tij dallues nuk ishte plogështia, karakteri gjysmak dhe frazeologjia... ishte një revolucion serioz, i cili, pasi i përmbysi monarkistët, i shtypi ata deri në fund... Për klasën e vet, për të cilën ai punoi, për borgjezinë, ai bëri aq shumë, sa që gjithë shekulli XIX, ai shekull që i dha qytetërimin dhe kulturën mbarë njerëzimit, kaloi nën flamurin e revolucionit francez»¹.

Jakobinët e vitit 1793 kanë hyrë në histori si një shembull me shumë vlerë i luftës me të vërtetë revolucionare të klasës së shtypur kundër klasës së shfrytëzuesve.

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 29, f. 392, 412.

Në shkrimin e tij «Zhvillimi i socializmit nga utopia në shkencë» Engelsi thekson:

«Revolucioni i madh francez ka qenë... e para kryengritje që u zhvesh krejt nga rrobat fetare dhe në të cilën lufta u zhvillua haptazi në terren politik. Ajo ka qenë gjithashtu kryengritja e parë në të cilën lufta u çua me të vërtetë deri në fund, deri në zhdukjen e plotë të njërës nga palët luftuese, pikërisht të aristokracisë, dhe deri në fitoren e plotë të palës tjetër, pikërisht të borgjezisë. Në Angli vazhdimësia e institucioneve të kohës para revolucionit dhe pas revolucionit dhe kompromisi midis pronarëve të mëdhenj të tokës dhe kapitalistëve gjetën shprehjen e vet... në ruajtjen dhe në nderimin e formave juridike feudale. Në Francë, përkundrazi, revolucioni u shkëput përfundimisht nga traditat e së kaluarës, zhduku gjurmët e fundit të feudalizmit...»¹.

Revolucion nga lart u bë edhe në Gjermani. Prej tij doli perandoria e krijuar nga Vilhelmi I dhe nga Bismarku. Edhe këtu revolucioni demokratiko-borgjez u bë si rezultat i bashkëpunimit midis borgjezisë së lëkundur e të pavendosur gjermane, nga njëra anë, dhe feudalëve dhe junkerëve, pronarë të mëdhenj të tokave, nga ana tjetër. Borgjezia gjermane filloi të indus-

1. K. Marks e F. Engels, «Vepra të zgjedhura», vëll. II, Tiranë, 1975, f. 107-103.

trializonte ekonominë dhe, nëpërmjet kulturkamfit¹, tentoi të tërhiqte me vete edhe proletariatin që po formohej. Në krahasim me këtë revolucion, Revolucioni Demokratiko-Borgjez Francez i vitit 1789 ka ndryshim rrënjësor. Sikurse vëren Lenini revolucioni demokratiko-borgjez gjerman i vitit 1848 nuk u çua deri në fund, se nuk i shkatërroi monarkinë dhe reaksionin. Borgjezia gjermane e prapambetur politikisht dhe jorevolucionare u bë «mburoja e frontit». Në rastin e revolucionit në Francë u mobilizuan masat e popullit, të cilat për një kohë e lanë mënjanë borgjezinë e moderuar, kurse revolucioni në Angli u bë kryesisht nën drejtimin e borgjezisë liberale. Për këto arsye borgjezia e lëkundur në vendet e tjera u është trembur tmerrësisht «rreziqeve të padëgjura të rrugës së vitit 1789», dhe preferoi më tepër rrugën e Gjermanisë së 1848-s.

Duke gjykuar nga karakteri dhe forcat lëvizëse të Revolucionit Demokratiko-Borgjez Francez, domethënë duke e analizuar këtë ngjarje të madhe historike nga detyrat që zgjidhi, nga fakti se çfarë klase përmbysi dhe çfarë klase solli në fuqi, çfarë marrëdhëniesh në prodhim zhduku e çfarë marrëdhëniesh në prodhim vendosi etj., si dhe nga fakti se cilat klasa e shtresa shoqërore morën pjesë në të, mund të kuptohet qartë sa shumë të drejtë kishte Lenini kur thoshte se revolucion borgjez klasik ka qenë pikërisht revolucioni i madh frëng i shekullit të 18-të.

Këto ishin disa nga karakteristikat më tipike të revolucioneve demokratiko-borgjeze.

1. Gjermanisht: lufta për kulturë.

Si mund ta përcaktojmë revolucionin kinez, duke analizuar karakterin dhe forcat e tij lëvizëse në dritën e materializmit historik? Edhe atje ekzistonte feudalizmi, pushteti i mandarinëve, Perandoria e Mesit, siç i thonë. Edhe atje revolucioni, i kryesuar nga Sun Jat Seni dhe nga organizata e Guomindanit, që ishte e fuqishme në atë kohë, synonte të rrëzonte feudalizmin dhe perandorinë. Problemi kyç i këtij revolucioni, përveç shembjes së feudalizmit dhe të perandorisë duhej të ishte reforma agrare, me fjalë të tjera duhej t'u rrëmbehej toka pasanikëve. Që të kishte sukses ky revolucion ishte e domosdoshme mbështetja te fshatarësia. Nga analiza e karakterit dhe e forcave lëvizëse del se edhe revolucioni kinez ishte demokratiko-borgjez.

Më 1921 u krijua Partia Komuniste e Kinës. Sido që ishte e re, kjo parti duhej t'i kishte të qarta karakterin e revolucionit dhe forcat lëvizëse të tij. Ajo duhej të kishte ndërtuar një program minimal dhe një program maksimal. Partia Komuniste e Kinës duhej t'i ruante edhe aleancat me Guomindanin, me Sun Jat Senin e me të gjitha forcat e tjera progresive, të përcaktonte mirë qëllimin e programit të saj minimal — revolucionin demokratiko-borgjez, domethënë likuidimin e feudalizmit bashkë me shtetin që e mbronte këtë rend ekonomik-shoqëror, dhe kryerjen e reformës agrare, duke shpronësuar borgjezinë e madhe pronare të tokave. Pasi të përmbyseshin feudalizmi, mandarinët dhe të merrrej pushteti në dorë, të shkohej nga reforma në reformë, nga një etapë e revolucionit në tjetrën.

Revolucioni demokratiko-borgjez kinez ndodhi në kohë dhe në kushte të ndryshme nga Revolucioni De-

mokratiko-Borgjez Francez. Në kohën e Revolucionit Demokratiko-Borgjez Francez borgjezia ishte klasë përparimtare, kurse në kohën kur u bë revolucioni në Kinë, borgjezia e këtij vendi nuk ishte e tillë. Në Francën e viteve 1789-1794, që Marksii e merr si periudhën e ngjitjes së revolucionit demokratiko-borgjez, proletaria-ti nuk kishte dalë akoma si klasë më vete, kurse në kohën e revolucionit kinez ai ekziston dhe lufton, bile ka edhe partinë komuniste e teorinë marksiste-leniniste për të cilën nuk mund të bëhej fjalë në Revolucionin Demokratiko-Borgjez Francez. Franca e kohës së revolucionit të madh borgjez vërtet kërcënohej me sulm nga ana e Ferdinandit të Brunsvikut, nga Koblenci dhe feudalët që kishin emigruar, por kufijtë e saj nuk u sulmuan, kurse Kina u pushtua nga Japonia dhe nga shtete të tjera imperialiste. Kështu revolucioni demokratiko-borgjez në Kinë do të zhvillohej nëpërmjet një lufte nacionalçlirimtare jo vetëm kundër pushtesve japonezë, por edhe kundër imperialistëve të tjerë; ai duhej të ishte më radikal. Revolucioni kinez kishte para vetes një shembull të madh historik, Revolucionin e Madh Socialist të Tëtorit nga ku mund të frymëzohej dhe të merrte eksperiencë shumë të vlefshme për perspektivat e tij.

Pra, Partia Komuniste e Kinës nuk duhej ta humbiste busullën në përcaktimin e programit të saj minimal, por të ndiqte me besnikëri vijën e Kominternit dhe ta shikonte Bashkimin Sovjetik si atdheun e madh të proletariatit, ndihmësin kryesor për fitoren e revolucionit të saj. Parimet udhëheqëse të veprimtarisë së kësaj partie duhet të ishin marksiste-leniniste. Që ajo të sigu-

ronte rolin hegjemon të klasës punëtore në revolucion, ideologjia e saj lypsej të ishte ajo e klasës punëtore.

Në këtë çështje Partia Komuniste e Kinës nuk realizoi si duhet aleancat në revolucionin demokratiko-borgjez. Ajo nuk pati përcaktime të qarta për qëndrimin ndaj borgjezisë së pasur, ndaj borgjezisë së madhe të tokave. Natyrisht, forca kryesore lëvizëse në këtë revolucion ishte fshatarësia, por kjo nuk do të thotë aspak që pikëpamjet mikroborgjeze të fshatarësisë të bëheshin ideologjia udhëheqëse e kësaj partie dhe që klasa punëtore të mos ishte hegjemone. Në këtë kohë në Kinë klasa punëtore ishte formuar dhe ideologjia e saj kishte fituar në Bashkimin Sovjetik.

Pavarësisht nga të gjitha të papriturat që u vërtetuan, lufta kundër japonezëve dhe imperialistëve të tjerë u fitua. Populli luftoi, në radhë të parë luftuan fshatarësia dhe klasa punëtore. Ndryshe nga ç'pritej, pas çlirimit, reformat nuk u zhvilluan në mënyrë radikale. Partia komuniste e Kinës, me Mao Ce Dunin në krye, u mbështet te fshatarësia duke përfshirë edhe fshatarësinë e pasur, së cilës ia la tokat që t'i shfrytëzonte si më përpara! Edhe borgjezia nuk u shpronësua. Në këtë mënyrë jo vetëm nuk u prek baza ekonomike e shfrytëzuesve, por këta nuk u prekën as politikisht. Udhëheqësit e Partisë Komuniste të Kinës deklarorin se gjoja ishin kundër borgjezisë kompradore, por kjo borgjezi, me gjithë Çan Kai Shinë, kishte emigruar jashtë, duke lënë si reaksion brenda në vend borgjezinë e pasur fshatare dhe industriale.

Në Kinë revolucioni demokratiko-borgjez duhej të çohet deri në fund, por nuk u çua. Ky revolucion nuk

bëri reforma radikale, u mbështet pak te klasa punçtore kineze. Vërtet perandoria u rrëzua, por uniteti i Kinës nuk u arrit nën pushtetin e borgjezisë. Që në kohën e Sun Jat Senit dhe më pas nuk u bë diferencimi në qëndrimin ndaj borgjezisë së madhe, borgjezisë kompradore, borgjezisë së vogël dhe fshatarësisë. Ky ishte një defekt i madh që, më vonë, do të kishte konsequenca të rënda për fatin e revolucionit demokratiko-borgjez të Kinës dhe, me siguri do të ngadalësonte e do ta pengonte zhvillimin e tij. Shndërrimet që janë problemi kyç i një revolucioni demokratiko-borgjez, në Kinë mbetën në gjysmë të rrugës, sepse atje nuk u likuidua plotësisht feudalizmi; pronarët e mëdhenj të tokave, që mund t'i quajmë feudalë ose gjysmëfeudalë, nuk i humbën prerogativat e tyre. Pas çlirimit të Kinës, më 1949 dhe më pas, udhëheqësit kinezë kishin mendimin që etapa e parë e revolucionit demokratiko-borgjez duhej të vazhdonte gjatë, rreth 30 vjet, dhe në këtë etapë do të zhvilloheshin bashkërisht edhe kapitalizmi, edhe socializmi.

Të mendosh e të veprosh në këtë mënyrë, do të thotë të mos kesh një pikëpamje të qartë mbi historinë e zhvillimit të revolucionit demokratiko-borgjez dhe mbi shndërrimin e tij në revolucion socialist, të mos kesh të qartë programin minimal dhe maksimal të Partisë, të mos kesh të qartë cilat janë reformat që duhet të bëhen njëra pas tjetrës, të mos kuptosh se ç'aleanca duhet të bëhen në dobi të revolucionit dhe cila klasë duhet të jetë në udhëheqje të tij.

Partia Komuniste e Kinës, udhëheqësit kinezë, Mao Ce Duni, nuk i kishin të qarta këto probleme të rëndë-

sishme, prandaj revolucioni demokratiko-borgjez në Kinë u zhvillua me zigzage të mëdha, në konfuzion, në anarki, në kaos. Një qëndrim i tillë pengoi seriozisht zhvillimin e bujqësisë dhe të industrisë, për arsye se partia nuk i kishte të qarta dhe s'donte t'i kishte të qarta rrugët që duhej të ndiqte, se udhëheqja e saj ishte oportuniste, e pavendosur në rrugën e marksizëm-leninizmit. Mao Ce Duni derisa vdiq mbeti në pozitën e revolucionit demokratiko-borgjez, sepse i tillë ishte botëkuptimi i tij.

Kina mbeti prapa për vite të tëra. Edhe pas çlirimit ajo ka vuajtur dhe vazhdon të vuajë nga mungesa e një qartësie parimore për sa u përket perspektivave të zhvillimit. Tridhjetë vjet u mbushën dhe meqë nuk u punua drejt, nuk u vu që në fillim uji në zjarr, revolucioni kinez jo vetëm s'ka bërë asnjë hap përpara, por përkundrazi, me grushtin e shtetit të Hua Kuo Fen-Ten Hsiao Pinit, po bën hapa prapa. Për sa kohë që klasa punëtore e ndan pushtetin me borgjezinë, ky pushtet nuk mund të jetë diktaturë e proletariatit. Kështu ndodhi në Kinë, prandaj revolucioni kinez nuk mund të jetë një revolucion socialist.

Tash, grupi puçist që ka marrë fuqinë me metoda si ato të Napoleonit I e të Napoleonit III, kërkon të fitojë kohën e humbur duke avancuar në rrugën kapitaliste, për të konsoliduar pozitën e borgjezisë së vjetër dhe të re. Kjo duket qartë nga fakti që këta puçistë po sjellin në fuqi gjithë elementët reaksionarë revizionistë e çan-kaishistë, bijtë e stërnipërit e tyre.

Aktualisht Kina ecën në rrugën e zhvillimit kapitalist. Këtë prirje për regres të Kinës duhej ta kishin pa-

rashikuar më parë udhëheqësit kinezë dhe Mao Ce Duni, por ata jo vetëm nuk e parashikuan sepse nuk gjykonin drejt se nuk ishin marksistë-leninistë, por edhe sepse ishin dakord me të.

Me pak fjalë, Kina e sotme kapitaliste me një udhëheqje të tillë do të ngjitë një Golgota të vështirë dhe do të futet më thellë në llumin e kapitalizmit kaotik, në shfrytëzimin barbar të pasurive të saj, në varfërimin e masave të gjera të popullit dhe veçanërisht të fshatarësisë. Në këtë proces kapitalist, ku po bëhen orvatje për të ndërtuar fabrika dhe kombinatë nga më modernet, proletariati, i cili do të jetë një klasë e shtypur, me dëmtim do të shpërthejë në greva e në demonstrata për t'i bërë varrin këtij regjimi reaksionar, që mori pushtetin në Kinë.

Marrë nga libri:

Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 10, f. 61

TE SHKRUAJME NJE HISTORI TE DENJE TE POPULLIT TONE

Shënime

6 shkurt 1978

Kam shkruar në ditarin tim, por edhe shumë herë kam biseduar me shokët se nuk mjafton që për historinë e Shqipërisë që është historia e popullit tonë, të kemi vetëm librin «Historia e Shqipërisë». Kam theksuar se është e domosdoshme të bëhen edhe monografi të veçanta për periudha të ndryshme, për kryengritjet e popullit tonë, jo vetëm kundër osmanëve, por edhe më herët: kundër romakëve, kundër serbomëdhenjve, kundër grekëve, kundër italianëve dhe, këto monografi të shërbejnë për të bërë sinteza të ndryshme të epokave të historisë së vendit tonë.

Është e natyrshme që historia e popullit tonë të shkruhet duke u bazuar në marksizëm-leninizmin, në materializmin dialektik e historik, larg metodave të gabuara antishkencore të historianëve borgjezë. Dihet që jo të gjithë historianët borgjezë e falsifikojnë historinë, por realiteti është se të gjithë ata i minimizojnë

luftën, aspiratat, qëllimet e popullit, të vegjëlisë dhe vënë në dukje e në plan të parë veprimtarinë e udhëheqësve, të mbretërve, të gjeneralëve, të marшалëve, të kontëve, të princërve etj.

Për hartimin e historisë së popullit tonë ne ndjekim rrugë tjetër: Vëmë në dukje edhe meritat e udhëheqësve të popullit tonë, që në përgjithësi janë udhëheqës të dalë nga gjiri i tij, nga gjiri i vegjëlisë, por në radhë të parë vëmë në dukje kryesisht faktorin e madh kolektiv, popullin, si dhe bijtë e tij të shquar që janë me mijëra dhe që kanë luajtur një rol të madh në kryengritjet shumëshkullore gjatë gjithë historisë së vendit tonë.

Një trajtim i tillë i historisë së Shqipërisë ka filluar të bëhet pas Çlirimit të vendit, por duhet të thellohet më shumë. Megjithëse «Historia e Shqipërisë» që është botuar, si dhe monografitë e ndryshme që po bëhen shkruhen në bazë të metodologjisë marksist-leniniste dhe të materializmit dialektik e historik, në to përmenden njerëzit kryesorë që kanë udhëhequr lëvizjet e popullit dhe meritat e tyre, kurse për popullin, që ka marrë pjesë në këto lëvizje, flitet në përgjithësi. Por në këtë histori dhe në këto monografi nuk flitet sa duhet për komandantët e thjeshtë trima, të cilët kanë luajtur një rol të madh në luftërat që janë zhvilluar.

Është fakt se në çdo periudhë të historisë sonë ka pasur njerëz të tillë, të cilët populli, për nga guximi e trimëria, i ka krahasuar me vetëtimën. Kështu, për shekullin, këndohet në këngën:

*«Kush e njeh Demo Eminë,
Demo Emin mjekërzinë
burrë i shkurtër vetëtimë
me mauzer mbrojtë kufinë».*

Dhe ai, që populli i ka kushtuar këtë këngë, është një ndër personazhet historike nga Nivica e Kurveleshit, që, me çetën e tij, bashkëpunoi dhe luftoi me Çerçiz Topullin e me Bajo Topullin. Mirëpo, kur vjen puna për të shkruar, përmenden vetëm meritat e Bajos e të Çerçiz Topullit, kurse për Demo Eminin e të tjerë si ky nuk flitet.

Këto katër vargje i citova për të theksuar edhe një herë se historia e popullit tonë gjendet e kristalizuar dhe e konkretizuar, qysh në periudha shumë të lashta, në gurrën e pashtershme popullore; pra, ajo është shkruar me gjuhën e popullit dhe është lënë trashëgim gojë pas goje, këngë pas kënge. Pikërisht, këto këngë përbëjnë atë pjesë të folklorit tonë të pashkruar, por të kënduar e të mbajtur mend. Prandaj, nuk duhet lënë të kalojë koha por ky folklor i pasur, i bukur e shprehës, që u këndon trimave të popullit tonë, të shkruhet e të mbetet në histori. Ja dhe një copë nga një vjershë tjetër:

*«Mbi male në Samarinë,
lufton Shemua me Hysninë,
primë o Hysni Pasha primë
të shoç Shemo mjekërzinë
se si ai lëviz sfungjinë».*

Shumë bukur e qartë jepet në këto pak vargje trimëria e shqiptarëve që luftojnë me Hysni Pashën. Hysni Pasha nuk vinte me 5 veta, por me mijëra për të shtypur kryengritjen shqiptare, kurse shqiptari i thotë «pritmë se të erdha», i tregon edhe taktikën e tij të luftës trup me trup.

Tash folklorin e popullit e kemi mbledhur dhe po vazhdojmë ta mbledhim. Por unë dua të përsërit, duke e theksuar, që ky folklor të mos rrijë i vdekur, dhe të mos mbetet vetëm në disa referate të disa studiuesve të Institutit të Folklorit, por të bëhet, e ritheksoj, objekt studimi i historianëve tanë, të periodizohet dhe pastaj të shkruhet në formë historike. Më 1848 populli shqiptar, në Jug e në Veri, ishte ngritur në kryengritje kundër feudalizmit otoman, prandaj të mos shkruhet se këto janë thjesht lëvizje kundër Tanzimatit, e histori të tjera me emra turq etj., etj. Sigurisht, këto lëvizje, konkretizoheshin në mospagimin e xhelepeve, në mosvajtjen nizam etj., etj. por shkaku dhe qëllimi kryesor i këtyre ishte lufta për çlirimin e vendit. Pse kjo luftë për çlirim shpërtheu kaq e fortë dhe u përhap në atë periudhë, këtë e tregojnë edhe këngët popullore, edhe situata e atëhershme ndërkombëtare.

Prandaj, duke e parë në prizmin marksist-leninist, shkrimin e Historisë së Shqipërisë duhet ta bazojmë në dokumente që hedhin dritë mbi fakte e prova reale. Natyrisht ka edhe dokumente të shkruara që gjenden në arkivat e vendeve të tjera, të cilat, tani për tani, nuk kemi mundësi t'i përdorim; por ne kemi arkivat tona të pasura me këngë popullore, të kënduara e të shkruara me një thjeshtësi dhe me një ekzaltim të madh pa-

triotik, me një saktësi të habitshme në përshkrimin e figurave, të aksioneve e të luftërave.

Pikërisht një veprimtari e tillë duhet ndërmarrë. Na përket neve, marksistë-leninistëve, të shkruajmë një histori të denjë të popullit tonë, për t'i treguar këtij populli se është vetëm ai që ka luftuar e ka derdhur gjakun lumë për lirinë dhe pavarësinë e tij, se nga gjiri i këtij populli kanë dalë trimat, udhëheqësit e luftërave dhe jo nga klasat shtypëse e shfrytëzuese, dhe se krahas këtyre njerëzve që janë shquar, ka pasur njerëz të tjerë të popullit që janë po aq të shquar, por që janë lënë në harresë. Historia, aq sa është shkruar, ka përmendur disa figura patriotësh, por nuk kanë qenë vetëm këto figurat e mëdha, sepse krahas tyre kanë qenë edhe figura të tjera jo më pak të rëndësishme, por akoma të panjohura nga publiku ynë.

Me sa kam lexuar, historitë e vendeve të tjera shkruhen nga historianë borgjezë. Ne, duke shkruar historinë e popullit tonë luftëtar, do të vëmë në dukje me të vërtetë rolin vendimtar të tij dhe njerëzit e shquar të dalë po nga gjiri i tij e që e kanë udhëhequr atë në beteja. Nuk duhet të qëndrojmë në pozitat e vjetra të hartimit të historisë sonë, e cila vërtet është trajtuar në prizmin marksist, por ky trajtim nuk është i plotë dhe ka boshllëqe. Këto boshllëqe, më duket mua, duhet t'i plotësojmë dhe për këtë çështje duhet t'i nxitim historianët tanë që të interesohen. Fakt është se folklori nuk vlerësohet sa duhet; janë fare pak veta që merren me studime në këtë fushë dhe që shkruajnë gjëra të vogla, të cilat shpesh nënvleftësohen e përçmohen. Ky është një gabim i madh. Është si puna e atyre shkrim-

tarëve që dikur nuk donin të shkruanin skenarë për filma, por i viheshin punës për të shkruar romane të mëdha. Që të shkruanin romane të tilla, natyrisht s'i kundërshtonte njeri, por edhe rëndësia e filmit është shumë e madhe. Por, një film pa tekstin nuk mund të xhirohet. Kështu që na është dashur ta nxitim një gjë të tillë dhe fakti është që tash ne kemi një numër të madh filmash jo vetëm me nivel të lartë artistik, por edhe me përmbajtje të thellë politike e ideologjike që të frymëzon. Kështu pra duhet të bëjmë dhe për epokat e ndryshme të historisë sonë. Nuk është keq të kemi një histori të përgjithshme, por kjo nuk mjafton. Duhet që për periudhat e ndryshme të thellohemi më tepër nga ana historike dhe këto të shikohen në prizmin e teorisë marksiste-leniniste e të dialektikës historike materialiste.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

DIREKTIVA ZBËRTHEHET DREJT, JASHTË SKEMAVE E SIABLLONEVE TË ZAKONSHME

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

8 shkurt 1978

Në këtë takim, shoku Ramiz Alia informoi për disa probleme të rrethit të Beratit, rreth të cilave u zhvillua kjo bisedë:

SHOKU RAMIZ ALIA: Isha në Berat dhe mora pjesë në një seminar për problemet e tregtisë. Seminari ishte një mbledhje e zgjeruar ku merrnin pjesë shokë nga të gjitha rrethet e zonës së Jugut. Referati që u mbajt trajtonte probleme të ndryshme që kishin dalë nga studimi që kishin bërë shokët e aparatit tonë dhe synonte në forcimin e punës së Partisë në sektorin e tregtisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Sektori i tregtisë është mjaft i koklavitur dhe nxjerr vazhdimisht probleme.

SHOKU RAMIZ ALIA: Dobësitë e tregtisë janë si domos në furnizimin e dyqaneve. Shpesh dyqanet i furnizojnë në kohën e punës dhe blerësit detyrohen të rrinë e të presin. Mall ka po radha formohet; të krijohet

radhë për një mall që mungon në treg, ka arsye, por, të krijohet ajo vetëm për mungesë organizimi dhe dobësi të tjera, kjo nuk është e drejtë.

SHOKU ENVER HOXHA: Këtu ka një çikë edhe tendencë nga ana e shitësit, për arsye se ata e bëjnë furnizimin në kohën e punës dhe jo shpejt. Kjo ka bërë që shitësi të mbyllë dyqanin edhe tri herë në javë nga një orë e gjysmë dhe nuk praktikohet furnizimi i dyqaneve natën, si kudo. Kështu shitësi rri një orë apo një orë e gjysmë jashtë orarit dhe e merr mallin në dorëzim pa penguar blerësit, po këtë nuk e bëjnë gjithmonë.

SHOKU RAMIZ ALIA: Një gjë tjetër është se nuk zbatohet ideja e madhe e Partisë, e kontrollit punëtor e fshatar. Më e keqja është se edhe inventarizimi nga ana shtetërore shpesh bëhet formalisht. Për shembull vete revizori për kontroll në dyqan dhe i numëron kutitë po nuk shikon çfarë kanë ato brenda. Çështja tjetër që desha të ngre ka të bëjë me problemin e ambalazhimit, të cilin ju e keni theksuar disa herë.

Pra, po t'u futemi si duhet këtyre problemeve, do të kemi rezultate më të mira se, në shumë prej tyre, kemi të bëjmë thjesht me çështje organizimi dhe llogarie.

SHOKU ENVER HOXHA: Te disa shitës të tregtisë sonë sundojnë akoma pikëpamjet e bakallit të dikurshëm.

SHOKU RAMIZ ALIA: Në bujqësi rrethi i Beratit detyrat i ka mjaft të ngjeshura. Aty më bëri përshtypje shumë të mirë fakti që ata kishin ngritur shkollat e përhapjes së eksperiencës së përparuar. Në to marrin

pjesë specialistë, brigadierë dhe kultivues të shquar. Bëhet teori e praktikë. Kishin organizuar edhe kontrollin e zbatimit të njohurive që merreshin nga këto shkolla.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë. Kjo është interesante, se vihet në baza të shëndosha përhapja e eksperiencës së përparuar. Nëpërmjet këtyre shkollave bëhet jo vetëm edukim e propagandë, por dhe punë konkrete.

SHOKU RAMIZ ALIA: Një problem tjetër që dëshon të ngre është puna e Partisë me kuadrin. Ne duhet të luftojmë për të rritur kërkesën ndaj kuadrove që dijenitë e tyre t'i vënë me të vërtetë në shërbim të popullit e të socializmit. Dijenitë që kanë fituar t'i vënë në zbatim dhe për këtë duhet të gjenden rrugët më të përshtatshme dhe të mos e kufizojnë veprimtarinë e tyre, si të thuash, vetëm në një rreth të ngushtë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po Partia përse nuk e bën këtë? Ne duhet të gjejmë se cilat janë arsyet që pengojnë. Mos është puna e rëndomtë dhe rutinë e disa kuadrove të Partisë? Mos vallë udhëzimet që jepen brenda në Parti nuk janë gjithmonë në atë nivel që t'u hapin horizont njerëzve? Apo për këto probleme nuk kërkohet sa duhet llogari në organizatën e Partisë? Këtu ka të bëjë edhe fakti se çfarë gjëra shtrohen për diskutim në organizatat-bazë. Gjithashtu, të kemi kujdes se mos Partia na bëhet si diçka e plotfuqishme që kërkon të imponojë një direktivë apo orientim me masa administrative e formale, se mos bëhet një punë shumë e rëndomtë në disa organizata-bazë. Se ndryshe s'ka pse të ngjasin këto gjëra.

SHOKU RAMIZ ALIA: Po të bisedosh me punonjësit e aparateve të Partisë, shpesh këto probleme nuk t'i thonë, se nuk i njohin. Kjo ndodh se nuk merren si duhet me to.

SHOKU ENVER HOXHA: Shqetësimin e kisha këtu, tek ajo që thashë, se mos direktiva apo orientimi i Partisë imponohet nga njerëz që nuk kanë horizont të gjcrë e nivel të lartë dhe që merren me disa gjëra të rëndomta, rutinë etj. Duke qenë të tillë, nuk shohin qartë dhe larg orientimin e Partisë, se ku synon ajo. Por të mos harrojmë se fjala e tyre merret si orientim, si direktivë. Ai vërtet është punonjës i aparatit të Partisë, po puna është se ç'tha, çfarë horizont hapi e përse orientoi? Bile, jo për një problem, por për disa probleme. Kështu duhet parë çështja. Në fakt thuhet: «nën udhëheqjen e Partisë», por duhet parë nëse udhëheq me të vërtetë Partia që njerëzit tanë të zhvillojnë plotësisht kapacitetet e tyre. Fjala vjen, me ekonomistët Partia duhet të luftojë që të aktivizohen sa më shumë e të dëgjohet fjala e tyre, se problemet e prodhimit ata i kuptojnë më mirë, pasi janë specialistë. Kjo është detyrë parimore, prandaj, kur ata bëjnë propozime të arsyeshme e me vlerë, ato të vihen në vendim e të luftohet për zbatimin e tyre. Po këto që ngrenë specialistët mund të mos i çojë atje ku duhet punonjësi i aparatit të Partisë. Po pse nuk i çon? Kjo duhet parë. Ka mundësi të ndodhë edhe ajo që themi ne, sklerozimi i punës së Partisë. Mbasandaj vjen ajo që përmendi këtu shoku Ramiz, se kemi gjithë këta kuadro, gjithë këta njerëz të mësuar, por dijet e tyre nuk i përdorin si duhet dhe presin e presin që t'i nxitë dikush. Por shpesh herë edhe

këtë nuk e bën njeri. Bile, ka nga ata që mund të thonë: «Unë të kam vënë këtu për këtë punë dhe ti vrit veten po deshe». Atëherë, ndodh ajo që thamë, që specialisti merret me gjëra të vogla e me punë rutinë.

SHOKU HYSNI KAPO: Rëndësi ka dhënia e direktivës dhe zërthimi i saj.

SHOKU ENVER HOXHA: Ja, konkretisht, mënyra se si e ka parë organizata e Partisë e Beratit çështjen e shkollës së përhapjes së eksperiencës së përparuar, është një gjë shumë e mirë që i orienton specialistët e punonjësit në teori e në praktikë. Ai që merr pjesë në këto shkolla nuk është i panjohur për ato probleme që trajtohen në to. Por, kur i shikon konkretisht ato atje në brigadën e rendimenteve të larta, bindet se si është vepruar praktikisht për të arritur ato rezultate. Kjo është një gjë e mirë, është një iniciativë jashtë rregullave dhe skemave të zakonshme. Kush e ka ndaluar atë që ta bëjë? S'e ka ndaluar njeri, po atij i ka punuar mendja një çikë më shumë pa e ka bërë këtë. Domethënë, një direktivë të Partisë, siç është ajo e përhapjes së eksperiencës së përparuar, ata e kanë zërthyer drejt. Kanë menduar të ngrihen shkolla të tilla në këtë dhe në atë kooperativë që shquhen për rendimente të larta, që nga fillimi e deri në fund e, në momentet kyç, edhe për problemet e bimëve bujqësore. Meqenëse aty është edhe agronomi, edhe veterineri, edhe brigadieri apo punëtori i dalluar, pra, tërë këta, kanë se ç't'u thonë atyre 100 vetave që kanë mbledhur në ato pesë ditë. Ka, pra, gjëra të tilla të mira që njerëzit i kanë zërthyer drejt direktivat e dhëna.

SHOKU RAMIZ ALIA: Në kalanë e Beratit pashë

një gjë fantastike, shoku Enver, që nuk e kisha parë ndonjëherë. Aty vizitova nja katër kisha të vjetra, në të cilat kishin restauruar pikturat e Onufrit.

Më bëri përshtypje një gjë, për të cilën u fola edhe shokëve të rrethit. Njëra nga këto kisha kishte ikonostas-in të punuar në dru. Kujdestari që ishte aty më tha se do të më tregonte një pëlhurë të vjetër. U skandalizova kur e pashë. Ishte një akt i vitit 1370 a 1380. Po si e mbani këtu këtë send me vlerë kaq të madhe, u thashë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ajo pëlhurë është e periudhës së anzhuinëve. Po pse, ashtu po e mbajnë atë? Është e tmerrshme!

SHOKU RAMIZ ALIA: Atë u thashë edhe atyre. Të merrni masa menjëherë për ta siguruar se kjo është një pasuri që nuk zëvendësohet kurrë.

SHOKU ENVER HOXHA: Duhet të jetë e frankëve, që venin në kryqëzatat që organizoheshin në atë kohë. Nuk i kuptojnë këto çështje, të cilat kanë një rëndësi të madhe artistike dhe historike.

SHOKU RAMIZ ALIA: Edhe për popullin tonë.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo nuk është një çështje fetare. Se mund të thotë tjetri, për shembull, për veprat e Onufrit, që kjo është ikonë. Mirë, por ne nuk e mbajmë për këtë qëllim, po si një pikturë me vlerë të madhe, të jashtëzakonshme, sepse ata që i kanë bërë janë piktorë të popullit tonë. Edhe ne kemi kaluar në ato periudha, si të gjithë popujt e tjerë dhe të parët tanë na kanë lënë gjëra të vlefshme, të cilat duhet t'i ruajmë, absolutisht duhet t'i ruajmë, se, siç thashë, kjo s'ka të bëjë fare me çështjen e fesë. Fenë ne e kemi luftuar

dhe do ta luftojmë, por këto objekte të çmuara do t'i ruajmë.

SHOKU RAMIZ ALIA: Kishat ishin shumë të vogla. Njëra prej tyre, tre muret e saj i kishte me afreske. Më tërhoqi vëmendjen se te dera ishte shkruar edhe data. Këtë e kishte shkruar vetë Onufri: viti 1580. Më bëri përshtypje shqiponja me dy krerë, e cila nuk ishte e vizatuar kështu siç e kemi ne sot: krahët dhe këmbët i kishte të ngritura një çikë lart, kishte marrë pak formën e shqiponjës natyrale.

SHOKU ENVER HOXHA: E ka karakteristikë Onufri këtë. Në librat që kam lexuar dhe në albumet që kam parë për të, figurat e tij janë të gjalla, njerëzore; nuk janë ashtu të ngrira si priftërinjtë e Bizantit, po u ka dhënë karakteristikat e njerëzve, të popullit. Këto duhet t'i ruajmë.

Botohet për herë të parë, sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar që gjendet në AQP

NË USITRI TË MOS KRIJOHET EUFORI

*Disa vërejtje për një film dokumentar
të një stërvitjeje ushtarake*

13 shkurt 1978

Kam disa vërejtje për një film të ushtrisë në lidhje me stërvitjen «Furtuna». E pashë këtë film dhe më pëlqeu, por kisha disa vërejtje, të cilat i bëra në mbarim të filmit.

E kam fjalën për dinamikën e kësaj stërvitjeje. Kjo dinamikë mund të bëhej më e gjallë, se sigurisht vetë stërvitja ishte e tillë. Por më ranë në sy disa gjëra që mund dhe duhej të dilnin më mirë, pse janë karakteristika të ushtrisë sonë dhe të stërvitjes ushtarake. Këtë qëllim kishte edhe filmi.

Çështja e parë është se filmi ka shumë zhurmë, me fjalë të tjera në film viheshin në dukje zhurmat, krismat e topave, të mitralozave, të minave etj. Kjo është e natyrshme, pse imitohej realiteti në luftime, por duhej që në këtë film këto të balancoheshin me paraqitjen e manovrimit e të lëvizjes së trupave. Ashtu si u ishte vënë rëndësi qitjeve, duhej të mos dukej qoftë edhe në masë të vogël një ngathtësi në lëvizjet e trupës, domethënë

të dukej mirë si komanda, por edhe forcat që hidheshin në luftime e në sulm. Ky manovrim në zbatimin e urdhrit të komandantit të paraqitej edhe në luftim, në mënyrë jo shabllone. Filmi të nxirrte në pah gjithashtu edhe veprimin e vetëveprimin e ushtarit që tregon shkathtësi e zgjuarsi në zbatimin e këtij ose të atij vendimi. Kjo gjë nuk dilte mirë në film.

Filmi nuk duhet të kishte thjesht karakterin e një skenari të përgatitur që më përpara dhe veprimet ushtarake të mos merreshin në mënyrë formale, shabllone. Por sulmet, ndaljet, zbrapsjet, futjet në llogore, goditjet e kundërshtarit etj. të merreshin në veprim e sipër, të ishin ca më të gjalla, jo si skena të organizuara. Të dilte më mirë në pah realiteti i stërvitjes, realitet që varet nga urdhri dhe nga zbatimi i tij, bile jo vetëm nga ky, por edhe nga taktika e nga sulmet e kundërshtarit.

Një çështje tjetër është ajo që, kur sheh filmin, të fiksohet më shumë në mendje problemi i bunkerëve. Shumë mirë janë bërë transhetë e bunkerët që për një luftë moderne, aktuale, duhen medocmos, por nuk duhet zmadhuar shumë kjo anë, pse mund të lihet përshtypja sikur nesër lufta do të jetë vetëm një luftë transheje, do të bëhet nëpërmjet bunkerëve nga frëngjitë e të cilëve «këndon» mitralozi. Në luftë ne do të mbrohemi edhe në bunkerët për një kohë, po pastaj do të dalim prej tyre dhe do të sulmojmë, nga bunkerët do të mbrojmë edhe shokët që do të sulmojnë armikun në luftimin me bajonetë e trup me trup. Këtu duheshin treguar shkathtësia e karakteri guximtar i ushtarit tonë, pse në luftërat e ardhshme, ashtu si edhe në luftërat e mëparshme, ndeshjet trup me trup do të ekzistojnë. Në luftë

ne do të kemi të bëjmë edhe me armikun që na vjen përpara bunkerëve, por do të kemi të bëjmë edhe me parashutistët që na vijnë prapa bunkerëve, të cilët do t'i sulmojmë dhe do t'i asgjësojmë.

Në përgjithësi, në këtë film unë nuk pashë të paraqitet një aktivitet i tillë i ushtrisë sonë, atje paraqiteshin më shumë dalje nga transheja, futje në transhe dhe zjarra nga bunkerët. Po kështu lufta trup me trup duhet të tregojë edhe forcën fizike, gjallërinë dhe shpejtësinë në sulm, që karakterizon e do të karakterizojë luftën e Ushtrisë sonë Popullore.

Çështja tjetër që më ra në sy ishte veprimi i desantit detar. Ky tregohet cekët, paraqiteshin një varkë dhe 3-4 të vrarë në plazh. Mundet që varkat në det të mos dukeshin, por sulmi mbi plazhet tona të tregohet më realisht, në mënyrë më masive dhe jo me qindra armiq të binin në rërë. Që duheshin paraqitur një pjesë e këtyre në film, kjo është e kuptueshme, por të tregoheshin po ashtu se disa të tjerë do ta kapërcenin bunkerin, domethënë vijën e parë të mbrojtjes dhe do të ndodheshin në mes vijës së parë dhe vijës së dytë të mbrojtjes sonë. Kjo nuk paraqitet, jepej pra përshtypja sikur desanti do të ishte i parëndësishëm, gjë që nuk është kështu, pse armiku që do të na sulmojë nga deti do t'i bëjë llogaritë mirë, ai do të sulmojë me egërsi dhe me vllaga të njëpasnjëshme për të kapur pozicionet tona, për të na kapur bunkerët dhe për të siguruar terren ku të zbarkojë. Një eventualitet i tillë që duhej të tregohet më mirë, i mungonte filmit. Në film dhe në stërvitje, natyrisht, është e nevojshme të pasqyrohet se ushtria jonë do të përballojë variantet më të vështira dhe jo sikur bunke-

rët nuk kanë çfarë të bëjnë, jo sikur brezi i parë vepron dhe mbetet i paprekshëm, sepse në realitet nuk do të ngjasë kështu.

Çështja tjetër, që më ra në sy në këtë film, është paraqitja shumë mekanike, shumë zyrtare dhe në tavolinë e shtabeve. Kjo përshtypje m'u krijua, pavarësisht se kuadrot thoshin «me vendim të Partisë» etj., etj. dhe vrap e në telefon. Unë nuk i pashë pjesëtarët e këtyre shtabeve tamam të shqetësuar, nuk pashë në to njerëz me nerva të ngritur në momente të rënda. Përveç kësaj, nuk më zuri syri që komandantët ose komisarët të dilnin nga llogoret tok me ushtarët dhe të hidheshin në sulm. Drejtuesit njihen nga kasketa, por kjo çështje duhet parë, pse do të jetë komandanti ai që do të japë urdhrin, por shumë herë ai do të japë edhe shebullin personal për togën apo për kompaninë e tij që lufton. Ai duhet të duket kudo, të jetë në ballë të luftës. Me këtë nuk dua të them që komandanti apo komisari të zëvendësojnë ushtarin, por sidoqoftë të shihen më qartë udhëheqja, komanda, shtabi.

Në fillim thashë se dëgjohej shumë zhurma e topave, e pushkëve, e mitralozave të të gjithë kalibrave, por nuk pashë mortaja dhe del pra sikur këto armë s'kanë rëndësi në luftimin tonë, prandaj edhe këto mendoj të plotësojnë filmin, pse mund të lihet përshtypja sikur nga ne nuk u vihet rëndësi këtyre lloj armëve.

Duke bërë vërejtje për filmin e kam fjalën që kur bëjmë një stërvitje ushtarake jo vetëm duhet ta hartojme mirë atë në teori, por sidomos ta ndërtojmë e ta zbatojmë mirë në praktikë, të jetë ajo një stërvitje e shkathët, e manovrueshme. Sot ne kemi kuadro dhe

ushtarë të ngritur teorikisht, që njohin mirë edhe Artin Ushtarak të Luftës Popullore, por e kam fjalën që teoria të vlerësohet drejt dhe të mos mbivlerësohet nga praktika. Kjo teori të zbatohet si duhet në kohën edhe në vendin e vet.

Edhe kur bëhet analiza e një stërvitjeje, rekomandoj që ajo të mos bëhet në forma të përgjithshme, por t'u futet mirë anëve kritike të saj, të vihen në dukje anët e mira dhe të metat. Unë nuk i përjashtoj rezultatet e mira, se këto kanë të bëjnë me stërvitjen e vazhdueshme të ushtrisë, por rezultatet e mira të mos e bëjnë ndonjë shok që të zvogëlojë boshllëqet e konstatuara, të cilat duhen vënë në dukje e të mos përsëriten. Me këtë dua të them që në ushtri nuk duhet të krijohet eufori, por të krijohet një mendim serioz me shumë përgjegjësi, nga ushtarët dhe nga oficerët, sepse në kohë lufte euforia shkakton dëme të mëdha, kurse në ushtrinë tonë, në komandat, në shtabet dhe në kuadröt e saj, në organizatën e Partisë në radhë të parë, duhet të sundojnë pjekuria, guximi, manovrimi, dhënia e drejtë e mendimit dhe zbatimi i shpejtë e me sukses i tij.

Të mos harrojmë vetëkënaqësinë që mund të krijohet te kuadro të ushtrisë, që rrjedh edhe nga mbeturinat e frymës së vjetër në ushtri, e cila nuk duhet konsideruar e zhdukur plotësisht, pasi akoma ka mbeturina të kësaj fryme, ka prirje të raportimit formal dhe të zbulimit të anëve të zbatimit.

Kur thashë për shtabet që m'u dukën të ngrira, e kam çështjen e kontaktit të kuadrit me ushtarët. Të them të drejtën unë nuk i kam shumë qejf bisdat e

marrëdhëniet me letra. Mirë që zbërthehen mendimet, bëhen debate e jepen sqarime e porosi, por, po të jetë e mundur, këto të bëhen gojarisht. Por në luftë duhen përdorur të gjitha mjetet, që nga letra e deri te telefoni. Në përgjithësi, si kudo, ca më shumë në ushtri, nuk mjafton vetëm dhënia e urdhrit te vartësi, as përgjigjja «si urdhëron» e të kënaqemi me kaq. Vartësit dhe eprori duhet të shkëmbejnë mendime me njëri-tjetrin dhe ta ndjekin këmba-këmbës zbatimin e urdhrit apo të vendimit, se nga zbatimi i tyre ne duhet të nxjerrim konkluzione. Konkluzionet janë sinteza e këtij apo e atij problemi, e këtij apo e atij ushtrimi, e kësaj apo e asaj stërvitjeje apo çështjeje që kemi përpara dhe kjo vlen jo vetëm për ushtrinë, po për këdo. Të gjitha këto e pasurojnë teorinë që nesër ta zbatojmë më mirë, më me efekt, pse nga praktika janë nisur klasikët e marksizëm-leninizmit që kanë nxjerrë konkluzione dhe ligje që aktualisht ne i studiojmë dhe udhëhiqemi prej tyre.

Këto vërejtje mbi këtë film ua thashë shokëve sekretarë, veçanërisht shokut Hysni, që mundësisht t'i ketë parasysh, të bisedojë me shokët e aparatit të Komitetit Qendror që merren me çështjet ushtarake, në mënyrë që, në qoftë se do të bëhen disa korrigjime, filmi të përmirësohet në këto drejtime dhe aspekte që përmenda, për arsye se ky për të cilin flas është një film stërvitor.

Po ashtu u thashë shokëve sekretarë që nuk është mirë të bëjmë shumë lëvizje kuadrosh në ushtri dhe të kemi parasysh frymën e vjetër për këtë problem. Në kohën e Beqir Ballukut me shokë, oficerët bridhnin

me lecka në krahë, nuk u jepej mundësia të njiheshin me ushtarët, me popullin, me terrenin ku do të luftonin, por lëviznin pa kriter, sipas qejfit të njërit apo të tjetrit. Në lëvizjet e dikurshme kishte shumë subjektivizëm, kishte shumë hatëre nga Petrit Dumja dhe shokët e tij.

Tani në ushtri ne kemi ngritur shumë kuadro të rinj. Kjo është jashtëzakonisht e mirë, por këta kuadro duhen lënë për shumë kohë në repart, të mos lëvizin, t'i njohë ushtria, t'i njohin ushtarët, t'i njohë populli, të lidhen me të ngushtë, të njohin terrenin, prandaj në lëvizjen e tyre shoku Hysni dhe shokët e Ministrisë së Mbrojtjes duhet të bëjnë kujdes.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PUNA E GJYKATAVE DHE E PROKURORIVE — TREGUES I RËNDËSISHËM I ZHVILLIMIT TË LUFTËS SË KLASAVE

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit
të Kuvendit Popullor të RPSSH¹*

24 shkurt 1978

Kam përshtypjen se po jepen shumë gjopa nga gjykatat e fshatrave dhe kështu, në vend që këta të merren kryesisht me punën parandaluese ndaj veprimtarisë keqbërëse, po anojnë më tepër nga dënimet. Kjo punë duhet kontrolluar më mirë nga gjykatat e rretheve dhe nga Gjykata e Lartë.

Organizatat e Partisë dhe levat e tyre në fshat, me sa duket, nuk bëjnë përpjekje të mjaftueshme e serioze që t'i sqarojnë e t'i bindin kooperativistët me qëllim që ata të mos e shkelin statutin e kooperativës, që të mos e dëmtojnë pasurinë kooperativiste dhe, për rrjedhim, të mos gjykojnë e të mos gjobiten kështu.

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur për punën e bërë nga organet e prokurorisë për verifikimin në praktikë të saktësisë dhe të drejtësisë së ligjeve.

Gjyqtarët e gjykatave të fshatrave zor se u bëjnë kritika në mbledhjet e organizatave-bazë shokëve të kryesisë së kooperativës kur këta kanë kërkuar gjykimin e shumë kundërvajtjeve. Por edhe në qoftë se këta kanë kritikuar ndonjëherë, nuk ua ka vënë kush veshin kritikave të tyre. Gjykatat duhet të vendosin pushimin e çështjeve kur çmojnë se qëllimi edukativ i dënimit është arritur dhe nuk është nevoja për gjykitje. Këto organe shtetërore duhet të shqyrtojnë vetëm kundërvajtjet që meritojnë të gjykohen e të ndëshkohen sipas ligjit. Ky problem duhet shikuar në radhë të parë politikisht. Jam i bindur se shumë nga shkeljet e ligjit do të evitoheshin në qoftë se do të bëhej një punë politike e vërtetë, sqaruese, bindëse dhe e gjithanshme nga gjykatat e fshatit, nga këshillat popullorë dhe nga kooperativat bujqësore.

Ndodhë nganjëherë që, megjithëse flasin për ruajtjen e pasurisë socialiste, duke filluar nga kryetari i këshillit popullor, i kooperativës e deri te sekretari i organizatës-bazë të Partisë, lëshojnë bagëtitë e tyre personale në arat e kooperativës. Ka pasur raste kur këta nuk i ka gjykuar gjykata e fshatit, e cila është marrë më tepër me kooperativistët e tjerë.(!) Ky qëndrim nuk është i drejtë, pse prek parimin kushtetues të barazisë së të gjithë shtetasve përpara ligjit.

Komitetet e Partisë, komitetet ekzekutive dhe gjykatat e rretheve duhet ta shikojnë shkeljen e ligjeve si cenim të drejtpërdrejtë të interesave të Partisë e të socializmit. A ka interes shoqëria jonë socialiste që të shtohen radhët e keqbërësve dhe për rrjedhim numri i të dënuarve? Kurrë! Duke ndëshkuar një, dy, tre apo

katër herë me gjobë fshatarët, që janë njerëzit tanë, krijohet pakënaqësi në masat e popullit. Natyrisht, ata që gjobiten kanë bërë kundërvajtje, por kjo nuk do të thotë që, herë pas here, të mos shikohet nëse po gjobohen e po dënohen shumë fshatarë, me shumë faj ose me pak faj, që mund të bëhen të pakënaqur. Këtë pakënaqësi ata nuk e kanë vetëm për gjykatën që i gjykon e i dënon, por edhe për organizatat shoqërore, për këshillin popullor të fshatit etj., me kërkesën e të cilëve ka filluar procedimi i kundërvajtjes. A studiohen në këtë prizëm nga gjykatat dhe nga Partia këto gjykime? Unë mendoj se kjo punë me shumë vlerë nuk bëhet vazhdimisht e në mënyrë të thelluar.

Është fare kollaj të jepen gjoba për kundërvajtje në fshat, por është e domosdoshme të shihen shkaqet dhe arsyet përse vërtetohen kaq shumë kundërvajtje. Që të eliminohen sa më shumë këto, duhet të gjenden shkaqet. Po të vazhdohet kështu, që ilaçi i parandalimit të kundërvajtjeve të kufizohet vetëm te gjobat, pakënaqësia do të shtohet shkallë-shkallë dhe do të arrijë deri në atë masë sa ndryshimet sasiore të kthehen në ndryshime cilësore. Shokët që drejtojnë dhe punojnë në organizatat-bazë të Partisë, në këshillat popullorë, në kryesitë e kooperativave, në gjykatat dhe në prokuroritë duhet ta kuptojnë këtë proces që mund të ndodhë. Këtu nuk është fjala që shokët të tregohen liberalë ndaj zbatimit të ligjeve. Përkundrazi, çështja shtrohet që të luftohet qëndrimi sektar, pra kërkohet që të jemi të drejtë dhe t'i gjykojmë gjërat me gjakftohtësi. Partia kërkon të trajtohen drejt kontradiktat që lindin në

shoqërinë tonë dhe të ruhet uniteti në rrugën e zbatimit korrekt e të matur të ligjeve në fuqi.

Partia kërkon që ligjet tona të jenë sa më të drejta dhe vendimet që do të jepen në bazë të tyre të jenë sa më të pjekura. Në këtë drejtim punonjësit e organeve të drejtësisë, kanë një detyrë të rëndësishme sepse, siç dihet, ligji shpreh vijën e Partisë, prandaj, duke zbatuar ligjin drejt, mbrohet edhe vija e Partisë. Vija e Partisë si kudo edhe në fushën e zbatimit të ligjeve nuk realizohet duke u hedhur nga njëri ekstrem në tjetrin, nga oportunizmi në sektarizëm, por duke ecur me vendosmëri e pa lëkundje në rrugën e drejtë. Kjo gjë, mjerisht, harrohet nga disa shokë në bazë. Prandaj të ngrihet zëri ndaj cilitdo, qoftë ky edhe sekretar i Partisë, kur vërehet se nuk i kushton vëmendje politikës së dënimeve. T'i tërhiqet vëmendje cilitdo që mendon se na shërben dënimi i pakufizuar i njerëzve.

Ndërhyrja për të korrigjuar të metat e njëri-tjetrit është reciproke. Edhe Partia, që udhëheq, ndërhyr tek organet e drejtësisë që këto të marrin vendime të bazuara në ligj, por edhe organet e drejtësisë, si ndihmëse të Partisë, bëjnë vërejtje për të vënë rregull e disiplinë atjo ku konstatojnë se shkelen ligjet. Duhet të jemi të tërë të gatshëm që të mbrojmë vijën e Partisë. Të mos ketë ngurrime për kritikë edhe pse ai që duhet kritikuar mund të jetë zgjedhur në byronë e organizatës. Asnjëri, kudo që të jetë dhe çfarëdo përgjegjësie që të ketë, nuk i lejohet që të mos thellohet përse janë bërë këto apo ato faje, që duhet të ndreqen jo vetëm me masa administrative, por kryesisht e në radhë të parë me një punë politike intensive. Që kuadri për-

gjegjës të ecë mirë, kur është rasti, duhet ta ngresh problemin edhe në konferencë, bile ta kritikosh edhe me emër si person apo edhe si forum. Ndryshe kontradiktat që lindin do të thellohen dhe zgjidhja e tyre me vonesë do të na kushtojë. Po zbatuam drejt vijën e Partisë sonë, që mbështetet në marksizëm-leninizmin, punët do të na shkojnë mirë edhe në këtë drejtim.

Gjykata e Lartë, në bazë të kontrollit që ushtron në veprimtarinë gjyqësore dhe administrative të të gjitha gjykatave, ka për detyrë, veç të tjerave, edhe të përgjithësojë eksperiencën e punës. Është detyrë e saj të studiojë uniformitetin në zbatimin e ligjit dhe në dhënien e gjykimeve nga gjykatat e shkallëve të ndryshme. Duke qenë i detyruar të zbatojë ligjin me përpikëri, çdo gjyqtar studion përmbajtjen e tij. Kjo hyn, si të thuash, në anën teorike të ligjit. Kur vjen çështja e zbatimit konkret të këtij ligji, nuk ka kurdoherë uniformitet nga gjykatat e rretheve të ndryshme. Natyrisht, ngjarjet dhe veprimet e njerëzve nuk janë kudo njësoj. Është e njohur se kryerja e veprës penale realizohet në rrethana të ndryshme, të cilat trupi gjykues doemos i merr parasysh. Këto rrethana janë: mënyra e kryerjes së krimit, motivet, objekti që pëson goditjen, rrethanat familjare apo personale të fajtorit, pasojat e veprimtarisë së rrezikshme, shkalla e organizimit të veprës, numri i personave që marrin pjesë në të etj. Por në zbatimin e ligjit penal nuk mund të mos merren parasysh gjithashtu edhe gjendja e përgjithshme politike e rrethit, dinamika e kriminalitetit në rreth, disa zakone të këqija që ndikojnë më tepër etj., etj. A bëhen herë pas here përgjithësime për më-

nyrën e zbatimit të ligjeve nga gjykatat dhe a u shërbejnë këtyre organeve statistikave e përqindjet që të dalin me konkluzione shkencore për uniformitetin e zbatimit të ligjit në dhënien e vendimeve? Jam i mendimit se pavarësisht nga larmia e rasteve në praktikën gjyqësore nuk duhet të ndodhë që një vjedhje e një shume të caktuar të hollash, për shembull, të dënohet në gjykatën e një rrethi me dy vjet dhe në gjykatën e një rrethi tjetër me tetë vjet heqje të lirisë. Këto diferencime të pajustificueshme edhe mund të ngjisnin përpara kur niveli ideopolitik, kulturor e profesional i gjyqtarëve tanë nuk qe ky i sotmi. Shkohet apo nuk shkohet drejt përmirësimit në këtë drejtim? Nuk e kam fjalën këtu për standardizimin e dënimeve, që ne e kemi kritikuar me të drejtë, por dua të theksoj se gjykata, kur cakton masën e dënimit, duhet ta vlerësojë drejt shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale e të fajtorit, shkallën e fajësisë dhe rrethanat e tjera që shoqërojnë veprën penale. Të mos veprohet kurrë në mënyrë arbitrare, duke u lënë fushë veprimi subjektivizmit të gjyqtarëve. Puna e gjyqtarëve duhet vlerësuar nga fakti nëse ata mësojnë apo nuk mësojnë nga teoria dhe praktika gjyqësore, nëse bëjnë apo nuk bëjnë përparime në këtë fushë. Natyrisht, unë e kam fjalën më shumë për gjyqtarët e gjykatave të rretheve, e jo për ata të gjykatave të fshatrave dhe të lagjeve të qyteteve që nuk janë juristë.

Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, që janë organe me rëndësi të shtetit të diktaturës së proletariatit dhe që mund të japin një kontribut shumë të madh në studimin e problemeve shoqërore dhe evo-

lucionin e tyre, u rekomandoj të aktivizohen shumë në këtë drejtim. Në punën e përditshme gjykatat e prokuroritë kanë të bëjnë: me veprimet e njerëzve në jetë, me shfaqjet e mendimeve të tyre në shoqëri, me përplasjen e së resë me të vjetrën, me lindjen, pjekjen dhe zgjidhjen e kontradiktave të ndryshme që manifestohen në vetë thelbin e luftës së klasave, prandaj, këto organe, nuk duhet të kufizohen vetëm në gjykimet e rasteve që u paraqiten, se këtë punë, në bazë të ligjit, borgjez, e bën edhe gjykata borgjeze, por ato duhet të nxjerrin prej tyre mendime të përgjithshme për zhvillimin konkret të shoqërisë sonë. Puna e gjykatave dhe e prokurorive është një nga indikatorët më të rëndësishëm të zhvillimit të luftës së klasave dhe të formave të ndryshme që merr kjo luftë. Në praktikën e punës së tyre verifikohet saktësia dhe drejtësia e ligjeve tona, si dhe efekti që bëjnë këto ligje në masat e gjera të popullit.

Unë kam respekt të madh për punën e organeve të drejtësisë, prandaj dua që njerëzve që punojnë në këta sektorë t'u hapen horizonte më të gjera studimi e përgjithësimi. Dëshiroj të shoh nga juristët tanë të shkruajnë libra për zhvillimet me karakter historiko-shoqëror të krahinave të ndryshme. Deri tani unë nuk kam parë nga gjyqtarë me eksperiencë botime të kësaj natyre, megjithëse ata kanë një material të pasur faktik në duart e tyre. Këto studime duket sikur u janë lënë në dorë vetëm disa shkrimtarëve, sociologëve, historianëve ose filozofëve. Nuk them që këta të mos merren më me studime të tilla, përkundrazi le të merren sa më shumë, por mua më duket se gjyqtarët, prokurorët e

punonjësit e Organeve të Punëve të Brendshme, janë në radhën e parë të ballkonit të teatrit të shoqërisë sonë dhe i shikojnë ngjarjet, proceset e fenomenet shoqërore në lëvizje e në veprim.

Që ta kryejnë mirë këtë detyrë, gjyqtarët e prokurorët doemos duhet edhe të studiojnë. Të mos kufizohen vetëm me studime të karakterit ngushtësisht juridik, por të studiojnë edhe historinë e zhvillimit ekonomik, shoqëror e politik të Shqipërisë, dhe veçanërisht të krahinave të veçanta të saj në periudha të ndryshme. Kështu, për shembull, gjyqtarët e Gjirokastrës duhet të dinë edhe evolucionin e shoqërisë në rrethin ku punojnë e jetojnë, zakonet dhe normat e sjelljes që janë zbatuar në periudha të ndryshme historike etj. Kjo është një kërkesë e domosdoshme për punën e çdo gjyqtari, i cili është kuadër që jeton në një shoqëri të tillë revolucionare ku zhvillohet luftë e ashpër me mbeturinat e vjetra të shoqërisë, me zakonet prapanike, me hatëret e me të gjitha shfaqjet tipike të botës së vjetër. Prandaj, në këtë drejtim, edhe Gjykata e Lartë edhe Prokuroria e Përgjithshme duhet ta vënë më mirë ujin në zjarr. Me konkluzionet dhe shkrimet e tyre, në drejtimet që përmenda, ata do t'i bëjnë një shërbim të madh Partisë, zhvillimit të luftës së klasave dhe progresit shoqëror. Unë nuk dua të them se gjykatat dhe prokuroritë tona nuk kanë dhënë asgjë në fushën studimore, por desha të shtroj disa kërkesa që mendoj se mund t'i kenë më mirë parasysh në punën e tyre në të ardhmen.

Ka rëndësi të madhe që të studiohet edhe përmbajtja klasore e ligjeve të borgjezisë e të feudalizmit para

çlirimit në vendin tonë dhe vendimet që jepeshin në bazë të tyre, në disfavor të masave të popullit të shtypur. Pjesa më e shtypur e popullit tonë ka qenë fshatarësia, mbi kurrizin e së cilës ka rënduar më tepër rreptësia e ligjit të klasës sunduese. Prandaj gjykimet e zhvilluara kundër fshatarësisë në kohën e regjimeve të kaluara, përbëjnë një fushë me rëndësi historike e shoqërore për t'u studiuar. Ne të gjithë e dimë, për shembull, që fshatarësisë sonë i ishte rrëmbyer toka që ajo punonte; dimë që ajo rëndohej me shumë taksa, që bejlerët e shfrytëzonin gjer në palcë, se këto janë të tëra të shkruara. Por puna është të njohim në mënyrë shkencore se si e mbronte ligji dhe gjykata shtypësin, si e mbronin padrejtësinë të ashtuquajturat organe të drejtësisë etj. Prandaj, në këtë drejtim mendoj se duhet të studiojnë më shumë. U bie për detyrë jo vetëm historianëve, por, në radhë të parë, gjyqtarëve e prokurorëve që të gjejnë kohë e t'i studiojnë me kujdes këto dosje gjyqësore, që kanë zënë pluhur. Për këtë qëllim, për të plotësuar këtë detyrë me rëndësi të madhe, të programohet puna dhe të caktohen njerëzit më kompetentë. Nuk është kohë e humbur të shfletosh dokumentet në dosjet e vjetra dhe, në dritën e materializmit historik, të nxjerrësh prej tyre konkluzione teorike, shoqërore e historike. Gjer më sot unë nuk kam parë ndonjë studim të botuar për këto probleme.

Në arkivat ka dokumente me vlerë të madhe, të cilat, gjer më sot, kanë mbetur të vdekura. Prandaj ndodh që kur flitet për historinë e vendit tonë, shumë prej nesh hapin sytë nga habia. Të tërë e ndoqëm mbrë-

më emisionin televiziv për jetën e Hasan Tahsinit. Disa nga ne ndoshta nuk e dinin që ky filozof dhe enciklopedist kaq i madh i shekullit të kaluar ka qenë rektor i Universitetit të Stambollit. Ai kishte një kulturë kaq të gjerë saqë studionte me kompetencë në fusha të ndryshme, që nga logaritmet e deri tek astronomia. Ai njihte thellë filozofinë e iluministëve francezë, zotëronte teorinë e Dekartit etj., etj. A diheshin të gjitha këto për një figurë të tillë të Shqipërisë si Hasan Tahsini? Jam i mendimit se nga shumë njerëz nuk diheshin në atë shkallë që u dhanë në televizor. E solla këtë shembull për të treguar se këto të dhëna gjenden në dosjet që përmbajnë dokumente të historisë së vendit tonë, të popullit tonë, të jetës së njerëzve a shtresave të caktuara të shoqërisë sonë.

Punonjësit e organeve të drejtësisë duhet të ndjekin zhvillimin historik të mendimit politik, shoqëror dhe juridik. Studimet e konkluzionet që nxjerrin të na i dërgojnë dhe neve, organeve të Partisë e atyre shtetërore, që të njihemi me to e të na shërbejnë për drejtimin sa më të mirë të punëve.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Presi-
diumit të Kuvendit Popullor të
RPSSH, që gjendet në AQP*

FORCIMI EKONOMIK I KOOPERATIVAVE BUJQËSORE KËRKON RRITJEN E PJESËMARRJES NË PUNË

Shënime

24 shkurt 1978

Me shokët sekretarë të Komitetit Qendror pata sot një bisedë për kooperativat bujqësore. Ne kemi suksese në kooperativa, por konstatojmë edhe të meta serioze, që po të eliminohen, sukseset do të jenë më të mëdha.

Gazetat vënë në dukje herë pas here, bile edhe sot, se ka rrethe me toka shumë të mira, nën ujë, por që nuk i zbatojnë mirë dhe në kohën e duhur metodat agroteknike, i lënë ato pas dore, gjë që, natyrisht, ka efekte negative në rendimentin e prodhimit. Merren mjaft vendime dhe bëhen mjaft mbledhje, na thuhet se bëhen diskutime të mira, por kur vjen puna për zbatimin e këtyre vendimeve dhe për zbatimin e agroteknikës ka shumë të meta, shumë lëshime dhe një qëndrim oportunist. Mendoj se Partia dhe organet e pushtetit duhet t'i bëjnë një analizë të thellë të metave që konstatohen në zbatimin e rregullave të agroteknikës dhe të detyrave, si në sasi, në cilësi dhe në kohë, pse kam përshtypjen që po ecet me metoda të vjetra pune

me një formë të vjetër kontrolli të vendosur prej kohësh, që në momente të caktuara kanë dhënë efekte dhe rezultate, por që aktualisht, kur bujqësia është zhvilluar, u ka kaluar koha. Zhvillimi aktual dhe kërkesat e mëdha që kemi vënë para bujqësisë lypin që detyrat të zërthehen mirë, të zbatohen mirë, të kontrollohen mirë.

Por këto jo kudo bëhen mirë. Megjithëse është grumbulluar mjaft eksperiencë, në praktikë shohim se zërthimi teorik i problemeve dhe ndjekja për zbatimin e detyrave nuk bëhen në atë shkallë, në rreth edhe në qendër, që të merren masa të përshtatshme për ta përmirësuar vazhdimisht gjendjen. Ç'konstatojmë ne? Konstatojmë se bëhen pak ditë-punë, njerëzit si pa të keq e lënë punën ose nuk dalin fare, venë nga një fshat në tjetrin etj. Për këto lëvizje ndihmon edhe vendosja e autobusëve që qarkullojnë disa herë në ditë, edhe kur nuk është nevoja. Nga Divjaka deri në Lushnjë autobusi shkon tri-katër herë në ditë.

Kështu, fshatarëve të Divjakës, që i kanë në fshat të gjitha ç'u duhen, venë në Lushnjë për të shitur 3-4 vezë, në një kohë kur në kooperativë vlon puna. Shtëpinë e kulturës ata e kanë të mrekullueshme, doktorët te dera e shtëpisë, kanë gjithashtu farmacinë e tyre, dyqanet dhe çdo gjë tjetër. Atëherë përse lënë punën e shkojnë në Lushnjë? Mos favorizon këtu edhe autobusi edhe fakti që bileta e udhëtimit është shumë e lirë dhe kështu kooperativistit të Divjakës, për shembull, s'i prishet asgjë po të mos dalë në punë një ditë e të shkojë në qytet?

Si kudo, por veçanërisht në bujqësi, rëndësi të ma-

dhe ka norma e punës. Me sa duket, normat në disa procese pune janë të ulëta. Këtë përfundim e nxjerr nga fakti se numri i ditë-punëve normë për çdo kooperativist, si mesatare, del më i madh nga numri i ditëve kalendarike që ata punojnë efektivisht gjatë vitit. Ne kemi kooperativa të mira që bëjnë edhe 220-230 ditë kalendarike në vit. Po në ditët e tjera çfarë bëjnë këta kooperativistë? Një pjesë bëjnë punë vetjake, shkojnë në qytet, ruajnë pulat në oborr, se mbajnë nga 50-60 pula deti, dhe arrijnë të fitojnë prej tyre afro dy-tre mijë lekë në vit. Më kanë thënë se në atë pak oborr sa një shami xhepi, fshatarët marrin zarzavate e produkte të tjera që nuk i përdorin vetë, por për t'i shitur. Ç'tregon kjo? Kjo tregon se interesi personal shpeshherë vihet mbi interesin e përgjithshëm. Nga ana tjetër, duket se nga përparimi i bujqësisë, që, natyrisht, është rezultat i punës së mirë që është bërë nga fshatarësia kooperativiste, ka lindur ndjenja e vetëkënaqësisë.

Kur flasim për normat e punës si bazë për caktimin e ditë-punës normë, ato duhet të kontrollohen mirë në sasi dhe në cilësi, sepse po nuk u kontrollua ashtu si duhet, atëherë mund të shkruhen ditë-punë më shumë nga ç'ka në realitet. Me këto lloj normash edhe mobilizimi në punë nuk nxitet e nuk është në atë masë që kërkohet, gjë që reflektohet në mosrealizimin e planit dhe bën që përparimi ynë të mos jetë aq i madh, në përputhje me kushtet e bujqësisë sonë. Kush duhet ta kontrollojë këtë gjë? Natyrisht kjo është një detyrë e madhe partie. Është detyrë partie, në radhë të parë, puna me njerëzit që këta të kuptojnë rëndësinë e shken-

cës e të diturisë dhe të punojnë vazhdimisht për t'u pajisur me to e për t'i zbatuar në jetë e në praktikë. Që të realizohet kjo kërkohet që Partia në rreth e në bazë të bëjë një punë politike intensive për ngritjen e ndërgjegjes së fshatarësisë kooperativiste. Kjo, në një shkallë të konsiderueshme, bëhet, por është fakt se duhet akoma shumë punë për formimin e plotë të ndërgjegjes proletare, prandaj kemi edhe thyerje të disiplinës në punë.

Çështja tjetër është që brigadat në kooperativa kanë nga 60-70 veta dhe 60-70 bile edhe 80 hektarë tokë në fushë ose në mal, duke pasur vetëm një brigadier. Çfarë detyrash ka konkretisht ky? Të gjitha detyrat ia kemi ngarkuar këtij njeriu, kapaciteti i të cilit edhe fizikisht, edhe nga ana e njohurive është mesatar. Kërkesat janë që ky të organizojë punën e brigadës, të skuadrave, të kontrollojë e të shënojë normat, të bëjë borderotë, të bëjë instruktazhin e brigadës, të interesohet për plehun dhe për farën. Pra, për të gjitha duhet të interesohet ky njeri. Mirëpo a është në gjendje ai ta bëjë këtë gjë, kur, përveç këtyre detyrave, i është caktuar të bëjë edhe 100 ditë-punë në prodhim? A është e mundur kjo? Qoftë fizikisht po dhe nga kapaciteti kjo është e pamundur. Për këtë arsye shohim që në fushat tona nuk ka zbatim të rregullt të planit, nuk ka zbatim të rregullt e shkencor të agroteknikës, nuk ka kontroll të rreptë të zbatimit të normave e të ditëve të punës, nuk ka një organizim të mirë dhe nuk bëhet si duhet një instruktazh shpirtëror, politik e teknik i brigadës dhe i skuadrave. Prandaj ç'duhet bërë në këtë rast? A duhet të sakrifikojmë gjë-

thë të ardhmen, gjithë këtë përparim material dhe moral e të mos shtojmë një normist në brigadë? Mua më duket se nuk bëjmë ndonjë sakrificë të madhe duke shtuar një normist, vetëm se këta njerëz duhet të zgjidhen, të instruktohen e ta kryejnë si duhet detyrën tok me brigadierin, tok me komunistët dhe me kooperativistët që janë në brigadë. Por është fakt se për këto detyra nuk bëhet një ndarje proporcionale.

Unë mendoj se po të bëhet një provë e tillë do të konstatojmë një rritje shumë të madhe të prodhimit, do të evitojmë largimin nga puna si pa gjë të keq, do të kontrollohen dhe do të zbatohen si duhet normat, të cilat duhet të rriten dhe ditët e punës do të fitohen me djersë. Në këtë mënyrë do të evitojmë në njëfarë mase edhe gjyqet që bëhen në fshatra dhe dënimet që u jepen fshatarëve me gjoba për dëmtimet që i bëhen pronës kolektive nga bagëtitë e anëtarëve ose për shkelje të ndryshme. Duke vënë gjoba ose duke u marrë bagëtitë edhe kooperativistët i bëjmë të pakënaqur, edhe nuk punohet sa duhet me ta për t'i edukuar në punë e sipër e për t'i lidhur më mirë me punën e përbashkët në kooperativë, por mjaftohemi vetëm me masat administrative.

Për të nxitur pjesëmarrjen më të madhe në punë, përveç këtyre çështjeve, duhet të shikojmë e të përdorim më mirë edhe disa forma të tjera, që lidhen me shpërblimin e anëtarëve. Për shembull, unë mendoj se kur jepen paradhëniet, nuk duhet t'u japim të gjithëve njësoj, si atyre që realizojnë ditë normat ose ditët kalendarike, edhe atyre që nuk i realizojnë ato. Një pjesë e mirë e këtyre të fundit janë nga ata që bredhin

ose lënë punën e kooperativës dhe merren me oborrit kooperativist. Këtyre duhet t'u japim një paradhënie më të vogël. Kjo mendoj unë, është një rrugë tjetër, e cila, krahas punës edukative ideopolitike e masave të tjera organizative, do të bëjë që ata të mos braktisin punën, do të ndihmojë për të frenuar rastet e shturjes e të mungesave në punë.

Ne mund të mendojmë dhe të gjykojmë edhe për forma të tjera organizimi më të shëndosha në kooperativat e zonave fushore. Disiplina shkencore në punë nuk mund të vendoset vetëm me edukim politik e ideologjik, por kërkon që kjo të shoqërohet me masa organizative për zbatimin e saj dhe me forcimin e kontrollit. Si do të bëhet ky kontroll, këtë ta mendojnë organizatat e Partisë dhe pushteti në rreth.

Flitet shumë për kontrollin punëtor dhe fshatar, por në realitet ky kontroll nuk kontrollon pikërisht në këto drejtime që theksova më lart. Ai duhet të ndihmojë që këto probleme të vihen në vend, të zgjidhen si duhet, sepse ato ndikojnë edhe në edukimin e fshatarësisë kooperativiste me ndërgjegje të lartë proletare.

U thashë shokëve sekretarë të Komitetit Qendror se këto çështje që lidhen me statutin e kooperativave bujqësore kanë nevojë të rishikohen. Për sa i përket lënies së lirë të numrit të pulave që mund të mbajë çdo anëtar, ndaj këtij fenomeni tani kooperativat, por edhe vetë kooperativistët, janë bërë shumë të ndjeshëm, sepse nuk është aq kollaj të mbash 50 ose 60 pula deti në atë sipërfaqe të oborrit kooperativist. Prandaj që t'i ushqejnë ato i lëshojnë fshehurazi të kullotin në

drithin e kooperativës. Mirëpo, nga ana tjetër ato duan edhe njerëz që të kujdesen për to. Kështu njerëzit pengohen për të shkuar në punët e kooperativës. Dhe në kushtet kur ata fitojnë lekë nga shitja e pulave të detit të ushqyera mirë dhe fshehurazi u bie interesi për të futur sa më shumë ditë-punë në kooperativë. Po a duhet ta lejojnë organizatat e Partisë këtë situatë? Unë mendoj se ka ardhur koha të merren masa sa më parë për rregullimin e kësaj gjendjeje.

Logjika të shtyn të mendosh se përderisa në oborret kooperativiste mbahen nga 50-60 pula deti pse nuk u bie në mend mjaft drejtuesve nëpër kooperativa dhe nuk e vënë aspak ujin në zjarr për ta shtuar numrin e këtyre shpendëve në kooperativë? Kooperativat, sidomos në Myzeqe, mund dhe duhet të rritin me mijëra pula deti. Mirëpo pse nuk bëhet kjo? Sepse udhëheqja e kooperativës dhe vetë kooperativistët kanë ndjenjën e pronës personale dhe interesohen më shumë për këtë pronë sesa për pronën e përbashkët të kooperativës.

Këto probleme, duhet të studiohen konkretisht, të mendohet e të merren masa të shumanshme edukative, organizative, politike, ideologjike dhe, po të jetë e nevojshme, edhe ligjore. Çështja është se nuk duhet lejuar një punë fantaziste ose që deri në një kohë ka dhënë prova, por që tash nuk është efektive dhe koha kërkon metoda dhe stil më të përparuar, si në punë ashtu edhe në drejtimin e kooperativave bujqësore.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PUNA E ORGANIZATAVE TË MASAVE TË JETË E KOORDINUAR DHE NËN UDHËHEQJEN E PARTISË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

25 shkurt 1978

Jam dakord edhe unë me paraqitjen e raportit e me tezat që ka përgatitur organizata e gruas për Kongresin e saj të 8-të, si dhe me diskutimet që bënë shokët e tjerë. Dëshiroj të theksoj se ne kemi ecur përpara për sa i përket ngritjes së gruas, nuk jemi në statet e kaluara, por është e qartë se duhet të bëjmë akoma shumë më tepër kujdes në këtë drejtim.

Siç e theksoi shoku Ramiz [Alia], duhet të bëjmë përpjekje më të mëdha për të ngritur nivelin politik dhe ideologjik të gruas, se vetëm kështu ajo do të kup-

1. Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti i Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të BGSH «Mbi veprimtarinë e BGSH midis dy kongreseve dhe detyrat për zbatimin e vendimeve të Kongresit të 7-të të Partisë së Punës të Shqipërisë», si dhe tezat për raportin e Kongresit të 8-të të BGSH.

tojë misionin e lartë që ka vetë në shoqërinë socialiste, si dhe punën që duhet bërë që këtë mision ta kuptojnë edhe burrat, edhe djemtë. Kjo do të thotë se nuk janë vetëm gratë që duhet t'u mësojnë burrave dhe djemve si t'i kuptojnë dhe si t'i zgjidhin politikisht problemet që i dalin përpara shoqërisë sonë, por duhet punuar, gjithashtu, që edhe burrat të ngrihen gjithnjë e më shumë politikisht dhe ideologjikisht. Kur themi se gruaja nuk është ngritur akoma në atë nivel që kërkon Partia, kjo do të thotë që nuk është ngritur në një nivel më të lartë as burri, pse një burrë i ngritur politikisht dhe ideologjikisht, jo në mënyrë automatike, se kjo nuk sjell gjë, por efektivisht, do ta mësojë gruan, do të bëhet një faktor me rëndësi që ta edukojë këtë jo si në shkollë, por në jetë, në punë, në shoqëri, në familje e kudo, duke shfaqur pikëpamje të drejta politike, duke mbajtur qëndrime të drejta shoqërore ndaj saj. Në këtë mënyrë do të krijohet ajo barazi reale në mes tyre në rrugën e partisë së proletariatit.

Pavarësisht se gratë në shumë çështje janë akoma inferiore, duhet të kemi parasysh se janë edhe vetë mjaft burra në këtë gjendje. Ata, nga pozitativ që mbajnë nga e kaluara dhe nga «prepotenca», mund të duken sikur qëndrojnë më lart se gratë, por prapa kësaj te burri fshihet një mungesë e theksuar e pikëpamjeve të drejta politike për problemet e shoqërisë dhe për zgjidhjen e tyre.

Çështja e gruas është një çështje e madhe dhe me rëndësi. Për t'iu futur më në hollësi këtij problemi, Partia duhet t'i vërë në lëvizje levat e saj. Por, sipas mendimit tim, nuk është e drejtë që t'ia hedhim të

gjitha fajet Partisë. Nuk është e drejtë në rast se edhe ju, shoqe të organizatës së gruas, mendoni kështu dhe nuk punoni në këto drejtime që përmenda. Pse nuk është e drejtë? Nuk është e drejtë sepse si leva të Partisë ju viheni vazhdimisht në korent të problemeve, si gjithë të tjerët, edhe nga Partia, edhe nga pushteti. Udhëheqjet e organizatave të masave vihen në korent totalisht për orientimet që jepen dhe për vendimet që merren. Nuk është e domosdoshme dhe praktikisht nuk është e mundur që orë e çast udhëheqja e Partisë t'ju thërresë dhe t'jua zbërthejë këto vendime dhe orientime. Por nuk ekskludohen edhe raste që thirreni, si, fjala vjen, për problemet kapitale, dhe këtë e bëjnë Partia dhe organet e pushtetit, sepse gjithë këto konferenca, mbledhje e aktive që po bëhen çfarë shtrojnë? Mua më duket se me këto punë merren, domethënë diskutojnë problemet dhe japin orientime. Por çështja është që zbërthimin e tyre duhet ta bëjnë organizatat-bazë të Partisë, organizatat e bashkimeve profesionale, të gruas, të rinisë. Pra, kontaktet nuk duhen kuptuar vetëm me udhëheqjen e Partisë.

Udhëheqja e Partisë e merr në analizë, ta zëmë, dy ose tri herë në vit problemin e gruas dhe më duket se kaq është mjaft që ta analizojë këtë problem, vetëm se duhet ta analizojë mirë. Pra, nuk ka se si bëhet më shumë, se në qoftë se kërkohet të merren kontakte për të gjitha problemet, kjo nuk është e mundur të realizohet dhe as që është e drejtë. Pra, mund të merren kontakte për probleme të mëdha, ndryshe nuk mund t'i dilet kësaj pune. Çështja shtrohet se si është bashkëpunimi në bazë, në fshat, në qytet, në lagje i organi-

zatës së Partisë me këshillin e gruas, me këshillin e bashkimeve profesionale kur zbërthehen direktivat, kur caktohen detyrat. Mua më duket se në praktikë bëhet kështu, por kjo punë edhe nënvleftësohet. Nuk them se kjo bëhet perfekte, është larg që të bëhet e përsosur, por e keqja qëndron, siç thashë, te nënvleftësimi. Mendoj se burimi mund të jetë te njëfarë pikëpamjeje jo e drejtë e një organizimi në vetvete, që puna të bëhet në mënyrë burokratike, duke kaluar nga një këshill më i lartë në një këshill tjetër më të ulët, duke thënë: kjo është specifika e gruas, kjo është specifika e këtij dhe kjo e atij. Çdo organizatë ka specifikat e saj, ndryshe nuk ka arsye përse të ekzistonin. Por këto specifika, më duket mua, ndodhen brenda specifikës së përgjithshme të luftës që bën Partia për një jetë më të mirë, për një shoqëri më të kulturuar, për një realizim të planit në të gjitha shkallët me normat që janë caktuar, me ligjet e me çdo gjë tjetër.

Prandaj, për zbërthime të tilla nuk mund të lajnë duart vetë këto organizata, ajo e gruas, e bashkimeve profesionale, e rinisë. Partia u ka dhënë këtyre të drejtë ta bëjnë këtë në bazë, pse atje ka edhe komunistë anëtarë të këtyre organizatave, qoftë të zgjedhur në kryesinë e tyre, por edhe si aktivistë. Duke e ndërtuar punën ashtu siç është, në mënyrë masive, që çdo gjë ua hedh masave përpara për zbërthim, për diskutim, për aprovim, për emulacion, a nuk ua ka dhënë të drejtën Partia këtyre grave dhe burrave, anëtarë partie ose jo, të cilët bëjnë pjesë në organizatën e bashkimeve profesionale, të gruas ose të rinisë, që të marrin pjesë aktivisht në mbledhjet e organizatave të masave, të diskutojnë,

të japin mendime, të propozojnë që punët të ecin kurdoherë më mirë? Po, ua ka dhënë. Atëherë lypset që të ngrihet gjithnjë e më lart ndërgjegjja e tyre në bazë të vijës së Partisë dhe Partia në këtë çështje duhet të luajë rolin kryesor. Megjithatë, nuk hiqet në asnjë mënyrë as përgjegjësia e levave të Partisë, ndryshe Partia izolohet.

Partia nuk mund të rrojë pa u futur thellë në masat dhe kjo bëhet në mënyrë të organizuar. Organizimi bëhet në mënyrë të tillë që udhëheqjet e organizatave të masave punën, aktivitetin, organizimin t'i zhvillojnë në bazë me bazën, me masat e punonjësve dhe nga konkretizimi i kësaj vije të zbërthyer dhe të zbatuar mund të dalin konkluzione shumë të drejta.

Si është e mundur të flasim se po bëhet një punë politike e mirë, kur ka raste, siç ka ndodhur në stadiume, që njerëzit rrinë e bëjnë sehir disa që kryejnë akte të papranueshme për moralin tonë proletar? Atëherë si do të kuptohet nga masat tona punonjëse ky moral proletar? Si do të korrigjohen këto të meta? Na vjen propozimi në Presidiumin e Kuvendit Popullor që t'i falim tre muaj dënim një njeriu i cili ka bërë një faj. Po çështja nuk është vetëm te faji i këtij njeriu. Prokurori i përgjithshëm dhe kryetari i Gjykatës së Lartë na kanë thënë se, në mjaft raste, kur ndodh diçka, ka njerëz që tërhiqen, gjë që tregon indiferencën e tyre. Njerëzve që kanë ndonjë qarje, disa u thonë: «Shkoni në gjyq!». Këta që mbajnë qëndrime të tilla janë edhe nga aktivistët e organizatave të masave, të Frontit, të bashkimeve profesionale ose të gruas. Pse t'i thuhet tjetrit: «Shko në gjyq!»? Si ore të shkojë në gjyq për gjëra

të vogla? Fenomene negative ekzistojnë edhe te ne; kjo nuk do të thotë që çdo gjë ta shohim të zezë, por as edhe t'i nënvleftësojmë këto fenomene, pse në fakt ekzistojnë.

Prandaj duhet të bëhet një punë e dyanshme, edhe me burrat, edhe me gratë dhe jo të rrimë e të qahemi për çështjen e atavizmit të burrit për të sunduar në familje. Atavizmi, dakord, duhet luftuar në të dyja anët, por mbi të gjitha duhet luftuar politikisht e ideologjikisht. Është e drejtë ajo që thotë shoqja Vito¹, që edhe disa masa të merren, por jo administrative, po masa organizative, masa ekonomike dhe të tjera. Kush e ka në dorë t'i marrë këto masa? Mos vallë i ka ndaluar Partia? Ajo ka dhënë kurdoherë direktiva se si duhet vepruar për zgjidhjen e problemeve. Mos ka ndaluar Qeveria që të shtohen, fjala vjen, karrocet për transport, me qëllim që të lehtësohet puna e njerëzve, e sidomos e grave etj., etj.? Jo, nuk ka ndaluar. Po atëherë përse nuk bëhen? Po kështu edhe për shumë gjëra të tjera. Pra, nuk mund të thuhet nga askush se nuk duan Partia dhe pushteti. Atje ku punohet ka komunistë, aktivistë të organizatave të masave. Këta kanë përgjegjësinë e tyre për dobësitë që shfaqen në punë.

Është e vërtetë, për shembull, që nuk ka çerdhe kudo, po kjo nuk është një çështje që u përket vetëm komunistëve. Pastaj ngritja e çerdheve ka edhe një kufi, megjithëse ka edhe çerdhe që, në fakt, nuk shfrytëzohen në tërë kapacitetin e tyre. Atëherë kush e ka

1. Vito Kapo, në atë kohë, presidente e Bashkimit të Grave të Shqipërisë.

fajin për këtë, Partia? Sigurisht, organet dhe organizatat e Partisë kanë për të bërë shumë në këtë drejtim, por faj ka edhe organizata e gruas, ka edhe ai që nuk është komunist. Pse e ka fajin ai? E ka sepse nuk e çon fëmijën në çerdhe dhe e lë gruan në shtëpi ta rritë atë. Ai e bën këtë sepse nuk e kupton rëndësinë e punës, të prodhimit shoqëror, të pronës së përbashkët, rëndësinë e daljes së gruas në punët e kooperativës etj. Në praktikë ndodh që, si pa gjë të keqe, shkelen statutet. Fjala vjen, është lënë në Statutin e Kooperativave Bujqësore e drejta që për mirëqenien e familjes fshatare të mbahen pula fushe, mirëpo ka që mbajnë edhe gjela deti. Këta i mbajnë edhe disa komunistë, pra i mban edhe burri, edhe gruaja, bile më shumë i mban një grua me nivel të ulët politik, e cila shikon më shumë interesin e ngushtë familjar, sepse nuk del në punët e kooperativës. Në fakt një punë ajo e bën, por në oborrin personal, dhe prej saj nxjerr të ardhura, gjë që i vjen mirë edhe burrit, edhe gruas. Pra, e shikoni, këto probleme janë mjaft të koklavitura, shokë.

Të gjithëve u vihet detyrë nga Partia që të mos bëjnë punë për t'u dukur. Nga çdo komunist kërkohet punë e palodhur konkrete dhe e kujdesshme me njerëzit. Partia, sigurisht, duhet të mendojë edhe për të ardhmen dhe e ardhmja ndërtohet duke forcuar pandërprerë ekonominë, por, siç dihet, gjatë punës për ndërtimin ekonomik të vendit kalitet, ndërtohet, si të thuash, edhe njeriu i ri. Natyrisht që në gjithë këtë veprimtari ekziston lufta e klasave, e cila duhet të përdoret nga ne për të spastruar ndërgjegjen e njerëzve tanë, për të goditur ashpër armikun. Por njerëzit tanë kontradiktat

duhet t'i zgjidhin në një mënyrë të atillë që këto të vij-në duke u zvogëluar dhe njerëzit të dalin nga kjo luftë më të shëndoshë e më të pastër.

Këto probleme lypin refleksion në punë dhe marr-je përgjegjësie nga cilido, qoftë në udhëheqje, qoftë në bazë. Të mos i vihen tjetrit në kurriz ato që nuk i për-kasin. T'i vihen në dukje dhe të mos i lihen në hije ato që ka dhe që duhet medoemos t'i ndreqë, ndryshe nuk rregullohen këto gjëra.

Në përgjithësi, të gjithë jemi dakord që organizata e gruas është aktive. Konstatojmë me kënaqësi se ka su-ksese dhe e dimë që shoqet e kësaj organizate punojnë mirë, po edhe duhen ndihmuar nga Partia dhe nga pu-shteti. Sidoqoftë, të gjithë konstatojmë se ka një ngritje në veprimtarinë e kësaj organizate, ka dhe aktivitet.

Fola këtu për çështjen e bashkëpunimit midis or-ganizatave. Ky bashkëpunim duhet të ekzistojë vazhdi-misht për çdo gjë dhe jo formalisht, por, duke qenë de-tyrat të ndara për disa specifika, prapë të tërë jemi të bashkuar në probleme. S'ka problem, sado i vogël qoftë ky, që të mos i interesojë edhe organizatës së bashkime-ve profesionale, edhe organizatës së gruas ose të rinisë. Prandaj çështja nuk është të merret kontakt dhe të shtrohen problemet formalisht, por të merret kontakt dhe kurdoherë të jemi të pleksur e të bashkuar në or-ganizatave të masave. Në punë dhe në luftë nuk ka dalli-me që ti je më i madh dhe ai më i vogël. Të tërë kemi një detyrë të madhe të përbashkët, të tërë do të ndër-tojmë socializmin, do të mbrojmë atdheun, duke zbatuar Artin Ushtarak të Luftës Popullore, do të luftojmë ar-mikun që do të guxojë të na sulmojë e të tjera, e të tjera.

Prandaj kështu duhet të konsiderohet puna e organizatave të masave në luftën për zbatimin e detyrave, e koordinuar ndërmjet tyre, nën udhëheqjen e Partisë.

Atëherë po e mbyllim këtë çështje. Ju urojmë sukses dhe tash gjithë puna, derisa të vijë Kongresi, të jetë një punë bazë, një përgatitje bazë.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Për gruan» (Përmbledhje
veprash), f. 596*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Për gruan»
(Përmbledhje veprash), f. 596*

JO VETËM TË MARRIM MASA POR EDHE TË KONTROLLOJMË ZBATIMIN E TYRE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

25 shkurt 1978

Në fillim, shoqja Naunka Bozò, në atë kohë sekretare e parë e Komitetit të Partisë të Rrethit të Fierit, informoi për masat që ishin marrë në atë rreth, për të arritur rendimente sa më të larta në pambuk. Duke u interesuar për këtë problem shoku Enver Hoxha bëri disa ndërhyrje e pyetje:

Të gjitha këto masa që numërove ti këtu janë shumë të mira, po unë do të të pyes një gjë: Si i kontrollojnë Partia dhe pushteti realizimin e tyre? Se edhe vitin e kaluar ju kishit parashikuar gjithë ato masa, megjithatë prodhimin e pambukut nuk e realizuat. Atëherë, na thuaj pak se si i zbërtheni ju detyrat dhe direktivat që ju jepen dhe si e kontrolloni zbatimin e tyre?

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe relacioni: «Mbi masat që duhen marrë për kulturën e panxharsheqerit dhe të pambukut për të siguruar nevojat që ka vendi për sheqer e pambuk në bazë të direktivave që ka shtruar Kongresi I 7-të i PPSH».

SHOQJA NAUNKA BOZO: Këtë vit, kemi krijuar një shtab drejtues për ndjekjen e të gjitha masave tekniko-organizative që janë caktuar për pambukun.

SHOKU ENVER HOXHA: Prej sa vetash përbëhet shtabi?

SHOQJA NAUNKA BOZO: Nuk e di ekzakt, janë 9 ose 10 veta.

SHOKU ENVER HOXHA: 10 veta mendoni ju të kontrollojnë gjithë sipërfaqen e mbjellë me pambuk në rrethin e Fierit?

SHOQJA NAUNKA BOZO: Ky është një shtab drejtues, jo për të kontrolluar tërë punën.

SHOKU ENVER HOXHA: Dakord, po unë po të pyes se si e kontrolloni konkretisht? Këtë dua të di unë, domethënë, nëse u bë, ta zëmë, qilizma. Por, ama, për ta parë nëse u bë me të vërtetë dhe nëse u realizua 60 centimetra e thellë apo nuk u realizua. A mund të na thoni se kush e ka kontrolluar konkretisht? Ka vajtur njeri ta matë atje, në vend, thellësinë e punimit të tokës dhe të verifikojë me këtë nëse është realizuar kjo detyrë sipas direktivës? Ja përse është i domosdoshëm të bëhet ky kontroll. Traktoristi duhet ta bëjë qilizmën 45 centimetra të thellë dhe, për këtë thellësi, ai, sipas normës duhet të lërojë një sipërfaqe të caktuar toke në ditë. Mirëpo del që ai punon një sipërfaqe toke më të madhe. Prandaj duhet bërë kontrolli i punës që ka kryer, sepse mund të ndodhë që ai ta ketë punuar tokën më cekët. Këtu e kisha fjalën, kontrollohen këto gjëra apo jo?

SHOQJA NAUNKA BOZO: Për këtë ne kemi organizuar edhe kontrole me grupe pune, duke futur në to edhe specialistë, brigadierë e kuadro të tjerë.

Një defekt tjetër i punës sonë vitin e kaluar ka qenë se ne nuk e morëm asnjëherë në analizë problemin e bimëve industriale.

SHOKU ENVER HOXHA: Si është e mundur të mos merrej asnjëherë në analizë nga komiteti i Partisë gjendja e bimëve industriale?! Rendimenti i bimëve industriale është një nga problemet më të rëndësishme të bujqësisë në rrethin tuaj. Ato që thuhet në teori janë të gjitha të drejta, por çështja është se si punohet në praktikë dhe si do ta kontrollojmë këtë punë që të mos na përsëriten më këto gjëra në të ardhmen.

Partia dhe organet e pushtetit duhet të mendojnë jo vetëm se si të zërthehet direktiva, por dhe se si do të bëhet kontrolli i zbatimit të saj dhe të mos mjaftohemi duke thënë se «kemi të meta». Të meta ne, vërtet, mund të kemi, por puna është që të luftojmë kundër tyre, pra, që të kemi sa më pak. Të metat ndreqen me një organizim të rreptë. Në goftë se bëjmë 100 herë përpjekje për një organizim të mirë të punës në uzina e fabrika, në fermat e kooperativat bujqësore duhet të bëjmë 300 herë, për vetë karakterin e fshatarësisë e për vetë rrethanat e hapësirës në bujqësi. Një brigadier, për shembull, ka në ngarkim 80 hektarë tokë dhe në të punojnë, bie fjala, 70 veta etj. Atëherë, a nuk duhet të vrasim mendjen e të mendojmë një çikë se si ta kontrollojë ai punën e anëtarëve të brigadës? Këtë nuk mund ta bëjë dot jo vetëm brigadieri, por as shtabi, por vetëm po të mobilizohen të gjithë. Vërtet se në radhë të parë është ngritja e ndërgjegjes nëpërmjet punës politike, po nuk mjafton vetëm kjo. Aq më keq po u kuptua puna politike që «mjafton të vemi në bazë dhe

të themi disa fjalë». Sado bindëse që të jenë ato, s'kanë për të bërë efektin e duhur. Duhet ta pranojmë se në organizimin e punëve dhe në kontrollin e zbatimit të direktivave ne çalojmë. Pikërisht, në këtë drejtim duhet ta vrasim edhe më shumë mendjen se si të punojmë.

Kthehemi edhe një herë te kontrolli i punës në brigadë. Specialisti i sektorit nuk i merr punët në dorëzim, po që se ato nuk janë bërë sipas kërkesave të agroteknikës. Megjithatë, edhe specialistë nuk kemi shumë, sa të kontrollojmë tërë punimet e kryera. Prandaj, a nuk ka mundësi që pranë një specialisti, kur vjen koha për të marrë në dorëzim punën e kryer, të ketë edhe dy, tre, katër komunistë afër, që të kontrollojnë cilësinë e shërbimeve agroteknike të këtij ose atij brigadieri, fjala vjen? Sigurisht që ka mundësi. Po a bëhet kjo? Jo, nuk bëhet. Këtë detyrë me kaq rëndësi dhe përgjegjësi ia lëmë në dorë një specialisti dhe i themi: «Bëji ti!». Po çfarë të bëjë ai më parë? Po kështu edhe një brigadier që drejton 60-70 veta çdo ditë. Në një brigadë janë 6-7 skuadra. Mirëpo brigadieri duhet të matë, të bëjë borderonë, të marrë plahun, të flasë me anëtarët e brigadës, të bëjë kështu e të bëjë ashtu etj. A ka mundësi, pra, ai që t'i bëjë gjithë këto gjëra? Pse të mos aktivizojmë më shumë skuadërkomandantët dhe t'u vëmë këtyre detyra më konkrete, më të afërta dhe më praktike që ta lehtësojmë brigadierin dhe ky të bëhet me të vërtetë drejtues e organizator i brigadës? Ne, shokë, duhet të vendosim disa rregulla të forta në bujqësi. Këtë e kemi problem kudo dhe jo vetëm në Fier. Kjo është çështja kryesore.

Nuk mund të zhduken të metat, siç thashë edhe më parë, duke mos u marrë asnjëherë në analizë nga komiteti i Partisë problemi i bimëve industriale, të paktën një herë në vit. Industria e naftës vërtet është e rëndësishme, por ajo ka në vetvete tërë ato drejtori e administrata, kurse në kooperativat bujqësore puna është ndryshe. Prandaj ato kanë nevojë më shumë për ndihmën dhe kontrollin e rrethit.

E përsëris edhe një herë. Nuk është çështja vetëm për rrethin e Fierit, por edhe për të tjerët. Për sheqermbull, kjo vlen edhe për rrethin e Korçës, sepse edhe mosrealizimet që patëm atje vitin e kaluar, prapë kishin të bënin kryesisht me çështje organizimi e mosinteresimi nga ana e komitetit të Partisë të atij rrethi.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

MUZEU DUHET TË KETË TËRËSISHT KARAKTER KOMBËTAR

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

25 shkurt 1978

Pasi u njohën me platformën dhe maketin e Muzeut Historik Kombëtar e të Monumentit të Lirisë dhe pasi diskutuan rreth tyre, shoku Enver Hoxha tha:

Mua më duket se në platformë vepra është paraqitur drejt.

Kisha mendimin që pjesa e shtëpive që vjen pas korpusit kryesor të Muzeut Kombëtar të mos duket si vjetërsirë, sepse jemi në rrugën kryesore, pranë Hotelit të Madh. Prandaj, t'i jepet rëndësi gjithë kompleksit: përpara, anash dhe pas. Këtu do të kalojë unaza e vogël e qendrës, dhe, për këtë, çdo pjesë e saj duhet të ketë një bukuri të veçantë. Ju², sigurisht, keni menduar dhe vetë për këtë problem.

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për platformën e Muzeut Historik Kombëtar dhe për Monumentin e Lirisë.

2. U drejtohet disa arkitektëve që ishin ftuar në këtë mbledhje.

Vërejtja tjetër imja është për ambientet e brendshme, të cilat duhet t'u adaptohen të jashtmeve, të jenë në harmoni me to. Edhe kjo pjesë mund të bëhet objekt i një studimi kompleks. E kam fjalën për dritaret, muret, të ndarat etj. Të tëra duhet të jenë të planifikuara shumë mirë, që muzeu të shfrytëzohet jo vetëm aktualisht, por edhe në të ardhmen¹.

Pastaj vjen çështja e fasadës. Edhe kjo duhet të ketë karakter kombëtar, sepse të dy objektet e tjera që janë këtu, si Hoteli i Madh, edhe Pallati i Kulturës, nuk e kanë të pasqyruar këtë kërkesë; por, edhe ndërtesa e Bankës nuk ka karakter kombëtar. Prandaj, çdo gjë duhet t'i përshtatet arkitekturës dhe artit tonë kombëtar. Unë nuk mund të them tash ndonjë gjë konkretisht se si e qysh mund të realizohet kjo, por arkitektët, piktorët e skulptorët tanë kanë bërë studime, kanë botuar edhe albume të mëdha e, nga sa kam parë, në këto krijime të tyre, kam vënë re që ata kanë arritur të nxjerrin tipiken, karakteristikën kombëtare. Zotësia e tyre tash është që nga ato qindra të dhëna të veçanta që kanë nxjerrë, të përpiqen të gjejnë disa nga karakteristikat më tipike kombëtare, për t'i pasqyruar pastaj ato me gjuhën e artit në fasadën e këtij muzeu.

1. Këtë ide, që Muzeu Historik Kombëtar të pasqyrojë jo vetëm të kaluarën e të sotmen, por të ketë vend edhe për të ardhmen, shoku Enver Hoxha e trajton edhe në mbledhjen e Byrosë Politike, më 20 qershor 1978, ku u diskutua edhe një herë për maketin e muzeut. Duke u ndalur posaçërisht në këtë problem, ai thekson: «Duhet të ketë edhe salla rezervë, sepse në jetën e popullit do të ketë ngjarje të tjera të rëndësishme, të cilat patjetër që do të pasqyrohen në këtë muze».

Mendoj që në katin e parë, të mos ketë xhamllëk. E kam fjalën që në këtë ndërtesë monumentale nuk duhet të ketë xhamllëqe të tilla që pjesët e këtij kati të duken si vitrina dyqanesh. Muzeu edhe në këtë pjesë duhet të jetë solid. Por, kjo nuk do të thotë që aty të mos ketë ndonjë portë dhe dritare me xham që të lejojë hyrjen e dritës me intensitet të plotë në hollin brenda.

Kryesorja është që ky muze duhet të ketë të pasqyruar tërësisht karakteristikën kombëtare të forcës dhe të pavdekësisë së kombit tonë. Ai të tregojë që është jo vetëm i fortë, por edhe i lehtë e i zhdërvjellët, si populli ynë. Të jetë i tillë që të shprehë idenë se njerëzit tanë luftojnë dhe fitojnë. Çështja është që, kur të vijnë të tjerët e të shikojnë këtë muze, të zbulojnë të ky karakteristikat e popullit tonë.

Ne në vendin tonë kemi shtëpi karakteristike ku janë vendosur disa gurë të veçantë për të shprehur një ide të caktuar. Sikur të mendojmë që edhe në këtë muze, në një formë ose në një tjetër, të vendosen disa gurë karakteristike në një mënyrë të tillë që të japin përshtypjen e gjerdanit me fishekë. Natyrisht, kjo të mos bëhet e rënduar si puna e asaj nuses që ia vënë të gjitha stolitë që ka edhe në ballë, edhe në fytyrë e në duar, me një fjalë e ngarkojnë jashtë mase. Çështja është t'i jepet ndërtesës kudo ngjyra kombëtare. Kjo tani është puna juaj, por edhe ne, pasi ta kenë studiuar ju, mund ta shikojmë.

Ju, shokë, duhet t'i merrni një nga një në shqyrtim e t'i diskutoni këto probleme që u ngritën këtu. Pastaj të vendoset se cila prej tyre mund të realizohet në

këtë ansambël arkitekturor dhe cila jo. Duhet menduar e diskutuar për gjithçka, deri edhe te ngjyrat, që të përfytyrohet tamam se si do të duket e përfunduar. Pra, të mendohet e të vendoset me kohë për të gjitha problemet e kërkesat e nevojshme.

Atëherë, ju urojmë sukses!

*Dotohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TË PËRMIRËSOHET MË TEJ BASHKËPUNIMI MIDIS ORGANIZATAVE TË MASAVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

27 shkurt 1978

Ju, shokë, që punoni me organizatat e masave, më duket se duhet të reflektoni më thellë për çka u fol këtu. E kemi theksuar edhe më parë se në këto organizata nuk duhet të lejohen puna me bujë dhe rutina, por të bëhen përpjekje që gradualisht të përmirësohen në to stili dhe metoda e punës së përbashkët. Kur vë në dukje këto, nuk nënvleftësoj aspak punën e mirë që është bërë dhe vazhdon të bëhet nga ana e këtyre organizatave, sepse ato punojnë dhe janë me të vërtetë ndihmëse efektive të Partisë. Vetëm se, kur i sjellim në Byronë Politike dhe në Sekretariatit e Komitetit Qendror këto çështje, meqenësc i ngremë dhe duhet t'i ngremë, natyrisht, e kemi për detyrë t'u bëjmë edhe

1. Në këtë mbledhje u diskutua për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të organizatave të masave për zbatimin e vendimeve të Kongresit të 7-të të Partisë.

kritikën disa pikave të dobëta, prandaj kjo kritikë të kuptohet drejt, nga ana teorike dhe praktike. Çështja është që të përmirësohet puna.

Mendoj se nuk është keq që, në radhë të parë, Bashkimet Profesionale t'u kthehen mësimëve të Leninit për t'i sqaruar më mirë detyrat në këtë drejtim, por Partia jonë, që tashmë ka një eksperiencë të madhe edhe në këto probleme, duhet t'i zbërthejë e t'i adoptojë këto mësimë edhe për sa u përket organizatave të tjera të masave. Lenini në veprat e tij na orienton, veçanërisht, edhe për punën organizative, pale për çështjet ideologjike dhe politike që janë të dorës së parë.

Te shokët e organizatave të masave vihet re disa herë që bëjnë kritika ndaj organeve të pushtetit dhe të Partisë. Ka vend, më duket mua, edhe për kritika të tilla; bile këto mund të jenë edhe më të shumta. Por çështjen e kam gjetkë, që këto organizata të punojnë më aktivisht e më me iniciativë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

Gjithë kjo masë e klasës punëtore, gjithë kjo masë e komunistëve, që bëjnë pjesë edhe në organizatën e Frontit, shumë edhe në atë të rinisë ose të gruas, në rendin tonë socialist, marrin pjesë aktive në gjithë veprimtarinë dhe jetën shoqërore, një pjesëmarrje aktive kjo që është përcaktuar në direktivat e Partisë, në Kushtetutën e Republikës, në ligjet, të cilat shkojnë vazhdimisht duke u përmirësuar. Prandaj për çdo problem, po të kuptohet rëndësia e tij, gjendet edhe zgjidhja më e përshtatshme dhe më e shpejtë, natyrisht, brenda caqeve të caktuara, kurse për zgjidhjen jashtë këtyre caqeve, është e domosdoshme të kërkohet lejë në qendër,

sepse ne jemi një shtet me drejtim të centralizuar. Por çështja është që problemet, goftë ato të planeve ekonomike, por edhe ato të fushave të tjera, ashtu siç tha shoku Hysni [Kapo], të zgjidhen në bazë, për arsye se për bazën janë dhënë direktiva nga Partia, janë caktuar detyra, janë caktuar edhe fonde, janë marrë edhe masa organizative për zbatimin e tyre. Por shkojnë vallë punët lisho? Jo, ato nuk shkojnë lisho për shkaqet subjektive dhe objektive që i dimë, prandaj nuk dua t'i përmend.

Është e rëndësishme që problemet të zgjidhen frontalisht jo vetëm nga tre ose pesë shokë drejtues. Drejtuesit ta ndiejnë përgjegjësinë që kanë dhe të mendojnë mirë për zbërthimin, shtrirjen dhe shpjegimin e qartë të direktivave në të gjitha instancat, pastaj të punojnë që masat t'i kuptojnë ato dhe t'i zbatojnë, natyrisht, jo në mënyrë mekanike, por krijuese. Këtu vijmë tek ajo që tha shoku Ramiz [Alia] domethënë të mos mjaftohemi me një shtruarje apo me shpjegimin e problemit ose të direktivës vetëm në organet qendrore, pasi kështu nuk mund të na shkojnë mirë punët.

Duhet të kemi parasysh se shumë të meta na vijnë nga burokratizmi, prandaj të shfletojmë veprat e Leninit dhe të mësojmë prej tij se si të luftohet kjo e keqe dhe si t'u ndalim dorën burokratëve. Po ku janë te ne këta burokratë? Vallë vetëm nëpër ministri? Jo, ata s'janë vetëm nëpër ministri, sepse të tillë ka në të gjitha shkallëzimet, deri tek organizatat e masave. Të tillë mund të jenë njerëz të veçantë, anëtarë partie dhe anëtarë të organizatave të masave, që kanë mbeturina të theksuara, të cilat pengojnë punën. Është për këto

arsye që Partia ka krijuar dhe po i ushqen me vijën e saj të drejtë vazhdimisht këto organizata.

Organizatave të masave janë organizata të gjera të punonjësve dhe zhvillojnë punë politike me anëtarët e tyre, nën drejtimin e Partisë. Pra, ato vetë të mendojnë si ta organizojnë punën që të realizohet mirë në jetë vija e Partisë në të gjitha aspektet, se për këtë qëllim i ka krijuar ajo.

Mirëpo ç'ngjet? Ngjet që drejtuesit e këtyre organizatave shpeshherë presin që direktivën e Partisë, vendime ose detyra të saj t'ua zbërthejnë sekretarët e komiteteve të Partisë. Por nuk është e drejtë që shokët e organizatave të masave të mendojnë që komiteti i Partisë, sekretari i komitetit ose ministri janë të detyruar të venë e t'u flasin për të gjitha gjërat në mbledhjet e tyre. Përse duhet medoemos të vejë për çdo gjë në forumin e Bashkimeve Profesionale sekretari i komitetit të Partisë? Nuk përjashtohen raste që edhe ky mund të vejë, por gjithë ai numër anëtarësh partie që bëjnë pjesë në këtë ose në atë organizatë masash çfarë bëjnë kur venë në to, hedhin valle? Jo, ata duhet t'i zbërthejnë atje direktivat e Partisë, por edhe kur e bëjnë këtë zbërthim, shpesh e bëjnë jo të detajuar, por në përgjithësi. Mirëpo ata e kanë për detyrë të mendojnë se si duhet ta zbërthejnë konkretisht një direktivë dhe jo të presin ta bëjë këtë Byroja Politike, jo të presin që t'u thuhet nga qendra si e qysh të veprojnë deri në hollësinë më të vogël.

Të gjithë anëtarët e Partisë janë pa përjashtim anëtarë të Frontit, të Bashkimeve Profesionale; shoqet komuniste janë edhe anëtare të Bashkimit, të Grave; të

tjerë, më të rinj, janë anëtarë të organizatës së rinisë. Një pjesë e rëndësishme e komunistëve bile janë edhe në udhëheqje të këtyre organizatave. Atëherë të gjithë këta, tok me udhëheqjen e Partisë, duhet të mendojnë se si të zërthehet kjo apo ajo direktivë. Pse e them këtë? Mos vallë se nuk zërthehen direktivat? Jo, nuk flas në mënyrë kategorike, sepse në organizatat e masave direktivat zërthehen, por ato duhet t'i përmirësojnë më tej stilin dhe metodën e punës, se kështu luftohet edhe burokratizmi. Zërthimi i direktivës në bazë duhet të shërbejë për zbatim. Por lidhur me këtë, nuk mund të kërkohet kohë e pa kohë të bëhen mbledhje të organizatave të masave. Kjo nuk do të thotë aspak që këshillat apo kryesitë e organizatave të masave të mos mblidhen përnjëherë për të zgjidhur problemet që shtron Partia dhe, në bazë të direktivës, e cila mund të jetë edhe një apo vetëm dy radhë, t'u punojë koka vetë, ta diskutojnë atë bashkërisht e ta zërthejnë, sepse ka rëndësi që ta kuptojnë thellë atë, pastaj të mendojnë edhe se si do ta zgjidhin organizativisht. Një direktivë, qoftë kjo e shprehur edhe vetëm me dy radhë, u përket të gjithëve. Ajo është, si me thënë, universale, pavarësisht se mund të bëjë fjalë, ta zëmë, për rendimentet, për higjienën ose për vajtjen e rinisë në fshat etj.

Asnjë nuk mund t'u shpëtojë çështjeve shoqërore, asnjë nuk mund t'i shpëtojë detyrës për kujdesin që duhet treguar, fjala vjen, për gratë shtatzëna, nëse respektohen apo jo udhëzimet që jepen për ruajtjen e shëndetit të nënës dhe të fëmijës së ardhshme. Të gjithë duhet të jenë të interesuar për këto çështje dhe jo ve-

tëm organizata e gruas; të gjithë duhet të interesohen që gruaja ta kalojë mirë me shëndet periudhën e shtatzënisë. Një problem i tillë u përket jo vetëm grave, por edhe burrave, se edhe këta kanë detyra në këtë drejtim. Nuk është vetëm gruaja ajo që duhet të kujdeset për ta ruajtur kalamanin nga të ftohtit, por edhe burri, prandaj ky të mos vejë të pijë dy kafe në ditë, ose të bëjë shpenzime të tjera, por të kujdeset, për shembull, që foshnja kur lind apo fëmija e vogël të ketë veshje të ngrohtë. Pra, ka disa probleme që janë njëkohësisht probleme për të gjithë. Në të tilla raste nuk duhet menduar se ky ose ai problem është «specifik» për një organizatë, prandaj me të nuk do të merren organizatat e tjera.

Kur thashë që nuk është e domosdoshme të bëhen mbledhje në çdo rast, të mos kuptohet sikur nuk duhen bërë fare, pse, kur është rasti, duhet të bëhen, bile dhe serioze. Të tërë e njohim shokun Pilo Peristeri, i cili jo vetëm interesohet dhe di nëse mbliidhen apo nuk mbliidhen organizatat e masave në ndërmarrjen që drejton, por ai nuk i lë gjërat të zgjidhen vetëm me mbledhje. Ai jep shembullin personal në punë, sa shkon vetë mbledh mbeturina hekurishtesh të hedhura andej-këtej nëpër rrugët e oborret e uzinës, që punëtorët i shikojnë, megjithatë kalojnë fare indiferentë para tyre. Në ndërmarrjet e tjera mund të mos veprohet kështu, por çështja është që edhe organizatat e masave duhet të veprojnë me iniciativë në këtë drejtim, për edukimin e masave. Për këtë ato duhet edhe të bashkëpunojnë ndërmjet tyre.

Ky bashkëpunim nuk duhet të ekzistojë vetëm në

krye, domethënë të mblidhen vetëm kryetari i këshillit të Bashkimeve Profesionale me atë të Frontit, të Gruas apo të Rinisë. Ky bashkëpunim duhet realizuar edhe në bazë, në qendrat e punës e kudo. Pse, bie fjala, të mos bëhen mbledhje më të gjera, me aktivistët ose anëtarët? Po çfarë mbledhje të bëjnë? Mbledhje zyrtare? Jo, në asnjë mënyrë! Por edhe në 15 ditë një herë sikur të mblidhen dhe të thonë: More, ku gjendemi me këtë ose me atë vendim që kemi marrë dhe për të cilin i kemi bërë letër edhe Komitetit Qendror të Partisë? Mbledhjet me qëllim bashkëpunimi të drejtuesve të këtyre organizatave janë të domosdoshme, më duket mua. Po pse nuk mblidhen atëherë? Mos presin që këto mbledhje t'i bëjë Partia? Partia i udhëheq organizatat e masave, i sqaron, i udhëzon. Ajo porositi anëtarët e saj që janë njëkohësisht anëtarë ose të zgjedhur në forumet e Bashkimeve Profesionale, të Gruas, të Rinisë apo të Frontit që, kur të marrin një vendim, të kontrollojnë edhe zbatimin e tij. Po si ta kontrollojnë një vendim të tillë? Ta kontrollojnë duke u konsultuar me njëri-tjetrin, duke thënë, për shembull, «Ti e kreve detyrën që të takon në repartin tënd?». «Në repartin tim puna nuk po më ecën mirë», thotë tjetri. «Po pse nuk ecën?». «Sepse filan punëtor, ose një grup punëtorësh kanë këto apo ato të meta». Kështu flitet edhe për organizatën e gruas apo të rinisë dhe përgjegjësit përkatës të këtyre organizatave mendojnë bashkërisht se çfarë duhet bërë, pastaj mund të shkojnë e t'i ngrenë probleme Partisë.

Partia i ka krijuar këto organizata si «rripa transmisioni» për të edukuar anëtarët e tyre, njerëzit tanë.

Drejtuesit e këtyre organizatave mund të venë në Parti të kërkojnë ndihmë, por jo për të shkarkuar përgjegjësinë e vet. Çdo organizatë masash duhet t'i vërë detyrë vetes që «këtë apo atë detyrë duhet ta zgjidh unë», «këtë vendim që kemi marrë, na përket ta zbatojmë vetë». Në qoftë se drejtuesit e uzinës pengojnë me mënyra burokratike për të zbatuar vendimin që është marrë, atëherë t'u thuhet: «Mjaft, pse nuk po zbatohet kjo apo ajo detyrë nga administrata? Pse po na pengoni? Kush duhet ta bëjë këtë?». Lenini na mëson se kush duhet ta bëjë. Ai na mëson gjithashtu që të goditet burokratizmi në organet dhe në administratat shtetërore. Në qoftë se drejtori dhe krycinxhinieri i një uzine kanë frikë të venë në ministri për të marrë ato masa që i takon t'i marrë kjo, atëherë janë Bashkimet Profesionale që i detyrojnë ata, si anëtarë të tyre, të venë atje dhe, në qoftë se nuk venë, atëherë, ato dhe vetë punëtorët drejtohen deri në Komitetin Qendror dhe thonë: «Ne nuk mund të ecim me atë drejtor ose krycinxhinier, mbasi na është caktuar në plan që të bëhet kjo punë, kurse drejtorja nuk e bën ose pengohet nga ministria». E them këtë se ndodh që ose drejtori personalisht nuk guxon të vejë në ministri, ose ministria nuk përgjigjet fare për këtë ose atë punë, që parashikohet nga normat dhe nga ligjet tona. Edhe po ta kërkojë nevoja që diçka të bëhet jashtë planeve të parashikuara, natyrisht, kjo kërkon një studim nga lart dhe këtë duhet ta kuptojnë Partia dhe organizatat e masave në bazë. Por në rast se një kërkesë e tillë do të argumentohet dhe do të krijohet bindje se është e domosdoshme, ajo me siguri do të zgjidhet.

Në praktikë unë nuk e di me hollësi se si veprohet konkretisht në të tilla raste. Në qoftë se bëhet kështu siç thashë, është shumë mirë, në qoftë se bëhet diçka, duhet të bëhen përpjekje që të kryhet më mirë. Në qoftë se nuk bëhet fare, atëherë është i domosdoshëm një bashkëpunim i organizatave të masave në bazë, midis të cilave duhet të krijohet një lidhje e ngushtë, të krijohet një kuptim i drejtë i këtij bashkëpunimi jo vetëm nga udhëheqjet e këtyre organizatave, por edhe nga masat punonjëse, me qëllim që ai të realizohet praktikisht e të jetë në zhvillim, domethënë, të unifikohen mendimet dhe forcat, jo vetëm në këshillat apo në kryesitë e organizatave të masave, por edhe në bazë. Kjo ka rëndësi dhe duhet të kuptohet mirë. Ata që janë vënë në drejtim, duhet të mendojnë si drejtues, të thellohen në direktivat dhe të parashikojnë çdo gjë për organizimin e punës për zbatimin e direktivave, për kontrollin e zbatimit të detyrave, të mendojnë edhe çfarë duhet bërë më tutje. Kjo s'do të thotë që të mos mendojnë të tjerët. Këtu është gjithë rëndësia e vijës së Partisë: t'i bëjë të tërë të ndërgegjeshëm, që të mendojnë e të organizojnë mirë punën, dhe të kontrollojnë si duhet zbatimin e detyrave.

Po të bëjmë bilancin e përgjithshëm të veprimtarisë së këtyre organizatave, ky del pozitiv, por, kur futemi pastaj në disa çështje, shohim se ka akoma mjaft të meta. Kur flasim për rininë, del se kjo ka bërë dhe bën shumë gjëra të mëdha. Megjithatë s'duhet harruar se shfaqjet e huaja për moralin tonë komunist, në përqindje të madhe të tyre, i manifestojnë individë të moshave të reja dhe në mes tyre më shumë janë të rinj

punëtorë, mjaft prej të cilëve janë bij të punëtorëve, të njerëzve tanë. Atëherë kjo çështje, në radhë të parë, duhet të preokupojë Partinë, por njëkohësisht duhet të preokupojë edhe levat e saj, organizatat e masave dhe konkretisht, në këtë rast, organizatën e rinisë.

Këto probleme, më duket mua, kanë rëndësi të jashtëzakonshme për organizatat e masave. Prandaj i theksojmë këto gjëra, siç thashë më parë, e siç e vunë në dukje edhe shokët, që të përmirësohet më tej puna në këto organizata.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Për Bashkimet Profesio-
nale» (Përmbledhje vep-
rash), f. 636*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Për Bashkimet
Profesionale» (Përmbledhje
veprash), f. 636*

FIZKULTURA FORCON NJERIUN, VULLNETIN DHE REZISTENCËN E TIJ

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

27 shkurt 1978

Me ju² nuk matemi dot, se jeni të fortë, merreni me sportin. Edhe Piloja dikur ka qenë sportist, ka luajtur futboll.

SHOKU PILO PERISTERI: Ju kujtohet kur ishim në internat?

SHOKU RITA MARKO: Shoku Pilo ka qenë sportist, po tani, sheshi ku luanin të rinjtë, në uzinën «Traktori», është zënë me zhavor.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë isha vetëm tifoz, kurse ti Pilo, ishe aktiv, ishte lojtar i skuadrës «Skënderbeu» të Korçës. Ramizi, më duket, ka luajtur tenis. Ke konkurruar gjë për kupën në tenis ti, Ramiz?

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për zbatimin e detyrave që ka shtruar Komiteti Qendror i Partisë për përmirësimin e mëtejshëm të punës në sektorin e fizikulturës e të sporteve.

2. U drejtohet të ftuarve në këtë mbledhje.

SHOKU RAMIZ ALIA: Jo, akoma, po përgatitem (Të qeshura.).

SHOKU ENVER HOXHA: Desha të di se si zhvillohet sporti, sidomos ai masiv, po edhe degët e tjera të fizkulturës dhe të sportit dhe çfarë ndryshimi shikojmë ne në zhvillimin fizik dhe mendor të njerëzve tanë. Keni bërë ndonjëherë analiza për këto fenomene, për të parë gatishmërinë ushtarake dhe shkathtësinë në punë të njerëzve tanë? Pra, për këto probleme a mund të na bëni tash ndonjë sintezë?

Pasi u diskutua rreth raportit e çështjeve që u shtruan, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

E dini ju fjalën e urtë të latinëve që thotë «Mens sana in corpore sano»¹. Latinët dhe grekët i kanë pasë vënë shumë rëndësi kulturës fizike, sidomos atletikës. Mitologjia greke dhe romake çështjen e sportit e ka pasur si një apanage² të saj. Ajo i tregon njerëzit që merreshin me kalitjen fizike si krijesa të dashura të perëndive. Apoloni, Hefesti, Dionisi e të tjera perëndi greke merreshin me sport. Edhe Aleksandri i Maqedonisë ishte një vrapues i madh me kuaj dhe shkonte deri në stadiumin olimpik të Athinës nga Pella, kryeqyteti i Maqedonisë, për të marrë pjesë në të tilla vrapime. Në një nga këto aktivitete, ku vajti edhe Aleksandri tok me Efestionin hipur në kuajt e tyre, Demosteni, oratori i madh i Athinës, që nga morali nuk qëndronte lart, me këtë rast u ngrit e foli kundër Aleksandrit duke thënë: «Jashtë lojërave tona ky, barbari!», sepse Alek-

1. Mendje e shëndoshë në trup të shëndoshë.

2. Nga frëngjishtja — pjesë përbërëse.

sandri ishte i huaj për grekët dhe ata të gjithë të huajt i quanin «barbarë». Pas fjalës së tij, areopagu¹ nxori vendim në favor të Demostenit. Por, kur foli më pas Aleksandri, megjithëse ishte 16-vjeçar, e atakoi Demostenin, që i kishte gishtërinjtë të mbushur me unaza, dhe areopagu u detyrua t'i rikthehej prapë çështjes dhe të vendoste në favor të Aleksandrit, i cili u lejua të merrte pjesë në gara, ku edhe fitoi. Me këtë rast, doja të pyesja një gjë: «A organizohen te ne gara me kuaj?». Kjo çështje m'u kujtua nga ngjarja e Aleksandrit që përmenda. Të mos bëhen veprimtari me kuaj vetëm sa për të përgatitur një film si «Pylli i lirisë», që është me të vërtetë i bukur dhe ku kemi parë një kalë të bardhë.

Ne nuk do të bëjmë as hipodrome, as ushtri me kuaj, por këta neve na duhen, para së gjithash, për të lehtësuar gratë nga ngarkesa. Prandaj ta rritim një çikë kujdesin e Partisë në rrethe e në bazë për kuajt e për njëthundrakët në përgjithësi. Dhe, kur t'u futim njerëzve tanë «krimbin» e garave me kuaj, duke vënë për fituesit edhe ndonjë flamur a medalje, atëherë të shikonim se si do të interesohen më tepër për këto kafshë. Ky problem ka rëndësi të madhe edhe për mbrojtjen. Ne duhet të bëjmë gara jo vetëm me kuaj, por edhe me njëthundrakë të tjerë. Këtë nuk e them me shaka, por me plot seriozitet, se lindin edhe probleme ekonomike nga mungesa e këtyre kafshëve. Prandaj, ju, që merreni me sportin mund të punoni më shumë që të nxitet

1. Areopag, organ i lartë pushteti në Athinën e lashtë, i quajtur kështu sipas vendit ku bënte mbledhjet, në kodrën Ares, pranë Akropolit.

kujdesi për kuajt, sepse kjo ka rëndësi edhe nga ana ekonomike. Pastaj, është edhe një gjë e bukur të merrësh me kuajt, pse kali është një kafshë fisnike, i bukur dhe besnik i njeriut. Njëkohësisht, ai, siç thashë, është edhe shumë i nevojshëm për punën. Por, për ta nxitur rritjen e tij, të futim një çikë edhe pasionin për hipizmin. Të mos ketë sportistë vetëm për topin, por edhe për vrapime me kuaj. Këtu u tha se bëhen gara hipizmi, në disa rrethe, por deri tash unë nuk kam dëgjuar dhe as në gazetë nuk kam lexuar ndonjë lajm për gara me kuaj. Nuk duhet të kënaqemi me diçka të kufizuar, që ky ose ai kanë nga një kalë të mirë dhe, oburra, hajde, të bëjmë gara! Jo, jo kështu, por në mënyrë të organizuar.

E kisha fjalën këtu që, latinët, nuk e kanë sajuar kot atë proverb, por ishin shumë rigorozë dhe e zbatonin edhe në jetë atë që thoshin. Dhe, në fakt, ata ishin shumë të fortë e të shëndetshëm.

Në këto aktivitete sportive, a marrin pjesë edhe vajzat? Se nga sa shoh, në volejball dhe në basketboll ato marrin pjesë. Por, unë e kam fjalën për aktivitetet masive. Për shembull, në Gjirokastrë, apo në Dervişan, fjala vjen, kur bëhet thirrje që të mbliidhen e të bëjnë një garë, a venë dhe vajzat në këto aktivitete?

SHOKU VEIZ LELO¹: Në aktivitetet e organizuara vijnë edhe vajzat, kurse në aktivitetet e lira pjesëmarrja e tyre është shumë e kufizuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë, dëshira për

1. Në atë kohë, kryetar i Komitetit të Kulturës Fizike e Sporteve.

sportin te vajzat ekziston, por me to nuk bëhet punë sa duhet, kështu del konkluzioni.

Si janë sjelljet në mes djemve e vajzave në këto veprimtari sportive? Të rinjtë a kanë sjellje korrekte me njëri-tjetrin, sidomos ndaj vajzave?

SHOKU VEIZ LELO: Sjelljet midis sportistëve e sportisteve janë të rregullta e të pastra.

SHOKU ENVER HOXHA: Dhe t'i ruani të pastra. Shumë mirë, ta ruajmë rininë të pastër, kudo, kudo! Por, kjo nuk do të thotë që kur një djali i pëlqen një vajzë, apo një vajze i pëlqen një djalë, të mos fejohen e të mos martohen. Fjala është të mos bëjnë gjëra jashtë normave të moralit tonë.

A ka në të gjitha qendrat e punës fusha volejboli e basketboli, se këto nuk duan shumë punë për t'u bërë, por dy shtylla dhe një rrjetë; siguro gjithashtu topin dhe ja, çdo gjë është gati për të luajtur skuadra. A janë pra të zhvilluara këto sporte?

SHOKU VEIZ LELO: Volejboli është më i përhapur, sepse dhe kërkesat teknike janë më të vogla, kurse basketboli është më i komplikuar, prandaj është edhe më i kufizuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, më i komplikuar është, ka disa rregulla më të ndërlikuara.

SHOKU VEIZ LELO: Në spartakiadat e klasës punëtore, niveli i skuadrave të ndërmarrjeve nuk është në cilësinë e duhur.

SHOKU ENVER HOXHA: Po pse, për gara i bëni këto ju? Këto nuk duhen për gara, po për kalitje, për shëndet. Në qoftë se nuk nisemi nga këto qëllime, ato nuk kanë asnjë kuptim te ne. Prandaj, këtu nuk është

çështja që të nxjerrim specialistë për të luajtur. Kjo është një punë tjetër. Kurse kjo që po themi ne, ka të bëjë me aktivitetet masive.

Kur dal e shëtis rreth e rrotull Tiranës, në këmbë, shoh se në mes të oborreve dhe blloqeve ka sheshe; mirëpo në to nuk sheh njeri. Të gjithë kalamanët lozin në rrugë dhe, kur kaloj unë, rrinë gatitu. Atëherë, përse të ndodhë kështu e të mos shfrytëzohen këto mundësi që kemi? Rinia duhet të ketë më shumë iniciativë në këto drejtime.

Po elbasanllinjtë si janë, more shoku Fatmir¹? Të pyes, sepse, siç më kanë thënë, qëndrojnë në fund të pusit² (të *qeshura*), megjithëse atje ju ka ardhur një sekretar që dikur ka qenë sportist. Me sa duket edhe ai e ka harruar këtë sektor.

SHOKU FATMIR SELITA: Nuk e ka harruar, shoku Enver, por ne atje kemi edhe shokë të tjerë që kanë qenë futbollistë.

SHOKU ENVER HOXHA: E dini që keni pasur një tifoze të fortë, fenomen fare, ju në Elbasan, për futbollin?! Ti nuk je marrë me futboll dhe mbase nuk e di, po e di unë. Kur vajta në Elbasan, ka nja gjashtë apo shtatë vjet, më njoftuan se një grua e shkuar në moshë, donte të piqej me mua. Mirë, u thashë shokëve, le të vijë. Dhe e prita. Nuk ishte mëmë Hatixheja (Ekmekçiu), po një plakë tjetër që nuk e njihja. Ajo më puthi e më përqafoi. Kur e pyeta: «Si je, moj plakë,

1. Fatmir Selita, sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit.

2. Autori e ka fjalën për skuadrën e futbollit «Labinoti» që në kampionatin e atij viti nuk paraqitej mirë.

si shkon», unë e kuptova menjëherë që, shokët, të cilët më kishin thënë përpara se ishte tifoze, kishin të drejtë, se ajo menjëherë më tha: «Si të jem? Ja, e shikon këtë? dhe më tregoi zemrën, këtu e kam topin!», m'u përgjigj ajo. «Si, e paske topin në zemër?» e pyeta. «Unë vdiqa për një çikë futboll, nuk lë lojë pa parë. Edhe kur ikën skuadra jonë e futbollit jashtë Elbasanit, ia hip tomobilit dhe bre dh me të nga të katër anët.» S'kisha parë tifoze më të madhe se kjo grua. Sa ndenji, ndonjë orë me mua, për futbollin më foli.

SHOKU RAMIZ ALIA: Prandaj, është e papranueshme që «Labinoti» të bjerë nga kategoria.

SHOKU ENVER HOXHA: Vajti «Labinoti», ka marrë poshtë. Po kooperativa e Labinotit si paraqitet, a e realizon planin ekonomik?

SHOKU FATMIR SELITA: Kooperativa e Labinotit doli nga më të mirat e rrethit në realizimin e treguesve të vitit të kaluar.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë, shumë mirë.

Tani të kthehemi te tema që kishim. Ju në Elbasan keni shumë punëtorë, se metalurgjia është një vepër e madhe. Disa punë atje janë edhe të rënda. Atëherë, çfarë keni bërë ju për aktivizimin e punëtorëve të metalurgjisë në veprimtari sportive, gjë që do t'i shërbente edhe shëndetit të tyre? Keni bërë ndonjë gjë të veçantë për ta, apo i jeni qepur vetëm skuadrës së «Labinotit»?

SHOKU FATMIR SELITA: Ne jemi munduar ta bëjmë sportin më tepër problem të organizatave të masave.

SHOKU ENVER HOXHA: Dua të më flisni pak konkretisht për këtë çështje.

SHOKU FATMIR SELITA: Ne u patëm lënë detyrë shokëve të kombinatit që të bënin një terren të madh sportiv në hyrje të qytetit.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë, ju keni menduar që ata të bëjnë stadiumin një herë, pastaj të shohim ç'të bëjmë. Po pse nuk filluat një çikë nga brenda, ç'mund të bëhej tani për tani, pa pritur atë terrenin e madh sportiv.

SHOKU FATMIR SELITA: Në disa uzina kanë bërë disa terrene sportive e kanë organizuar edhe aktivitete.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa terrene sportive ka atje?

SHOKU FATMIR SELITA: Brenda kombinatit janë nja pesë apo gjashtë fusha sportive.

SHOKU ENVER HOXHA: Janë mijëra veta që punojnë në kombinat. Po dushe ka në të gjitha këto uzina të kombinatit?

SHOKU FATMIR SELITA: Në pjesën më të madhe të uzinave ka.

SHOKU ENVER HOXHA: I keni parë me sy se si funksionojnë ato?

SHOKU FATMIR SELITA: Disa prej tyre i kemi pasur me defekt, për shembull në uzinën e koksit.

SHOKU ENVER HOXHA: Tamam atje ku duhet më shumë, atje qenkëshin me defekte.

Po pse, cila është arsyeja? Mos mungon uji atje apo çfarë ka?

SHOKU FATMIR SELITA: Jo, më tepër është mungesa e vlerësimit të tyre.

SHOKU ENVER HOXHA: Ja, këtu është çështja.

Si mendoni ju, është më mirë të bëni atje një stadium tjetër, apo një pishinë të madhe që, me të dalë punëtorët nga puna, të drejtohen në pishinë për t'u larë. Më duket se kjo mund të bëhet. Aq më tepër që atje keni afër edhe ujin e lumit.

SHOKU RAMIZ ALIA: Po, e drejtë. Ju keni edhe Shkumbinin pranë që mund ta shfrytëzoni për këtë qëllim.

SHOKU ENVER HOXHA: Të jeni të bindur se organizata e rinisë e Kombinatit Metalurgjik është e gatshme të bëjë çdo gjë dhe, në fakt, ajo ka bërë gjithë ato gjëra të mira. Prandaj, po t'i thuash edhe për këtë, për tërë natën ajo ta ngre një objekt sportiv vetëm se për këtë punë nuk vihet ujët në zjarr as nga ju, shokët e komitetit të Partisë të rrethit e të kombinatit, as nga ata të komitetit të fizkulturës dhe as nga shokët e drejtorisë së kombinatit. Kurse unë jam i bindur që organizata e rinisë është gati qysh nesër ta ndërtojë pishinën. Bile, ata janë gati të rrinë edhe pa gjumë për këto çështje. Kur ka për të kritikuar, atëherë të kritikojmë.

SHOKU FATMIR SELITA: Ashtu është, shoku Enver, kjo është në radhë të parë mungesë e punës sonë. Masa e punëtorëve është e etur për t'u marrë me fizkulturë dhe sport.

SHOKU ENVER HOXHA: Është që ç'ke me të. Si domos në atë kombinat një aktivitet i tillë është shumë i nevojshëm. Për Kombinatin Metalurgjik kërkohet një kujdes i veçantë nga ana e Partisë.

Kam mendimin se gjimnastikës nëpër shkolla nuk

i kushtohet rëndësia e duhur. Gjithashtu nuk bëhet shumë edhe për propagandimin e aktiviteteve fizikurore.

Ndiej kënaqësi të madhe, për shembull, kur shoh në orkestrat e grupet artistike vajza, djem dhe pionierë që u bien violinave e veglave të tjera muzikore. Një kënaqësi të madhe ndien për këtë gjë gjithë populli ynë, dhe veglat muzikore të tërë i mësojnë me kënaqësi, shumica në shkolla dhe jo vetëm në shkolla artistike, por edhe në ato të arsimit të përgjithshëm.

Po është fakt se edhe niveli i mësimin të gjimnasit është ngritur, siç u tha këtu, por të them të drejtën në televizor nuk kam parë që t'i nxjerrin të rinjtë dhe të rejat, nxënësit e nxënëset e shkollave 8-vjeçare dhe të mesme që të nxiten një çikë në këtë drejtim të mërrën të gjithë me fizikurë dhe sport.

Televizioni luan një rol të jashtëzakonshëm për popullarizimin e çdo fushe të veprimtarisë në jetën tonë shoqërore, shkollë, artistike etj. Ai duhet të nxitë tek të rinjtë dhe të rejat tona që të shohin se Partia e vlerëson shumë edhe gjimnasitë, saqë ja, ajo po të vë përpara syve të popullit që të të shohin të gjithë, prandaj duhet të futen edhe në programet televizive këto aktivitete dhe ju e keni në dorë ta bëni një gjë të tillë.

Të mos shikojmë vetëm futbollistët, por edhe se si stërviten fëmijët, si hidhen, si forcohen e ngrihen fizikisht dhe kjo është një kënaqësi e madhe për të gjithë.

Rëndësia e kulturës fizike qëndron, ndër të tjera, edhe në faktin se ajo krijon te nxënësit njëfarë kuptimi më të drejtë për rregullin, për disiplinën, për zbatimin në kohë të urdhrin dhe jo plogështinë e çrregullimit.

Kanë rëndësi të madhe këto çështje, se duhet pasur parasysh edhe ana psikologjike e nxënësve. Çështja e zhvillimit fizik është me rëndësi të madhe edhe për shëndetin, për kalitjen e gjithanshme të brezit të ri.

Kur flasim për lojërat popullore, mendoj se nuk është fjala të përtërijmë lojërat popullore si një qëllim në vetvete, por të praktikojmë të gjitha ato që zhvillojnë forcën dhe, po t'i ndjekësh me kujdes, do të kuptosh se te çdo lojë popullore ka diçka të tillë. Tani kanë dalë lojëra të tjera, por edhe në kohën tonë të rinisë kishim edhe ne tonat. Lojërat popullore ndihmojnë për zhvillimin fizik të brezit të ri, ato kanë në vetvete edhe çështjen e forcës, të kalitjes së vullnetit etj. Kështu forcohej njeriu, forconte edhe vullnetin, edhe rezistencën. bëhej trim.

Nëpër shkollat tona, në kohë të caktuara mund të vejë ndonjë mjek t'u mbajë leksion për rëndësinë e fizikulturës dhe të sporteve, si dhe për dëmet që u sjellin duhani dhe pijet alkoolike atyre që merren me sport. Një instruktazh të tillë mund ta bëjnë edhe mësuesit e fizikulturës. Ata njohin anatominë e trupit të njeriut, sigurisht jo aq sa mjeku, por në mungesë të tij mund të bëjnë propagandimin e njohurive praktike.

Nxënësit duhet të porositen të jenë të pastër, të vishen lehtë dhe thjesht, që të kaliten, dhe jo siç na kanë mësuar brezin tonë që vazhdimisht na thoshin: «Mbulo-hu, ose vishu mirë se do të ftohesh». Ka edhe shumë gjëra të tjera, që mund t'u shpjegohen të rinjve. Është fakt se, po t'i zbatosh si duhet rregullat, nuk do të vuash nga sëmundjet ose do t'i përballosh më lehtë ato. Këto

porosi sigurisht, i di mjeku ose mësuesi i fizkulturës, i cili u shpjegon në mësim fëmijëve se, po të luajnë disa orë pa pushim dhe të bëhen qull në djersë, pastaj të rrinë në erë, ftohen menjëherë.

Atyre që merren me fizkulturë e sporte u duhet vënë disiplinë e rreptë në regjimin e tyre. Për këtë të bëjmë një propagandë intensive në gjithë rininë dhe veçanërisht në ata që merren me sport, që cigaren dhe pijet alkoolike të mos i përdorin se i dëmtojnë në aktivitetin sportiv. Unë nuk them që i riu të mos pijë një birrë, por jo ama edhe disa shishe në një të ulur në tavolinë. Edhe duhanin, me sa di unë, ka shumë njerëz te ne që e pinë. Mirëpo, siç dihet cigarja është mjaft e dëmshme. Këtë e kam provuar vetë kur e pija. Tash që e kam lënë e kuptoj se nuk ka gjë më të mirë kur nuk pi duhan njeriu e ndien veten jashtëzakonisht mirë. Si do të bëj, thosha, punohet dot pa duhan, mendohet dot pa duhan, mund të shkruash pa pirë duhan?!! More tash e shoh që mendohet dhe shkruhet që ç'ke me të, pa pirë fare duhan. Prandaj u thoni të rinjve që e pinë duhanin të mos e pinë atë. Unë e lashë duhanin në moshtë të madhe, kurse të rinjtë tanë mendoj që ta lënë sa më parë.

Me këtë rast doja të theksoja edhe një gjë, të mos harrojmë, shokë, kushtet e veçanta fizike të vajzave dhe të grave. Të kemi parasysh që të rejat të mos sforcohen gjatë zhvillimit të fizkulturës dhe të sporteve, se sforcimi sjell çrregullime në organizmin e tyre. Pikërisht këtu është një nga specifikat e organizatës së gruas, që Partia duhet ta ketë parasysh. Për këtë çë-

shtje duhet të kenë kujdes mësueset e fizkulturës, me të cilat vajzat komunikojnë më mirë. Prandaj duhet të keni shumë kujdes në këtë drejtim.

Ju urojmë sukses! Rinia është në duart tuaja, prandaj na e bëni atë gjithnjë e më të fortë.

*Botuar për herë të parë,
me shkurtime, në librin:
Enver Hoxha, "Për rininë"
(Përmbledhje veprash),
vëll. II, f. 491.*

*Botohet i plotë, sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali i
mbledhjes së Sekretariatit të
KQ të PPSH, që gjendet
në AQP*

KUSH ESHTË TEN HSIAO PINI DHE GJASHTË FAZAT E REVOLUCIONIT KULTUROR

Shënime

28 shkurt 1978

Tash që po zhvillon punimet Asambleja Popullore Kombëtare Kineze, është shtuar zhurma rreth pozitive të ardhshme të Ten Hsiao Pinit. Thuhet se ai do të bëhet kryeministër, kryetar i partisë e të tjera, e të tjera. Me këtë rast po shkruaj pak se kush është Ten Hsiao Pini.

Figurën dhe veprimet e këtij njeriu duhet t'i shikojmë dhe t'i vlerësojmë duke pasur parasysh periudhën e Revolucionit Kulturor. Në atë kohë Ten Hsiao Pini ishte anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i përgjithshëm i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës. Ai ishte krahu i djathtë i Liu Shao Çisë, president i republikës, anëtar i Byrosë Politike dhe nënkryetar i Partisë Komuniste të Kinës. Këta dy persona udhëhiqnin «bandën e zezë», siç u quajt grupi i tyre, i cili përbehej sidomos nga njerëz kryesorë, si Pen Çeni, anëtar i Byrosë Politike, kryetar i Bashkisë së Pekinit; Lu Din I, kandidat i Byrosë Politike, zëvendëskryeministër, drejtor i drejtorisë së propagandës dhe të kulturës e arsimit, dhe Lo Zhui Çini, shef i shtatmadhorisë. Në

të bënin pjesë, gjithashtu. Jan Shan Kun, kandidat i Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë, Dën To, sekretar i komitetit të partisë së Pekinit dhe Liao Mo Sha, gazetar dhe zëvendëskryetar i Bashkisë së Pekinit.

Ç'ngjau në fakt me këta njerëz? Në Republikën Popullore të Kinës këta kishin marrë fuqinë në parti e në administratë dhe bënin ligjin. Ligji i tyre ishte ligj kapitalist, politika e tyre ishte politikë e ekstremit të djathtë dhe kapitaliste. Këta dëshironin të vendosnin haptazi, nën flamurin e Mao Ce Dunit, kapitalizmin në Kinë. Mao Ce Duni, jo se ishte kundër zhvillimit të kapitalizmit, por sidoqoftë ai nuk bënte pjesë në grupin e tyre. Ai qëndronte mbi ta dhe në fillim i la të vepronin, megjithëse nuk dëshironte forcimin e pozitave të tyre në dëm të pushtetit të tij.

Revolucioni Kulturor në Kinë filloi me luftën kundër veprimeve të këtij grupi, i cili kishte sjellë dhe inkurajonte ardhjen në fuqi të intelektualëve, të një elite, e cila e kishte origjinën nga klasat e pasura, qoftë të qytetit, qoftë të fshatit. Liu Shao Çia dhe Ten Hsiao Pini me shokë ishin përkrahës të politikës së zhvillimit të pakufizuar të kapitalizmit në Kinë, predikonin bashkëjetesën e klasave antagonistë dhe integrimin paqësor të borgjezisë në socializëm.

Si rezultat i luftës midis grupeve kryesore në parti, në vitin 1959 u mënjanua nga udhëheqja e partisë marshali Pin De Hua. Në fillim të viteve 60-të lufta në gjirin e partisë u ashpërsua edhe më shumë. Grupi i Liu Shao Çisë dhe i Ten Hsiao Pinit doli në mbrojtje të Pin De Huasë. Në janar të vitit 1961 një nga pasuesit e tyre, historiani Vu Han shkroi dramën historike «Shkarkimi i

Haj Zhueit» me anën e së cilës përpiquej indirekt të rehabilitonte Pin De Huanë dhe natyrisht të kundërshtonte Mao Ce Dunin. Në vitin 1965, kësaj drame, me shtytjen e Mao Ce Dunit nëpërmjet një artikulli të shkruar nga Jao Ven Juani, me titull «Mbi dramën e re historike «Shkarkimi i Haj Zhueit»», iu bë një kritikë në Shangai që shkaktoi bujë të madhe. Mirëpo kjo kritikë ndeshi në kundërshtimin e Pen Çenit, sepse ishte Pen Çeni dhe grupi i tij që e vunë në skenë këtë dramë, me një synim të qartë. Pra, Pen Çeni u përpoq që kjo kritikë, e cila i bëhej ndihmësit të tij, të mbytej, të mos botohej në gazetatat qendrore të Pekinit. Megjithatë, pavarësisht nga kjo rezistencë, kritika u botua në Shangai më 10 nëntor të vitit 1965.

Nuk vonoi shumë dhe në fillim të shkurtit të vitit 1966 Pen Çeni, si kryetar i grupit për çështjet e Revolucionit Kulturor, për ta mbrojtur veprën e Vu Hanit, në mungesë të Mao Ce Dunit dhe në emër të tij, shpërndau projektin e një instruksioni, i cili u quajt nga grupi i Mao Ce Dunit «tezat e bandës së zezë». Më 16 maj 1966 Komiteti Qendror nxori qarkoren e hartuar nga vetë Mao Ce Duni që anulonte tezat e grupit për çështjet e Revolucionit Kulturor dhe urdhëroi shpërndarjen e grupit. Atëherë në Universitetin e Pekinit filluan të vendoseshin dacibaot dhe Revolucioni Kulturor filloi të merrte hov. Gjërat po komplikoheshin dhe pranë Komitetit Qendror u krijuan grupet e punës. Këto grupe u udhëhoqën nga Liu dhe nga Teni. Jeta dhe veprimtaria e këtyre grupeve vazhduan nja 50 ditë. Si vepruan këto grupe të punës? Qëllimi i Liu Shao Çisë dhe i Ten Hsiao Pinit ishte të shuanin kritikën ndaj njerëzve të tyre dhe të

mbytnin Revolucionin Kulturor. Gjatë kësaj kohe Mao Ce Duni bridhte nëpër Shangai e gjetkë. Pas kthimit të tij në Pekin, disa muaj pas fillimit të Revolucionit Kulturor, u mbledh sesi i 11-të plenar i Komitetit Qendror të Partisë, ku u përjashtuan nga Byroja Politike katër veta dhe u shkarkuan shtatë anëtarë të Sekretariatit nga trembëdhjetë që ishin ata. Liu Shao Çia dhe Ten Hsiao Pini mbetën anëtarë të Byrosë Politike, por vetëm nëpër gazeta u vu re që emrat e tyre nuk ndodheshin më në ballë, por shumë më poshtë nga ç'ishin më përpara.

Kritikat dhe masat e marra ndaj njerëzve që gabojnë në Kinë nuk dalin sheshit, por edhe në qoftë se dalin, kjo bëhet me shumë vonesë. Domethënë këto bëhen të njohura kur del komunikata e ndonjë mbledhjeje, ku radhiten ata që asistuan në të. Atëherë mund ta shikosh e ta kuptosh ose mund ta marrësh me mend se ç'ka ngjarë.

Në fazën e parë të Revolucionit Kulturor rolin kryesor e luanin Liu Shao Çia me Ten Hsiao Pinin. Vetëm pas Plenumit të 11-të të KQ të PKK u dobësuan pozitat e tyre dhe u forcuan pozitat e grupit të Mao Ce Dunit. Megjithatë ai përfaqësonte një etapë të ndërmjetme për ta kaluar udhëheqjen e Revolucionit Kulturor në duart e Mao Ce Dunit.

Faza e dytë e revolucionit fillon me krijimin e «Gardës së kuqe». «Garda e kuqe» ishte pararoja e Revolucionit Kulturor, krijimi i saj u inkurajua nga Mao Ce Duni «për t'i dhënë mësim partisë» dhe për të rrëzuar grupin e Liu Shao Çisë e të Ten Hsiao Pinit. Në fakt rrëzimi i këtyre ishte akoma larg, për arsye se Mao Ce

Duni ose nuk e kishte të qartë akoma situatën në vend, sepse dhe vetë ishte një oportunist i djathtë, ose nuk kishte gjë në dorë. Partia Komuniste nuk ishte në duart e tij dhe nuk ishte vepruese për realizimin e qëllimeve të tij, kështu që ai nxiti të rinjtë e shkollave të dilnin, siç dolën kundër «bandës së zezë».

Në këtë kohë, në krye të komisionit që drejtonte Revolucionin Kulturor erdhi njëfarë Tao Çu. Ishte koha kur miliona të rinj shkonin nga një vend në tjetrin, nga qytete të ndryshme të Kinës drejt Pekinit për të marrë eksperiencë. Kudo bëheshin mbledhje të mëdha të «Gardës së kuqe», ku Maoja, i veshur me rroba ushtarake, hipur në xhips, kalonte në rivistë. Këta filluan të futeshin edhe në uzina. Kështu që në atë kohë u bënë përpjekje për të tërhequr në Revolucionin Kulturor edhe klasën punëtore, por pa sukses.

Në tetor 1966, në qoftë se nuk gabohem, në kryeartikullin e numrit 13 të revistës «Flamuri i kuq», kritikoheshin indirekt Liu Shao Çia dhe Ten Hsiao Pini, që kishin penguar zhvillimin e Revolucionit Kulturor, kishin kundërshtuar vendimet e Plenumit të 11-të të KQ dhe u bëhej thirrje të bënin autokritikë. Pas kësaj ndodhën incidentet në Shangai me kundërofensivën revolucionare, dhe Liu Shao Çia e Ten Hsiao Pini bënë «autokritikë» për gabimet e konstatuara, por në fakt ata nuk i kishin hedhur armët, për arsye se Tao Çuja, i cili kishte besimin e Mao Ce Dunit dhe ishte vënë në krye të grupit që drejtonte Revolucionin Kulturor, mbronte Liu Shao Çinë dhe Tenin. Mbrojtja e tyre nga ana e tij konsistonte në moslejimin e zhvillimit të kritikës kundër

Liut dhe Tenit, por më në fund byrekut iu 'hoqën petët dhe dolën dacibao edhe kundër Tao Çusë.

Fillimi i fazës së tretë të Revolucionit Kulturor mund të përcaktohet me lëvizjen e madhe të janarit 1967 në Shangai dhe me përhapjen e saj në të gjithë Kinën. Gjatë gjithë kësaj periudhe, domethënë gjatë muajve të parë të vitit 1967, u krijuan «komitetet revolucionare», të cilat kishin një tendencë spontane, anarkike. I ashtuquajtur i Revolucion Kulturor i kapërceu kufijtë e një revolucioni të tillë. Mirëpo Liu dhe Teni me shokët e tyre nuk i kishin hedhur armët dhe në muajt shkurt-mars të vitit 1967 ata organizuan kundërkorrentin e djathtë. Nëpër rrugët e qyteteve u goditën punëtorët me «Gardën e kuqe», bile kundër punëtorëve u përdorën armë të rënda. Në pranverë të vitit 1967, shtypi kinez botoi tre artikuj njërin pas tjetrit që sulmonin Liu Shao Çinë e Ten Hsiao Pinin, veçse me perifriza. Edhe kritika kundër librit të Liu Shao Çisë «Si të jesh komunist i mirë» u bë këtë vit, pra më 20 prill 1967.

Faza e katërt e Revolucionit Kulturor mund të përcaktohet me konfliktin që ndodhi në gjirin e komitetit revolucionar të Pekinit midis ultra të majtëve dhe tendencës së zbutjes oportuniste të Çu En Lait. Në këtë kohë u dukën çarje edhe në fraksionin e Mao Ce Dunit. Edhe në masat e popullit që ishin ngritur të bënë revolucionin pasqyrohej po ashtu çarje. Është tamam koha që filluan të dilnin dacibao nëpër muret e Pekinit edhe kundër Çu En Lait, të cilat Mao Ce Duni i ndaloi. Në këto momente pati sulme edhe kundër ushtrisë. Kjo valë erdhi duke u shtuar në Kanton e në Pekin. Në muajin

gusht u dogj ambasada britanike. Maoja rrinte në Pekin dhe drejtonte revolucionin. Ai mbështetej nga Çu En Lai dhe nga ushtria, domethënë nga Lin Biaoja.

Në vitin 1967 partia ishte gati e shpartalluar. Udhëheqjes së Revolucionit Kulturor, ku bënte pjesë edhe Kan Sheni, iu desh të merrej me riorganizimin e partisë dhe të fillonte luftën kundër fraksionizmit, që ishte zhvilluar edhe në masat e popullit, të cilat ishin ngritur në revolucion dhe nuk mund të mbeteshin jashtë ngjarjeve që po ndodhnin në Kinë. Tash Çuja ishte eliminuar. Në këtë kohë u zhvilluan gjoja metodat e studimit të mendimit të Mao Ce Dunit, të veprave të tij, sidomos të «Librit të kuq», që Lin Biaoja e inauguroi me diskuret e tij, duke rekomanduar kurse studimi të këtij libri, që u shtyp në qindra milionë kopje. Tamam në këtë kohë u krijua komiteti revolucionar në Mongolinë e Brendshme, në Uhan në fillim të vitit 1968 e gjetkë.

Në fazën e pestë të Revolucionit Kulturor ne shohim dy kundërkorrente. Sie Fu Xhia u godit nga grupet e kryeqytetit dhe u mbrojt nga grupe të tjera. Sie Fu Xhia ishte njeriu i Çu En Lait.

Në pranverë të vitit 1968, nën pretekstin se duhej luftuar e majta, u krijua një korrent i djathtë, i cili përpiqej me çdo kusht të rehabilitonte revizionistët. Ky kundërkorrent u zhvillua, por lufta kundër tij vazhdoi dhe, natyrisht, fraksionizmi tash filloi të zhvillohej edhe në universitete që ishin bërë qendra e «Gardës së kuqe».

Mao Ce Duni në këtë kohë, domethënë në mars të vitit 1968, mbronte komitetet revolucionare dhe predikonte se nuk duhet të kemi frikë nga fraksionizmi, se ai është një pasqyrë e luftës së klasave. Kjo do të thotë se

Mao Ce Duni i lejonte fraksionet të zhvilloheshin dhe njerëzit e këtyre grupeve apo fraksioneve të vritnin me armë njëri-tjetrin. Vetëm në tetor të vitit 1968, në Plenumin e 12-të të KQ të PKK u shkarkuan nga detyrat Liu Shao Çia e Ten Hsiao Pini dhe partia bëri përafërsisht një bilanc të Revolucionit Kulturor, por akoma, në qoftë se nuk gabohem, nuk flitej me emër për Liu Shao Çinë.

Faza e gjashtë e këtij revolucioni filloi me përgatitjen e Kongresit të 9-të dhe me mësimet që duheshin nxjerrë nga puna administrative dhe nga mënyra e organizimit të ndërmarrjeve. Në këtë kohë u fol se partia u riorganizua dhe komitetet revolucionare u forcuan. Kështu që në prill të vitit 1969 u mbajt Kongresi i 9-të i Partisë Komuniste të Kinës dhe u zgjodh një Komitet i ri Qendror, i cili adoptoi edhe statutin e ri të partisë.

Pra, gjatë gjithë kësaj periudhe të turbullt, të pasigurt, pa udhëheqje, periudhë me luftë fraksionesh, luftë ideologjike, luftë politike, luftë për pushtet, grupi i Liu Shao Çisë dhe ai i Mao Ce Dunit u konfrontuan në një rrëmujë të papërshkrueshme, ku as njëri, as tjetri nuk kontrollonin dot veprimet e mbështetësve të tyre. Natyrisht, kjo gjë solli kaosin e madh në Kinë, por njëkohësisht forcoi pozitën e grupit të Mao Ce Dunit dhe dobësoi grupin e Liut. Disa mendojnë se Mao Ce Duni në këtë drejtim manovroi me zgjuars, por mendimi im është se ai nuk tregoi zgjuars të madhe, përkundrazi, tregoi dobësi në të gjitha veprimet. Ai kishte frikë të merrte vendime të guximshme dhe të rekomandonte forma organizative të përshtatshme për të rrëzuar një grusht komplotistësh, që në fakt kishin nën drejtimin

e tyre partinë dhe administratën. Ai ishte dhe mbeti një oportunist.

Maoja nuk ka vepruar me largpamësi, me qartësi dhe me guxim kundër komplotistëve, ai ka hezituuar gjatë gjithë periudhës së revolucionit dhe hezitimi i tij duket që në fillim të Revolucionit Kulturor. Ai vuri në krye të grupit të punës për drejtimin e revolucionit Pen Çenin, domethënë kreun e «bandës së zezë». Më vonë, në krye të këtij Revolucionit Kulturor la Liu Shao Çinë dhe Ten Hsiao Pinin, që ishin koka e kundërrevolucionit, i cili kishte për qëllim ta kalonte pushtetin plotësisht në duart e borgjezisë. E pastaj për drejtimin e Revolucionit Kulturor caktoi njëfarë Tao Çu, i cili bëri çmos ta frenonte Revolucionin Kulturor dhe të mbronte Liu Shao Çinë dhe Ten Hsiao Pinin. Vetëm atëherë, kur në udhëheqje të Revolucionit Kulturor u vunë Çen Po Taja, Kan Shen, Çian Çini, Jao Ven Juani, në mes tyre edhe Çu En Lai, ky «revolucion» filloi të marrë njëfarë forme më të konkretizuar dhe të shndërrohet në një akt dhune që çoi në dobësimin, diskreditimin dhe eliminimin e Liu Shao Çisë dhe të Ten Hsiao Pinit. Megjithatë Revolucioni Kulturor nuk u shndërrua në një revolucion politik për përmbysjen e borgjezisë dhe fitoren e socializmit, siç u pretendua, ai ishte një grusht shteti. Pavarësisht nga frazat e majta që u përdorën, në themel të Revolucionit Kulturor qëndronte maocedunideja dhe Kina mbeti atje ku kishte qenë.

Zhvillimi i ngjarjeve në Kinë gjatë Revolucionit Kulturor dëshmon se Ten Hsiao Pini është një kundërrevolucionar me damkë, i cili ka punuar që pushtetin në Kinë ta kishte vetëm borgjezia. Në «autokritikën»

e tij ai i numëron dhe i pohon të gjitha veprimet dhe mendimet e tij reaksionare. Ky reaksionar u rehabilitua nga Maoja, u rrëzua përsëri nga Maoja dhe pas vdekjes së Maos u rehabilitua nga Hua Kuo Feni. Ç'do të ngjasë me të, do ta shohim. Do të bëhet ky reaksionar i tërbuar, kryeministër dhe pastaj grupi i tij të ecë revan drejt një Kine socialimperialiste, apo do të qëndrojë në fuqi djathtisti, antimarksisti, por më i moderuar nga Ten Hsiao Pini, Hua Kuo Feni? Këtë do të na e qartësojë e ardhmja dhe kjo nuk është e largët.

Sidoqoftë, tash për tash, fati i Kinës është në duart e kundërrevolucionarëve, e rrymave të ndryshme kundërrevolucionare. Ajo çka tha Hua Kuo Feni në raportin që mbajti përpara asamblesë, se akoma duhet luftuar kundër «bandës së të katërve», do të thotë që korrenti i elementëve të njohur si «revolucionarë» radikalë, nuk është shuar akoma në Kinë. Sigurisht, udhëheqësit e sotëm kinezë do të vazhdojnë spastrimin dhe do të shtypin çdo përpjekje të elementëve më të majtë, që bëhet për të rrëzuar dhe për të eliminuar këta revizionistë, këta tradhtarë të marksizëm-leninizmit dhe të çështjes së drejtë të popullit kinez.

Marrë nga libri:

Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 10, f. 138

THELLIMI I REVOLUCIONIT TEKNIKO-SHKENCOR TI SHËRBEJË MODERNIZIMIT TË TEKNOLOGJISË SË PRODHIMIT

Shënime

1 mars 1978

Ë mbarova së lexuari me kujdes raportin dhe programin e punës që na paraqitet për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor¹. Në to përmbahen detyra me një problematikë që duhet të plotësohen në afate të ndryshme fillimi e mbarimi, caktohen pjesëmarrësit që do t'i bëjnë këto studime, si dhe me cilën ndërmarrje do të bashkëpunohet e do të kooperohet brenda e jashtë rretheve.

Mua më duket se studimeve të ndryshme shkencore dhe teknike njerëzit dhe institucionet tona u janë futur me kohë, por u bë mirë që u mor përsëri në studim kjo çështje dhe sidomos në këto momente, kur ne duhet të ecim plotësisht me këmbët tona dhe problemet që na dalin përpara t'i zgjidhim me forcat tona, pse ndihma e kinezëve është praktikisht e prerë.

1. Fjala është për raportin dhe programin trevjeçar të punës për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor të përgatitur nga aparati i Këshillit të Ministrave.

Në këtë drejtim ka studime që duhen thelluar në sektorin e gjeologjisë, sidomos për zbulimin e vendburimeve të reja minerare. Nga studimet e kryera deri tani ne kemi gjetur e kemi zbuluar shumë lloj mineralësh, por konturet e zonave mineralmbajtëse nuk janë akoma të përcaktuara si duhet.

Kemi krijuar një industri të madhe mekanike, mbi bazën e studimeve e të eksperimentimeve; tani nga ne kërkohet të prodhojmë jo vetëm vegla ndërrimi, por edhe makineri komplete të llojeve të ndryshme, sidomos për nevojat e bujqësisë dhe të industrisë së lehtë; lypsct, gjithashtu, të ndërtojmë vetë fabrika komplete. Një fushë e gjerë studimore, që e kemi theksuar vazhdimisht, hapet para specialistëve tanë për studimin e burimeve tona hidrike, për studimin e gjithë sistemit ujqor të vendit tonë dhe për të caktuar për një periudhë pak a shumë të gjatë kohe, mundësinë e ndërtimit të hidrocentraleve aq shumë të nevojshme, që e prodhojnë energjinë elektrike me kosto më të ulët në krahasim me TEC-et, të cilat punojnë me lëndë djegëse.

Në industri dhe në degët e tjera rëndësi të veçantë ka modernizimi i teknologjisë së prodhimit. Çështja e teknologjisë së re duhet të mbahet parasysh jo vetëm në veprat që do të studiojmë dhe do të rindërtojmë në bazë të planeve tona, por edhe për industrinë ekzistuese, ku duhen bërë përmirësime të atilla që të reflektohen në rritjen e rendimentit të punës, të cilësisë së prodhimeve, si dhe në uljen e kostos. Prandaj të mos humbasim mendimi i plotë i revolucionit tekniko-shkencor dhe të mos mendohet se meqë u krijuan grupe të ndryshme, të cilat kanë marrë përsipër detyra e studime të cak-

tuara për ndërtime veprash ose për prodhime të reja, të lihet mënjane zhvillimi tekniko-shkencor i industrisë aktuale nxjerrëse-përpunuese.

Aktualisht te ne është ngritur një numër i madh ndërmarrjesh, fabrikash, kombinatesh që prodhojnë mallra të konsumit të gjerë, siç janë kombinatet e tekstileve, uzina e porcelanit, fabrikat e këpucëve, e gomë-plastikës etj., etj., të cilat duhet të ecin përpara, t'i shumëzojnë e t'i përmirësojnë prodhimet, t'i bëjnë ato më të mira e më të lira. Kjo do të arrihet me zhvillimin e mëtejshëm tekniko-shkencor edhe në këtë degë. Pra, krahas caktimit të grupeve për të studiuar dhe për të nxjerrë në dritë probleme të rëndësishme të industrisë së rëndë, të bëhet kujdes që të mos lëmë mënjane direktivën e Partisë për zhvillimin më të madh të industrisë së lehtë, të prodhimit të mallrave të konsumit të gjerë, për ndërtimin e linjave të reja, jo si qëllim në vetvete e sa për të futur njerëzit në punë, gjë që edhe kjo ka rëndësinë e vet të madhe, por për të ndërtuar linja e fabrika që të prodhojnë më shumë artikuj dhe sende të nevojshme e me leverdi që të plotësojnë nevojat e popullit dhe për eksport.

Përveç industrisë, një vëmendje të veçantë kërkohet studimet, eksperimentimet dhe zbatimet në fushën e bujqësisë. Deri tani në këtë degë janë zgjidhur shumë probleme teknike dhe shkencore, por ka akoma mjaft probleme të tjera që kërkohet zgjidhje.

Çështjen e studimeve në bujqësi e kemi shtruar kurdoherë me një kujdes të veçantë, pse bujqësia duhet të ketë në themel të saj një punë shkencore të thelluar. Nga punonjësit e kuadrot e bujqësisë kërkohet të stu-

diojnë me kujdes eksperimentet dhe prej tyre të nxjerrin konkluzione shkencore, të përcaktojnë mirë në parim dhe në afate shërbimet e trajtimet e ndryshme që u bëhen tokës, bimëve e deri te farërat, të studiojnë racat e bagëtisë, rrugët e luftimit të sëmundjeve etj., etj.

Thellimi i revolucionit tekniko-shkencor, siç e kam theksuar edhe herë të tjera, duhet të zhvillojë edhe kooperimin, i cili kërkohet të ngrihet në një shkallë shumë më të lartë. Industria mekanike, industria tekstile dhe dogët e tjera të profilizohen e të forcojnë kooperimin jo vetëm për çështjet e mëdha, por edhe për probleme të vogla. Nuk duhet të pritët nga një uzinë që bën gjëra të mëdha të merret edhe me gjëra të vogla. Prandaj lypset kooperim edhe për gjëra që në pamje duken si të vogla, por që na zënë këmbët. Ndërsa po të zgjidhen ato me rrugën e kooperimit, vihen në vijë probleme të mëdha.

Për t'i vënë në jetë studimet që bëhen, natyrisht, duhet caktuar edhe baza materialo-teknike e nevojshme. Dihet se ne kemi krijuar një bazë të fuqishme materialo-teknike, por gjithë këto studime që parashikohen në këtë program do të kërkojnë edhe fonde monetare e materiale. Prandaj të gjitha duhet të parashikohen, përndryshe, vetëm duke caktuar kuadrot që do të marrin pjesë në këto studime, ato nuk mund të realizohen.

Unë besoj se këto studime do të kryhen me sukses nga kuadrot tanë. Ne kemi kuadro të ngritur politikisht e ideologjikisht, të mësuar dhe të aftë nga pikëpamja tekniko-shkencore. Një punë e tillë do t'i kalitë ata akoma më shumë, do t'u zgjerojë njohuritë, do t'u ngrejë nivelin e tyre tekniko-profesional dhe do t'i mësojë ata

për një metodë e stil më revolucionar në punë. Prandaj, në qoftë se këto detyra që janë caktuar në këtë program bëhen objekt i një kujdesi të veçantë të çdo dikasteri ose institucioni që do ta marrë përsipër këtë apo atë studim, atëherë do t'u dilët në krye me sukses këtyre çështjeve në kohën e duhur. Të gjitha këto do të na shërbejnë për planet në zhvillim dhe për planet e ardhshme. Kështu do t'u dalim përpara shumë problemeve që tash mund të na duken të parakohshme. Por koha ecën dhe ne duhet t'i paraprijmë asaj me studime dhe me punime tekniko-shkencore.

Detyrat që caktohen nuk janë fakultative. As shokët që marrin pjesë në këto grupe dhe as ata që i drejtojnë ato të mos mendojnë se kjo punë mund të bëhet si të bëhet. Jo, kjo të bëhet e planifikuar, e kontrolluar dhe me rezultate të mira.

Duke u hedhur një sy problemeve që janë shtruar për të studiuar, del se programi përmban shumë gjëra interesante. Veçse mendoj që këtu duhet të ruhem, sepse disa çështje nuk janë të reja. Për to deri tash janë bërë studime. Por ka mundësi që drejtuesit e sektorëve të ndryshëm i kanë shënuar përsëri disa prej tyre për të shtuar numrin ose për të fituar ndonjë vit a dy e të merren me disa gjëra, 3/4 e të cilave mund të jenë studiuar e të jenë zgjidhur, por nuk janë vënë akoma në zbatim. Kështu ndodh me disa probleme që, megjithëse janë studiuar, për shkak të burokratizmit të disa organizmave e drejtuesve, zbatimi i tyre është zvarritur, duke nxjerrë pretekste se gjoja nuk kanë qenë përfshirë në planin e shtetit, për mungesë fondesh etj.

Natyrisht, për të vënë në planin e shtetit ose për të zbatuar diçka me rëndësi që nuk është përfshirë në plan, kërkohet të merren vendime të veçanta dhe jo sipas dëshirës, për arsye se studimet mund të jenë të shumta, por zbatimi i tyre do të bëhet me radhë, sipas rëndësisë dhe prioritetit që ka secili. Megjithatë, në përgjithësi duhet thënë se zbatimi i detyrave të revolucionit tekniko-shkencor nuk ka ecur me shpejtësi e me ritmin që kërkon Partia. Ka ende mjaft ndërmarrje, të cilave u mungon dokumentacioni teknologjik i domosdoshëm, ruajnë akoma forma pune artizanale, nxjerrin prodhime me cilësi të dobët etj., etj.

Institetet kërkimore-shkencore medoemos duhen shkundur. Dhe kjo të bëhet jo me fjalë, por duke u caktuar detyra konkrete aktuale dhe perspektive për zhvillimin e thellimin e revolucionit tekniko-shkencor. Institetet nuk janë për të plotësuar punët operative të ministrive. Këto u përkasin ministrive dhe duhet t'i kryejnë kuadrot e saj e ndërmarrjet që kanë në vartësi, kurse Instituteve t'u caktohen detyra akoma më të mëdha se deri tash në fushën e studimeve. Në institute kemi kuadro të aftë, por kjo nuk do të thotë të mos merren masa për forcimin e mëtejshëm të tyre. Në to të çohen kuadro me kapacitet. Ata të zgjidhen nga terreni, nga njerëzit që kanë treguar me të vërtetë aftësi, pjekuri në mendime e në veprime dhe në terren e në zbatim të çojmë njerëz të rinj, të cilët do të fitojnë një eksperiencë të shëndoshë.

Në bisedën që pata me shokët sekretarë të Komitetit Qendror theksova se ministrinë ose institucionet duhet t'i mbajnë vazhdimisht pranë grupet studimore

që do të punojnë nën drejtimin e tyre, ta marrin këtë çështje seriozisht dhe t'i ndihmojnë e t'i kontrollojnë në punë e sipër grupet e caktuara.

Një çështje tjetër është se temat në fjalë nuk duhet të konsistojnë në studime akademike, por në studime të frytshme për t'i zbatuar ato në jetë. Ne nuk kemi nevojë për mbushje fletësh me teori të kopjuara nga librat, por dëshirojmë studime të atilla të frytshme që të shtyjnë përpara prodhimin. Pra, aplikimi i këtyre studimeve të japë rezultate. Prandaj studimet që do të bëjnë këta njerëz duhet njëkohësisht t'i shoqërojnë me eksperimentime nëpër laboratorë e uzina, nëpër fusha e stacione të bujqësisë, të blegtorisë, të zooteknisë etj., dhe jo vetëm duke lexuar libra. Puna e tyre të organizohet mirë në teori dhe në praktikë; teorinë ta përvetësojmë e ta zgjerojmë, por edhe ta zbatojmë në praktikë, për të dhënë rezultate dhe konkluzione të mira e të mundshme për t'u zbatuar.

Librat e përgatitur me emërtime e tituj detyrash për studime tekniko-shkencore të mos konsiderohen si çështje e përfunduar. Caktimi i një sërë problemesh, natyrisht, kërkon kujdes, por megjithatë nuk është aq vështirë, sepse njerëzit që i kanë caktuar këto kanë dijet dhe horizontin e nevojshëm. Çështja themelore është organizimi dhe kryerja e studimit, e eksperimentimit, e teknikës që do të përdoret dhe e rezultateve që do të arrihen, dhe zbatimi i tyre në praktikë. Prandaj nuk mjafton vetëm të caktohet titulli i studimit apo kush do ta studiojë këtë apo atë problem dhe të caktohet data që ai do të mbarojë. Çështja e vënies në jetë dhe

e konkretizimit të këtyre detyrave tani është detyra më kryesore.

Kjo kërkon që studimet të kenë konkluzione, propozime dhe rrugëzgjdhje konkrete. Ne i krijojmë këto grupe pune jo për të bërë shkollë e teori, por për të zgjidhur probleme që na preokupojnë e do të na preokupojnë në të ardhmen. Kjo të kihet mirë parasysh, sepse intelektualët, inxhinierët dhe specialistët e tjerë, që do të bëjnë pjesë në këto grupe, mund të kenë tendenca të studiojnë e të studiojnë dhe të nisen nga mendimi i gabuar sikur ata i kemi hequr nga punët vetëm për të shfletuar libra e për të zgjeruar njohuritë e tyre. Natyrisht, njohuritë e tyre shkencore ata duhet t'i zgjerojnë, por jo si qëllim më vete, por për të përballuar ato çështje të rëndësishme që i dalin ekonomisë, prodhimit. Ne kërkojmë në radhë të parë që studimet e tyre të na japin rezultate dhe t'i zbatojmë ato në jetë. Pastaj, po të duan ata, le të studiojnë edhe të tjera gjëra jashtë problemeve që u caktohen, pse shkenca nuk ka kufi. Këtë gjë duhet t'ua bëjmë të qartë e ta kuptojnë mirë të gjithë shokët që do të angazhohen në studimin dhe në zbatimin e programit të punëve tekniko-shkencore që do të aprovohet nga Qeveria.

Një gjë tjetër që duhet të kemi parasysh është që të mos harrojmë të kaluarën e hidhur lidhur me grupimet pa rezultat që u bënë me specialistët. Nga studimet e atëhershme nuk doli gjë në dritë, ose dolën disa gjëra pa vlera të mëdha për praktikën. Ndërsa nga studimet që po ndërmerren tani Partia pret të dalin punime të vlefshme, që të zbatohen e të vihen në jetë.

Në një bisedë që pata me shokun Pilo Peristeri,

ai më tha se në Uzinën Traktori ka një entuziazëm të madh në lidhje me revolucionin tekniko-shkencor; në mes të tjerave, ai më ngriti çështjen që shumë punonjës të uzinës i thonë: «Shoku Pilo, më fut edhe mua në grupet e punës për zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor». Kjo tendencë për t'u futur në grupe pune, mua më duket se ka të mirën e vet, por ka edhe anën e saj negative. Kjo dëshirë e tepruar për t'u futur në grupe pune flet edhe për atë që ka nga ata të cilët nuk e vlerësojnë drejt rëndësinë e punës së përditshme që u është caktuar, dhe se kanë tendencën apo ndjenjën e rehatisë, kanë sëmundjen e shkëputjes nga detyra e tyre funksionale, duke menduar se duke vajtur në grupet e punës së revolucionit tekniko-shkencor, do të jenë rehat, pasi, sipas tyre, puna në këto grupe do të jetë më e lehtë dhe me më pak përgjegjësi imediate e konkrete.

Këtej del se është e nevojshme të bëhet punë sqaruese që nga askush të mos kuptohet se revolucionin tekniko-shkencor do të kufizohet vetëm në krijimin e grupeve dhe se vetëm këta do të merren me veprimtari tekniko-shkencore. Në qoftë se çështja kuptohet dhe lejohet të kuptohet kështu, ky është një gabim dhe kjo pikëpamje duhet luftuar. Grupet që do të krijohen për këtë qëllim do të zgjidhin disa probleme shkencore e teknike dhe asgjë tjetër, kurse moria e kuadrove teknikë, e specialistëve, e mjeshtërve, e punëtorëve dhe e kooperativistëve të aftësuar do ta thonë fjalën e tyre në prodhim. Pikërisht atje, në prodhim, këta njerëz kanë për detyrë të përmirësojnë teknikën e teknologjinë e prodhimit, të bëjnë studime të thella. Kështu, për shembull, mund të mblidhen dhe të punojnë në

këtë drejtim dy-tre inxhinierë apo agronomë, punëtorë e kooperativistë që janë bashkë në një qendër pune, në fabrika, ndërmarrje bujqësore apo në kooperativa bujqësore. Prandaj në asnjë mënyrë të mos shkohet nga mendimi se tash me ngritjen e disa grupeve të punës ka kush mendon për revolucionin tekniko-shkencor, kurse ata që janë me dhjetëra mijë në prodhim s'kanë pse të mendojnë për zhvillimin e mëtejshëm të teknologjisë së prodhimit dhe për zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor. Në qoftë se gjykohet kështu atëherë do të gabohet rëndë. Që të mos ndodhë kjo, kërkohet që Partia, organet shtetërore dhe organizatat e masave të punojnë, të shpjegojnë e të ndihmojnë njerëzit e punës e të shkencës që të kontribuojnë e të ndihmojnë jo vetëm në grupe, por edhe jashtë grupeve, duke kryer detyrat që u janë caktuar.

Duhet të njohim gjithashtu se ministritë dhe institucionet qendrore veprojnë shumë ngadalë, se në stilin dhe në metodën e punës së tyre ekziston edhe burokratizëm e javashllëk. Ky javashllëk, ky burokratizëm dhe kjo mungesë kontrolli duhen luftuar, pse mund të ngjasë që u krijua një grup për një problem dhe, meqenëse ka edhe një kryetar grupi, ministria ose drejtoria e ministrisë as nuk e programojnë ndihmën dhe kontrollin e nevojshëm ndaj tyre, as nuk kërkojnë periodikisht llogari prej tyre, por e kërkojnë atëherë kur puna ka mbaruar dhe detyra nuk është realizuar ose ka mbetur në mes të rrugës.

Të gjitha këto duhet t'i kenë më mirë parasysh shokët e Qeverisë e të institucioneve. Partia të drejtojë e të ndihmojë në këtë drejtim, të punojë mirë politi-

kisht dhe ideologjikisht me njerëzit që problemet të kuptohen njëkohësisht thellë dhe të zhvillohen në rrugë të drejtë, që të mos ketë devijime në këto probleme, por ajo që është më kryesorja, të ketë sa më shumë rezultate të mira në këtë fushë. Këtë të mos e harrojmë. Kjo është detyrë e gjithë Partisë dhe jo vetëm e disa instruktorëve të saj. Por kjo është detyrë edhe e vetë pjesëmarrësve në këto grupe që janë ose jo anëtarë partie, nga të cilët kërkohet punë e kujdesshme në frymën dhe në rrugën marksiste-leniniste, të shkencës dhe të teknikës.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

REALITETI YNË NA NDIHMON TA KUPTOJME E TA PËRVETËSOJME ME THIELLË TEORINË MARKSISTE-LENINISTE

*Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë
të Partisë*

6 mars 1978

Ndoqa me vëmendje të gjitha diskutimet. Shokët që diskutuan në këtë mbledhje të organizatës-bazë të Partisë për dhënie llogari dhe zgjedhje i shtruan problemet në një nivel të lartë ideopolitik, prandaj në këtë drejtim nuk kam çfarë të shtoj.

Unë ndiej një kënaqësi të veçantë kur shoh që Partia me punën e saj të vazhdueshme dhe këmbëngulëse ka ndihmuar shumë që anëtarët e saj janë ngritur në një shkallë të lartë ideologjike e kulturore, gjë që shprehet qartë në sukseset e arritura në punën e tyre. Natyrisht të mos biem në vetëkënaqësi, sepse kemi akoma shumë për të bërë në këtë drejtim që të jemi gjithmonë në pararojë, por konstatoj se anëtarët e Partisë të organizatës sonë, ashtu si edhe gjithë komunistët e tjerë të aparatit të KQ të PPSH i njohin mirë direktivat e Partisë, të plenumeve të

Komitetit Qendror të PPSH dhe orientimet që jep Byroja Politike e Sekretariati i KQ të PPSH.

Në përgjithësi, kudo në Parti vihet re një ngritje e nivelit ideopolitik e kulturor të komunistëve. Kjo ngritje reflektohet, veçanërisht, edhe në mbledhjet që bëhen e në vendimet që marrin organizatat-bazë të Partisë. Shokët që diskutuan sot, i lidhën mirë direktivat e Partisë me jetën, me praktikën e punës së tyre. Lidhja e direktivave me jetën, me praktikën, është një çështje me shumë rëndësi, se një gjë e tillë do të thotë të lidhësh ngushtë teorinë me praktikën. Jo vetëm pa teori, por edhe pa zbërthimin e drejtë të kësaj teorie në praktikë nuk mund të ecet si duhet përpara. Prandaj, vazhdimisht duhet të punojmë që teorinë tonë të pagabueshme, marksizëm-leninizmin dhe vijën e Partisë sonë, t'i njohim, t'i mësojmë dhe t'i përvetësojmë mirë. Këtu në asnjë mënyrë nuk e kam fjalën për një të mësuar skolastik të teorisë. Jo, nga këto shfaqje të bëjmë ç'është e mundur që të largohemi. Teoria jonë marksiste-leniniste është e gjallë, revolucionare, gjithnjë krijuese dhe, që të mbetet e tillë, nuk duhet marrë kurrë si diçka e thatë, e ngrirë, e shkëputur nga realiteti konkret, por kurdoherë t'i shërbejë këtij realiteti.

Skolastika është karakteristikë e mesjetës, e universiteteve të asaj kohe, ku të mësuarit mbështetej në dogmat e kishës, në arsyeime abstrakte, ku gjithçka shikohej në mënyrë idealiste, si e rregulluar nga një fuqi hyjnore dhe nuk mbështetej aspak në jetën reale. Të gjithë filozofët e mesjetës skolastikën e kanë pasur si metodën e tyre të punës e të të menduarit,

por dhe në atë kohë ka pasur njerëz të shquar përparimtarë, që kanë luftuar kundër kësaj metode anti-shkencore. Disa nga këta dijetarë, si Xhiordano Bruno, Galileo Galilei ose «heretikët rebelë», si taboritët ose si Mynceri, Jan Husi e të tjerë, që u ngritën kundër obskurantizmit fetar, inkuizicioni mesjetar i persekutoi tmerrësisht, bile disa i dogji në zjarr. Edhe filozofët e mëdhenj arabë, si Ibn Sina (Avicena), Ibn Rushd (Averroes) e të tjerë, i kanë sjellë perturbacione skolastikës.

E kam fjalën që të gjithë ne, komunistët, të studiojmë, të përvetësojmë thellë dhe të zbatojmë në mënyrë krijuese teorinë tonë të marksizëm-leninizmit, e cila i sheh sendet dhe fenomenet në tërë procesin e luftës e të zhvillimit. E tërë kjo teori, që pasqyron këtë luftë, është kurdoherë në lëvizje, kurdoherë në përpjekje dhe zhvillohet nëpërmjet luftës për zgjidhjen e kontradiktave antagoniste dhe joantagoniste, të cilat çojnë shoqërinë përpara.

Kështu ne, punëtorët e Partisë, duke e përvetësuar mirë e thellë teorinë tonë, botëkuptimin revolucionar të klasës punëtore, do të jemi në gjendje, në çdo moment të jetës e të veprimtarisë sonë, t'i analizojmë ngjarjet e ndryshme në mënyrë të tillë që të mund të shohim e të kapim përnjëherë thelbin e problemeve, të jemi në gjendje t'i kuptojmë thellë ato, duke i analizuar në bazë të mësimëve të Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit, si dhe në bazë të vijës së Partisë sonë, ku mishërohen këto mësimë.

Në këto çështje duhet të jemi ekzigjentë, se eksperiencia e Partisë sonë na tregon që ato organiza-

ta-bazë partie, ato komitete partie dhe ata shokë, në qendër ose në bazë, që kanë dalë nga një rreth i ngushtë njohurish për të fituar një kulturë të përgjithshme, për të zgjeruar kulturën e tyre, që e kanë përvetësuar thellë shkencën e marksizëm-leninizmit, i trajtojnë më drejt problemet konkrete me të cilat ndeshen në praktikë. Në përgjithësi kjo ndodh te ne. Këtë e vërtetojnë eksperiencia dhe vitaliteti i unitetit në Partinë tonë, si dhe të përballuarit me sukses, pa lëkundje, pa hezitime i gjithë atyre vështirësive që kanë dalë herë pas here.

Ne, shqiptarët, në rrugën tonë jemi ndeshur me shumë të këqija, vështirësi e pengesa dhe nuk jemi përkulur, por çdo të keqe e kemi përballuar me sukses dhe kemi fituar duke u mobilizuar. Kështu ka ndodhur e do të ndodhë kurdoherë, se në bazë të veprimeve tona është teoria e pagabueshme e marksizëm-leninizmit, është kuptimi dhe zbatimi i drejtë i saj. Për këtë arsye është e domosdoshme që të gjithë të bëjnë përpjekje për ngritjen e nivelit ideologjik dhe veçanërisht të bëjmë përpjekje ne, punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, me qëllim që shokëve të bazës t'u jepet një ndihmë sa më e kualifikuar. Është fakt se në këtë drejtim ne kemi arritur suksese dhe këtë ia kushtojmë Partisë, ua kushtojmë bazës dhe përpjekjeve tona individuale. Janë puna dhe eksperiencia e madhe e Partisë dhe e popullit, është jeta jonë, e marrë në tërë kompleksin e saj, që na kanë armatosur dhe na bëjnë ta kuptojmë e ta përvetësojmë më me lehtësi teorinë tonë, marksizëm-leninizmin.

Ndërtimi i socializmit realizohet në kushtet e zhvillimit të luftës së klasave brenda dhe jashtë vendit tonë. Vështirësitë që hasen në këtë rrugë, s'duhet të na bëjnë pesimistë, por dhe nga sukseset s'duhet të dehem. Kurdoherë të jemi realistë, kurdoherë, siç thonë francezët, të jemi *en brèche*, domethënë kurdoherë të sulmojmë përpara, me mend në kokë. Ju theksuat me të drejtë në diskutimet tuaja, që akoma ka të meta, akoma ka mbeturina te njerëzit tanë. Tashiti nuk do të zgjatem për të shpjeguar arsyet dhe shkaqet që ndikojnë në shfaqjen e mbeturinave të huaja për shoqërinë tonë, ju këto i dini, se që të gjithë jeni kuadro, por ne, si punonjës të aparatit, duhet të përpiqemi që, sa të jetë e mundur, t'i edukojmë njerëzit, t'i këshillojmë e t'i mësojmë me durim të madh që t'i luftojnë mbeturinat se kështu ka vepruar Partia edhe me ne kur kemi qenë të rinj. Nga mungesa e eksperiencës disa gjëra nuk i kemi pasur të qarta, jemi përpjekur të mos bëjmë gabime në punë, por edhe kemi bërë. Kush punon edhe gabon, kjo është dialektike, po të punojmë e të luftojmë që të gabojmë sa më pak.

Ekzistojnë mbeturina të së kaluarës dhe presioni i jashtëm borgjezo-revizionist që veprojnë ndaj njerëzve tanë. Ne vëmë re se ka njerëz që kanë të meta dhe i trashin këto duke bërë gabime të rënda në mënyrë të pandërgjegjshme etj. Ndaj gabimeve të ndryshme s'duhen mbyllur sytë, por masat që duhet të marrë Partia ndaj njerëzve që gabojnë të jenë kurdoherë në rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Ne nuk duhet të jemi as sektarë, as liberalë në veprimet e në

qëndrimet tona. Të dyja janë të këqija, edhe majtizmi dhe djathtizmi, pra dhe sektarizmi dhe liberalizmi. Është thënë se rreziku kryesor është oportunizmi i djathtë. Me të vërtetë, oportunizmi i djathtë përbën rrezik kryesor për fatet e socializmit, tradhtia e revizionistëve modernë është djathtizëm dhe ne duhet ta luftojmë atë, këmba-këmbës, por jo nga pozitat e sektarizmit, jo me majtizëm.

Partia jonë dënon si majtizmin ashtu edhe djathtizmin. Të jesh majtist sot do të thotë t'i përgatitësh shtratin djathtizmit të nesërm; një veprim majtist, sektar, mund të duket si revolucionar, por në fakt ai favorizon krijimin e situatave të vështira për të ardhmen.

Kur kuptohet drejt vija e Partisë, kuptojmë më mirë edhe njëri-tjetrin, secili e kupton më mirë shokun apo shogën kur i vë në dukje një të metë dhe i thotë me takt: «Sikur nuk e ke mirë këtë gjë, puno që ta ndreqësh». Nuk duhet harruar se ka rëndësi edhe mënyra e të thënit, pra si ia vë në dukje gabimin shokut. Në qoftë se veprohet me kujdes, shokut të kupton mirë, në të kundërtën, kur ia ekzagjeron gabimin, jo vetëm në të shprehur, por edhe në trajtimin e qëndrimin që mban në esencë ndaj tij, ai nuk mund të të kuptojë drejt. Nga një trajtim jo i mirë dhe nga mungesa e taktit me ata që gabojnë, ka prej tyre që bëhen të pakënaqur. Pakënaqësi të tilla nuk duhet të krijohen, se kjo nuk është e mirë as për shokun as për Partinë, sepse, siç na mëson dialektika marksiste-leniniste, nga grumbullimi sasior në një moment të caktuar kalohet në ndryshime cilësore:

Ne punojmë dhe vazhdimisht i forcojmë pozitën e socializmit. Rruga nëpër të cilën ecim nuk është fushë me lule, por çahet me luftë të ashpër kundër forcave të jashtme armiqësore. Duke ecur në një rrugë të tillë, s'ka dyshim që edhe situata të vështira do të ketë, prandaj qëndrimet tona ndaj njerëzve kurdoherë duhet të jenë të atilla që të ushqejnë dhe të forcojnë vazhdimisht një besim të pjekur, të argumentuar teorikisht se kjo shton dashurinë e respektin e çdo qytetari të Partisë jonë, të vija e saj, qoftë ky komunist ose jo komunist. Dhe në fakt kështu është. Dashuria dhe respekti i masave e kanë bërë Partinë tonë që të jetë e fortë e të përballojë me sukses çdo pengesë e vështirësi, duke u treguar e matur dhe e drejtë në çdo gjë, vigjilente ndaj armiqve të saj, të popullit e të socializmit.

Ne e shikojmë se si u katandisën partitë komuniste në një numër vendesh në Evropë apo në Azi, që u larguan nga teoria e marksizëm-leninizmit. Ato janë kthyer në parti revizioniste, siç është bërë edhe Partia Komuniste e Kinës. Këta shembuj i solla sepse dua të theksoj atë që, sa të jetë e mundur, ne, punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë dhe gjithë kuadrin e punonjësit e tjerë, të punojmë vazhdimisht me këmbëngulje për edukimin tonë komunist, për ngritjen e nivelit teorik. Kështu do të kemi kurdoherë mendime të peshuara mirë, prandaj këtë teori, në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas mundësive të tyre, t'ua rrënjosim njerëzve tanë që kemi në punë, në shtëpi, me biseda të ndryshme e në forma sa më të përshtatshme e të larmishme, bindëse. Pra

jo të dalësh e të flasësh me mendjemadhësi, pa u përgatitur, duke menduar se i di gjërat, por të jesh në gjendje që të përfitosh edhe nga një mendim që shfaqin punonjësit në punë e sipër, të qëndrosh, të bisedosh me ta këmbëkryq për t'ua bërë të qarta parimet që na udhëheqin ne, në mënyrë të tillë që t'u nguliten në kokë e në mendje. Unë mendoj se kjo formë pune është shpeshherë më e frytshme sesa ndonjë lëksion i përgjithshëm, i palidhur me jetën, me problemet konkrete. Me këtë nuk dua të them që të mos bëhen lëksione, se ne vetë i kemi vënë ato në programin e edukimit politik, por çështja është që këto lëksione të jenë të kuptueshme nga masat, të jenë të thjeshta.

Unë e ndjek shtypin rregullisht, si të gjithë ju. Të dielën në gazetën «Zëri i popullit» lexova një artikull për Stalinin. Artikulli nuk them se ishte i keq, jo, ishte i mirë, por ama nuk lejohet të mos flitet aty se ishte Stalini ai që, në krye të Partisë Bolshevike e udhëhoqi Bashkimin Sovjetik në Luftën e Madhe Patriotike që shkatërroi nazizmin gjerman, duke kontribuar kështu për çlirimin e popujve që ishin të robëruar nga ky armik. Pra, lufta e madhe e popullit sovjetik, udhëheqja e Stalinit, e këtij strategu të madh në luftë, gjenia e tij teorike, arti i tij ushtarak, të gjitha këto bënë të sigurohej fitorja nga popujt sovjetikë mbi nazizmin gjerman. Pikërisht këto gjëra s'ishin përmendur në këtë artikull, kurse të tjerat vihehin mirë në dukje.

Partia na zgjedh e na cakton ne në disa vende me rëndësi, të cilat kërkojnë që t'i shohim gjërat në një prizëm të gjerë politik e ideologjik. Prandaj, neve, kuadrove të Partisë, na duhet të kemi sedër revolu-

cionare, të përpigemi të mësojmë dhe ta kuptojmë teorinë marksiste-leniniste dhe të jemi të aftë për t'ua dhënë atë njerëzve, nëpërmjet veprimtarisë sonë si punëtorë partie. Siç e theksova dhe më lart, një gjë e tillë ka rëndësi të madhe, veçanërisht për instruktorët e aparatit të KQ të PPSH e të komiteteve të Partisë, se kështu bëhet lidhja e teorisë me praktikën.

Në diskutimet e tyre shokët folën edhe për kuptimin nga ana e komunistëve dhe e kuadrove të Partisë e të shtetit të direktivave të Kongresit të 7-të të Partisë, të Byrosë Politike, të Sekretariatit të KQ të PPSH, direktiva këto të bazuara në marksizëm-leninizmin dhe në përvojën tonë konkrete. Kështu, për shembull, një nga shokët foli këtu për qëndrimin indiferent të agronomit të një kooperative bujqësore. Bëjmë pyetjen: Pse të jetë indiferent ai, pse të mos ketë një shpirt revolucionar e organizativ për të shpërndarë detyrat mirë dhe në kohë? Atëherë, instruktorët e aparatit të KQ të PPSH apo të komitetit të Partisë që konstatojnë një situatë të tillë, duhet të dalin medoemos me disa konkluzione për ta ndihmuar atë dhe për ta përmirësuar situatën. Ky është roli i tyre si punonjës të Partisë. Kështu, duke njohur mirë situatën, instruktori mendon se ky njeri nuk është i keq, ai është i klasës sonë, mund të jetë edhe anëtar partie, ka mbaruar shkollën e lartë, atëherë çfarë i duhet këtij, pse nuk është i mobilizuar në punë? Prandaj, gjatë kësaj kohe, instruktori mund t'i shpjegojë qartë atij e t'i thotë se si njeri i shkolluar që është, duhet që edhe punën ta organizojë mirë, ndryshe direktiva nuk zbatohet. Ai agroteknikën mund ta dijë, por në qoftë se nuk e organizon punën ashtu

si duhet për ta zbatuar atë në praktikë, një për një e pa asnjë lëshim, edhe rendimentet në grurë, në misër etj. nuk do të jenë të larta.

Përshtypja ime nga mbledhja e sotme është se të gjithë shokët kanë një nivel të mirë ideopolitik e kulturor. Unë përfitoj shumë nga mbledhjet e organizatës-bazë të Partisë, se njihem me problemet e shtruarra, dhe natyrisht mbaj edhe shënime, gjë që më ndihmon në punën time. Prandaj ju falënderoj në emër të Partisë dhe të Komitetit Qendror.

Përderisa e kuptojmë mirë e drejt ideologjinë tonë marksiste-leniniste dhe vijën e Partisë, s'është qe mbështetet në të, përderisa e ndiejmë se duhet të punojmë akoma më shumë, se duhet të bëjmë përpjekje çdo ditë e më të mëdha që Partia e atdheu ynë të forcohen, kam besim që punët do të ecin kurdoherë mirë.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime, 1978-1979», f. 23.

Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime, 1978-1979», f. 23

ZBATIMI I KOMPETENCAVE TË BËHET NË DOBI TË ZHVILLIMIT TË EKONOMISË

Shënime

11 mars 1978

Çështjet ekonomike më preokupojnë veçanërisht, sepse në situatat aktuale kur Kina po na krijon shumë vështirësi, ato kanë një rëndësi të posaçme, vendimtare. Prandaj duhet absolutisht të realizojmë plotësisht dhe në kohë planet që kemi caktuar.

Po ndjek plenumet që bëhen në rrethe në lidhje me punimin e materialeve të Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror, në të cilat po zbërthehet plani i vitit 1978. Natyrisht, ka diskutime të mira, por nëpërmjet këtyre diskutimeve zbulohen edhe të meta, disa prej të cilave shumë serioze, dhe që e kanë shkakun te burokratizmi që ekziston jo vetëm në bazë, por edhe në qendër, veçanërisht nëpër ministritë deri dhe në Kryesinë e Këshillit të Ministrave.

Kemi folur shumë herë për çështjen e kompetencave që duhet të kenë ministritë dhe ndërmarrjet. Në qoftë se këto kompetenca ekzistojnë, dhe në fakt ekzistojnë, këto janë kompetenca materiale dhe monetare, të cilat, natyrisht, duhet të zbatohen në favor të orga-

nizimit e të drejtimit më të mirë të ekonomisë dhe të zhvillimit të saj të mëtejshëm. Por ka edhe çështje që, për të mos folur për iniciativën e ndërmarrjeve, iniciativa e ministrive duhet të jetë e madhe. Kjo iniciativë, sipas mendimit tim, nuk ekziston sa duhet; në të kundërtën, ekziston një ngurtësi, një rutinë dhe një mungesë daljeje nga disa caqe të përcaktuara. Po dole nga ky cak i përcaktuar, atëherë duhet t'i drejtohesh Kryesisë së Këshillit të Ministrave, domethënë zëvendëskryeministrave, por ndodh që edhe këta nuk u japin zgjidhje të shpejta problemeve.

Unë mendoj se zgjidhjet e problemeve nga shokët e Kryesisë së Këshillit të Ministrave duhet të jepen edhe kolegjialisht, por edhe individualisht. Në rast se një zëvendëskryeministër gjykon se një propozim që bëhet nga ana e një ministrie, që ka në vartësi, është i drejtë, duhet t'i japë menjëherë rrugë çështjes. Këtë gjë të bëjë edhe ministri për sa u përket kompetencave që ai ka në drejtim të ndërmarrjeve vartëse. Por në praktikë këto gjëra nuk bëhen kështu.

Për shembull, flitet shumë për çështjen e revolucionit tekniko-shkencor dhe mjaft gjëra të mira bëhen, por, siç më thonë shokët, ndodhin edhe disa gjëra të palejueshme. Për shembull, ka motmot që kemi sjellë nga Gjermania një fabrikë të dytë për të prodhuar karton për arka ambalazhi. Të gjitha makineritë e kësaj fabrike janë në arka, kurse ndërtimi e montimi i objektivit nuk ka filluar, për arsye se duhet të vijnë specialistët e huaj, dhe për këtë zvarritet objekti. Kjo më të vërtetë është skandaloz!

Ose më thonë që Uzina e PVC-së në Vlorë, granu-

limin e bën në një mënyrë të atillë që nuk mund të shërbejë për mbështjelljen e telit të Shkodrës, i cili, në qoftë se nuk bëhet me atë standard që e kërkon klienti jashtë, nuk na e merr njeri. Kështu e kanë lënë këtë lloj PVC-je që nuk është ndonjë sasi e madhe, prandaj aktualisht nuk na blihet teli, kurse ne vazhdojmë të prodhojmë, na shtohen stoqet dhe nuk rekuerojmë devizën e duhur për importin që kemi kontraktuar dhe, si rrjedhim, na mungojnë mallrat e importit që vënë në lëvizje fabrikat tona.

Një çështje tjetër. Soda e kalcinuar nga Vlora qarkullon e lëngshme në gjithë Shqipërinë. Kjo do të thotë që ne transportojmë në të katër anët e vendit 12 mijë tonë ujë. Përse? Për arsye se këtë uzinë e morëm nga kinezët pa makinën e tharjes, pa llogaritur këtë humbje që na shkaktohet tani e të tjera gjëra të tilla.

Por, mirë, i shkon vallë ndër mend ministrit përkatës që, duke i parë këto situata, të caktojë inxhinierë edhe kimistë aq sa duhet dhe ku duhet që të studiojnë dhe të përgatitin ato materiale për ta bërë PVC-në të përshtatshme për telat tanë, për ta tharë sodën e kalcinuar, për të prodhuar mekanizmat e ndryshëm që do të na shërbejnë për ndërtimin e elementeve para-fabrikate për bancesat etj., etj.?

Siç më tha një punëtor, në qoftë se ne nuk do të marrim masa për të mekanizuar prodhimin, atëherë parafabrikatet do t'i bëjmë në mënyrë artizanale, bancesat do të ngrihen me ngadalësi dhe si rrjedhim do të na kushtojnë shtrenjtë. Çështja e ndërtimit të makinave për prodhimin e elementeve parafabrikate lyp

të përcaktohen edhe sheshet, edhe mekanizmat etj. Mirë, po a mendojnë Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit të Tiranës dhe Ministria e Industrisë për këto gjëra? Jo, nuk mendojnë. A kanë iniciativë? Jo, nuk kanë plotësisht iniciativë.

Këto janë probleme që duhen pasur parasysh në plan të parë, po duhen organizuar, duhen parashikuar me kohë. Duhet parashikuar nga organet përkatëse prodhimi i pjesëve me të cilat do të ndërtohet fabrika e re që do t'i shtohet Fabrikës së Sheqerit në Korçë. Mirëpo në mbledhjen e Byrosë Politike sekretari i Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës u ngrit e tha që Ministria e Industrisë s'po e bën këtë gjë. Unë u hoqa vërejtjen drejtuesve të kësaj ministrie dhe u thashë se, kur të vijë koha e vjeljes së panxharit për t'u përpunuar, fabrika duhet të ketë mbaruar. Do të mbarohet më thanë, po këtë do ta shohim. Po si këto ka edhe shumë probleme të tjera, që më duket se nga lart duhet të shikohen me një sy shumë objektiv dhe të zgjidhen me një organizim më të shëndoshë, me një kontroll më të madh. Duhet të ketë më tepër përgjegjësi, më duket mua, siç duhet të ketë më tepër përgjegjësi dhe elasticitet edhe në çështjen e tregtisë së jashtme. Që të ecin mirë punët në këtë sektor ne krijuam një dikaster të tërë të veçantë për tregtinë e jashtme, duke e shkëputur nga Ministria e Tregtisë së Brendshme.

Unë kam ngritur problemin se në këto situata nuk mundet dhe nuk na pret koha të krijojmë stoqe të mëdha kromi, bakri ose lënde të parë tjetër, kur jemi në vështirësi, prandaj duhet të çajmë jashtë sa më parë, të gjejmë tregje, duke iu përshtatur çmimeve ndër-

kombëtare. Këtë vit, si dhe vitin e ardhshëm, ka mundësi që ne të mos jemi shumë ekzigjentë në kërkesat tona. Dua të them të mos ngulim këmbë ta shesim kromin jo më pak se 90 dollarë tonin, kur këtë mineral nuk e blen kush me këtë çmim dhe kur të gjitha ofertat që na bëhen nuk shkojnë më tepër se 70 dollarë toni. Në këto kushte çfarë të bëjmë? Të vazhdojmë të grumbullojmë qindra mijë tonë krom në Portin e Durrësit dhe të mos kemi të paguajmë importin e mjeteve të ndryshme e të lëndëve të para që na duhen për fabrikimin e mallrave tona? Në asnjë mënyrë jo. Nuk duhet të ndodhë që të na ikin blerësit. Çështja qëndron këtu që çmimi i kromit aktualisht ka rënë, pse si të gjitha mallrat në botë, edhe kërkesa për këtë, është në rënie dhe, natyrisht, kur nuk ka kërkesa, çmimet do të ulen. Prandaj, kur e shikojmë këtë situatë, nuk mund të lejojmë dhe nuk na pret puna të grumbullojmë stoqe, por ta shesim njëherë për njëherë kromin qoftë edhe me çmim më të ulët. Kalon kjo situatë, pastaj përsëri manovrojmë.

Ose, siç më raportojnë, bëhen disa gjëra të pakuptueshme. Ne sjellim nga jashtë lesh të ashpër për të prodhuar qilima shumë të bukur. Këta qilima janë të leverdishëm, pse shiten lehtë jashtë dhe i nxjerrin shpenzimet e blerjes së leshit, por ne nuk eksportojmë leshin e butë ose këtë lesh nuk e përdorim për të prodhuar stofat e nevojshëm për ushtrinë që i prodhoni me lesh të ashpër. Tash ne nuk kemi lesh të ashpër në atë sasi që kishim përpara, se e kemi përmirësuar aktualisht racën, pra edhe cilësinë e leshit të deleve. Atëherë përse të mos e përdorim ose përse të mos e

eksportojmë një pjesë të leshit të butë dhe me devizën që do të sigurojmë të sjellim lesh të ashpër, në qoftë se ky do të na duhet për të përmirësuar teknologjinë e prodhimit të qilimave?

Të gjitha këto gjëra, më duket mua, janë në kompetencat e ministrive. Mirëpo çdo gjë duhet të kryhet me kohë, të parashikohet me kohë, të bëhen ndryshimet me kohë, por është fakt se këto nuk bëhen dhe zvarriten, gjë që nuk është e mirë për ekonominë tonë. Unë mund të kem folur mjaft herë për këto çështje, prandaj do të propozoj që në Byronë Politike të ndryshojë edhe mënyra e shtruarjes së problemeve.

Është e vërtetë se në Byronë Politike ne nuk mund të futemi në detaje të problemeve, sepse ekzistojnë ministritë, ekzistojnë komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, ekzistojnë ndërmarrjet, por, kur na dalin një sërë problemesh të tilla me karakter të rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë dhe shohim se ka një burokratizëm të dënueshëm, më duket se nuk mjafton që problemi të shtrohet në parim. Prandaj, duke dhënë edhe shembuj konkretë, të diskutohet pse është një situatë e tillë dhe të thuhet konkretisht se ç'duhet bërë dhe ç'masa duhen marrë.

Prandaj i këshillova shokët sekretarë që me shokët e Kryesisë së Këshillit të Ministrave të mos bisedojnë vetëm për disa çështje që ngre Partia, por të diskutojnë edhe si kryhen ose pse nuk kryhen këto detyra që caktohen; t'i ngrenë këto jo vetëm në parim, por t'i bëjnë edhe kritikë njëri-tjetrit që të ndreqet kjo ose ajo situatë jo e mirë. Që të gjithë shokët, qoftë sekretarët e Komitetit Qendror, qoftë shokët e Kryesisë së

Këshillit të Ministrave, duhet të bëjnë me njëri-tjetrin debate dhe të kritikojnë punën e të metat e njëri-tjetrit. Kjo është rruga më e drejtë për ta vënë si duhet në lëvizje «makinën», sepse ne jemi në kushte të tilla që makina shtetërore ka mundësi të punojë me rendiment më të lartë, prandaj askush nuk duhet të lejojë pengesa të tilla që na frenojnë.

Edhe raportimet që u kërkojmë shokëve përgjegjës, ka raste që na i rrumbullakosin. Pyeta një ditë shokët e Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës, se si shkon puna në Valias, a është problem çështja e punëtorëve? Mirëpo ma bënë shesh me lule dhe më thanë se janë dërguar në Valias rreth 400 veta, se kanë rregulluar mensat, kanë rregulluar autobusët urbanë etj., etj. Me një fjalë, i kanë «rregulluar» të tëra. Por, në fakt, çfarë ngjet? Sot sekretari i Komitetit Qendror, shoku Prokop Murra, që ishte në aktivin e Tiranës, më raportoi që në ndërmarrjen e qymyrgurit të Valiasit sivjet kërkohen edhe 600 punëtorë, kurse vitin tjetër do të duhen edhe 1000 të tjerë. Pra, del se problemi i punëtorëve atje nuk qenka zgjidhur, kurse këtë vit më duket se do të merret më pak qymyr nga kjo minierë, kurse vitin tjetër prodhimi duhet të rritet së tepërmi. Prodhimin që duhej të nxirrte kjo minierë këtë vit ua kemi ndarë minierave të tjera, por vitin e ardhshëm nuk duhet të praktikohet më një gjë e tillë. Kjo kërkon të merren masa që tashti, prandaj gjetjen e punëtorëve dhe përgatitjen e tyre ideologjike e politike, problemet ekonomike të kësaj ndërmarrjeje etj., etj., Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës duhet t'i parashikojë që tani dhe tok me komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të këtij

rrethi ta kenë në vëmendje të posaçme këtë problem. Probleme të tilla, qoftë Ministria e Industrisë dhe e Minierave, qoftë rrethi, kanë shumë dhe këto nuk mund t'i zgjidhin një ose dy persona. Drejtuesit kryesorë duhet të kenë sytë në të gjitha problemet e rrethit ose të ministrisë që drejtojnë, të jenë kompetentë për mbarëvajtjen e tyre dhe të dinë të shfrytëzojnë, të drejtojnë e të kërkojnë llogari nga vartësit e nga specialistët, individualisht ose në grupe, kolegjisht ose në mënyrë të vetmuar, ndryshe nuk mund të zgjidhen dhe nuk mund t'u dilët me sukses gjithë këtyre problemeve që dalin përpara për të zgjidhur.

Ja, kam përpara pasqyrat e plotësimit të planit për disa tregues kryesorë të dymujorit janar-shkurt të vitit 1978, sipas të dhënave operative, dhe konstatoj se ka boshllëqe të mëdha. Pra puna nuk ka filluar mirë. Në shumë zëra ka mosrealizime të dukshme, që, duke i analizuar me imtësi, del se ka prej tyre që nuk kanë arritur të realizohen për shkaqe objektive, por ekzistojnë edhe shkaqe subjektive si mungesa në organizim etj. Në qoftë se vazhdohet me këto ritme, me këtë organizim si tash, atëherë do të jetë e zorshme të plotësohen këta zëra të parcalizuar gjatë dy muajve të parë. Kurdoherë është thënë se do t'i plotësojmë gjatë vitit, por çështja qëndron në atë që ne duhet të mësohemi të realizojmë planet që në fillim dhe ritmiksht, sepse ritmika bën të vlerësosh si duhet të gjitha të dhënat e planit, t'i çmosh këto të dhëna, ndryshe shpejtimi në fund dobëson cilësinë, dëmton shpërndarjen, shkatërron transportin, bën të shtohen stoqet, pengon eksportin dhe importin e shkakton shumë të këqija të tjera.

Të gjitha këto mendoj se janë probleme të rëndësishme të Qeverisë, të ministrive veç e veç, por edhe të ndërmarrjeve. Kam theksuar kurdoherë se realizimin e planit ndërmarrjet nuk duhet ta shikojnë vetëm në prizmin e tyre, por të shikojnë edhe interesin e përgjithshëm të republikës, planin e shtetit, pse ky është një plan unik. Në qoftë se ato nuk e realizojnë dhe nuk bëjnë përpjekje që edhe ta tejkalojnë këtë plan në të gjithë zërat, atëherë do t'i sjellin perturbacione gjithë ekonomisë së vendit tonë. Këtë çështje ka shokë të bazës që akoma nuk e kanë kuptuar dhe jo vetëm kaq, por që as nuk bëjnë përpjekje që ta kuptojnë se sa e rëndësishme është kjo për planin unik dhe të kontrolluar të shtetit tonë socialist, të diktaturës së proletariatit në vendin tonë.

Dotohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RRUGË SOCIALIMPERIALISTE E KINËS

Shënime

11 mars 1978

Duke lexuar lajmet e dhëna nga HSINHUA-ja dhe disa artikuj të «Zhenminzhibaos», vërehen qartë tendencat aktuale politike e ideologjike të Kinës. Në këta artikuj shohim, gjithashtu, se vihet në dukje me të madhe personaliteti i Çu En Lait. Për të po organizohen ekspozita të gjera, në të cilat tregohet aktiviteti i tij i madh, «i shkëlqyer» që nga koha e rinisë dhe derisa vdiq. Në një ekspozitë të madhe që është hapur kohët e fundit në Pekin, siç na raportohet dhe siç po shohim në shtyp, fare-fare pak përmendet personi i Mao Ce Dunit. Ai del vetëm në disa fotografi, sa për të thënë se e ruajnë, por jo më si udhëheqës kryesor i Kinës, siç paraqitej deri tash. Sot një gjë e tillë është shumë larg.

Është e qartë tendenca për të nxjerrë në dritë si një gjeni të vërtetë Çu En Lain, këtë personalitet oportunist dhe revizionist me damkë, mbështetës i teknokratizmit, i praktikizmit, i grupit të vjetër të Liu Shao Çisë dhe të Tenit. Për Çunë shkruhen artikuj të gjatë në gazeta nga turli-turli njerëz, që nga studentë të universiteteve, e deri te punëtori më i thjeshtë. Këta artikuj kanë një

karakteristikë të vetme: t'i ngrenë himne Çu En Lait. Në ta numërohet sa herë ka vajtur ai në shkolla e në Universitetin e Pekinit, si ka biseduar me nxënësit e me studentët, sa dashuri tregonte ai për ta etj. Në një artikull të gjatë, rreth 15-16 faqe, që lexova me një durim të madh, nuk gjeta, veçse një herë në të kaluar, të thuhet se në një mbledhje Çu En Lai foli për një çështje duke u mbështetur në mendimin e Mao Ce Dunit, dhe vetëm kaq. Asnjë fjalë tjetër nuk gjen për të në këtë artikull.

Çu En Lai paraqitet kudo si «ndërtuesi» i të gjitha fushave të jetës në Kinë, «ndërtues» dhe «kalitës» i Partisë Komuniste të Kinës, «udhëheqës i shquar i luftës», «politikan i dëgjuar», «vigjilent», «revolucionar i orës së parë» dhe «proletar», «mbështetës i diktaturës së proletariatit» e të tjera e të tjera. Shkurt, nga regjimi i sotëm kinez Çu En Lai po mbështetet me forcë, ngrihet lart emri i tij dhe ulet Maoja.

Unë mendoj se ekipi që drejton sot në Kinë, nuk dëshiron ta likuideojë Maon, ashtu siç bëri Hrushovi me Stalinin. Po të jetë për Tenin, ky po, e likuidon Maon. Pavarësisht se Maoja ishte një oportunist, një centrist, Teni dëshiron ta likuideojë për arsye se Maoja ishte armik i tij, i Liut dhe i djathtistëve ose i ekstremit të djathtë. Por kjo nuk është e lehtë të bëhet, për shkak se Mao Ce Duni në Kinë ka autoritet, autoritet ky që, natyrisht, do të gërryhet nga vetë këta. Por kjo do të bëhet me kujdes, pse Mao Ce Duni tash për tash shërben si një figurë e madhe, veçanërisht për grupin e Hua Kuo Fenit.

Megjithëkëtë as vetë Hua Kuo Feni nuk e do Mao

Ce Dunin, sepse i bën hije. Këtë hije Huaja do që ta ruajë, por, sa të jetë e mundur, ta zvogëlojë dhe ta mbajë sa më larg vetes së tij. Aktualisht fotografitë e Maos janë të ngjitura nëpër mure, por do të vijë koha që ato të shkoliten dhe të duket kudo kulti i Hua Kuo Fenit. Në këtë drejtim punon vetë ky.

Për sa i përket vijës së Hua Kuo Fenit, kjo mund të ketë një ndryshim nga vija e grupit të Ten Hsiao Pinit. Ky i fundit, mendoj unë, kërkon ta kthejë Kinën me shpejtësi të madhe dhe sa më parë në një vend kapitalist të zhvilluar, sa më të lidhur me imperializmin amerikan e me kapitalin botëror dhe të marrë sa më shumë kredi prej tyre për të përsosur teknologjinë, për të zhvilluar ekonominë dhe për të fuqizuar forcën e saj goditëse, ushtrinë.

Në fakt, edhe Hua Kuo Feni e do këtë gjë, por ky dëshiron dhe përpiqet të ecë me ritme jo kaq të precipituara si Ten Hsiao Pini. Por që të dy në një rrugë shkojnë dhe do të shkojnë, veçse njëri nxiton më shumë, tjetri më pak. Ai që nxiton më pak është Hua Kuo Feni, për arsye se ka frenime në udhëheqjen kineze, ku nuk ka akoma stabilitet, nuk ka unitet. Kur flasim për unitet në udhëheqjen kineze, nuk duhet kuptuar një unitet marksist-leninist, por një polarizim sa vjen e më i madh i forcave, i rrymave reaksionare që sundojnë sot në këtë vend. Ky polarizim do të zhvillohet në konkurrencë me dy rrymat kryesore që kanë ekzistuar dhe që vazhdojnë të ekzistojnë në parti. Prandaj atje nuk do të ketë stabilitet, gjë që do të pasqyrohet në ngadalësimin ose në shpejtimin e procesit të ndërtimit të kapitalizmit në Kinë.

Tash problem është çështja se si do të bëhet shndërrimi i plotë i Kinës nga një vend «socialist» në një vend kapitalist. Na është mësuar goja të themi «Kina socialiste», por në fakt ky vend nuk ka qenë dhe nuk është vend socialist. Kina, pavarësisht nga sloganet që përdor ose që thuhën për të, nuk është nën diktaturën e proletariatit; revolucioni socialist atje ka mbetur në mes të rrugës dhe disa tipare të tij do të jenë objekt i shndërrimeve të plota në kapitalizëm.

Kina, në përgjithësi, është një vend demokratiko-borgjez dhe rrugët që do të marrin reformat që janë bërë atje, si, për shembull, ajo e tokës, kanë dhe do të kenë në të ardhmen një rëndësi të veçantë. Ç'do të bëhet me reformën agrare, ashtu siç është bërë ajo në Kinë, ose me ato forma kooperativash bujqësore që janë krijuar atje? Mendoj se në këtë drejtim do të bëhet një transformim rrënjësor gradual, në mënyrë që të vihet në zbatim teoria e vjetër e Liu Shao Çisë dhe e Mao Ce Dunit, sipas së cilës kapitalistët e mëdhenj të tokave, domethënë feudalët e vjetër, kulakët, pronarët e tokave, të rimarrin javash-javash e në radhë të parë forcën ekonomike.

Po si do ta marrin ata këtë forcë ekonomike? Kinezët mund të mbështeten për këtë qëllim në eksperiencën jugosllave. Sipas kësaj eksperience titistët në fillim krijuan disa të ashtuquajtura kooperativa me emrin zadruqa, të cilat i lanë në mes të rrugës, pastaj krijuan njëfarë arteli bujqësor, që e lanë, gjithashtu, në mes të rrugës. Më vonë organizuan kooperativat e punës, të cilat ishin krijesa të formës kapitaliste. Më në fund e më në bisht, sistemi, sipas të cilit u organizuan në Jugosllavi koope-

rativat; bujqësore dhe drejtuesit që u vunë në krye të tyre, bënë që bujqësia në fshatin jugosllav të merrte tipare kapitaliste. Me fjalë të tjera; titistët kaluan në zbatimin e teorive buhariniste e trockiste, në inkuadrimin e kapitalizmit në socializëm. Socialiste këtyre kooperativa-ve u mbetet vetëm emri, sepse brendinë e kanë kapitaliste.

Aktualisht në Jugosllavi ekzistojnë pronarë të mëdhenj tokash. Më 1956 atje kishte pronarë që posedonin nga 50 hektarë toka, të cilat i punonin fshatarë me pagesë. Këta pronarë tokash ishin pasuruar, kishin blerë edhe mjete pune, si traktorë, makina shirëse etj., të cilat i përdornin për vete dhe për t'ua dhënë me qira fshatarëve të mesëm e të varfër. Në këtë mënyrë, këta pronarë dominonin edhe në kooperativat kapitaliste të punës. Të ardhurat, natyrisht, i merrnin sipas sasisë së tokës, të kafshëve të punës, të makinave bujqësore, domethënë sipas pasurisë që kishin vënë në këtë tip kooperative kapitaliste. Kjo bëri që pak nga pak pronarët e mëdhenj të tokave t'i rritnin më tej pronat e tyre, deri në 100-150 hektarë. Pra, në Jugosllavi gradualisht u krijuan pasanikët e fshatit.

Një gjë e tillë, si në Jugosllavi, do të ngjasë edhe në Kinë. Se çfarë formash konkrete do të marrë këtu ky transformim, do ta shikojmë, por ka mundësi që fshati kinez të ecë në rrugën jugosllave, fshatari i varfër të ruajë ndonjë mu¹ tokë, kurse sipërfaqet e mëdha t'i rimmarrin pasanikët e fshatit, të cilët i ka mbrojtur me

1. Një mu tokë është baras me 1/16 e hektarit.

këmbëngulje grupi i Liu Shao Çisë, e njëkohësisht e në të njëjtën mënyrë edhe vetë Mao Ce Duni.

Transformimi i fshatit në Kinë do të shkojë vërtet drejt modernizimit të bujqësisë, drejt një bujqësie intensive, veç jo në rrugën socialiste, por në rrugën e bujqësisë intensive amerikane. Për sa kohë do të shndërrohet kjo bujqësi kineze në intensive, në të përparuar dhe në të mekanizuar si ajo e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, është vështirë të thuhet, megjithatë mendoj se nuk do të duhet ndonjë kohë e gjatë. Por, që bujqësia kineze të ecë në rrugën amerikane, përveç mjeteve shtetërore dhe fermave shtetërore që do të ndihmojnë në këtë proces transformimi, ajo duhet të marrë tiparet e një bujqësie kapitaliste duke krijuar fermerët e mëdhenj, të cilët të disponojnë fuqi të madhe ekonomike, mekanike etj.

Për sa i përket industrisë kineze, kjo do të vazhdojë të mbetet sektor shtetëror, veçanërisht në disa drejtime, si minierat, kombinatet e mëdha që ekzistojnë dhe të tjera që do të ngrihen më vonë, por të gjitha këto do të marrin karakterin e kapitalizmit monopolist shtetëror, domethënë do të jenë ndërmarrje të mëdha të një shteti plotësisht kapitalist.

Përveç këtyre, në industrinë kineze do të zhvillohet edhe kapitali i vogël e i mesëm. Përse? Për arsye se atje elementë borgjezë, të kapitalit të vogël e të mesëm, kanë gëzuar deri në fund rentat e pasurive të tyre. Tash, me ardhjen në fuqi të përfaqësuesve të tyre, si Ten Hsiao Pini, Hua Kuo Feni, Jeh Çien Jini e të tjerë, këta pasanikë të qytetit do të lejohen të zhvillojnë më tej veprimtarinë e tyre. Borgjezia industriale e qytetit në rrugë të ndryshme do të marrë drejtimin e një sërë fabrikash, të

cilat pastaj do të shohim se si do të zhvillohen. Këtu nuk është fjala që në Kinë të lejohet medoemos zyrtarisht industria e vogël private, sepse ajo ka qenë tradicionale edhe në kohën e të ashtuquajturit regjim socialist. Privatët kinezë me kohë kanë punuar e kanë prodhuar në shtëpi, por, të lejohen ata të punojnë, në një vend me 900 milionë njerëz, me mjetet e tyre dhe tash, kur u lihen edhe 5 ose 6 punëtorë me mëditje, në mos më shumë, mund të imagjinohet se ç'kapacitet prodhues mund të krijohet dhe me ç'shpejtësi do të ngjitet e do të zhvillohet atje kapitalizmi.

Në këtë drejtim kinezët kanë fushë të gjerë ku të mësojnë, jo vetëm në Jugosllavi, por edhe në vendet kapitaliste. Ata do të marrin nga eksperiencia jugosllave vetëm atë çka u nevojitet sa për t'u maskuar si «socialistë». Por atyre u duhet të marrin eksperiencë edhe nga vendet e mëdha kapitaliste se si duhet të ecin me një ritëm të shpejtë për t'u shndërruar në superfuqi.

Tok me ndryshimet e strukturës ne po fillojmë të njihemi më hapur me gjithë ndryshimet e tjera që po ndodhin në Kinë. Është e vërtetë se Partia Komuniste e Kinës ekziston më shumë në kartë sesa në realitet. Ajo, sipas mendimit tonë, nuk ka ekzistuar as më parë, për arsye se atje «kanë lulëzuar njëqind lule» dhe «kanë konkurruar njëqind shkolla». Kjo njihet dhe është bërë në formë zyrtare. Zyrtarisht Mao Ce Duni ka thënë se në Kinë nuk është dhe nuk duhet të jetë në udhëheqje vetëm Partia Komuniste, por të jenë edhe partitë e tjera. Rruga kapitaliste në Kinë është parapërgatitur sepse atje udhëheqja e vendit nuk ishte as në dorë të klasës punëtore, as të Partisë Komuniste. Aktualisht ne shohim,

dhe më vonë do të shohim akoma më mirë, që emri i Partisë Komuniste në Kinë do të ruhet dhe parimet e normat e saj jo vetëm që do të jenë larg nga ato marksiste-leniniste ose nuk do të jenë fare të tilla, por do të mbeten slogane (pse sloganet i kanë shumë qejf kinezët).

Ne dimë që edhe përpara Mao Ce Duni u kishte dhënë fuqi partive të borgjezisë, por tash, pas mbledhjes së fundit të Asamblesë Kombëtare, ku u pranua një kushtetutë e re, vihet theksi në «unitetin kombëtar». Ç'duan të thonë atje me «unitet kombëtar»? Jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, me «unitet kombëtar» ata duan të justifikojnë faktin që në asamble u zgjodh llumi i borgjezisë kapitaliste, dolën nga varri «për t'u zgjedhur» në asamble gjithë të goditurit, gjithë kapitalistët e mëdhenj, manjatët industrialistë, tregtarët e mëdhenj, klerikët, paçenlamët¹ e kush nuk doli tjetër, deri edhe gjeneralët e ardhur nga Tajvani dhe u bënë anëtarë të udhëheqjes kryesore të shtetit «socialist» kinez. Aktualisht propaganda kineze po i bën një reklamë të madhe Frontit Kombëtar ku përmbliidhen të gjitha partitë, edhe Partia Komuniste e Kinës, por edhe nja 10 a 12, parti të tjera borgjeze, në mos më shumë, që nga ajo e Guomindanit e gjithë të tjerat me radhë.

Fronti Kombëtar kinez nuk është si Fronti ynë Demokratik, ku udhëheq vetëm Partia e Punës e Shqipërisë. Jo. Sipas teorisë së Mao Ce Dunit, këtë front në Kinë e udhëheqin të gjitha partitë dhe jo vetëm Partia Komuniste. Me këtë tezë dilet në artikullin që u botua së

1. Paçenlama — titull i rangut të dytë (pas dalallamëve) në hierarkinë e lamalzmrit, një nga rrymat e budizmit.

fundi, sipas të cilit është ky Front i Bashkuar Kombëtar që drejton Kinën, që do të marrë Tajvanin, që do të bëjë ndërtimin «e madh» të Kinës, që do të zhvillojë teknologjinë, që do të forcojë ushtrinë e të tjera e të tjera!

Po flitet se ky front në fakt udhëheq Kinën «socialiste» dhe kjo udhëheqje përbëhet konkretisht prej shumë partish. Pra, këto parti të borgjezisë erdhën në udhëheqje dhe në krye të këtij fronti është vënë Ten Hsiao Pini, zëvendëskryetar i Partisë Komuniste të Kinës, që mban edhe postin e shefit të shtabit të përgjithshëm të ushtrisë kineze, kurse ministër i Mbrojtjes u emërua një element, që është ndjekës i Ten Hsiao Pinit. Kjo do të thotë se filloi likuidimi i Partisë Komuniste të Kinës, parti e cila nuk është bazuar dhe nuk bazohet në ideologjinë marksiste-leniniste. Por edhe në qoftë se ekzistojnë disa reminishenca, këto do të zhduken. Tash (e më vonë ca më mirë) kjo parti do të fshihet nën Frontin e Bashkuar Kombëtar. Do të ngjasë, pra, ashtu siç ngjau në Jugosllavi, ku me çlirimin e vendit, fronti mori epërsi dhe Partia Komuniste e Jugosllavisë u maskua nën frontin, gjoja për të mos e trembur borgjezinë jugosllave. Mund të merret me mend se qysh në atë kohë qëllimi i titistëve ishte që Jugosllavia të mos merrte rrugën e socializmit. Mirëpo rrethanat e kërkonin që ajo të vepronte akoma e maskuar dhe, në fakt, Partia Komuniste e Jugosllavisë luajti një rol të madh në luftën për çlirimin e vendit, prandaj Titoja nuk mundi që ta likuidonte Partinë Komuniste sipas qejfit të vet. Atij i duhej për këtë qëllim një kohë dhe kjo u arrit. Edhe fronti e humbi atë epërsi që kishte dhe u bë një organizatë amorfe; atij i kishte mbetur vetëm emri. Ky front ka pasur në

përbërjen e kryesisë së tij edhe një shqiptar pa asnjë vlerë, por që ishte vënë sa për formë, për të treguar sikur fronti gjoja përfaqësonte «bashkimin dhe vëllazërimin» e gjithë popujve të Jugosllavisë.

Gjatë kësaj kohe u duk qartë se Partia Komuniste e Jugosllavisë filloi të degjeneronte nga komuniste në revizioniste dhe u bë, më në fund, një vegël e sigurimit të shtetit jugosllav. Partia Komuniste e Jugosllavisë i humbi krejtësisht tiparet, normat marksiste-leniniste dhe u kthye në një parti që kryen vetëm funksionin e «edukatores». Ne e dimë se çfarë edukate u jepte masave Partia Komuniste e Jugosllavisë, që më pas u quajt «Lidhja e Komunistëve». Ne dimë, gjithashtu, që në Jugosllavi depërtoi thellë kapitali i huaj, i cili mori koncesione të mëdha, e skllavëroi ekonomikisht dhe e degjeneroi politikisht dhe ideologjikisht Jugosllavinë. Degjeneroi kështu edhe partia dhe anëtarët e saj u bënë përfituesit kryesorë të fitimeve që u linin koncesionarët kapitalistë të huaj të cilët kishin bërë atje investime, u bënë trafikantët më të djallëzuar dhe u krijuan kështu shtresa e borgjezisë së re jugosllave. Degjenerimi filloi të përhapej në popull. Partia kishte vetëm emrin komuniste.

Kështu do të ngjasë edhe në Kinë. Atje, mendoj unë, do të zhvillohet një proces i tillë dhe, në qoftë se nuk gabohem, do të shkohet drejt thellimit të pluralizimit. Aktualisht në udhëheqje atje ekzistojnë shumë parti. Një gjë e tillë është fiksuar nga maocedunideja. Megjithatë me zhvillimin e Kinës drejt një vendi social-imperialist, partitë që janë në front, mund të qëndrojnë në kuadrin e kësaj organizate, por, ato do të përpi-

qen të manifestojnë haptazi ekzistencën e tyre, ashtu siç e manifeston aktualisht edhe Partia Komuniste e Kinës. Kështu ajo do të zhvishet nga çdo prerogativë dhe do të mbajë vetëm emrin, ndërsa fronti, i përbërë nga një sërë partish të rrymave të ndryshme të borgjezisë kineze, mbetet i plotfuqishëm. Këto parti borgjeze, që udhëheqin, do të përpiqen të qëndrojnë më vete si parti të pavarura, në alcancë e në bashkëpunim me njëra-tjetrën, duke bërë, ashtu si në vendet kapitaliste, lojën parlamentare. Po ashtu, mund të ndodhë që këto parti të ndryshme të borgjezisë, kur të jenë majmur dhe të kenë fituar soliditet politik dhe ekonomik, si dhe influencë në ushtri, të grumbullohen në një, në dy apo në tri parti me etiketa të ndryshme, gjithnjë borgjeze, që të drejtojnë si në vendet kapitaliste.

Ky është një problem me rëndësi për të parë se si do të zhvillohet në Kinë transformimi drejt kapitalizmit dhe drejt socialimperializmit. Natyrisht, ky transformim do të ketë influencë dhe reperkusione në të gjithë Azinë, për arsye se edhe vende të tjera të ashtuquajtura socialiste janë në rrugë kapitaliste. Por ky shembull do të shërbcjë edhe për ato vende kapitaliste të kësaj zone, të cilat do të gjenden përpara krizave të mëdha për shkak të luftës së popullit dhe të proletariatit dhe, natyrisht, në situata të vështira për kapitalizmin që sundon aktualisht, do të kërkojnë të gjejnë rrugëdalje. I gjithë ky proces duhet të vërchet me kujdesin më të madh.

Marrë nga libri:

Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 10, f. 206

TREGUESIT

TREGUESI I LËNDËS

A

Aftësia prodhuese, shfrytëzimi i saj — 397-398.

Ambasada e RP të Kinës në RPS të Shqipërisë dhe në Poloni — 42, 46, 82.

Ambasadat e RPS të Shqipërisë në Kinë e në Francë — 31, 159.

Arkitektura, arkitektët — 338-341.

Arkivat, dokumentet arkivore — 290, 315-316.

Armiqtë e brendshëm e të jashtëm, veprimtaria armiqësore dhe lufta kundër tyre — 52, 255-256, 259, 270.

Arsimi në Shqipërinë e paraçlirimit — 2, 3-4.

Arsimi në RPSSH — zhvillimi i arsimit; revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës. Arsimi i mesëm profesional, shkollat e mesme bujqësore — 5-6, 236-237;

— programet, lëndët mësimore; nxënësit, mësuesit, pedagogët — 6-7, 188, 236-237, 360-363.

Arti Ushtarak i Luftës Popullore — 300-303, 304, 331.

Autarkia — 48-49, 61, 258.

B

Bashkimet Profesionale të Shqipërisë; detyrat e tyre — 343-351.

Bashkimi i Grave të Shqipërisë; detyrat. Kongresi i 8-të i BGS — 324, 325-328, 331.

Bashkimi Sovjetik (1917—1953); Partia Komuniste (bolshevike) e Bashkimit Sovjetik — 27, 119, 251-252, 282, 283, 393.

Bashkimi Sovjetik, socialimperializmi sovjetik; strategjia dhe taktikat; politika e jashtme hegjemoniste dhe ekspansioniste. Synimet e tij në Lindjen e Mesme — 27-29, 63, 65, 68-69, 71-72, 77, 169;

— qëndrimi ndaj Kinës, Vietnamit e ndaj konfliktit kamboxhiano-vietnamez — 170, 171, 193, 194.

Bibliotekat — informacioni shkencor — 100-103, 267.

Blegtoria në RPSSH — politika e Partisë për zhvillimin e blegtorisë; lopa. Baza ushqimore — 217-218, 233-234, 268-269.

Borgjezia, Borgjezia e re në vendet revizioniste — 8, 10-11, 13, 21, 23-24, 144, 152, 213, 273, 275, 276-277, 278, 279-280.

Bujqësia në RPSSH; vendi dhe roli i bujqësisë në ekonominë popullore; organizimi dhe drejtimi i punës, kuadrot e specialistët; studimet në fushën e bujqësisë — 223-224, 231, 232, 267, 335-336, 377-378;

— bimët industriale, pam-buku. Toka, të dhënat dhe hartat pedologjike; agroteknika, shërbimet agroteknike — 96-98, 222, 231-232, 317.

Burokratizmi, lufta kundër shfaqjeve të tij — 200, 229, 344-345, 349, 379, 384, 396, 401.

D

Dënimet, vepra penale, masat ndëshkimore; efekti edukativ i dënimit — 307-310, 311-312.

Shih edhe: Ligjet, legjislacioni...

Dialektika materialiste; metoda materialiste-dialektike në trajtimin e fenomeneve të shoqërisë. Trajtimi konkret historik — 264-265, 287-292, 309-310, 311-316, 388-389, 390, 391.

Diktatura e proletariatit dhe demokracia socialiste — 163, 246, 343-344.

Disiplina proletare, disiplina shkencore dhe ajo e punës — 221, 310-323.

E

Edukimi komunist — rrugët, format dhe mjetet e edukimit komunist — 320, 324-325, 335-336, 392-395;

— bindja dhe masat administrative; detyrimi — 228, 234, 307-308, 321.

Efektiviteti i ekonomisë — 96-101.

Egjipti; politika e jashtme. Marrëdhëniet e kontradiktat me BS, me ShBA dhe me vendet arabe — 63, 64-65, 66-67, 68-69;

— kontradiktat dhe lidhjet me Izraelin — 65-67, 72-75.

Ekonomia në vendet kapitaliste; kriza financiare e valutore — 54-61.

Ekonomia popullore — zhvillimi i saj. Drejtimi dhe organizimi i ekonomisë. Struktura e degëve të saj. Kooperimi — 48-50, 94, 100, 104-105, 214-215, 226-227, 238-239, 257-263, 266-267, 378, 396-404.

Emancipimi i shoqërisë — 324-325, 329, 346-347.

Engels, Fridrih — 25, 101, 108, 141, 248, 270, 279, 388.

Enver Hoxha — të dhëna autobiografike — 1-2, 3, 106-107, 162, 166, 181-182, 299, 352, 357-358, 363, 395.

F

Feja. Roli reaksionar i fesë në historinë e popullit shqiptar; qëndrimi i PPSH dhe i shtetit ndaj saj — 62, 162-163, 298-299.

Folklori — 288-290, 291.

Forcat prodhuese, mjetet e prodhimit — 49-50, 211.

Franca; historia dhe kultura e Francës; politika e jashtme e saj — 10, 14, 73, 77, 156, 157-158, 169, 178, 247, 248, 277, 282;

— marrëdhëniet dhe qëndrimi ndaj Shqipërisë. Shoqata e Miqësisë Francë—Shqipëri — 155-158,

160-161, 165-166, 183-184, 186.

Fronti Nacionalçlirimtar. Fronti Demokratik i Shqipërisë — 163, 253.

Fshatarësia — gjendja e saj para Çlirimit. Fshatarësia kooperativiste; edukimi ideopolitik dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja — 315, 318-323.

Fuqia punëtore — politika e Partisë për angazhimin e të gjitha forcave aktive në punë — 227-228, 262-263, 402.

Furnizimi materialo-teknik, normativat e harrimit të materialeve — 234-236.

G

Greqia; politika e jashtme — 28, 29-30, 52, 100.

Gruaja dhe vajza shqiptare; politika e Partisë për emancipimin e saj — 237-238, 324-325, 326-328, 355-356, 363-364;

— edukimi ideopolitik; roli dhe pjesëmarrja e gruas në prodhim — 237-238, 324-325, 329-330.

Gruaja në vendet kapitaliste. Kritikë pikëpamjeve borgjeze për pozitën dhe rolin e gruas në shoqëri — 16-21.

Grupet armiqësore dhe lufta

kundër tyre; grupi armiqësor, komplotist e puçist i B. Ballukut, P. Dumes etj. në ushtri — 175, 305-306;

— *grupi armiqësor sabotues i A. Këllezit, K. Theodhosit etj. në ekonomi — 104-105, 203-204, 210-211, 212-213, 263-264.*

GJ

Gjykata e Lartë; gjykatat, gjykatat e fshatrave; gjyqtarët — 307-316, 328.

II

Historia e popujve të botës, e kulturës dhe e qytetërimit të tyre — 156, 157-158, 353-354. Historia e Shqipërisë; lufta dhe përpjekjet e popullit shqiptar për liri, pavarësi e përparim shoqëror — 1-2, 3-4, 288-291;

— *Rilindja Kombëtare Shqiptare, rilindësit. Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878—1881) — 3-4, 240, 242, 244, 316;*

— *shkrimet, dokumentet dhe studimet për historinë e Shqipërisë; trajtimi materialist-dialektik i saj.*

Historianë, studiues dhe personalitete të huaj për historinë e Shqipërisë — 157-158, 244, 267-292, 293.

I

Industria e rëndë në RPSSH; industria e lëndëve djegëse (e naftës, e qymyrgurit); specialistët e saj. Minerat — 193, 225, 227-229, 402-403;

— *Industria mekanike, prodhimi në vend i pjesëve të këmbimit dhe i fabrikave — 376, 398-399.*

Industrializimi socialist — sigurimi, vlerësimi e përpunimi i lëndëve të para të vendit — 199, 201.

Interesi i përgjithshëm dhe ai vetjak — 319, 322-323, 330, 404. Internacionalizmi proletar — 167, 189-190.

Internacionalja e Tretë Komuniste (Kominterni); Lenini dhe Stalini për revolucionin në Kinë — 110, 113, 115-120, 123, 124-125, 126-128, 133, 140, 243.

Investimet, investimet në bujqësi — 269.

Izraeli; politika e jashtme; vegël e imperializmit amerikan në Lindjen e Mesme. Kon-

flikti i tij me Egjiptin — 64, 65-66, 68, 72-75, 89.

J

Jugosllavia, revizionizmi jugosllav; politika e jashtme — 27-28, 167;

— gjendja e brendshme, konfliktet nacionale; Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë; degjenerimi i partisë, i pushtetit dhe i jetës ekonomiko-shoqërore; depërtimi i kapitalit të huaj — 22-27, 40, 167-168, 169, 408-409, 413-414;

— agjenturë e imperializmit. Roli sabotues i saj në lëvizjen komuniste botërore dhe në lëvizjen e popujve për liri e pavarësi — 22-30, 167, 181.

K

Kambozia; konflikti i saj me Vietnamin — 39, 191, 193, 194, 195-196.

Kapitalizmi, sistemi kapitalist; ligje, karakteristika të përgjithshme të zhvillimit të tij; kriza, kontradiktat — 20-21, 185, 212, 243, 249, 259, 408-411, 415.

Këshillat popullore dhe komitetet ekzekutive të tyre. Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit të Tiranës — 215, 219, 308, 399, 402-403.

Këshilli i Ministrave (Qeveria), Kryesia e Këshillit të Ministrave — 163, 201, 202, 205, 214, 226, 229, 264, 263, 384, 396, 397, 401-402, 404.

Kina, revizionizmi kinez — 44-46, 245, 246;

— gjendja e brendshme; lufta e grupeve për pushtet. Revolucioni Kulturor — 31-34, 79-80, 85-87, 110-111, 132, 140-141, 150, 171-172, 174-175, 285-286, 365-374, 405-407;

— zhvillimi i kapitalizmit në Kinë; ndërhyrja e kapitalit të huaj — 35, 38, 109, 110-111, 138-139, 235-286, 366, 406-411, 415;

— klasat dhe lufta e klasave në Kinë; borgjezia në Kinë. Partitë, pluralizmi politik dhe ideologjik — 85-86, 110, 120, 121, 137-139, 141-142, 143, 283, 410-413, 414-415;

— Partia Komuniste (revizioniste) e Kinës; vija e saj politike, ideologjike dhe organizative; qëndrimi ndaj marksizëm-leninizmit. Kongreset, plenu-

- met, fraksionet në parti.
Maocedunideja — 35, 112-116, 117-118, 119-120, 122-123, 125, 126-131, 133-134, 141-143, 144-148, 151-153, 171-172, 201, 282-283, 365-374, 392, 407, 411-412, 413;
- lidhjet me BS (1917—1953). Lidhjet dhe qëndrimi ndaj Kominternit — 110, 111-112, 113-114, 118-120, 123, 124-127, 128;
 - politika e jashtme koniunkturale; përpjekjet për t'u bërë superfuqi; lidhjet dhe bashkëpunimi me ShBA dhe me shtetet e tjera kapitaliste. Marrëdhëniet dhe kontradiktat me BS — 35-41, 44-47, 79-92, 110-111, 147, 152-154, 169-171, 172-174, 175-176, 191-192, 195;
 - roli sabotues në lëvizjen komuniste marksiste-leniniste dhe në luftërat nacionalçlirimtare të popujve — 36-37, 44-45, 153, 173, 178-179;
 - marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me klikat reacionare; marrëdhëniet me grupet, me partitë dhe me vendet e tjera revizioniste — 39-40, 45-47, 179;
 - marrëdhëniet dhe kontradiktat me vendet fqinjë; qëndrimi ndaj konfliktit kamboxhiano-vietnamez — 38-39, 191-196;
 - qëndrimi ndaj vendeve të Lindjes së Mesme — 37-38, 40-41, 69-70, 77-78, 89;
 - marrëdhëniet, qëndrimi armiqësor ndaj PPSH dhe RPSSH — 34, 42, 44, 170-171, 173-174, 175, 178-180, 243, 375.
- Shih edhe:* Revolucioni në Kinë...
- Klasa punëtore në Shqipëri — roli dhe detyrat e saj në ndërtimin socialist — 198-199, 211-212, 358-360.*
- Klasa punëtore (proletariati) në vendet borgjeze e revizioniste — shfrytëzimi kapitalist; domosdoshmëria e organizimit dhe e rritjes së ndërgjegjes klasore të saj — 10-11, 119, 130, 212.*
- Kombi, kombësia dhe çështja nacionale — 62-63, 140.*
- Komunisti, cilësitë; roli pararojë i tij në ndërtimin socialist të vendit; ngritja e nivelit ideopolitik dhe kulturor të tij — 255, 229, 330, 386-387, 388-389;*
- roli i tij në organizatat e

- masave — 327-328, 345-346, 348.
- Konservatorizmi; lufta kundër shfaqjeve të tij — 234, 237-238.
- Kontradiktat antagonistike dhe joantagoniste, rrugët e zgjedhjes së tyre — 309-311, 313, 330-331.
- Kontradiktat ndërmjet vendeve kapitaliste, shfrytëzimi i tyre — 51-52, 87-88, 90, 185, 270.
- Kontrolli i Partisë, i shtetit dhe i klasës punëtore; kontrolli dhe kërkesa e llogarisë — 221, 319-320, 322, 333-337.
- Kooperativat bujqësore; organet drejtuese dhe kuadrot e tyre; kooperativistët. Organizimi i punës në to; marrëdhëniet me shtetin; të ardhurat — 219-222, 234-236, 269, 318-323.
- Kritika dhe autokritika — 209, 310-311, 342-343.
- Kuadrot, specialistët; cilësitë, roli dhe detyrat e tyre në ndërtimin socialist të vendit. Politika e Partisë me kuadrin. Kuadrot e Partisë — 101-102, 199, 223-224, 264, 295, 376, 378-379, 382, 383, 392-395;
- zgjedhja, vendosja, shpërndarja dhe kualifikimi i tyre — 101, 212-213, 378-379, 380, 382.
- Kultura fizike dhe sportet — zhvillimi dhe masivizimi i sportit; veprimtaritë sportive; lojërat popullore — 352-364.
- Kultura në RPSSh — qëndrimi ndaj trashëgimisë kulturore — 298-299.
- Kushtet e punës e të jetesës të klasës punëtore — 211-212, 228, 265-266.
- Kuvendi Popullor, Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSSh — 102, 328.

L

- Lenin, Vladimir Iljç — 23, 25, 27, 101, 108, 112, 115-116, 118, 122, 126, 133, 141, 146, 150-151, 167, 246, 248, 273, 280, 343, 344, 349, 333.
- Letërsia dhe artet në RPSSh; artet figurative; shkrimtarët — 291-292, 339-340.
- Lëvizja komuniste në Shqipëri para themelimit të PKSh — 2-3.
- Lëvizja komuniste punëtore e marksiste-leniniste ndërkombëtare — strategjia dhe taktikat; partia marksiste-leniniste; roli udhëheqës, vija, parimet e normat e saj; puna me

masat — 8-14, 251-252.

Libri, puna me librin — 100-101.

Ligjet, legjislatiionit; politika e Partisë në fushën e legjislatiionit. Njohja, zbatimi dhe lufta kundër shkelësve të ligjeve — 310, 311-312, 314-315.

Shih edhe: Dënimet...

Lindja e Mesme; pozita strategjike; planet e superfuqive dhe të reaksionit në këtë zonë — 37-38, 62, 63-65, 71.

Lufta e Dytë Botërore (1939-1945); lufta e popujve të botës kundër agresorëve fashistë — 23, 158-159.

Lufta e klasave në vendin tonë; roli i diktaturës së proletariatit në zhvillimin e luftës së klasave — 254, 307-316, 330-331, 390;

— diferencimi në zhvillimin e luftës së klasave; lufta kundër qëndrimeve oportuniste, sektare e liberale — 164, 309-311, 390-392.

M

Marksizëm-leninizmi, busull dhe udhëheqje për veprim; përvetësimi e zbatimi krijues i tij — 2-3, 246-247, 248, 252-253, 254-255, 387, 389, 392-395.

Marks, Karl — 25, 101, 107, 108, 122, 141, 146, 150-151, 246, 248, 282, 388.

Masat dhe individit — 287-292.

Mbështetja në forcat e veta — 43, 44, 48-50, 99, 104, 257-258, 375.

Mbrojtja e atdheut, forcimi i gatishmërisë luftarake të ushtrisë, të popullit dhe të gjithë vendit për mbrojtje — 29, 30, 301, 331-332.

Mesjeta; filozofia dhe filozofët në mesjetë; skolastika — 387-388.

Metoda dhe stili në punë — 93-95, 317-318, 323.

Ministritë dhe kuadrot e tyre; detyrat, kompetencat; metoda dhe stili në punë — 94, 102-103, 198, 200-201, 207, 215, 229, 380-381, 384, 396-404;

— Ministria e Mbrojtjes — 306;

— Ministria e Industrisë dhe e Minierave — 94, 200, 228, 229, 399, 403;

— Ministria e Bujqësisë — 97, 219, 220;

— Ministria e Ndërtimit — 266;

— Ministria e Tregtisë së Brendshme — 94, 399;

— Ministria e Tregtisë së Jashtme — 53, 270.

Minoriteti grek në Shqipëri — 180-181.

Muzetë, Muzeu Historik Kom-
bëtar — 338-341.

N

Ndërgjegjja, morali; formimi
i ndërgjegjes socialiste — 320,
328-330.

Ndërmarrjet socialiste — 404.
Ndërtimi i socializmit në
Shqipëri; karakteristika, pari-
me të ndërtimit socialist —
43, 343, 390, 392.

Novatorizmi, novatorët. Shpi-
kjet, racionalizimet — 198-199.

O

Organet e drejtësisë — revo-
lucionarizimi i tyre; roli dhe
detyrat e tyre — 307-316.

Organet shtetërore dhe ato
ekonomike — 261, 264, 317.

Organizata-bazë e Partisë;
puna e saj për zbërthimin dhe
zbatimin e vendimeve e të
direktivave të Partisë. Mble-
dhjet e saj — 227, 295, 326-
-328;

— organizata-bazë e Partis-
së në fshat dhe në ush-
tri; puna e saj me or-
ganizatet e masave —
304, 307-308, 326-328, 330.

Organizata e Kombeve të Ba-
shkuara — 37, 65, 81-82.

Organizatet e masave — de-
tyrat e tyre; roli udhëheqës i
Partisë në to; kuadrot drej-
tues të tyre — 325-329, 331-
-332, 342-351.

Organizimi dhe drejtimi — 93-
-105, 200-202, 205-207, 214-
-216, 333-337.

P

Palestina, palestinezët — pla-
net dhe veprimet armiqësore
të imperialistëve ndaj çësht-
jes palestineze — 64, 66, 70,
74-75.

Partia e Punës e Shqipërisë —
vija, vendimet, direktivat,
ndërtimi dhe jeta e brendshme

— vija dhe roli udhëheqës
i saj në Luftën Antifa-
shiste Nacionalçlirimtare
dhe në ndërtimin socia-
list të vendit — 4-5, 50-
-51, 159-160, 179, 188-189,
220, 253-256, 271-272, 296-
-297;

— faktorët objektivë dhe
subjektivë që çuan në
krijimin e saj; vija, ve-
ndimet, direktivat; njoh-
ja dhe zbatimi i tyre —
93, 97-99, 167, 203-204,
206-207, 214, 221, 233, 234,
252-253, 296-297, 310-311,
326-328, 333-334, 335-336,

- 343-350, 377, 386-387, 391, 394-395;
- normat e Partisë; revolucionarizimi i saj — 253, 254-255;
 - puna e Partisë; metoda dhe stilli i punës së saj; ndihma dhe kontrolli për bazën; puna e saj me organizatat e masave — 219-220, 227, 295, 296-297, 325-329, 333-334, 335-337, 342-351, 400-401;
 - lidhjet e Partisë me masat; letrat e popullit dhe puna me to — 163-165, 296-297;
 - puna e Partisë me njerëzit, bindja; qëndrimi ndaj të metave e gabimeve dhe ndaj njerëzve që gabojnë dhe bëjnë fajë — 167, 220, 223, 310-311, 319-320, 390-395;
 - studimet, materialet për organet udhëheqëse të Partisë — 208-209, 402;
 - eksperiencia e Partisë; njohja, përgjithësimi i saj — 388-389.
- Partia e Punës e Shqipërisë*
- organet udhëheqëse qendrore e në rrethe
 - Kongresi i Partisë, Kongresi VII i PPSH (1-7 nëntor 1976) — 5, 103, 160, 178, 214, 221, 242, 257;
 - Komiteti Qendror, Byroja Politike, Sekretariati i KQ — 97, 103, 163, 198, 203, 209, 210, 214, 221, 269, 342, 330, 399, 401;
 - Plenumi i 3-të i KQ (13-14 tetor 1967); Plenumi i 8-të i KQ (1969) — 5, 104, 149, 263;
 - Plenumi i 2-të i KQ (28-29 qershor 1977); Plenumi i 4-të i KQ (30-31 janar 1978) — 149, 257-272, 396;
 - aparati i KQ; organizata-bazë e aparatit të KQ — 305, 386-387, 389, 392, 394;
 - komitetet dhe aparatet e Partisë në rrethe — 220, 296-297, 308, 394;
 - komitetet e Partisë të rretheve të Elbasanit dhe të Fierit — 333, 335, 337, 360;
 - Organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Korçës; organizatat e Partisë të rretheve të Beratit dhe të Tiranës — 233, 297, 337, 399, 402.
- PPSh — karakteristikat e saj; edukimi në Parti; studimi dhe përvetësimi i marksizëm-leninizmit, zbatimi krijues i tij*
- 180, 252-253, 255-256, 337, 388-389.
- Partia e Punës e Shqipërisë*

— *politika e jashtme; marrëdhëniet me partitë marksiste-leniniste* — 242-243;

— *qëndrimi parimor dhe lufta për demaskimin e revizionizmit sovjetik, jugosllav dhe kinez* — 149-150, 154, 170-171, 172-175, 176-177, 178-179, 253-254.

Partia Komuniste (marksiste-leniniste) e Spanjës — 8-15.

Partia Komuniste (revizioniste) e Spanjës — 9, 11, 13.

Partitë borgjeze; pluralizmi politik — 8, 14, 45.

Përvoja e përparuar; përgjithësimi i saj — 218-219, 265, 295, 297.

Planifikimi — parimet themelore të planifikimit; lufta për realizimin e planeve. Plani i 6-të pesëvjeçar — 43-50, 61, 239, 263, 403-404;

— *planet, planifikimi në bujqësi dhe në kooperativat bujqësore; lufta për realizimin e tyre* — 217-218, 234-236, 257-263, 267-268, 271.

Politika e jashtme e RPSSH; parimet themelore të saj — 42-43, 52, 82, 160, 161, 167, 169, 171, 179, 195-196;

— *rritja e prestigjit dhe e autoritetit të RPSSH në botë. Përkrahja e popujve*

të botës për Shqipërinë. Të huajt, miqtë për Shqipërinë — 43, 160, 161-162;

— *lufta për demaskimin e imperializmit, socialimperializmit dhe reaksionit* — 173, 185-186;

— *marrëdhëniet dhe qëndrimi parimor ndaj Kinës* — 42-43, 44, 84, 161, 169-171, 173-180;

— *marrëdhëniet me vendet fqinje; qëndrimi parimor ndaj Kosovës* — 30, 52-53, 167, 169, 180-181;

— *marrëdhëniet me Francën* — 155-158, 160-161, 165-166, 180, 183-184, 186;

— *propagandimi i Shqipërisë dhe i revolucionit socialist në Shqipëri* — 246-247, 248.

Populli shqiptar — cilësitë; traditat përparimtare, arsimdashëse të tij — 3-4, 157, 291, 340.

Prodhimi material; cilësia; prodhimi i mallrave të konsumit — 270, 377.

Prokuroria e Përgjithshme. Prokuroria, prokurorët — 312-314, 315, 323.

Prona socialiste; prona private — 303, 319, 322-323.

Puna; normimi i punës, nor-

mat teknike — 204-205, 265, 319-320.

R

Radiotelevizioni Shqiptar — 315-316, 361.

Rendimenti — faktorët që ndikojnë në rritjen e tij — 204, 211-212, 265-266.

Revizionizmi modern; revizionistët modernë tradhtarë të marksizëm-leninizmit — 245-246, 391, 392.

Revolucionet borgjeze; thelbi i tyre. Revolucionet demokratiko-borgjeze në Evropë në shek. XVII, XVIII dhe XIX; karakteri dhe forcat lëvizëse të tyre — 106-107, 121, 143-144, 147, 150, 172, 247-248, 273-280, 281-282.

Revolucioni i Madh Socialist i Tetorit (1917) — 2, 108, 111, 112, 113, 115, 150, 246, 248, 282.

Revolucioni në Kinë; karakteri, etapat e tij — 108-109, 133-134, 137-140, 149, 172, 281, 403;

— *revolucioni demokratiko-borgjez në Kinë. Guomindani* — 109-112, 115, 119-122, 124, 126-130, 281-282, 283-284;

— *Lufta e Dytë Revolucio-*

nare Civile në Kinë (1927—1930); Lufta Nacionalçlirimtare në Kinë (shtator 1931—tetor 1949)

— 122-124, 129-131, 282;
— *faktori objektiv dhe subjektiv për revolucionin në Kinë; kryengritja e armatosur. Qëndrimi i PK të Kinës për këtë problem* — 123-125, 148;
— *pikëpamja e PK të Kinës për shndërrimin e revolucionit demokratiko-borgjez në revolucion socialist dhe për rolin udhëheqës të partisë marksiste-leniniste në të* — 114-118, 121-122, 136, 133-139, 281-282, 284-285;

— *karakteri, forcat lëvizëse, aleancat dhe detyrat e revolucionit socialist; roli hegjemon i klasës punëtore dhe i partisë së saj; roli i fshatarësisë; qëndrimi ndaj borgjezisë. Vija e PK të Kinës për këtë problem. Mohimi i rolit udhëheqës të partisë marksiste-leniniste* — 114-117, 118-122, 126-128, 129-131, 137-139, 142-143, 281-285, 411-413;

— *Revolucioni Popullor në Kinë. Vija politike, ekonomike, sociale e PK të*

Kinës në revolucionin popullor — shtrembërim i teorisë marksiste-leniniste për ndërtimin e socializmit — 131-143, 283-285.

Revolucioni socialist në Shqipëri, etapat e tij — 246-247.

Revolucioni socialist proletar, domosdoshmëria e tij. Roli i faktorit subjektiv në revolucion — 107-108, 248, 249-250.

Revolucioni tekniko-shkencor; kuptimi, përmbajtja dhe rëndësia e tij — 203-209, 211-213, 225-226, 263-266, 375-385;

— politika dhe roli udhëheqës i Partisë për zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor; domosdoshmëria e mbështetjes së tij në teorinë marksiste-leniniste — 197-199, 206, 214, 215-216, 384-385;

— roli i tij në zhvillimin e forcave prodhuese, të shkencës e të teknikës — 198-199, 211-212, 217-230, 265, 375-385;

— grupet e punës, organizimi i punës në to; roli dhe pjesëmarrja e masave — 200-202, 205-206, 211, 213-216, 225, 226, 228-230, 238-239, 264, 265, 375-385;

— studimet, kërkimet dhe

eksperimentimet shkencore; lidhja e tyre me praktikën e me prodhimin; informacioni e komunikimi shkencor — 100-102, 198-202, 206, 211, 225, 375-385;

— mekanizimi, përsosja e procesit teknologjik. Shpikjet, racionalizimet — 96-97, 98, 205, 211-212, 228-230, 266, 376-377, 398-399;

— përpjekjet e armiqve për ta devijuar zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor — 210-211, 212-213, 263.

Rezervat e brendshme, shfrytëzimi i tyre — 259-260.

Rinia dhe Dashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë; roli dhe detyrat e tyre; edukimi komunist, patriotik dhe kulturor i rinisë — 183-189, 237, 266, 356, 357, 360, 363;

— rinia para Çlirimit — 2, 3, 4-5.

RR

Rrethimi, bllokada imperialisto-revizioniste dhe lufta për çarjen e tyre — 51, 60-61, 255-256, 259, 260, 270.

S

Stalin, Josif Visarionoviç — 23, 25, 27, 101, 108, 120, 126, 127, 140, 141, 153, 180, 246, 248, 252, 388, 393.

Stimujt materialë — 321-322.
Superfuqitë; politika hegjemoniste dhe ckspanioniste, aleancat dhe rivaliteti ndërmjet tyre. Përpyekjet për zona influence; synimet e tyre në Lindjen e Mesme — 28-29, 62, 63-64, 71-72, 75, 76, 77, 185-186, 195.

SH

Shëndetësia; kujdesi për nënën dhe fëmijën — 329-330, 346-347.

Shfaqjet e huaja dhe mbeturinat e së kaluarës, lufta kundër tyre — 328-330, 350-351, 390-392.

Shkenca në RPSSH — politika e Partisë për zhvillimin dhe masivizimin e shkencës. Roli i saj në zhvillimin e prodhimit; lidhja e shkencës me prodhimin — 158, 211, 215, 331-332;

— organizimi e drejtimi i punës shkencore. Studimet dhe veprimtaritë shkencore; shkencëtarët — 101-102, 214-215, 223-

-224, 240-241, 242-243, 244-245, 375-376;

— Akademia e Shkencave, kuadrot e saj. Institucionet shkencore — 100-101, 102-103, 222-223, 242, 244-245, 267, 380-381, 384.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës — politika e jashtme. Përpyekjet e tyre për të vendosur dhe për të ruajtur sundimin në Lindjen e Mesme; përkrahja për Izraelin — 23-25, 63, 64, 65, 66, 68, 69, 71-72, 74-77:

— politika hegjemoniste në Lindjen e Largme, ndërhyrjet në Kinë. Politika e agresionit dhe e luftës ndaj Vietnamit, disfata në Vietnam — 83-84, 111, 130, 174, 192-193.

Shtypi dhe botimet në RPSSH — përmbajtja — 228, 241-242, 313, 317, 393.

Shtypi dhe propaganda borjezo-revizioniste — 31-32, 35-36, 46, 87, 152, 193, 366-367, 369, 370, 371, 405-406, 412-413.

Shtypi përparimtar botëror — 161-162, 163.

T

Teknokratizmi; lufta kundër shfaqjeve të tij — 263-264.

Teoria e praktika, uniteti dialektik i tyre — 206-207, 211, 225, 297, 303-304, 305, 318, 335, 381-382, 387, 388-389, 392-395.

Teoritë dhe pikëpamjet borjezo-revizioniste dhe kritika ndaj tyre: për rolin e gruas, për rrugët e kalimit në socializëm dhe për revolucionin tekniko-shkencor — 16-21, 212-213, 245-246, 249-250;

— *teoria kineze e «tri botëve», e «lulëzimit të njëqind luleve dhe e konkurrimit të njëqind shkollave», e mohimit të rolit të partisë; nihilizmi kinez* — 35, 38-37, 41, 45, 69-70, 85, 87-91, 172, 174-175, 176-179, 184, 411-413, 414-415;

— *teoria jugosllave për «vendet e paangazhuara»* — 26.

Transporti — organizimi i punës në transport; transporti detar — 99-100.

Tregtia e brendshme, furnizimi i popullit — 293-294.

Tregtia e jashtme; parimet themelore në fushën e tregtisë së jashtme — 43-44, 52, 53;

— *eksporti, importi; çmimet në tregun ndërkombëtar;*

punonjësit e tregtisë së jashtme — 48, 49, 50, 53-54, 60, 61, 93-99, 269-271, 399-401.

U

Uniteti Parti—popull — 43, 163, 180, 189.

Ushtria Popullore. Edukimi ushtarak; stërvitja ushtarake. Kuadrot politikë e ushtarakë — 300-306.

V

Vendet arabe. Lidhjet, bashkëpunimi, kontradiktat ndërmjet tyre. Domosdoshmëria e forcimit të unitetit të tyre — 62-63, 181.

Vendet revizioniste; politika e jashtme, lidhjet dhe kontradiktat me Kinën e me BS — 46-47, 181.

Vështirësitë; lufta për kapërcimin e tyre — 60-61, 179-180, 229, 390, 392.

Vietnami; marrëdhëniet dhe kontradiktat me Kinën; lufta kundër agresionit amerikan; konflikti me Kamboxhian — 39, 83-84, 192-193, 194, 195-196.

TREGUESI I EMRAVE

A

- Alia, Ramiz — 8, 101, 207, 235.
241, 243, 293-295, 296, 297-
-298, 299, 324, 344, 352, 353,
358, 360.
Aleksandri i Madh i Maqedoni-
nisë — 353-354.
Antonesku, Ion — 252.
Apoloni — 353.
Asad, Hafëz el — 67.
Asdreni (Aleks Stavre Drenc-
va) — 4.

B

- Babani, Fuat — 5.
Babani, Sedat — 5.
Babëf, Fransua Noel — 144.
148, 275-276.
Bako, Koci — 4.
Balluku, Beqir — 175, 305.
Bare, Mohamed Siad — 41.
Begin, Menahem — 63, 73-74.
Bellkameni, Spiro — 3-4.
Berlinguer, Enriko — 151.
Bernar, Klod — 153.
Bethoven, Ludvig van — 184.
Bijo-Varen, Zhan Nikolas —
144.

- Bismark, Oto — 247, 279.
Bonaparti, Napoleon — 19, 147,
148, 276, 277, 285.
Bonaparti, Charl Lui — 147,
277, 285.
Borodin — 126.
Bozo, Naunka — 333, 334-335.
Bruno, Xhordano — 388.
Brunsvik, Ferdinand — 282.
Bualo, Nikola — 16.
Buda, Aleks — 240, 241, 242,
244-245, 250.
Buharin, Nikolai — 126.
Bumedien. Huar — 67.
Buonaroti, Filip — 144.

C

- Cipo, Kostaq — 4.

Ç

- Çuko, Lenka — 222, 224.
Çan Kal Shi — 110, 120, 128,
130, 131, 283.
Çen Du Siu — 113-114, 118,
122.
Çen Jun Kuel — 193.
Çen Po Ta — 373.
Çian Çin — 373.

Çu De — 124, 131, 142.

Çu En Lai — 79, 82-83, 84, 85,
86, 125, 128, 131, 139, 145,
171, 172, 173, 175, 177, 191,
192, 370, 371, 373, 405, 406.

D

D'Alamber, Zhan lë Rond —
17-18.

Danton, Zhorzh Zhak — 144.

Dekart, Rene — 316.

Demosteni — 353, 354.

D'Estën, Zhiskar — 73, 76.

Dë Gol, Charl — 169.

Dën To — 366.

Didëro, Deni — 18, 19.

Dionisi — 353.

Dume, Petrit — 306.

Dushku, Vaskë — 5.

E

Efestioni — 353.

Ekmekçiu, Hatixhe — 357.

Emini, Demo — 289.

F

Fenëlon (Fransua dë Salinjak
dë la Mot) — 16, 17.

Frashëri, Naim — 3.

Fratari, Musa — 5.

G

Gallei, Galileo — 388.

Gërmenji, Themistokli — 3.

Godar, Zhysten — 158.

Grameno, Mihal — 4.

Gramshi, Antonio — 243.

H

Hoxha, Nexhmije — 197, 237,
242, 243, 250.

Hebert, Zhak Rene — 144.

Hefesti — 353.

Hitler, Adolf — 163.

Hoxha, Fejzi — 182.

Hrushov, Nikita — 27, 170, 171,
176, 406.

Hua Kuo Fen — 31, 32, 33, 34,
35, 77, 79, 86-87, 91, 147, 150,
175, 285, 374, 406-407, 410.

Huan Hua — 79.

Husi, Jan — 388.

Hysein, Abdullah — 67, 72,
75.

I

Isai, Hekuran — 93, 197-198,
203, 210.

Ibarruri, Dolores — 9, 11, 13,
14.

Ibn Rushd (Averroes) — 388.

Ibn Sina (Avicena) — 388.

J

- Jan Shan Kun — 366.
 Jao Ven Juan — 367, 373.
 Jeh Çlen Jin — 79, 86, 410.
 Jofe, Adolf Abramoviç — 126.

K

- Kapo, Hysni — 198, 235, 297,
 305, 306, 344.
 Kadaf, Mohamer — 67.
 Kalenja, Dino — 5.
 Kalmet, Albert — 153.
 Kameniev, Lev — 126.
 Kan Shen — 371, 373.
 Kapo, Vito — 329.
 Karter, Xhimi — 73, 74, 75, 77.
 Karriljo, Santiago — 9, 11, 13,
 14, 151.
 Këllezi, Abdyl — 104, 204,
 210, 212, 213, 263.
 Kisinger, Henri — 82, 83, 173.
 Kodra, Ilo — 101.
 Kondorse, Mari Zhan Antuan
 dë Karita — 19.
 Konfuci — 114, 117, 151.
 Koni, Shaqir — 96.
 Konstan, D'Esturnel dë — 158.
 Kromuell, Oliver — 277.

L

- La Bryjer, Zhan dë — 16.
 Lelo, Veiz — 355, 356.
 Le Zuan — 39.

- Liao Mo Sha — 366.
 Li Da Çao — 114.
 Li Li San — 113, 123, 125, 128,
 130, 142.
 Lin Biao — 131, 174, 371.
 Lister, Enriko — 13.
 Liu Shao Çi — 32, 33, 35, 85,
 136, 139, 145, 146, 172, 174,
 365, 366, 367-368, 369, 370,
 372, 373, 405, 406, 408, 410.
 Lo Zhui Çin — 365.
 Luarasi, Petro Nini — 3.
 Lubonja, Xhafer Cenko — 5.
 Lu Din I — 365.
 Ludvig, Emil — 140.
 Luigji I 14-të — 17.

M

- Marko, Rita — 352.
 Miska, Pall — 193.
 Murra, Prokop — 203, 402.
 Mao Ce Dun — 32, 34, 35, 45,
 78, 79, 82-83, 84, 85, 86, 113,
 117, 124, 127, 130, 131, 132,
 133, 134, 135, 136, 138, 139,
 140, 141-142, 145, 146, 147,
 148-149, 150, 151, 152, 171,
 172, 173, 174, 175, 176, 177,
 179, 191, 192, 283, 284, 285,
 296, 366, 367, 368-369, 370,
 371-373, 374, 405, 406-407, 408,
 410, 411, 412.
 Marshall, Xhorxh — 130.
 Marshe, Zhorzh — 151, 250.

Matiez, Albert — 107.
 Menci — 114, 151.
 Mif, Pavël — 125.
 Miliez, Pol — 155-156, 158-159,
 160-161, 162, 165, 166, 178,
 181, 182, 183-184, 185, 186.
 Mio, Vangjush — 4.
 Mishële, Zhyl — 106.
 Mitko, Thiml — 3.
 Mobutu, Sese Seko — 41, 89.
 Moller (Zhan Baptist Pokëlen)
 — 16, 17, 184.
 Montenj, Mishel — 157.
 Monteskjë, Sharl — 17.
 Myncer, Tomas — 388.
 Myteveli, Floresha — 5.

N

Naser, Gamal Abdel — 65.
 Negovani, Papa Kristo — 3.
 Nikson, Riçard — 83, 84, 173,
 174, 192.

O

Onufri — 298, 299.

P

Peristeri, Pilo — 226, 347, 352,
 382-383.
 Pahlevi, Muhamed Reza — 40,
 72.

Papakristo, Sotir — 4.
 Pastër, Lul — 158.
 Pasha, Hysni — 290.
 Pen Çen — 33, 145, 365, 367,
 373.
 Pin De Hua — 33, 366, 367.
 Pompidu, Zhorzh — 169.
 Pu Ji — 143.

Q

Qirinxhi, Raql — 5.

R

Rasin, Zhan — 16.
 Rashid, Harun el — 40.
 Robespier, Maksimilian — 19,
 144, 275.
 Romel, Ervin — 66.
 Ronsar, Pier dë — 158.
 Rul — 158.
 Ruso, Zhan Zhak — 18-19.
 Rusvelt, Franklin — 56.

S

Skënderbeu, Gjergj Kastrioti
 — 157, 158.
 Sadat, Anvar el — 37, 65, 66,
 67, 68, 69, 70, 73, 74, 75, 77.
 Sadul, Zhorzh — 107.
 Saud, Ben Abdel Azis — 75,
 177.

Selasie, Haile — 77.
 Selita, Fatmir — 357, 358, 359,
 360.
 Sie Fu Xhi — 371.
 Sofokliu — 18.
 Sotiri, Pandeli — 3.
 Sun Jat Sen — 106, 109, 110-
 -112, 113, 114, 115, 118, 143,
 146, 281, 284.

SF

Sho Kian — 112-113.

T

Tahsini, Hasan — 316.
 Tao Çu — 369-370, 371, 373.
 Ten Hsiao Pin — 31, 33, 34,
 35, 79, 85, 86-87, 131, 136,
 139, 145, 147, 150, 172, 174,
 175, 285, 365, 366, 367-369,
 369, 370, 372, 373-374, 405,
 406, 407, 410.
 Tito, Josip Broz — 22-23, 24,
 25-26, 27, 30, 167, 168, 176,
 179, 181, 413.
 Topulli, Bajo — 229.
 Topulli, Çerçiz — 229.
 Trocki, Lev — 126.

TH

Theodhosi, Koço — 201, 212,
 213.

Thomai, Themie — 217, 218,
 219.

V

Van Min — 130.
 Veqilharxhi, Naum — 3.
 Vilhelmi I — 279.
 Vojtinski, Grigori — 118.
 Volter (Fransua Mari Aruë) —
 13, 19.
 Vu Han — 366-367.

X

Xoxe, Koçi — 254.

XII

Xhuvani, Ptoleme — 5.

Z

Zinoviev, Grigori — 126.
 Zogu, Ahmet — 253.

ZU

Zhores, Zhan — 107.
 Zhyrke, Zhak — 178.
 Zhyst, Sen — 144.

TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

A

- Adriatik (deti ~) — 23.
Afrikë — 63, 76, 77, 249.
Akademia ushtarake «Vam-
pu» (Kinë) — 128.
Algjeri — 63, 67, 72, 76.
Amerika e Veriut — 59.
Angolë — 41, 90.
Arabia Saudite — 63, 64, 67,
72, 75, 76.
Austri — 28, 277.
Azi — 415.

B

- Bab el-Mandeb (ngushtica ~)
— 74.
Balli Kombëtar (organizata
~) — 253.
Banka e Shtetit Shqiptar —
59-60, 339.
Banka Qendrore e Francës —
55.
Bastijë (Francë) — 275.
Belgjikë — 14.
Berat — 219, 263.

- Beteja e Vaterlosë (qershor
1815) — 277.
Biblioteka Kombëtare, Tiranë
— 102.
Bretën Udz (ShBA) — 56.
Britania e Madhe — 14, 20,
77, 147, 176, 247, 250, 277,
278.
Burbonët (dinastia ~) — 277.

C

- Cisjordani — 74.

Ç

- Çansha (Kinë) — 124.

D

- «Demokracia dhe nacionalizmi
në Kinë» (V. I. Lenin, Vepra,
vëll. 18) — 115.
Deti i Kuq — 69, 74.
Dibër — 238.
Divjakë (Lushnjë) — 318.
Durrës — 94, 96, 100, 193, 268.

E

- Elbasan — 219, 357, 358-360.
 Elbë (ishulli ~) — 277.
 Eniratet e Gjirit Persik —
 63, 64, 67, 72, 75.
 Etiopi — 77, 90.
 Evropë, «Evropa e bashkuar»
 — 10, 14, 59.

F

- Fabrika e Sheqerit [Kombinati
 i sheqerit «8 Nëntori»], Maliq,
 (Korçë) — 399.
 Fabrika e Zhveshjes së Pam-
 bukut, Fier — 96.
 Fier — 336, 337.
 «Flamuri i kuq» (revista ~)
 — 369.

G

- Golan (Siri) — 60, 73.

GJ

- Gjermani — 184, 247, 270.
 Gjermania Perëndimore (RF e
 Gjermanisë) — 40, 73, 176, 178.
 Gjiri i Adenit — 74.
 Gjiri i Tonkinit — 194.
 Gjiri Persik — 40, 69.
 Gjirokastër — 238.

H

- Hanoi — 192.
 «Historia e Partisë së Punës të
 Shqipërisë» (teksti ~) — 241-
 -242.
 «Historia e Shqipërisë» (tek-
 sti ~) — 287, 289.
 Holandë — 14.
 Hong-Kong — 83.
 Hoteli i Madh [Hotel «Tira-
 na»], Tiranë — 338, 339.
 HSINHUA (Kina e Re) — 35,
 405.

I

- Instituti i Folklorit [Instituti i
 Kulturës Popullore], Tiranë
 — 290.
 Instituti i Kërkimeve Bujqë-
 sore, Lushnjë — 222, 224.
 Instituti i Studimeve Marksis-
 te-Leniniste pranë KQ të
 PPSH, Tiranë — 244.
 Irak — 40, 63, 67, 75.
 Iran — 40, 64, 75.
 Itali — 10, 14, 28, 30, 51-52.
 «Izvestia» (gazeta ~) — 193.

J

- Japoni — 59.
 Jemeni i Veriut — 65.
 Jenan (Kinë) — 131.

Jerusalem — 66.
 Jordani — 63, 72.
 Jordan (lumi ~) — 74.

K

Kajro — 67, 73.
 Kanali i Suezit — 65, 74.
 Kanton (Kinë) — 109, 120, 370.
 Kaspik (deti, zona ~) — 40.
 Kaukaz (Bashkimi Sovjetik) — 40.
 Kensi (Kinë) — 124.
 Koblenç (Gjermani) — 144, 292.
 Kombinati Metalurgjik [Kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë»], Elbasan — 179, 358, 359, 360.
 Komiteti Ekzekutiv i Internacionales Komuniste (KEIK) — 123, 124, 125.
 Konferenca kombëtare për problemet e ndërtimit socialist (Tiranë, 22—23 nëntor 1979) — 244, 245.
 Konferenca shkencore me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (Tiranë, 12—15 qershor 1978) — 240, 244.
 Kongresi i Dytë i Kominternit (19 korrik — 7 gusht 1920) — 116-117.
 Kongresi i popujve të Lindjes së Largme — 118.
 «Kontrata shoqërore» (libri

~, Zh. Zh. Ruso) — 19.
 Kooperativa Bujqësore e Labinotit, Elbasan — 358.
 Kooperativa Bujqësore e Mëzezit, Tiranë — 233.
 Korçë — 2, 5, 95, 337.
 Kore (RDP e Koresë) — 39.
 Kosovë — 168.
 Krujë — 193.
 Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë — 343.
 Kuvajt — 63.

L

Laos — 194.
 «L'esprit des lois» (libri ~, Sh. Monteskjë) — 17.
 «L'essai sur les mœurs» (libri ~, Volter) — 18.
 «Le Monde» (gazeta ~) — 161.
 Liban — 63, 67, 75-76.
 Libi — 63, 67, 68, 75, 76.
 Liceu i Korçës [Shkolla e mesme e përgjithshme «Raqi Qirinxhi»] — 1-5, 6-7.
 Lindja e Largme — 111, 196.
 Lufta e Kipurit (6 tetor 1973) — 65.
 Lufta e Spanjës (1936—1939) — 13-14.
 Lushan (Kinë) — 125.
 Lushnjë — 222, 313.

M

- Makao — 83.
 Mançuri (Kinë) — 143.
 Maqedoni — 29.
 Maqedonia e Egjeut (Greqi)
 — 29.
 Marok — 63, 72, 75.
 Mat — 238.
 Mauritani — 63, 72.
 Mbledhja e partive komuniste
 e punëtorë në Bukuresht (qer-
 shor 1960) — 170.
 Memaliaj (Tepelenë) — 223.
 Mesdhe (deti, zona ~) — 23,
 40, 68, 69, 71, 74.
 Miniera e Qymyrgurit e Vallasit,
 Tiranë — 227-228, 229, 402-
 -403.
 Mongolla e Brendshme (Kinë)
 — 371.
 Moskë — 125, 127, 171.
 Myzeqe (krahina ~) — 323.

N

- NATO (Organizata e Traktatit
 të Atlantikut Verior) — 28-
 -29, 62, 169.
 NEP-i (Politika e re ekonomike)
 — 35, 138-139.
 Nivcë (Tepelenë) — 289.

O

- Oqeani Indian — 74.

P

- Pakistan — 39.
 Pallati i Kulturës, Tiranë —
 178-179, 339.
 Paris — 275.
 Pekin — 171, 173, 192, 368,
 369, 370-371, 405.
 Pella (Greqi) — 253.
 Perandoria Persiane — 40.
 Pogradec — 218, 268.
 POLISARIO (fronti ~) — 72.
 Porti i Durrësit [Porti detar i
 Durrësit «Enver Hoxha»] —
 400.
 «Pravda» (gazeta ~) — 115.
 Prusi — 277.

R

- Revolucioni Demokratiko-Bor-
 gjez Anglez (shek. XVII) —
 247, 277-278, 280.
 Revolucioni Demokratiko-Bor-
 gjez Francez (1789—1794) —
 106-107, 121, 143-144, 147,
 150, 172, 247, 273-280, 281-
 -282.
 Revolucioni Demokratiko-Bor-
 gjez Gjerman (1818) — 247,
 279-280.
 Rusi — 277.

RR

- Rripi i Gazës — 74.

S

- Selanik (Greqi) — 29.
 Serbi — 167.
 Siberi (Bashkimi Sovjetik) —
 83, 154, 172.
 Sinai (gadishulli, shkretëtira
 ~, Egjipt) — 65, 66, 74.
 Sirl — 63, 64-65, 67, 68, 71, 73,
 74.
 Skuadra e futbollit «Labinoti»
 — 357, 358.
 Skuadra e futbollit «Skënder-
 beu» — 352.
 Somali — 41, 77.
 Spanjë — 8-15.
 Statuti i Kooperativave Buj-
 qësores — 320.

SH

- Shangai (Kinë) — 120, 124,
 367, 368, 369.
 Shën Elenë (ishulli ~) — 277.
 Shkodër — 95, 268.
 Shqipëria e Jugut — 52, 290.
 Shqipëria e Veriut — 290.

T

- Tajlandë — 39.
 Tajvan — 81, 83, 174, 413.
 «Tetëmbëdhjetë brymeri i
 Lui Bonapartit» (K. Marks,
 vepra ~) — 107.

- Tiranë — 95, 212, 223, 229, 238,
 357.
 Traktati i Varshavës — 62.
 «Traktat për edukimin e vaj-
 zave» (libri ~, Fenëlon) —
 17.
 Tregu i Përbashkët Evropian
 — 10, 55.
 Tripoli (Libi) — 66-67, 68.
 Tunizi — 63, 67.

U

- Uashington — 41, 73, 74, 77.
 Uhan (Kinë) — 124, 371.
 Universiteti i Pekinit — 33,
 367, 406.
 Universiteti i Stambollit —
 316.
 Universiteti i Tiranës [Univer-
 siteti i Tiranës «Enver Hoxha»]
 — 102, 267.
 Uzina e PVC [Uzina e Sodës
 dhe e PVC], Vlorë — 397-398.
 Uzina e Telave dhe e Kabllor-
 ve Elektrike, Shkodër — 398.
 Uzina Mekanike e Prgozi-
 nës. Durrës — 104, 267.
 Uzina mekanike «Traktori»
 [Kombinati i autotraktorëve
 «Enver Hoxha-], Tiranë —
 265, 383.

V

- Versajë (Francë) — 275.
 Vlorë — 219.

Z

Zaire — 177.
«Zëri i popullit» (gazeta ~)
— 228, 393.
Zvicër — 20.

ZII

«Zhenminzhibao» (gazeta ~)
— 32, 35, 405.
«Zhvillimi i socializmit nga
utopia në shkencë» (F. Engels,
vepra ~) — 279.

L E N D A

PARATHËNIE PËR VELLIMIN E 63-TË	V—IX
UNË RUAJ PËR SHKOLLËN TUAJ DHE TIMEN DASHURI E RESPEKT TË THELLË — Letër drej- tuar kolektivit të shkollës së mesme të përgjithshme «Raqi Qirinxhi» në Korçë (1 dhjetor 1977)	1—7
PËR GJENDJEN AKTUALE NË SPANJË — Shënime (2 dhjetor 1977)	8—15
EMANCIPIMI I GRUAS DHE SHKRIMTARËT SO- CIOLOGË E FILOZOFË TË SHEKUJVE TË KALUAR — Shënime (3 dhjetor 1977)	16—21
ÇDO TË BËHET NË JUGOSLLAVI PAS VDEKJES SË TITOS — Shënime (3 dhjetor 1977)	22—30
PANORAMË E ZYMTË KINEZE — Shënime (8 dhje- tor 1977)	31—47
MBËSHTETJA NË FORCAT TONA NUK ËSHITË AU- TARKI — Nga blseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (9 dhjetor 1977)	43—61
TRAGJEDIA E POPUJVE ARABË — Shënime (10 dhjetor 1977)	62—70

- ÇESHTJA E LINDJES SË MESME NË DRITËN E
NGJARJEVE TË FUNDIT — Shënime (17 dhjetor 1977) 71—78
- INKOHERENCA E POLITIKËS SË JASHTME TË KI-
NES — Shënime (13 dhjetor 1977) 79—92
- ÇDO GJË DUHET BËRË SA MË E STUDIUAR, ME
PERGJEGJËSI E NË BAZË TË DIREKTIVAVE TË
PARTISË — Nga biseda në takim in ditor të sekre-
tareve të KQ të PPSH (24 dhjetor 1977) 93—105
- A MUND TË QUHET REVOLUCIONI KINEZ NJË
REVOLUCION PROLETAR? — Shënime (26 dhje-
tor 1977) 106—154
- NE USHQËJMË NDJENJA TË SINGERTA PËR PO-
PULLIN FRANCEZ — Nga biseda me kryetarin e
Shoqatës së Miqësisë Francë-Shqipëri, profesor Pol
Miliezin (29 dhjetor 1977) 155—186
- JU JENI E ARDHMJA E LUMTUR E ATDHEUT —
Përshëndetja në mbrëmjen e organizuar me rastin e
Vilit të Ri (30 dhjetor 1977) 187—190
- PRAPA KONFLIKTIT KAMBOXHIA—VIETNAM
QËNDRON RIVALITETI I SUPERFUQIVE — Shë-
nime (1 janar 1978) 191—196
- TË NXITEN E TË INKURAJOHEN MË SHUMË
SHPIKJET DHE RACIONALIZIMET — Shënime (13
janar 1978) 197—202
- REVOLUCIONI TEKNIKO-SHKENCOR TË SHIKO-
HET NË GJERËSINË DHE NË THELLËSINË E TIJ
— Shënime (19 janar 1978) 203—209

- MË PAK BUJË E TEORIZIME DHE MË SHUMË PUNË PËR THELLIMIN E REVOLUCIONIT TEKNIKO-SHKENCOR — Shënime (20 janar 1978) 210—216
- ZHVILLIMI I REVOLUCIONIT TEKNIKO-SHKENCOR NDIKON NË REALIZIMIN E PLANEVE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH — (24 janar 1978) 217—230
- TË ARDHURAT E KOOPERATIVISTËVE VAREN NGA VETË PUNA E TYRE — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (26 janar 1978) 231—239
- PIKËPAMJET TONA JANË PIKËPAMJE SHKENCORE, TË BAZUARA NË MARKSIZËM-LENINIZMIN — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (26 janar 1978) 240—250
- PARTIA E PUNËS E SHQIPËRISË U FORMUA NË RRETHANA TË NDRYSHME NGA PARTI TË TJERA KOMUNISTE — Shënime (26 janar 1978) 251—256
- TË MBËSHTETEMI TËRËSISHT NË FORCAT TONA — Fjala e mbylljes në Plenumin e 4-t të KQ të PPSH (31 janar 1978) 257—272
- REVOLUCIONI NË KINË ËSHTË THJESHT DEMOKRATIKO-BORGJEZ — Shënime (2 shkurt 1978) 273—286
- TË SHKRUAJMË NJË HISTORI TË DENJË TË POPULLIT TONË — Shënime (6 shkurt 1978) 287—292
- DIREKTIVA ZBËRTHEHET DREJT JASHTË SKEMAVE E SHABLLONEVE TË ZAKONSHME — Nga

- biseda në takim in ditor të sekretarëve të KQ të PPSH
(8 shkurt 1978) 293—299
- NË USHTRI TË MOS KRIJOHET EUFORI — Disa
vërejtje për një film dokumentar të një stërvitjeje
ushtarake (13 shkurt 1978) 300—306
- PUNA E GJYKATAVE DHE E PROKURORIVE —
TREGUES I RËNDËSISHËM I ZHVILLIMIT TË LUF-
TËS SË KLASAVE — Diskutim në mbledhjen e Pre-
sidiumit të Kuvendit Popullor të RPSSH (24 shkurt
1978) 307—316
- FORCIMI EKONOMIK I KOOPERATIVAVE BUJ-
QËSORE KËRKON RRITJEN E PJESËMARRJES
NË PUNË — Shënime (24 shkurt 1978) 317—323
- PUNA E ORGANIZATAVE TË MASAVE TË JETË E
KOORDINUAR DHE NËN UDHËHEQJEN E PAR-
TISË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të
KQ të PPSH (25 shkurt 1978) 324—332
- JO VETËM TË MARRIM MASA POR EDHE TË
KONTROLLOJMË ZBATIMIN E TYRE — Nga dis-
kutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të
PPSH (25 shkurt 1978) 333—337
- MUZEU DUHET TË KETË TËRËSISHT KARAKTER
KOMBËTAR — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Po-
litike të KQ të PPSH (25 shkurt 1978) 338—341
- TË PËRMIRËSOHET MË TEJ BASHKËPUNIMI MI-
DIS ORGANIZATAVE TË MASAVE — Diskutim
në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27
shkurt 1978) 342—351

FIZKULTURA FORCON NJERIUN, VULLNETIN DHE REZISTENCËN E TIJ — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27 shkurt 1978)	352—364
KUSH ËSHTË TEN HSIAO PINI DHE GJASHTË FAZAT E REVOLUCIONIT KULTUROR — Shënime (28 shkurt 1978)	365—374
THELLIMI I REVOLUCIONIT TEKNIKO-SHKENCOR T'I SHËRBEJË MODERNIZIMIT TË TEKNOLOGJISË SË PRODHIMIT — Shënime (1 mars 1978)	375—385
REALITETI YNË NA NDIHMON TA KUPTOJMË E TA PËRVETËSOJMË MË THELLË TEORINË MARKSISTE—LENINISTE — Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë (6 mars 1978)	386—395
ZBATIMI I KOMPETENCAVE TË BËHET NË DOBI TË ZHVILLIMIT TË EKONOMISË — Shënime (11 mars 1978)	396—404
RRUGË SOCIALIMPERIALISTE E KINËS — Shënime (11 mars 1978)	405—415
Treguesi i lëndës	419
Treguesi i emrave	435
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera	441